

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave ekonomike

Viti XI

2017

Shkodër, 2017

REDAKSIA

Prof. dr. Elez Osmani (kryeredaktor)
Dr. Arjola Halluni (Dergjini) (sekretare shkencore)
Prof. dr. Arjeta Troshani, prof. as. dr. Brilanda Bushati,
prof. as. dr. Blerta Dragusha, prof.as.dr. Albana Begani,
prof. as. dr. Ardita Boriçi (anëtarë)

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Adem BEKTESHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter:

Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e shkencave ekonomike
Tel fax: 00355 22800651

PASQYRA E LËNDËS

Albana BORIÇI (BEGANI)

Inteligjenca emocionale si faktor ndikues në suksesin e menaxherëve
nga vendi amë - rishikim literature

*Emotional intelligence as a factor impacting expatriates' success-A
literature review.....5*

Amela MALAJ, Arjeta TROSHANI

Zhvillimi i turizmit të 'errët' – rasti i qarkut Shkodër

Development of 'dark' tourism – Case Study Shkodra Region.....25

Ardita BORIÇI, Jetmir MUJA

Roli i arsimit në zhvillimin ekonomik: rasti i Ballkanit Perëndimor

The role of education in the economic development: Western Balkan case39

Erion SHALA, Elidiana BASHI

Faktorët ndikues në cilësinë e informacionit kontabël

Factors influencing the quality of accounting information.....51

Emirjeta BEJLERI (MEMA), Albiona KOKA

Diskriminimi ndaj grave dhe punësimi informal

Discrimination against women and informal employment.....73

Agim BERISHA

Shpenzimet publike dhe deficitet buxhetor në Republikën e Kosovës

Public expenditures and budget deficit in the Republic of Kosovo.....91

Matilda TOSKA

Menaxhimi i integruar i mbetjeve në qytetin e Elbasanit

Integrated waste management in the city of Elbasan.....105

Romina RADONSHIQI

Tregu i punës i të rinjve në Shqipëri

Youth labor market in Albania.....121

Klodiana PERDJA

Tavanet përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin buxhetor 2018 – Bashkia Shkodër

The final upper limits of revenues and expenses for the budgeting year 2018- Shkodra Municipality.....131

Renato ÇARDAKU

Efektiviteti i auditimit të brendshëm publik “Një rast studimi në sektorin publik shqiptar”

The effectiveness of public internal audit “A case study of Albanian public sector”.....143

Emirjona GRUDA

Struktura optimale e kapitalit: evidencë nga qyteti i Shkodrës

Optimal Capital Structure: Evidence from Shkodra City.....161

Ilirjana GJERGJI

Portofoli model i ekonomisë shqiptare “Al Index-100”

Model portfolio of Albanian Economy “Al Index-100”.....17

INTELIGJENCA EMOCIONALE SI FAKTOR NDIKUES NË SUKSESIN E MENAXHERËVE NGA VENDI AMË¹ - RISHIKIM LITERATURE

Albana Boriçi (Begani)²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik,
Departamenti i Administrim-Biznesit*

Abstrakt

Me rritjen e konkurrencës globale dhe të paqëndrueshmërisë në ekonominë botërore, përzgjedhja e menaxherëve të duhur është bërë jetësore, si për kompanitë vendase ashtu edhe ato ndërkombëtare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kompanitë shumëkombëshe që vendosin të dërgojnë menaxherët nga kompania mëmë për të drejtuar filialet e tyre jashtë vendit. Kostoja e tyre është mjaft e lartë dhe rritet skajshëm kur ata dështojnë në ushtrimin e detyrës së ngarkuar. Prandaj, përcaktimit të

¹*Menaxherë nga vendi amë* – Menaxherë të dërguar nga qendra e një kompanie shumëkombëshe për të drejtuar filialet e saj në vendet e tjera (Harzing, 2001 a, b).

²Diplomuar në korrik të vitit 1999 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Në dhjetor të vitit 2002 fiton gradën Master në Administrim-Biznes (MBA) pranë Universitetit të Illinoisit të Jugut në SHBA. Në qershor, 2009 i jepet grada Doktor i Shkencave Ekonomike nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, ndërsa në korrik, 2015, po ky institucion i akordon titullin Profesor i Asociuar. Ka marrë pjesë dhe ka përfunduar me sukses shumë kualifikime dhe punë kërkimore të zhvilluara në institucione të ndryshme universitare, të tilla si: Universiteti i Bolonjës, Chietit e Rimitit në Itali, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Eberswalde-s në Gjermani, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Braunschweig/Wolfenbuttel-it në Gjermani, Universiteti i Gracit dhe Vjenës në Austri, Universiteti Politeknik i Portos, Portugali etj. Ka punuar si lektore pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës që nga viti 1999, si dhe është ftuar për të dhënë leksione pranë Univeritetit të Vjenës, Austri, atij të Podgoricës, Mal i Zi dhe atij të Krakovit, Poloni. Aktiviteti i saj akademik është i gjerë, me pjesëmarrje në konferenca, aktivitete dhe publikime shkencore kombëtare e ndërkombëtare, të lidhura me problemet ekonomike, e në mënyrë të veçantë me sfidat e menaxhimit të biznesit ndërkombëtar.

faktorëve që stimulojnë suksesin e tyre dhe reduktojnë shanset e dështimit, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë.

Dy dekadat e fundit, një numër i konsiderueshëm studiuesish po theksojnë rolin e inteligjencës emocionale në rritjen e mundësive për sukses të menaxherëve në përgjithësi dhe atyre nga vendi amë në veçanti. Sipas tyre, ajo duhet konsideruar patjetër si një ndër kriteret për përzgjedhjen e menaxherëve, krahas kritereve tradicionale teknike dhe atyre të përshtatjes në rastin e menaxherëve nga vendi amë.

Meqenëse, mbështetur në dijeninë e autores, trajtimi i kësaj çështjeje në literaturën shqiptare është një risi, synimi i këtij punimi është pikërisht të hedhë dritë mbi konceptin e inteligjencës emocionale dhe rolin që luan ajo tek performanca e menaxherëve. Argumente dhe rezultate të punës kërkimore të mjaft autorëve prezantohen në këtë punim për të pasqyruar impaktin e saj në suksesin e menaxherëve, e veçanërisht në atë të menaxherëve nga vendi amë. Qëllimi është që në këtë mënyrë të tërhiqet vëmendja si e studiuesve shqiptarë ashtu edhe e kompanive vendase e të huaja në Shqipëri në lidhje me këtë çështje.

Fjalët kryesore (kyçe): Inteligjencë emocionale, menaxherë nga vendi amë, efektivitet menaxherial, aftësi për t'u përshtatur, kompani shumëkombëshe.

Emotional intelligence as a factor impacting expatriates' success-A literature review

Abstract

With the increase of the global competition and that of the instability in the world economy, the selection of the right managers has become vital, for both domestic and international companies. This is particularly important for multinational companies which decide to send out expatriates to run their affiliates overseas. Expatriates' cost is high and increases tremendously when they fail to do their job. Therefore, specific attention should be devoted to the determination of the factors stipulating their success and reducing their chances to fail.

In the last two decades, a considerable number of authors have been emphasizing the role of emotional intelligence in the increase of success chances for managers in general and for expatriates in particular. According to them, emotional intelligence must absolutely be considered as one of the

criteria to be used for the selection of managers, together with the technical and adjustment criteria in the case of expatriates.

Since, based on the author's knowledge, this particular issue seems to be new in the Albanian literature, the aim of this paper is to actually present the concept of emotional intelligence and its role on managers' performance. Arguments and results of the research work of many authors are presented in this paper in order to evidence the impact of emotional intelligence on managers' success, especially on expatriates' success. The goal is so to attract the attention of Albanian researchers as well as domestic and foreign companies in Albania on this issue.

Key words: Emotional intelligence, expatriates, managerial effectiveness, adjustment ability, multinational.

Hyrje

Nevoja për të qenë sa më konkurruese në tregjet vendase dhe ato ndërkombëtare i shtyn kompanitë të jenë të kujdesshme në marrjen e çdo vendimi biznesi, e në mënyrë të veçantë të atyre që lidhen me burimet njerëzore. Këto të fundit, përfaqësojnë burimin më të rëndësishëm të një kompanie, pasi janë pikërisht punonjësit ata që vënë në lëvizje dhe shfrytëzim të gjitha burimet e tjera të kompanisë, në shërbim të objektivave të saj (Boriçi (Begani), 2009). Në këtë kontekst, me përmasat globale që ka marrë sot biznesi, menaxhimi strategjik ndërkombëtar i burimeve njerëzore merr një rëndësi akoma më të veçantë (Boriçi (Begani) & Uruçi, 2008). Të paturit e individëve të duhur, në vendin dhe kohën e duhur, e sidomos e menaxherëve të duhur që drejtojnë filialet e kompanive shumëkombëshe në tregjet ndërkombëtare, përbën sot një çështje mjaft kritike për këto kompani (Bhatti, 2014).

Sipas Bhatti et al. (2014), të cilët citojnë Cao et al. (2012), kjo nevojë është zgjeruar akoma më shumë mbas krizës së fundit të ekonomisë botërore, në vitet 2007-2009, e cila çoi në shtimin e paqëndrueshmërisë dhe paparashikueshmërisë së mjaft ekonomive në botë. Në kushtet e kësaj pasigurie në rritje, nevoja e kompanive shumëkombëshe për të ushtruar kontroll ndaj filialeve të tyre jashtë vendit është shtuar ndjeshëm. Dërgimi i menaxherëve nga vendi amë është cilësuar nga shumë kërkues si një ndër mënyrat më të mira për ta realizuar një qëllim të tillë (Boriçi (Begani), 2009). Por ky transferim i menaxherëve nga kompania mëmë për në filiale shoqërohet me një kosto shumë të lartë, sidomos në rastet kur këta menaxherë dështojnë (Puck et. al., 2008; Cullen & Parboteeah, 2010; Boriçi & Çelepaja, 2014; Wild & Wild, 2016; Eroglu & Rahman, 2017)

duke u rikthyer në atdhe para përfundimit të detyrës, duke mos e kryer atë si duhet apo duke u larguar nga kompania menjëherë pas përfundimit të shërbimit jashtë vendit (Boriçi & Çelepija, 2014). Pikërisht, për të parandaluar situatat e dështimit është i domosdoshëm identifikimi i faktorëve që e shkaktojnë atë, si dhe, i cilësive që duhet të zotërojnë menaxherët nga vendi amë për të qenë të suksesshëm në përmbushjen e misionit të tyre. Nga ky këndvështrim, procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes i duhet kushtuar vëmendje e veçantë (Cullen & Parboteeah, 2010). Sipas Sulaiman et al. (2014) që i referohen Mendenhall et al. (2006), ka mënyra të ndryshme sesi mund të rriten shanset e menaxherëve nga vendi amë për sukses. Së pari, këta menaxherë duhet të zotërojnë aftësitë dhe njohuritë teknike për të realizuar detyrën që u është ngarkuar (Avril & Magnini, 2007; Cullen & Parboteeah, 2010, Czinkota et al., 2010; Sulaiman et al., 2014), por paralelisht me to duhet të gëzojnë edhe aftësinë për t'u përshtatur me kulturën, mjedisin dhe eksperiencat e reja në vendin pritës. Ndërkaq, dekadat e fundit, autorë të shumtë, profesionistë biznesi dhe psikologë të ndryshëm, po i kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje temës së *inteligjencës emocionale* (Rahman et al., 2016), si një cilësi e individit që ndikon pozitivisht në performancën e çdo menaxheri e në mënyrë të veçantë në atë të menaxherëve të dërguar me detyra jashtë vendit. Pikërisht për këtë arsye, nëpërmjet këtij punimi synohet të hidhet dritë mbi konceptin e inteligjencës emocionale dhe elementeve që e përbëjnë atë, si dhe mbi rolin që luan ajo në realizimin me sukses të funksioneve menaxheriale, duke e përqendruar vëmendjen tek rasti i menaxherëve nga vendi amë.

Përcaktimi i inteligjencës emocionale dhe elementeve që e përbëjnë atë

Megjithëse aspektet e inteligjencës së një individi, që shkojnë përtej aftësive për të mbajtur mend dhe zgjidhur problemet (Nel et al., 2015), janë diskutuar që në vitet 40' të shekullit të kaluar, ndër të parët që prezantuan dhe përcaktuan konceptin e *inteligjencës emocionale* ishin psikologët Peter Salovey dhe John Mayer në vitin 1990 (Musten et al., 2003). Sipas tyre *inteligjenca emocionale* nënkupton aftësinë e individit për të monitoruar emocionet e veta e të tjerëve, për t'i diferencuar ato, si dhe aftësinë për ta përdorur këtë njohuri si udhërrëfyes të të menduarit dhe vepruarit të tij (Tucker et al., 2014; Tekin & Gündoğan, 2017). E thënë me fjalë të tjera ajo përfaqëson aftësinë e individit për të menaxhuar emocionet e veta e të tjerëve në shërbim të zgjidhjes së problemeve dhe marrjes së vendimeve të duhura (Nel et al., 2015). Nisur nga ky përcaktim dhe duke iu referuar Tan

et al., (2005), Avril & Magnini (2007), theksojnë se inteligjenca emocionale në një këndvështrim të gjerë mund të shihet e përbërë nga:

- ✓ Aftësia për të vlerësuar dhe manifestuar emocionet,
- ✓ Aftësia për të rregulluar emocionet e vetes dhe të të tjerëve,
- ✓ Aftësia për të kanalizuar emocionet drejt rritjes intelektuale dhe emocionale, si dhe
- ✓ Aftësia për të gjeneruar emocione që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve.

Kontributi tjetër i padiskutueshëm në zhvillimin e mëtejshëm të konceptit teorik të inteligjencës emocionale është ai i Daniel Goleman (1995), me librin e tij të famshëm “Inteligjenca Emocionale-Pse ajo është shumë më e rëndësishme se IQ-ja (koeficienti i inteligjencës)” dhe artikullin po aq të njohur të publikuar në vitin 1998 në Harvard Business Review “Çfarë e bën një lider?” (Munsten et al, 2003; Rahman et al., 2016; Tekin & Gündoğan, 2017). Goleman (1995, 1998) u mbështet në modelin e inteligjencës emocionale të Salovey dhe Mayer (1990), duke e përshtatur dhe lidhur atë me performancën në punë (Munsten et al., 2003), e veçanërisht me performancën e liderëve (Goleman, 1998). Sipas tij, inteligjenca emocionale përbëhet nga 5 komponentë të cilët janë: 1) vetëdija vetjake, 2) vetërregullimi, 3) vetëmotivimi, 4) empatia (ndjeshmëria) dhe 5) aftësitë shoqërore. Kushdo që gëzon një nivel të lartë të secilit prej komponentëve të sipërpërmendur mund të thuhet që zotëron inteligjencë të lartë emocionale.

Vetëdija vetjake nënkupton që individit njeh shumë mirë emocionet e veta, pikat e forta e të dobëta të tija, si dhe nevojat e stimujt që e shtyjnë përpara. Njerëz që zotërojnë një nivel të lartë të vetëdijes vetjake janë të zotë të kuptojnë sesi ndjenjat e tyre ndikojnë tek ata vetë, te të tjerët dhe tek performanca në punë (Goleman, 1998).

Vetërregullimi përfaqëson komponentin e dytë të inteligjencës emocionale, që nënkupton aftësinë e individit për të menaxhuar gjendjet e impulset e tij brenda vetes, si dhe atë për të menaxhuar burimet e veta (Goleman, 1995 cituar nga Munsten et al., 2003). Ai i përngjet një bisede të vazhdueshme të individëve me vetveten, ku këta të fundit humorin dhe impulset emocionale negative i ndjejnë njëlloj si të gjithë të tjerët, por në ndryshim prej tyre janë më të zotë për t'i kontrolluar e madje për t'i përdorur ato në mënyrë të dobishme (Goleman, 1998).

Motivimi (ose vetëmotivimi) përbën kompetencën e tretë që duhet të zotërojë një individ për t'u konsideruar emocionalisht inteligjent. Ai përfaqëson kontrollin e tendencave emocionale të cilat çojnë ose lehtësojnë

arritjen e qëllimeve (Goleman, 1995 cituar nga Munsten et al., 2003). Individët që zotërojnë këtë kompetencë nuk motivohen nga një pagë apo një status më i lartë si shumica e njerëzve, përkundrazi ata i motivon pasioni për punën dhe tendenca për të arritur rezultate sa më të larta, përtej pritshmërive të tyre dhe të të tjerëve. Për më tepër ata i karakterizon optimizmi dhe përkushtimi ndaj organizatës, madje edhe në situata të vështira (Goleman, 1998).

Empatia (ose ndjeshmëria) nga ana tjetër, nënkupton të qenit i vetëdijshëm për ndjenjat, nevojat dhe shqetësimet e të tjerëve (Goleman, 1995 cituar nga Munsten et al., 2003) dhe aftësinë për t'i trajtuar njerëzit bazuar në reagimet e tyre emocionale (Goleman, 1998). E parë nga këndvështrimi i një lideri kjo do të thotë të marrësh në konsideratë ndjenjat e njerëzve krahas faktorëve të tjerë teksa merr vendime inteligjente (Goleman, 1998).

Së fundi, po jo për nga rëndësia, renditet komponenti i pestë i inteligjencës emocionale, *aftësitë shoqërore*. Njerëzit që e zotërojnë këtë kompetencë kanë shumë njohje, përpiqen të gjejnë pika e interesa të përbashkëta me të tjerët dhe besojnë në bindjen se gjërat nuk mund të bëhen vetëm. Për këtë ata ndërtojnë marrëdhënie të mira me të tjerët, gjë që më pas i ndihmon të udhëheqin të tjerët në drejtimin e dëshiruar (Goleman, 1998). Duhet theksuar gjithashtu, se katër komponentët e përmendur më lart të inteligjencës emocionale, ndikojnë pozitivisht në zgjerimin e aftësive sociale të një individi. Secili prej nesh, që arrin të kuptojë dhe kontrollojë emocionet e veta e të të tjerëve, që është i ndjeshëm ndaj tyre dhe njëkohësisht është i vetëmotivuar, ka shanse më të mëdha për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie të mira me të tjerët (Goleman, 1998).

Literatura e gjerë kushtuar inteligjencës emocionale (Pekaar et al, 2017) ka çuar në zhvillimin e teorive, konstrukteve dhe matësave të ndryshëm të saj, duke zgjeruar njëkohësisht kritikizmin mbi mënyrën sesi ajo duhet përcaktuar dhe matur (Shipper et al., 2003; Gabel et al, 2005; Nel et al., 2015; Pekaar et al, 2017). Modele të ndryshme të inteligjencës emocionale janë zhvilluar ndër vite, por dy janë modelet teorike bazë që kanë dalë në pah, ai i “aftësive” dhe “modeli i përzier” (Nel et al., 2015; Tekin & Gündoğan, 2017). Modeli i parë, i cili kombinon emocionin dhe inteligjencën, mbështetet në përkufizimin origjinal të dhënë nga Salovey & Mayer (1990) dhe e konceptualizon inteligjencën emocionale në të njëjtën mënyrë siç konceptualizohet inteligjenca njohëse (e matur nga IQ apo koeficienti i inteligjencës) (Baczynska & Thorton, 2017). Ndërkaq, modeli i dytë kombinon tiparet e individit me sjelljet dhe kompetencat e tij

shoqërore (Nel et al. 2015) dhe mbrohet e mbështetet më tepër në punimet e Goleman (1995, 1998) dhe Bar-On (1997).

Debati ndërmjet autorëve të ndryshëm këto dhjetë vitet e fundit ka qenë pikërisht ai mbi përshtatshërinë dhe efikasitetin e këtyre dy modeleve (Nel et al. 2015). Mbrojtësit e modelit të aftësive argutojnë se, modelet dhe matësat e tyre, janë të provuar shkëncërisht dhe të pavarur nga ana psikometrike nga matësa të tjerë të personalitetit. Ndërsa, mbrojtësit e modelit të përzier thonë që qasja e tyre është e lidhur më fort me rezultatet në organizatë, zhvillimin e saj dhe lidhësin. Po kështu i fortë është debati edhe mbi mënyrën e matjes së inteligjencës emocionale (Shipper et al, 2003; Nel et al. 2015; Pekaar et al., 2017). A duhet matur ajo nëpërmjet një testi aftësish (i ngjashëm me atë që mat inteligjencën njohëse, modeli i aftësive) apo nëpërmjet një instrumenti vetëraportues (i ngjashëm me instrumentet e përdorura për matjen e personalitetit, modeli miksi) (Pekaar, 2017)? Lidhur me këtë, autorë të ndryshëm argumentojnë se matësat e bazuar në aftësi, janë të vlefshëm nga ana teorike, por janë më pak të aftë të parashikojnë rolin e inteligjencës emocionale tek performanca në punë. Në të njëjtën kohë, matësat e bazuar në modelin miksi e parashikojnë mirë marrëdhënien e sapopërmendur, por janë të diksutueshëm për nga vlefshmëria e tyre teorike (Nel et al., 2015).

Sipas Rahman et al, (2016, pg. 239), pavarësisht debateve të sipërpërmendura, një seri e gjerë modelesh janë ndërtuar për matjen e inteligjencës emocionale, si: TMMS (Salovey et al., 1995), EQ-i (Bar-On, 1997), ECI (Boyatzis et al., 1999), EIQ (Dulewicz & Higgs, 2000), SUEIT (Palmer & Stough, 2001), MSCEIT (Mayer et al., 2002), EQI (Rahim et al., 2002), WEIP (Jordan et al., 2002), apo AES (Schutte et al., 2009).

Gjithashtu, edhe pse sipas Victor & Higgs (2000), të cituar nga Tekin & Gündoğan (2017), pjesa më e madhe e punës kërkimore mbi inteligjencën emocionale i përket fushës së edukimit dhe asaj të psikologjisë, të shumtë janë punimet që theksojnë rolin e saj në efektivitetin dhe suksesin e liderëve dhe menaxherëve të biznesit (Goleman, 1998; Chawla et al., 2013; Rahman et al., 2016; Tekin & Gündoğan, 2017; Baczynska & Thorton, 2017). Për këtë arsye, seksioni në vazhdim do të paraqesë argumentet e disa punimeve dhe autorëve që mbështesin rolin e inteligjencës emocionale në performancën dhe suksesin e menaxherëve.

Roli i inteligjencës emocionale në performancën e një menaxheri

Inteligjenca emocionale është përmendur gjerësisht nga autorë të ndryshëm gjatë këtyre dy dekadave të fundit, si një ndër faktorët kryesorë

që ndikojnë në performancën e lartë në punë. Studiues të ndryshëm kanë zbuluar që individët me nivel të lartë të inteligjencës emocionale janë më të suksesshëm në karrierë, e ndjejnë më pak pasigurinë në punë, janë liderë më të mirë, përshtaten më mirë në situata stresuese, janë shitës më të mirë dhe kanë strategji më të mira për të përballuar situatat e ndryshme (Chahar & Rana, 2014). Po kështu, Rahman et al. (2016), duke iu referuar Goleman (1998), theksojnë që 80% suksesit në punë është rezultat i inteligjencës emocionale, në një kohë që vetëm 20% e tij është rrjedhojë e koeficientit të inteligjencës. Ndërkaq, nëse ky i fundit është relativisht i pandryshueshëm, inteligjenca emocionale është diçka që mund të mësohet, përmirësohet dhe maturohet me kalimin e kohës. Për më tepër, sipas Trivellas & Reklitis (2014), cituar po nga Rahman et al. (2016), me rritjen e nivelit të inteligjencës emocionale menaxherët shndërrohen në lidera (Rahman et al., 2016). Më poshtë janë prezantuar rezultatet e disa studimeve të fundit të kryera nga kërkues të ndryshëm nga vende të ndryshme mbi ndikimin që ka inteligjenca emocionale në performancën e menaxherëve.

Chawla et al., (2013) testuan marrëdhënien ndërmjet inteligjencës emocionale dhe performancës së menaxherëve të nivelit të parë në zinxhirët e dyqaneve të shitjes me pakicë në Nju Delhi. Nga kërkimi i tyre rezultoi një marrëdhënie e fortë pozitive mes këtyre dy variablave. Menaxherët me nivel më të lartë të inteligjencës emocionale shfaqën një nivel më të lartë performance. Ata mund të menaxhonin më mirë emocionet e tyre, pyetjet e klientëve dhe marrëdhëniet me kolegët, gjë që i ndihmonte të kishin një performancë më të lartë.

Një punim tjetër kushtuar lidhjes që ekziston ndërmjet inteligjencës emocionale dhe efektivitetit menaxherial është edhe ai i ofruar nga Chahar & Rana (2014), zhvilluar sërish në kontekstin e mjedisit të biznesit indian. Këta autorë morën në studim 155 menaxherë kompanish që operonin në sektorin e shërbimit dhe atë të prodhimit. Për matjen e inteligjencës emocionale ata përdorën shkallën e hartuar nga Hyde, Pethe & Dhar (2001), kurse për matjen e efektivitetit menaxherial përdorën shkallën e propozuar nga Gupta (1996). Rezultatet treguan që ekziston një lidhje domethënëse pozitive ndërmjet inteligjencës emocionale dhe efektivitetit menaxherial, megjithëse kjo lidhje rezultoi relativisht e fortë (me një koeficient korrelacioni, $r = 0.510$). Madje, një lidhje domethënëse pozitive rezultoi gjithashtu ndërmjet secilit prej komponentëve të inteligjencës emocionale (të propozuar nga Hyde, Pethe & Dhar, 2001), dhe efektivitetit të menaxherëve. Ndër to, kjo lidhje ishte më e fortë në rastin e vetëdijes vetjake, menaxhimit të marrëdhënieve, sjelljes alturiste dhe vetëmotivimit. Kjo do të thotë që individë të cilët njohin dhe vlerësojnë si duhet emocionet

e tyre, që dinë të vendosin e mbajnë marrëdhënie të mira me të tjerët e i mbështesin ata, si dhe janë të motivuar, janë më të priur për ta kryer si duhet detyrën e tyre si menaxherë.

Në artikullin e tyre “Roli i inteligjencës emocionale tek efektiviteti i menaxherëve; Një studim empirik”, Rahman et al. (2016) morën në shqyrtim marrëdhënien ndërmjet inteligjencës emocionale dhe tri roleve që duhet të përmbushë një menaxher për të qenë efektiv, përkatësisht, rolit ndërpersonal, atij informues dhe rolit vendimmarrës. Mbështetur në argumentet e autorëve të ndryshëm (Minstzberg, 1973; McCall & Segriszt, 1978; Tsui, 1984), Rahman et al. (2016) e shohin rolin ndërpersonal të menaxherit si detyrën e tij për të vendosur, mbajtur, menaxhuar e udhëhequr marrëdhëniet me të tjerët. Roli informues nga ana tjetër vlerësohet si detyra e menaxherit për të monitoruar mjedisin e jashtëm, por edhe detyra e tij për të prezantuar kompaninë apo njësinë që drejton para këtij mjedisi. Ndërsa roli vendimmarrës nënkupton detyrën e menaxherit për të planifikuar dhe zbatuar ndryshimet, për të zgjidhur problemet dhe siguruar burimet në organizatë. Mostra e marrë në studim ishin studentët e Masterit në degën Administrim-Biznes që studionin në një universitet publik të Bangladeshit, të cilët punonin me kohë të plotë. Ata iu nënshtruan një pyetësori nëpërmjet të cilit ata vetë raportonin nivelin e tyre të inteligjencës emocionale dhe efektivitetit si menaxherë, bazuar në një shkallë të Likertit. Për të matur inteligjencën emocionale u përdor Indeksi i Koeficientit Emocional (Emotional Quotient Index) nga Rahim et al., (2002), ndërsa për të matur efektivitetin menaxherial u përdor modeli i përshtatur i Tsui-t (1984) (Rahman et al., 2016). Rezultatet e kërkimit treguan një lidhje relativisht të fortë pozitive ndërmjet inteligjencës emocionale dhe të tri roleve që përcaktojnë efektivitetin menaxherial. Pra menaxherët që zotërojnë një nivel më të lartë inteligjence emocionale janë në gjendje që, së pari të ndërtojnë marrëdhënie më të mira me të tjerët dhe të stimulojnë punën në grup. Së dyti, ata janë më të zotë për të vlerësuar mjedisin e jashtëm të kompanisë e nevojat e saj, si dhe për të siguruar burimet që i nevojiten asaj për të vazhduar aktivitetin. Gjithashtu, menaxherët me inteligjencë të lartë emocionale janë më të zotë edhe të marrin vendime më inteligjente, pavarësisht nga situata me të cilën përballen.

Baczynska & Thorton (2017) analizuan marrëdhënien ndërmjet tri formave të inteligjencës, përkatësisht, asaj analitike, praktike dhe emocionale dhe pesë dimensioneve të sjelljes menaxheriale, përkatësisht, lidërshiptit, iniciativës, orientimit ndaj objektivave, orientimit ndaj ndryshimit dhe zhvillimit të punonjësve. Një literaturë e gjerë u mor në

shqyrtim prej tyre për të përcaktuar dimensionet e sjelljes menaxheriale dhe rolin që luajnë aftësitë dhe karakteristikat individuale në performancën e suksesshme të menaxherëve. Ata zhvilluan 23 sesione ditore testesh dhe simulimesh me rreth 163 menaxherë në Poloni. Nga këto sesione rezultoi që ekzistonte një lidhje më e fortë dhe më e shpeshtë mes inteligjencës analitike dhe të gjithë dimensioneve të sjelljes menaxheriale të përmendur më lart, duke mbështetur kështu konkluzionet e shumë studimeve të mëparshme që i atribuojnë inteligjencës analitike kontributin kryesor në zhvillimin e kompetencave më të rëndësishme të një individi. Inteligjenca praktike rezultoi gjithashtu e vlefshme në zhvillimin e kompetencave menaxheriale. Ajo rezultoi të kishte një lidhje të moderuar me katër nga pesë dimensionet e sjelljes menaxheriale dhe gjatë analizës së regresionit rezultoi të kishte ndikim veçanërisht në variancën e tre prej këtyre të fundit, përkatësisht të lidërsipit, orientimit ndaj objektivave dhe zhvillimit të punonjësve.

Ndërkohë, inteligjenca emocionale nuk rezultoi të kishte marrëdhënie domethënëse me dimensionet e performancës menaxheriale të përmendur më lart. Autorët e argumentojnë këtë përfundim duke u mbështetur në dy fakte, së pari në mënyrën e përdorur për matjen e performancës menaxheriale dhe së dyti në kategorinë e menaxherëve të marrë në studim. Sipas tyre, natyra e simulimeve të përdorur për matjen e performancës menaxheriale gjatë këtij studimi ndikoi ndjeshëm në tipin e inteligjencës së përdorur nga menaxherët. Gjatë këtyre simulimeve menaxherëve iu kërkua që të analizonin në thellësi, brenda një intervali kohor prej 30-60 minutash, panoramën e gjerë të tregut apo mjedisit të jashtëm të biznesit të simuluar nga kërkuesit, dhe më pas, të përfshiheshin në diskutimet në grup e të futeshin në rolin e tyre të menaxherit të përgjithshëm. Sipas Baczyńska & Thorton (2017), për ta bërë këtë sa më mirë atyre u duhej të shfrytëzonin më tepër aftësitë e veta analitike dhe praktike sesa ato të menaxhimit të emocioneve. Si rrjedhojë, vetë natyra e simulimeve të përdorura, kufizoi mundësinë e kërkuesve për të nxjerrë në pah aspekte të inteligjencës emocionale të zotëruara nga menaxherët e marrë si mostër studimi. Për më tepër, këta menaxherë i përkisnin nivelit më të lartë të drejtimit. Si të tillë, vetë roli që ata përmbushin në organizatë, duke u marrë më shumë me vizionin dhe strategjitë për zhvillimin e saj, me ndërtimin e stukturave etj., e duke patur më pak kontakt direkt me punonjësit, bën që ata të përdorin dhe të zhvillojnë më tepër inteligjencën e tyre analitike sesa format e tjera të saj.

Një argumentim të ngjashëm e gjejmë edhe tek Côté (2017), i cili thekson që inteligjenca emocionale ka ndikim më të pakët në performancën

e atyre punëve që nuk kërkojnë përfshirje emocionale apo nuk kanë karakter të mirëfilltë menaxherial, por janë më komplekse teknikisht. Ndërkaq, efekti i saj tek performanca është mjaft i ndjeshëm në ato punë ku punonjësit i kërkojnë vazhdimisht të rregullojnë emocionet në marrëdhëniet me bashkëpunëtorët, eprorët dhe klientët.

Roli i inteligjencës emocionale, në performancën e atyre punëve që kërkojnë menaxhim të marrëdhënive me klientët, përmendet dhe provohet edhe nga Tekin & Gündoğan (2017). Ata e shqyrtuan këtë lidhje në rastin e punonjësve të 29 hoteleve më të mira (me 5 vje) në Alanja të Turqisë. Sipas Tekin & Gündoğan (2017), klientët në një hotel e vlerësojnë cilësinë e shërbimit të ofruar aty duke u nisur nga mënyra se si ai shpërndahehet nga personeli i kontaktit (punonjësit që kanë kontakt direkt me klientin) e veçanërisht nga mënyra se si ky i fundit i trajton dhe ndërton marrëdhënien me ta. Nëse klientët mbeten të kënaqur nga komunikimi me personelin e kontaktit shanset që ata ta vlerësojnë pozitivisht shërbimin në hotel janë më të larta. Duke u nisur nga ky argumentim dy autorët e sipërpërmendur ndërtuan hipotezat e punimit mbi marrëdhënien mes inteligjencës emocionale dhe performancës së punonjësve dhe arritën në përfundimin që kjo lidhje është statistikisht domethënëse. Një zbulim interesant i këtij studimi ishte edhe fakti që niveli i inteligjencës emocionale dhe i performancës në punë ndryshonte me ndryshimin e karakteristikave demografike të punonjësve.

Megjithëse dy studimet e përmendura në fund (Côté, 2017; Tekin & Gündoğan, 2017) e vlerësojnë rolin e inteligjencës emocionale në performancën në punë në përgjithësi, dhe jo në performancën e menaxherëve në veçanti, pasqyrimi i tyre në këtë artikull bëhet me qëllim që të evidentohet rëndësia e padiskutueshme e inteligjencës emocionale në situatat ku kontakti mes njerëzve në organizatë është i shpeshtë.

Roli i inteligjencës emocionale në suksesin e menaxherëve nga vendi amë

Në hyrje të këtij punimi u përmend që, për të rritur mundësitë për sukses të menaxherëve nga vendi amë është e rëndësishme që ata të zotërojnë në radhë të parë afësitë e duhura teknike dhe njëkohësisht të jenë të zotë për t'u përshtatur me mjedisin e ri në vendin pritës. Aftësia për t'u përshtatur ndikon pozitivisht në marrëdhëniet e vendosura mes këtyre menaxherëve dhe punonjësve në vendet pritëse (Lee et al., 2013; Nunes et al., 2017), sikurse edhe në shkallën e vështirësisë me të cilën ata përballen në punë, duke influencuar kështu në performancën e tyre. Nga ana tjetër,

inteligjenca emocionale është vlerësuar nga mjaft autorë si një faktor që ndikon në aftësinë e menaxherëve nga vendi amë për t'u përshtatur (Lin et al., 2012; Lee et al., 2013; Sulaiman et al. 2014 etj.). Sipas Lee et al., (2013) që i referohen Ashkanasy & Daus (2005) dhe Mol et al. (2005), inteligjenca emocionale nënkupton aftësinë për të perceptuar, përshtatur dhe përjetuar në mënyrë të drejtë emocionet në një mjedis të ri kulturor. Menaxherët nga vendi amë, me një nivel të lartë të inteligjencës emocionale, janë të aftë për të kuptuar dhe menaxhuar emocionet e veta e të të tjerëve, për të ndërtuar marrëdhënie të mira ndërpersonale e për rrjedhojë, janë më të zotë për t'u përshtatur me ndryshimet kulturore mes vendeve, duke rezultuar kështu në një performancë më të lartë (Lee et al., 2013). Qëllimi i këtij seksioni është pikërisht të prezantojë argumentet e rezultatet e punës kërkimore të studiuesve të ndryshëm mbi rolin e inteligjencës emocionale në aftësinë për t'u përshtatur, si dhe në performancën e suksesin e menaxherëve nga vendi amë.

Gabel et al. (2005) ishin ndër të parët që vlerësuan konkretisht këtë marrëdhënie. Mbështetur në argumentet e autorëve të ndryshëm ata ngritën tri hipoteza kryesore dhe ndërtuan një model konceptual për të testuar rolin e inteligjencës emocionale si tek aftësia për t'u përshtatur ashtu edhe tek sukcesi i menaxherëve nga vendi amë. Mostra e marrë në studim përbëhej nga menaxherë të kompanive shumëkombëshe që operonin në Amerikën Latine. Për të matur inteligjencën emocionale autorët përdorën modelin e Bar-On (1997), që përfshin 133 elemente të kategorizuara në 5 grupe faktorësh: 1) aftësitë intrapersonale, 2) ato ndërpersonale, 3) përshtatshmërinë, 4) menaxhimin e stresit dhe 5) gjendjen e përgjithshme të mendjes. Ndërkaq, përshtatja me vendin pritës u mat sipas modelit të Black & Stephens (1989) e përbërë nga 14 elemente të strukturuar në tri kategori, përkatësisht: 1) përshtatja e përgjithshme, 2) përshtatja me njerëzit nga vendi pritës dhe 3) përshtatja me vendin e punës. Nga ana tjetër sukcesi i menaxherëve të transferuar u mat mbi bazën e tri dimensioneve, konkretisht: a) prirjes për të lënë detyrën para kohe (sipas shkallës së Caliguri, 2000), 2) kënaqësisë (sipas shkallës së Deiner & Lucas, 2000), dhe 3) performancës në punë (sipas shkallës së Caliguri & Day, 2000).

Nëpërmjet hipotezave të ngritura Gabel et al. (2005) synuan të testonin impaktin e inteligjencës emocionale tek sukcesi i menaxherëve nga vendi amë si në mënyrë direkte ashtu edhe indirekte, duke parë fillimisht ndikimin e saj tek aftësia për t'u përshtatur dhe më pas ndikimin e kësaj të fundit tek sukcesi. Gjithashtu, ata përfshinë në model edhe masën e ndryshimit kulturor mes vendit amë dhe atij pritës, (të matur sipas

Hofstede, 1993 dhe Spector et al., 2001), për të vlerësuar ndikimin e saj tek marrëdhënia mes inteligjencës emocionale dhe aftësisë për t'u përshtatur.

Gjetjet kërkimore nxorën në pah një marrëdhënie domethënëse pozitive ndërmjet aftësive ndërpersonale (një ndër komponentët e inteligjencës emocionale) dhe performancës së menaxherëve. Pra, një person i aftë për të menaxhuar drejt marrëdhëniet me të tjerët rezultoi të kishte më shumë mundësi për sukses. Përsa i përket lidhjes mes dimensioneve të aftësisë për t'u përshtatur dhe atyre të inteligjencës emocionale rezultoi që përshtatja me njerëzit në vendin pritës kishte lidhje me të gjithë komponentët e inteligjencës emocionale, ndërsa përshtatja me vendin e punës kishte lidhje vetëm me aftësitë intrapersonale. Ndërkaq, përshtatja e përgjithshme (që ka të bëjë me faktorë të tillë si kultura e të ushqyerit në vendin pritës, sistemi i transportit, shërbimet shëndetësore atje etj.) rezultoi të mos kishte lidhje me asnjërin nga komponentët e inteligjencës emocionale. Por, ajo rezultoi të kishte efekt pozitiv tek njëri nga dimensionet e suksesit e pikërisht tek kënaqësia. Një marrëdhënie negative rezultoi gjithashtu mes përshtatjes me vendin e punës dhe prirjes së menaxherëve për t'u larguar, që do të thotë se ata që kanë vështirësi për t'u përshtatur me ambientin dhe kulturën e punës në vendin pritës kishin më shumë mundësi ta linin detyrën përgjysmë. Bazuar në këto rezultate autorët propozuan që inteligjenca emocionale të përfshihej krahas kriterëve të tjera në vlerësimin e kandidatëve potencialë për t'u transferuar si menaxherë jashtë vendit.

Një tjetër kontribut i vlefshëm është edhe ai i Lin et al. (2012), të cilët studiuuan efektin e inteligjencës kulturore dhe asaj emocionale në aftësinë individit për t'u përshtatur me një mjedis të ri kulturor. Për këtë qëllim autorët iu drejtuan nëpërmjet një pyetësoi të huajve që studionin në universitetet e Taivanit verior dhe qendror. Ndër ata studentë që plotësuan pyetësorin pjesa më e madhe ishin aziatikë, ndërsa pjesa tjetër përbëhej nga evropianë, amerikanë, afrikanë etj. Analiza e të dhënave, e bërë përmes përdorimit të regresionit hierarkik, çoi në përfundimin se ekziston një marrëdhënie pozitive mes inteligjencës kulturore dhe aftësisë për t'u përshtatur me një kulturë të huaj, gjithnjë nëse mbahet nën kontroll efekti i variablave të tillë, si: gjinia, mosha, eksperiencat e mëparshme ndërkombëtare, si dhe aftësitë në gjuhën e vendit pritës apo në anglisht. Sipas Lin et al. (2012), nga studime të mëparshme kishte rezultuar që secili nga këta variabla kishte pasur efekt tek aftësia për t'u përshtatur me kulturën e një vendi të huaj, ndaj, për të vlerësuar drejt ndikimin e inteligjencës kulturore tek aftësia për t'u përshtatur ishte e nevojshme përfshirja e tyre në model si variabla kontrolli. Sa i përket inteligjencës

emocionale rezultoi që ajo kishte një efekt moderues pozitiv në marrëdhënien mes inteligjencës kulturore dhe aftësisë për t'u përshtatur. Kjo do të thotë që, kur një individ është i pajisur me inteligjencë kulturore, por njëkohësisht ka edhe një nivel të lartë inteligjence emocionale, ai ka shanse më të mëdha për t'u përshtatur më mirë me kulturat e vendeve të tjera.

Lee et al. (2013) testuan gjithashtu ndikimin e inteligjencës emocionale dhe asaj kulturore, tashmë në, 1) aftësinë e menaxherëve nga vendi amë për t'u përshtatur me kulturën e vendit pritës dhe 2) performancën e tyre. Për të realizuar testimin në fjalë ata morën në studim 256 menaxherë nga vendi amë që drejtonin filialet në Kinë dhe Vietnam të disa kompanive shumëkombëshe. Gjetjet kërkimore treguan që, si inteligjenca kulturore ashtu edhe ajo emocionale ndikonin pozitivisht në aftësinë e menaxherëve për t'u përshtatur me kulturën në vendin pritës, në një kohë që nuk u arrit të gjendej një lidhje direkte mes inteligjencës kulturore dhe/ose emocionale dhe efektivitetit të menaxherëve. Por, u zbulua që përshtatja me kulturën e vendit pritës luante një rol ndërmjetës shumë të mirë në këtë marrëdhënie. E thënë me fjalë të tjera, inteligjenca kulturore dhe ajo emocionale rrisnin shanset e menaxherëve për t'u përshtatur me kulturën e vendit pritës, gjë që çonte më pas në një efektivitet më të lartë menaxherial.

Lee et al. (2013) vlerësuan edhe efektin moderues të kontratave psikologjike në marrëdhënien ndërmjet inteligjencës kulturore dhe emocionale dhe aftësisë për t'u përshtatur. Kontratat psikologjike, përfaqësojnë një mjet që rregullon marrëdhënien punonjës-punëdhënës. Autorë të ndryshëm, të cilëve u referohen Lee et al. (2013), i shohin ato të përbëra nga dy komponentë, kontratat transaksionale dhe ato racionale. Të parat vënë theksin në marrëveshje të prekshme dhe afatshkurtra mbi përfitime ekonomike të caktuara, ndërsa të dytat kanë karakter afatgjatë dhe më të gjerë. Tek këto të fundit, në qendër të marrëdhënies ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit, nuk është thjesht elementi ekonomik, por edhe tregues të tjerë, të tillë si: besnikëria në këmbim të sigurisë dhe rritjes së punonjësit në organizatë. Gjetjet treguan që kontratat psikologjike kishin efekt moderues në marrëdhënien inteligjencë kulturore – përshtatje me kulturën e vendit pritës, por nuk kishin të njëjtin efekt në marrëdhënien inteligjencë emocionale – aftësi për t'u përshtatur. Kjo u argumentua me faktin se, individët me inteligjencë të lartë emocionale, duke qenë të zotë për të kuptuar drejt emocionet e lidhura me punën e tyre dhe të zotë për t'i shprehur ato natyrshëm, pavarësisht nga kontrata që kanë, transaksionale

apo racionale, vazhdojnë të ruajnë cilësinë e marrëdhënieve të tyre shoqërore në vendin pritës.

Në artikullin e tyre “Faktorët që ndikojnë në suksesin e menaxherëve nga vendi amë në Malajzi”, Sulaiman et al. (2014), prezantuan rezultatet e punës së tyre kërkimore me një grup prej 9 menaxherësh malajzianë që kishin qenë apo vazhdonin të ishin të transferuar me detyra jashtë vendit. Përzgjedhja e tyre ishte e qëllimshme pasi synimi i studimit ishte të thithte informacion të thelluar prej tyre. Për këtë ata iu nënshtruan një procesi intervistash të thelluara ku iu kërkua që, mbi bazën e eksperiencës së vet, të përcaktonin se çfarë nënkuptonin me sukses të menaxherëve nga vendi amë dhe cilët faktorë ndikonin në këtë sukses. Menaxherët e intervistuar përmendën një seri prej tyre si, procesin e duhur të përzgjedhjes, parapërgatitjen para nisjes, përshtatjen me vendin e ri të punës, mbështetjen dhe shpërblimin e duhur nga kompania mëmë, e natyrisht, edhe inteligjencën emocionale. Sa i përket kësaj të fundit, të gjithë ishin dakord që ajo përbën një faktor kyç në suksesin e menaxherëve të transferuar, madje, ajo duhej përshtatjet si një ndër kriteret për përzgjedhjen e tyre. Sipas të intervistuarve inteligjenca e lartë emocionale rrit nivelin e fleksibilitetit dhe aftësinë e menaxherëve nga vendi amë për t’u përshtatur me mjedisin e ri në vendin pritës, e për rrjedhojë shton mundësitë e tyre për një performancë më të lartë.

Mjaft interesant paraqitet edhe studimi i Wetchler et al. (2014), i cili synon të evidentojë rolin e moshës në marrëdhënien mes inteligjencës emocionale dhe aftësisë së menaxherëve nga vendi amë për t’u përshtatur me vendin pritës. Për realizimin e këtij studimi u përzgjedh një mostër prej 254 menaxherësh francezë, të cilët punonin jashtë vendit për llogari të një fondacioni francez me aktivitet në 133 vende të botës. Inteligjenca emocionale u mat nëpërmjet shkallës e propozuar nga Mayer, Di Paolo dhe Salovey (1990)³ dhe përpunuar nga Schutte et al. (1998), ndërsa aftësia për t’u përshtatur u mat nëpërmjet shkallës së propozuar nga Black & Stephens (1989)⁴.

Nga testimi i hipotezave autorët zbuluan që, së pari, moshë luan një rol lehtësues në marrëdhënien pozitive ndërmjet rregullimit dhe përdorimit të emocioneve (si dy dimensione të inteligjencës emocionale) dhe aftësisë për t’u përshtatur në përgjithësi me mënyrën e jetesës në vendin pritës. Të njëjtin impakt kishte moshë edhe në marrëdhënien ndërmjet rregullimit të

³ Shih më lart, seksioni “Përcaktimi i inteligjencës emocionale dhe elementeve që e përbëjnë atë”.

⁴ Shih më lart, seksioni “Roli i inteligjencës emocionale në suksesin e menaxherëve nga vendi amë”.

emocioneve dhe përshtatjes me njerëzit në vendin pritës. Kjo do të thotë që me rritjen e moshës së menaxherëve ata bëhen më të zotë të menaxhojnë emocionet e tyre dhe kjo i ndihmon që ta kenë më të lehtë përballjen dhe përshtatjen si me mënyrën e re të jetesës në vendin pritës ashtu edhe me njerëzit në këtë vend.

Interesante ishte edhe gjetja që eksperiencat e mëparshme si menaxherë jashtë vendit nuk ndihmonin shumë në lehtësimin e marrëdhënies pozitive mes inteligjencës emocionale dhe aftësisë për t'u përshtatur. Madje, edhe në të vetmin rast kur eksperiencat e mëparshme ndikonin në këtë marrëdhënie (më specifikisht në marrëdhënien mes përdorimit të emocioneve dhe aftësisë për t'u përshtatur me njerëzit në vendin pritës), ndikimi rezultoi negativ. Nisur nga kjo autorët konkluduan që, efekti moderues i moshës në marrëdhënien inteligjencë emocionale – aftësi për t'u përshtatur nuk është rrjedhojë e eksperiencave të mëparshme ndërkombëtare, të cilat përgjithësisht shtohen me rritjen e moshës. Por, sipas tyre, me rritjen e moshës, menaxherët nga vendi amë në mënyrë të natyrshme bëhen më të pjekur emocionalisht e si rrjedhojë më të zotë për t'u përshtatur me vendet pritëse.

Konkluzione

Menaxhimi strategjik ndërkombëtar i burimeve njerëzore përbën një çështje mjaft kritike për kompanitë shumëkombëshe sot. Përmasat globale që ka marrë konkurrenca dhe rritja e pasigurisë e paqëndrueshmërisë së ekonomisë botërore, sidomos mbas krizave të fundit, ka shtuar nevojën për përzgjedhjen e individëve të duhur për drejtimin e këtyre kompanive, e veçanërisht filialeve të tyre në vendet pritëse. Përgjegjësia për të zgjedhur njerëzit e duhur rritet sidomos kur kompania vendosë të transferojë menaxherë nga vendi amë për të drejtuar filialet e saj jashtë vendit, kjo pasi kostoja e tyre është mjaft e lartë dhe rritet akoma më shumë nëse ata dështojnë në përmbushjen e misionit të tyre. Dy dekadat e fundit, një seri e gjerë autorësh po i kushtojnë vëmendje konceptit të inteligjencës emocionale. Madje, ata po e theksojnë atë si një ndër cilësitë që duhet vlerësuar paraprakisht tek kandidatët potencialë për t'u dërguar me detyra menaxheriale jashtë vendit, krahas kriterëve të vlerësuar tradicionalisht, në mënyrë që të rriten shanset e tyre për sukses.

Inteligjenca emocionale nënkupton aftësinë e individit për të vlerësuar, rregulluar dhe menaxhuar emocionet e veta dhe ato të tjerëve në atë mënyrë që çon drejt zgjidhjes së problemeve dhe marrjes së vendimeve të duhura. Nga ana tjetër ajo mund të shihet e përbërë nga 5

komponentë, përkatësisht: 1) vetëdija vetjake, 2) vetërregullimi, 3) vetëmotivimi, 4) empatia (ndjeshmëria) dhe 5) aftësitë shoqërore. Dy modelet bazë teorike mbi inteligjencën emocionale, të zhvilluar ndër vite e që reflektojnë kontributin e autorëve të ndryshëm, janë “modeli i aftësive” dhe “modeli i përzier”.

Kontributet teorike dhe empirike që mbështesin rolin e inteligjencës emocionale në rritjen e efektivitetit menaxherial janë të shumtë. Autorë të ndryshëm kanë konkluduar se individët me inteligjencë të lartë emocionale ndjehen më të sigurt, janë në gjendje të menaxhojnë më mirë situatat stresuese, dinë të vendosin marrëdhënie të mira me klientët e punonjësit. Ata janë të aftë të orientojnë punonjësit drejt objektivave të organizatës, të stimulojnë punën në grup si dhe dinë të vlerësojnë më mirë mjedisin e jashtëm e të shfrytëzojnë oportunitetet që ai ofron. Për më tepër, inteligjenca emocionale është një cilësi që mësohet e maturohet me kohën, duke bërë që menaxherët gradualisht të shndërrohen në lidera.

Veçanërisht i rëndësishëm është roli i inteligjencës emocionale në suksesin e menaxherëve nga vendi amë. Rezultatet e kërkimeve empirike zhvilluar në vende e nga autorë të ndryshëm, edhe vitet e fundit, kanë treguar që ajo ka përgjithësisht një marrëdhënie pozitive me aftësinë e individëve për t’u përshtatur. Menaxherët me inteligjencë të lartë emocionale janë më të prirur për t’u përshtatur më shpejt e më me lehtësi si me mënyrën e jetesës në vendin pritës, me njerëzit në këtë vend, ashtu edhe me ambientin e kulturën e punës aty. Kjo nga ana tjetër, sipas literaturës kushtuar menaxhimit ndërkombëtar të burimeve njerëzore, zvogëlon mundësitë e tyre për të dështuar dhe rrit shanset për sukses. Ndaj del e domosdoshme që inteligjenca emocionale të bëhet pjesë e listës së kritereve që përdoren nga kompanitë shumëkombëshe për përzgjedhjen e menaxherëve nga vendi amë.

Ky punim përfaqëson një kontribut modest në literaturën shqiptare kushtuar menaxhimit ndërkombëtar të burimeve njerëzore. Sipas dijenisë së autores, trajtimi i rolit të inteligjencës emocionale në efektivitetin e menaxherëve në përgjithësi dhe në suksesin e menaxherëve nga vendi amë në veçanti, përbën një risi për këtë literaturë. Prandaj, ky punim synon më tepër ta bëjë prezent dhe të njohur këtë çështje, e të tërheqë vëmendjen e studiuesve shqiptarë dhe kompanive vendase e të huaja, në mënyrë që ato të fillojnë ta konsiderojnë inteligjencën emocionale përkatësisht në studimet e tyre dhe gjatë vendimmarrjes për burimet njerëzore.

Literatura

1. Avril, A.B., & Magnini, V.P. (2007), "A holistic approach to expatriate success", *International Journal of Contemporary Hospitality*, Vol. 19, No. 1, 2007, 53-64.
2. Baczynska, A. & Thorton, G.C. (2017), "Relationships of analytical, practical and emotional intelligence with behavioral dimensions of performance of top managers", *International Journal of Selection and Assessment*, Vol. 25, March, 2017, 171-182.
3. Bhatti, M.A., Battour, M.M., Ismail, A.R. & Sundram, V.P. (2014) "Effects of personality traits (big five) on expatriate adjustment and job performance", *Equality, Diversity, and Inclusion: An International Journal*, Vol. 33, No. 1, 2014, 73-96.
4. Boriçi (Begani), A., Celepija, J. (2014), "Expatriates difficulties and failure in foreign companies operating in Albania" *International Journal of Economics, Commerce and Management*, Vol. 2, No. 11, November 2014. Britani e Madhe. ISSN: 2340-0386. <http://ijecm.co.uk/wp-content/uploads/2014/11/21124.pdf>
5. Boriçi (Begani), A., (2012), "Staffing policies for managers in foreign companies in Albania", Monografi në anglisht, Shtëpia Botuese D&U, shtypur në Shtypshkronjën "Rozafa 1", Shkoder, Shqipëri, Dhjetor, 2012. ISBN: 987-9928-4087-4-7.
6. Boriçi (Begani), A. & Uruçi, E. (2008), "Managing expatriates in foreign banks in Albania", *Economic Diplomacy (Ekonomiska Diplomacija), Revistë e praktikave ekonomike dhe diplomatike, Institute of Economic Diplomacy*, Vol. 3, Nr. 9-10,11-12, Shtator-Tetor, Nëntor-Dhjetor, 2008, Beograd, SERBI. ISSN: 1452-4295. Fq. 29-42.
7. Chahar, B. & Rana, S. (2014), "Emotional Intelligence and Managerial Effectiveness", *4D International Journal of Mgt. and Science*, Vol. 4, No. 2., July 2014, ISSN-2250-0669.
8. Chawla, A., Bhaskar, P. & Khushboo, T. (2013), "Emotional intelligence and performance: A study of frontline executives in retail chain departmental stores", *National Conference on Paradigm for Sustainable Business: People, Planet and Profit*, organizuar nga Department of Management Studies, Indian Institute of Technology Roorkee, Roorkee-247 667, Uttarkhand, India. Proceedings e conferences me ISBN: 978-93-81583-94-4. Tërhequr online në Shtator 2017 nga adresa: <https://www.researchgate.net/publication/289193442>
9. Côté, S. (2017), "Enhancing managerial effectiveness via core four facets of emotional intelligence: self-awareness, social perception, emotion understanding, and emotion regulation", *Organizational Dynamics*, 2017. <http://dx.doi.org/10.1016/j.orgdyn.2017.05.007>
10. Cullen, J.B & Parboteeah, K.P. (2010), "International Business, strategy and the multinational company", Routledge, NY, USA.
11. Erogul, M.S., & Rahman, A. (2017), "The impact of family adjustment in expatriate success", *Journal of International Business and Economy*, Vol. 18, No.1, Spring 2017, 1-23.
12. Gabel, R.Sh., Dolan, Sh.L. , & Cerdin, J.L. (2005) "Emotional intelligence as predictor of cultural adjustment for success in global assignments", *Career Development International*, Vol. 10, No. 5, 375-395. <https://doi.org/10.1108/13620430510615300>
13. Goleman, D. (1998), "What makes a leader" *Harvard Business Review* (ripublikim në Janar 2004). Tërhequr online më 25 shtator 2017 nga adresa: <https://hbr.org/2004/01/what-makes-a-leader>

14. Harzing, A. W. K. (2001), "An analysis of the functions of international transfers", *Employee Relations*, Vol. 23, No.26, 581-598.
15. Harzing, A. W. K. (2001), "Who's in charge", *Human Resource Management*, Vol. 14, No.2, Summer 2001, 139-158.
16. Lee, L.Y., Veasna, S. & Sukoco, B.M. (2013) "The antecedents of cultural effectiveness: moderating effect of psychological contracts" *Asia Pacific Journal of Human Resources*, Vol. 52, 2014, 215-233.
17. Lin, Y., Shin-yihChen, A. & Song, Y. (2012) "Does your intelligence help to survive in a foreign jungle? The effects of cultural intelligence and emotional intelligence on cross-cultural adjustment" *International Journal of Intercultural Relations*, 2012. doi:10.1016/j.ijintrel.2012.03.001
18. Musten, S.M., Raud, M. & Titarenko, D. (2003), "Emotional intelligence as a tool for expatriate management", *University of Southern Denmark, Syddansk Universitet*, Odense, Danmark, 2003. Tërhequr online në shtator 2017 nga adresa: https://www.academia.edu/1836766/Emotional_Intelligence_as_a_Tool_for_Successful_Expatriate_Management?auto=download
19. Nel, P., Du Plessis, M. & Bossman, L. (2015), "Comparing different versions of the Rahim EI questionnaire in a South African context: A confirmatory factor analysis approach", *SA Journal of Industrial Psychology/SA Tydskrif vir Bedryfsielkunde*, Vol. 41, No. 1. Art #.1220, 9 pages. <http://dx.doi.org/10.4102/sajip.v41i1.1220>
20. Nunes, I.M., Felix, B. , & Prates, L.A. (2017) "Cross-cultural intelligence, cross-cultural adaptation and expatriate performance: a study with expatriates living in Brazil", *Revista de Administração*, Vol. 52, 219-232. <http://dx.doi.org/10.1016/j.rausp.2017.05.0710>
21. Pekkaar, K. A., Bakker, A. B., Linden, D. v.d. & Born, M. P. (2017), "Self- and other-focused emotional intelligence: Development and validation of the Rotterdam Emotional Intelligence Scale (REIS)", panuar pwr botim nga *Personal and Individual Differences*, nw August 20th, 2017, pwr t'u botuar nw *Personal and Individual Differences*, 120 (2018), 222-233. Twrhequr online në tetor 2017 nga adresa: <https://www.researchgate.net/publication/319623428>
22. Puck, J.F., Kittler, M.G. & Wright, Ch. (2008), "Does it really work? Reassessing the impact of pre-departure cross-cultural training on expatriate adjustment", *The International Journal of Human Resource Management*, Vol. 19, No. 12, 2008.
23. Rahman, S., Uddin, A. & Rahman, M. (2016), "Role of emotional intelligence in managerial effectiveness: An empirical study", *Management Science Letters*, Vol. 6, No.1, January 2016, 237-250.
24. Sulaiman, M., Omar, A., Yussuf, O.A. & Othman, A.K. (2014), "Factors affecting the success of Malaysian expatriates on foreign assignments", *International Review of Management and Business Research*, Vol. 3, No.2, June 2014, 938-948.
25. Shipper, F., Kincaid, J., Rotondo, D. M. & Hoffman, R. C. IV, "A cross-cultural exploratory study of the linkage between emotional intelligence and managerial effectiveness", *The International Journal of Organizational Analysis*, Vol. 11, No. 3, 2003, 171-191.
26. Tekin, O.A. & Gündoğan, H. (2017), "The relationship between emotional intelligence and job performance: A study on a five-star hotel employees", *Marmara Business Review*, Vol. 2, No. 1, June 2017, online ISSN-2564-6370, print ISSN-2536-457X, 51-69.

27. Tucker, M.L., Gullekson, N.L. & Kiger, C.E. (2017), "Accounting for EI: Does emotional intelligence predicts greater intercultural growth?", *Journal of International Business and Cultural Studies*, Vol. 8, June 2014, 1-11.
28. Wetchler, H., Koveshnikov, A. & Dejoux, C. (2015) "Just like a fine wine? Age, emotional intelligence on cross-cultural adjustment" *International Business review*, Vol. 24, 2015, 409-418.
29. Wild, J. J., & Wild, K. L. & (2016), "*International Business*", 8th Edition, Published by Pearson, USA.

ZHVILLIMI I TURIZMIT TË ‘ERRËT’ – RASTI QARKU SHKODËR

Amela Malaj⁵, Arjeta Troshani⁶

*Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, Fakulteti Ekonomik
Departamenti i Turizmit*

Abstrakt

Ngjarje të rënda të ndodhura ndër vite, në vende të ndryshme, kanë lënë pas gjurmë ndër të cilat sot kalohet me kuriozitet. Kureshtje për të përjetuar momente të dhimbshme dhe të tmerrshme, si një shembull konkret i asaj çfarë njeriu mund të mbart mbi vete e të mos mposhtet asnjëherë. Pikërisht këto ngjarje dhe vende, sot shihen si potencial turistik në shumë vende të botës, duke tërhequr mjaft turistë gjatë gjithë vitit. Është

⁵ Diplomuar në vitin 2015 në Bachelor Turizëm në Universitetin e Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’ dhe në 2017-ën ka marrë titullin Master Shkencor në Turizëm të qëndrueshëm në po këtë universitet. Ka përfituar bursë për një semester të plotë në Universitetin e Pragës, Fakultetin Ekonomik, nëpërmjet bashkëpunimit mes dy fakulteteve. Nga kjo eksperiencë është vlerësuar pozitivisht me rezultate të larta nga Fakulteti Ekonomik i Pragës përgjatë semestrit të parë të vitit të parë në Master Shkencor. Prej disa vitesh ka eksperiencë si menaxhere shitjeje pranë një biznesi të vogël privat, gjithashtu ka qenë pjesëmarrëse e trajnimeve të ndryshme të organizuara pranë Fakultetit Ekonomik të Shkodrës, pjesëmarrëse në konferenca dhe projekte të ndryshme.

⁶ Prof.dr.Arjeta Troshani është pedagoge e Marketingut me 25 vjet eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim në fusha të ndryshme që lidhen me ekonominë e sidomos me sfidat e vendeve në tranzicion. Ajo është autore e disa artikujve që lidhen me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe marketingun e produkteve turistike kryesisht në Ballkanin Perëndimor e sidomos në Veri të Shqipërisë. Ajo ka kryer disa eksperiencë kërkimore dhe mësimdhëniet në Universitetet Perëndimore, si: Universiteti i Ekonomiksit dhe Biznesit i Vjenës (WU), Austri, Universiteti i Karolinës së Veriut dhe Qendrorë, Universiteti i Pembrukut, SHBA, Universiteti i Opatise, Kroaci, Universiteti i Sarajevës, BiH etj. Gjithashtu prof. Troshani ka qenë mjaft aktive në tërheqjen e fondeve në Fakultetin Ekonomik nga BE nëpërmjet disa projekteve akademike perëndimore të Universitetit të Shkodrës në fushën e cilësisë në mësimdhënie, krijimin e lidhjeve midis ndërmarrjeve, administratës publike dhe universitetit dhe në lidhje me reformën e Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor. Prof. Troshani ka qenë Dekane e Fakultetit Ekonomik gjatë 2008-2016.

ana e 'errët', ajo ç'ka e bën këtë formë turizmi të jetë e veçantë në llojin e saj. *Qëllimi* i këtij punimi është për të analizuar motivet që shtyjnë turistët për të vizituar Shkodrën, veçanërisht muzeun e 'Dëshmisë & Kujtesës' dhe muzeun 'Dioqezan'. *Të dhënat* për të realizuar këtë punim janë siguruar nga literatura të ndryshme dhe nga të dhënat primare, duke përdorur kërkimin sasior nëpërmjet pyetësorit dhe kërkimin cilësor duke përdorur intervista më në thellësi me dy përfaqësuesit e dy muzeve në qytetin e Shkodrës, atë të 'Vendi i dëshmisë dhe kujtesës' dhe muzeut 'Dioqezan'. Modeli konceptual i përdorur në këtë punim bazohet në tre variabla të pavarura *edukimi, historia, kurioziteti*, nga ky model do të vërtetohet se kurioziteti ndikon më tepër vizitorët në vendimmarrje për udhëtim në krahasim me variablat e tjera. Kufizimet e këtij studimi lidhen me mungesën e gjerë të literaturës mbi konceptin e turizmit të 'errët' në Shqipëri, mbi mungesën e statistikave mbi numrin e vizitorëve dhe kohës së pamjaftueshme për të marrë në studim faktorë të tjerë ndikues.

Fjalët kyçe: *Turizmi i 'errët', motivimet, kërkesa dhe oferta, zhvillimi.*

Development of 'dark' tourism – Case Study Shkodra Region

Abstract

Serious events that have taken place over the years have left behind traces in various places, which are crazy today. Curiosity to experience painful and terrible moments as a concrete example of what man can carry on himself and never be defeated. These events and places are today seen as a tourist potential in many parts of the world, attracting many tourists throughout the seasons of the year. It's the 'dark' side, what makes this form of tourism special to its kind. The purpose of this paper is to analyze the motives that push tourists to visit Shkodra, especially the Museum of 'Testimony & Memory' and the 'Diocesan' museum. The data to accomplish this work is provided by various literature and primary data, using quantitative research through questionnaire and qualitative research using in-depth interviews with two representatives of two museums in the city of Shkodra, that of ' Testimony and Memory 'and the' Diocesan 'Museum. The conceptual model used in this paper is based on three independent variables of education, history, curiosity, from this model it is proved that curiosity influence the visitors on their decision making, more than other variables. The limitations of this study are related to the lack of literature on the 'dark'

tourism concept in Albania, the lack of statistics on the number of visitors and the lack of time to take into account many other influencing factors.

Key words: 'Dark' Tourism, Motivation, Demand and Offer, Development.

Objektivat e punimit

- Të eksplorohet mbi konceptin e turizmit të 'errët' në Shqipëri.
- Të përshkruhet situata aktuale e ofertës turistike në qarkun Shkodër.
- Të analizohet kërkesa aktuale në qarkun Shkodër rreth produkteve turistike që lidhen me formën e turizmit të 'errët'.
- Të analizohen edukimi, historia dhe kurioziteti si motivues kryesorë në nxitjen e vizitorëve për të udhëtuar dhe vizituar qarkun e Shkodrës si pjesë e turizmit të 'errët'.

Pyetja kërkimore

Cilat janë motivet që nxisin vizitorët drejt qarkut të Shkodrës si pjesë e turizmit të 'errët'?

Hipoteza

- H1. Edukimi, historia dhe kurioziteti janë motivues në vendimmarrjen e vizitorëve për të udhëtuar drejt qarkut të Shkodrës.
- H2₁ Edukimi është motivi kryesor që nxit vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të 'errët'.
- H2₂ Historia është motivi kryesor që nxit vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të 'errët'.
- H2₃. Kurioziteti është motivi kryesor që nxit vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të 'errët'.

Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur dy metoda për mbledhjen e të dhënave, të dhënat primare dhe sekondare. Nga të dhënat sekondare janë marrë për bazë disa literatura dhe materiale të ndryshme, janë grumbulluar materiale në muzeun e Dëshmisë dhe Kujteses, në muzeun Dioqezan dhe pranë drejtorisë së turizmit, Bashkia Shkodër. Përveç kësaj janë përdorur edhe materiale të ndryshme, që nga libra të autorëve që kanë përkufizuar për herë të parë turizmin e errët e gjer tek punimet e ndryshme të ndërmarra nga studentë apo akademikë rreth këtij fenomeni dhe ndikimeve të tij në vende të ndryshme. Të dhënat primare trajtohen në dy metoda kërkimi,

sasiore, të cilat janë ndërtuar në formën e një pyetësoi dhe cilësore në formën e një interviste personale. Alfred Politiz është një ndër autorët që mbron idenë e mostrave të mëdha, duke pasur rezultate të shumta ka mundësi që edhe konkluzionet të jenë të tilla. Nga ana tjetër Ernest Dithcher pohon se '10.000 x asgjë = asgjë' (Saunders., M, & Lewis., P, & Thornhill., A, (2007), 'Research Methods for Business Students', Fourth Edition), ndërsa mbron idenë e mendimeve të thella të personave specialistë të fushës, personave që kanë informacione të shumta dhe të rëndësishme. Ky studim do të mbështetet në të dy format e kërkimit, duke krijuar hapësirën e një studimi më të thellë nga kërkimi cilësor, e më të gjerë nga kërkimi sasior.

Popullimi i zgjedhur për studimin përfshin të gjithë vizitorët që kanë vizituar dy muzetë e marra në studim, gjatë kohës së punimit të kësaj teme. Duke qenë se popullimi është i lartë, është bërë një zgjedhje probabilitare, një kampion prej 100 vizitorësh. Ndërsa nga ana tjetër popullimi i intervistës në thellësi është i vogël, prandaj në këtë rast kampionimi ka qenë i përbërë prej dy personave specialistë të fushës dhe përfaqësues të institucioneve, nga të cilët janë marrë informacione dhe të dhëna të ndryshme të lidhura me temën. Janë shpërndarë 100 pyetësorë, ndër të cilët 83 janë marrë në konsideratë, ndërsa nga 17 prej tyre janë eliminuar për shkak të mungesës së informacionit. Pyetësori është trajtuar në gjuhën shqipe dhe në anglisht, përbëhet nga 13 pyetje me alternativa. Qëllimi i pyetësorit është të vërtetojë hipotezat e ngritura. Periudha e shpërndarjes së pyetësorit ka zgjatur afërsisht katër javë nga data 1 deri me datë 28 të muajit maj, 2017, ndërsa kohëzgjatja për plotësimin e pyetësorit ka qenë jo më shumë se 5 minuta. Janë realizuar gjithashtu dy intervista të drejtpërdrejta me dy përfaqësues të dy muzeve, këto intervista kanë pasur si qëllim, informimin rreth institucioneve më në detaj, statistika rreth vizitorëve dhe përshtypjet e tyre për muzetë, gjithashtu janë marrë ide, sugjerime apo edhe janë shprehur projekte që do të ndërmerren për të zhvilluar më tej këtë formë turizmi në qarkun e Shkodrës.

Koncepti i turizmit të 'errët'

Për të kuptuar më mirë qëllimin dhe për të punuar mbi gjetjet e këtij studimi, është e nevojshme që fillimisht të kuptojmë konceptin e 'Dark Tourism' dhe termat e lidhura me të. 'Dark Tourism' i përkthyer në shqip si 'Turizmi i errët' është një term i përdorur për herë të parë nga dy studiuesit, Malcolm J. Foley dhe J. John Lennon në librin e tyre të titulluar 'Dark Tourism'. Ky term është përdorur për të përshkruar një fenomen që përfshin ato udhëtime drejt vendeve të përfshira në fatkeqësi apo pjesë e

vdekjeve masive. Në librin e tyre, dy autorët e zgjeruan përkufizimin e tyre mbi turizmin e errët, duke vënë në dukje se cilat veprime përbëjnë dhe nuk përbëjnë këtë koncept. Vizitat nga miqtë apo familjarë të viktimave të përfshirë në këtë kategori turizmi, nuk mund të përcaktohen si turistë. Ato të cilët vizitojnë të tilla vende për arsye zbulimi, kurioziteti apo që janë pjesë e një itinerari turistik, mund të konsiderohen si turistë në bazat e turizmit të errët. Sipas autorëve motivet dhe nxitësit për këtë lloj turisti luajnë një rol pothuajse të parëndësishëm në turizmin e errët. Megjithëse gjatë punimit të tyre ato pranojnë se motivet ndikojnë në eksperiencën e turizmit të errët. Ato citojnë: *“Këto vizitorë duhet të kenë qenë të motivuar që kanë ndërmarrë një udhëtim të tillë drejt realitetit, pas fotove të mediave”* (1996:198). Në publikimin e tyre ‘Dark Tourism’ autorët synojnë për të kuptuar mënyrën sesi vdekja, fatkeqësia dhe mizoria trajtohen nga ata që ofrojnë ‘produkte’ turistike të lidhura me këtë aspekt. Turizmi i errët është edhe një produkt si i rrethanave të botës moderne ashtu edhe një ndikim i rëndësishëm mbi këto rrethana. Turizmi i errët nuk është turizëm masiv dhe kjo nuk paraqet shumë interes për ata të cilët kanë qëllime ekonomike, politike apo sociale. Një numër i madh vendesh të lidhura me luftën, vrasjet dhe ngjarje të tjera tragjike janë bërë destinacione të rëndësishme turistike.

Shkodra dhe regjimi komunist

Shkodra ka qenë ndër shekuj kryeqendra e Shqipërisë Veriore. 29 Nëntori i vitit 1944 nuk do të ishte një ditë e zakonshme për qytetin. Ajo ditë gdhju me hyrjen e brigadave partizane nëpër sheshet dhe rrugët kryesore, të cilat mbanin flamurin kombëtar, tashmë me një yll mbi shqiponjë e zezë. Shkodra u kthye në qytetin më fatkeq në Shqipëri, sepse diktatura i rezervoi persekutime, terror, vuajtje dhe vrasje. Shkodranët nuk mund të pajtoheshin me regjimin komunist, u organizuan dy revolta të armatosura, ajo e Kelmendit, e cila u zhvillua në janar të vitit 1945 dhe ajo e Postribës në shtator të vitit 1946. Këto lëvizje ishin vetëm fillimi i kontradiktave, që e shndërruan qytetin në simbol të izolimit dhe burgjeve të shumta. (*Mirdita, P, “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”*; nga vend vuajtjeje dhe torturash, në muze për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist. Shkodër 2016, fq.10 – 14). Burgjet e Shkodrës - Shtëpitë burg më të njohura të asaj periudhe ishin: 1. Shtëpia e Fasli Ademit; 2. Shtëpia e Çurçisë. Në vitet 1944-1950, shërbyen si burgje të përkohshme, hetuesi, qendra torturash apo qendra internimi këto objekte: Shtëpia e Sandër Saraçit; Shtëpia e Shkreleve; Shtëpia e Ulqinakut; Kuvendi Françeskan; Konvikti ‘Malet Tona’; Burgu i Gestapos.

Figura 1. Harta e burgjeve komuniste në qytetin e Shkodrës, 1994 – 1962.



Burimi: Mirdita, P. “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”; nga vend vuajtjeje dhe torturash, në muze për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist. Shkodër.

Muzeu i dëshmisë dhe kujtesës

“Vendi i dëshmisë dhe kujtesës” është i pari institucion që përkujton viktimat që vuajtën dënimin në burgjet e regjimit komunist. I konceptuar si hapësirë muzeale që nga shtatori i vitit 2014, sot është një memorial i periudhës së diktaturës komuniste, ku pjesa më kulmore janë qelitë origjinale të paraburgimit, të ish - Degës së Brendshme. Në fundin e këtyre qelive gjendet dhoma e torturave në të cilën janë ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike mbi të burgosurit. Përgjatë rrugës për tek zona e qelive gjendet një galeri ekspozimi me elemente dhe objekte të ndryshme që simbolizojnë torturat dhe dhimbjet apo edhe ecjen që përshkonte i burgosuri drejt qelive. Në këtë galeri gjenden mjaft objekte me vlerë, që nga raporte historike, dëshmi të të burgosurve deri tek objektet personale të përdorura nga ata. Në ekspozitë pasqyrohen gjithashtu dokumente origjinale të kohës që dëshmojnë persekutimin komunist të Shkodrës, kryengritjet, gjyqet, internimet, persekutimet, arratisjet e deri tek dënimet me pushkatim. Ky muze numëron plot tre vite aktivitet, të cilat kanë pasur mjaft sukses dhe interes. Misioni i këtij muzeu konsiston në përkujtimin e së kaluarës, jo vetëm, por edhe trajtime të ndryshme politike, kulturore, historike shoqëruar me fakte dhe dëshmi, duke iu drejtuar brezit të ri si një formë

ndërgjegjësimi mbi gabimet e së kaluarës dhe vizitorëve si një vend informimi dhe përkujtimi. Në këto qeli kanë qenë të burgosur mjaft emra të rëndësishëm të asaj kohe, të cilët janë ndëshkuar në mënyra barbare, disa nga këto emra janë;

- Marie Tuci (1928 – 1950), “Zoti më dha mëshirë të vdes e lirë”.
- Hafiz Ali Kraja – Tari (1900 – 1973), Klerik i lartë mysliman.
- Atë Zef Pllumi (1924 – 2007), “Kur njeriut t’i mungojë zemra nuk asht ma njeri”.
- Gjovalin Zezaj (1929), Antikomunist i organizatës “Bashkimi Shqipëtar”.

Muzeu Dioqezan i Shkodrës dhe Pultit

Një dëshmi e historisë së popullit shqiptar dhe e besimit të tij të krishterë katolik e treguar nepërmjet veprave të artit, objekteve kishtarë, objekteve të përdorimit dhe devocionit personal, fragmenteve dhe dokumenteve, dëshmime, fytyrave dhe zërave: historia e një populli ndërthuret me historinë; dëshmitë e besimit personal ndërthuren me historinë e kishës. Muzeu Dioqezan lind nga nevoja për të mbledhur, për të ruajtur dhe për ta bërë të disponueshme trashëgiminë historike në lidhje me fenë dhe kulturën e popullit shqiptar, që i referohet në mënyrë të veçantë zonës territoriale që bën pjesë në Dioqezën Shkodër-Pult. Veriu i Shqipërisë, ku historikisht tradita katolike është më e fortë sesa në të gjithë pjesën tjetër të vendit është dëshmitar dhe ruajtës i një feje që i ka rrënjët thellë në vetë zanafillën e krishtërit të epokës apostolike. Gjenden dy seksione tematike; ‘*Vende dhe shenja në kohë*’ (kati përdhes) dhe ‘*Zra fytyra, dëshmi në kohë*’ (kati parë). Muzeu Dioqezan është realizuar, me kriteret shkencore dhe mundësi përfitimi, si për të garantuar korrektësinë historike të asaj që është treguar, si ngaqë përgatitja e ekspozimit hyn në mes të tregimit nepërmjet mjeteve të ndryshme, duke e bërë atë sa më të kuptueshëm që të jetë e mundur për vizitorin (*Drejtorja e turizmit, Shkodër, 2017*).

Edukimi si motivues

H₂ Edukimi është motivi kryesor që nxitë vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të ‘errët’.

Pas rasteve të vdekjes apo fatkeqësive, nevoja për të kuptuar ngjarjen që ka ndodhur shfaqet në shumë mënyra. Disa individë kthehen në besime të larta fetare ose formave shpirtërore, duke kërkuar përgjigje përse u vranë personat e tyre të afërt, të tjerët marrin masa ligjore në mënyrë që të vendoset përgjegjësia për rastin. Vendet e turizmit të ‘errët’ mund të

ofrojnë të kuptuarit nëpërmes edukimit dhe njohurive. Industrializimi i shekullit erdhi në avancim dhe rritje në arsim, marketing, komunikim dhe infrastrukturë, të cilat nga ana tjetër çojnë në njohje arsimore. Nëse kthehemi në kohë dhe kujtojmë udhëtimet/turnetë edukative nga Thomas Cook me aristokratët e rinj, ku baza e tyre ishte arsimimi nëpërmjet udhëtimeve nëpër vendet më të famshme për edukim të lartë. Në kthesën e shekullit të 20-të turizmi i errët u promovua dhe u justifikua si një komponent arsimor. Sot, individët vazhdojnë të udhëtojnë për njohuri, kuptim dhe mundësi studimi, dhe vendet e turizmit të 'errët' vazhdojnë të promovojnë aspektet edukative. Nga ana tjetër vende të ndryshme vënë theksin mbi edukimin duke shpresuar që brezat e ardhshëm të mësojnë prej së kaluarës dhe të përmirësojnë gabimet. Dhe jo vetëm, por edukimi përdoret edhe për të forcuar ndjenjën tonë të përgjithshme të komunitetit duke avancuar barazinë edukative dhe mirëkuptimin multikulturor "(Brown Foundation, N.D.)

Nëse marrim rastin konkret të dy muzeve, ato janë një rast mjaft i mirë me baza edukative për të gjithë brezat. Ndonëse ka mjaft turistë të huaj pranë këtyre dy muzeve ka edhe mjaft qytetarë të Shkodrës apo të Shqipërisë, që nga shkollat fillore, gjimnazet e gjer tek universitetet, familjarë dhe mosha të thyera të cilët vizitojnë muzetë dhe informohen edhe më tepër më atë çka këto muze paraqesin. Komunizmi është një e kaluar e 'errët' e vendit e cila fillimisht duhet kuptuar për t'u kritikuar, duke komunikuar mbi ndikimet që u lanë në vend pas përfundimit të saj, duhen edukuar breza të ndryshëm mbi rëndësinë që ka fakti që kjo e kaluar të mbetet e tillë, të ndreqen gabime dhe të kemi edukim të përgjithshëm në komunitet. Nga rezultatet e pyetësorit, por edhe nga materiale të ndryshme e nga komunikime të drejtpërdrejta, edukimi rezulton të jetë një motivues i rëndësishëm për vizitorët e huaj dhe vendas.

Historia si motivues

H₂ Historia është motivi kryesor që nxit vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të 'errët'.

Studimet empirike mbi historinë si një motivues i turizmit të errët janë joekzistente. Megjithatë, duke shikuar në gamën e gjerë të produkteve në dispozicion të vizitorëve, mund të kuptohet se historia nxit vizitat drejt vendeve të vdekjes dhe të fatkeqësive. Një gamë e gjerë literaturash paraqesin aspektin që vendet e turizmit të 'errët' mund të 'përdoren' për kërkime të ndryshme, ato veprojnë si arkiva për kushtet sociale, klimat politike dhe mjedisin në vështirësi. Një nga problemet që lidhen me këtë aspekt, është manipulimi i historisë nga vlerat kulturore që këto vende të

ndryshme paraqesin. Pikërisht vendet e turizmit 'errët' ofrojnë përvoja të veçanta për vizitorët, prandaj vizitorët duhet të jenë të kujdesshëm që t'u komunikohet e gjithë historia në mënyrën më të mirë. Muzeu i 'Dëshmisë dhe Kujtesës' si dhe muzeu 'Dioqezan' na përkujtojnë një pjesë të historisë të së kaluarës të cilën jo të gjithë e njohin. E sjellur nëpërmjet objekteve, fotove apo dokumenteve të ruajtur ndër vite, është kjo histori, kjo e kaluar që i nxit vizitorët e dy muzeve t'i vizitojnë ato. Nga studimi i realizuar pranë këtyre dy muzeve dhe burimeve të ndryshme, por edhe nga rezultatet e pyetësorëve, historia është një ndër motivet apo nxitësit me përqindje të lartë. Historia që mbart Shqipëria dhe konkretisht qarku Shkodër duhet të jetë mjaft me interes për vizitorët, aq më tepër e kaluara komuniste, nga e cila tentohet të kuptohet sesi ndikoi në vend dhe në të gjithë popullsinë e saj. Është mjaft interesante të shohësh dëshirën e vizitorëve për t'u njohur me të kaluarën, duke 'prekur' vetë me dorë në një farë mënyre një pjesë të asaj së kaluare nëpërmjet ekzistencës së këtyre muzeve dhe objekteve që përmbajnë. Historia mund të trajtohet më vete edhe si formë e turizmit për qarkun e Shkodrës, pasi ka mjaft material për t'u studiuar, por në rastin konkret, historia është e lidhur me kulturën dhe artin duke dhënë në fund një formë më të gjerë siç është ai i turizmit të 'errët'.


Kurioziteti si motivues

H₂₃. Kurioziteti është motivi kryesor që nxit vizitorët të vizitojnë qarkun Shkodër si pjesë e turizmit të 'errët'.

Sharpley dhe Stone (2009) pohojnë se ka motive mbizotëruese në motivimet e turizmit të 'errët' të cilat janë hulumtuar në bollëkun e studimeve dhe këto përfshijnë: kuriozitet, argëtim, identifikim, dhembshuri, motive nacionaliste, pelegrinazhi, vlefshmëria e ngjarjeve, kërkimi i identitetit, arsimi dhe një ndjenjë të përgjegjësisë sociale. Interpretimet e vendeve të 'errëta' janë të ndikuara jo vetëm nga motivet turistike, por edhe nga imazhi që mbajnë ato atraksione (Sharpley dhe Stone, 2009). Njerëzit kërkojnë të çuditshmen dhe të ndryshmen, kjo mund të jetë një motivim për të vizituar vendet e 'errëta', pasi vizitorët mund të përjetojnë diçka të rrezikshme në sigurinë e mjedisit të turizmit (Dieke et al., 2011). Nga literatura të ndryshme janë identifikuar tri lloje turistësh kryesorë: ata që dëshirojnë të ndihen të lidhur me historinë, ata që dëshirojnë të mësojnë dhe ata që nuk kanë motive të lidhura me vendin historik të vizituar. Mund të supozohet se në varësi të strategjive që përdor një vend turistik i 'errët', do të tërhiqte një treg të caktuar turistik për të (Sharpley and Stone, 2009). Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme të aplikohet pranueshmëria, përshtatshmëria dhe etika e shfaqjes në mënyrë që të

tërheqin njerëzit që do të vizitonin vende të errëta me një qëllim të pranueshëm. Megjithatë, do të ketë gjithmonë një ekzistencë për kuriozitet, sepse është e natyrshme për njeriun si qenie. Kurioziteti duket të jetë një motivues mjaft i rëndësishëm për vizitorët në Shkodër. Ai ka përqindjen më të lartë dhe kryeson si nxitës në pyetësorin e bërë pranë muzeve. Vizitorët janë shprehur se kanë kuriozitet për t'u përballur me historinë që përcjellin muzetë dhe më objektet që gjenden me to, por kurioziteti nuk mbetet brenda muzeve, vizitorët shprehin kuriozitet për të vizituar më tej qytetin për të parë se si ajo e kaluar ka lënë gjurmë në qytet dhe komunitet. Mund të thuhet se kurioziteti është një motivues që e ndeshim përgjithësisht në të gjitha fomat e turizmit, ndoshta në rastin e turizmit të 'errët' ekzistojnë polemika nëse është etike të ketë kuriozitet në të tilla vende, por kurioziteti është pjesë e njeriut, që e nxit drejt vendimeve dhe udhëtimeve. Nëse kurioziteti në forma të tjera të turizmit është më i shprehur, në rastin e turizmit të 'errët', tenton të jetë më serioz dhe i matur, pikërisht për shkak të kontekstit që ka kjo formë turizmi.

Grafiku në vazhdim 1.1, është grafiku më me rëndësi për studimin.



Grafiku 1.1 Motivet e Vizitës

Në të paraqiten variablat e marra në studim dhe lidhja e tyre me kërkesën turistike mbi formën e turizmit të 'errët'. Nga të dhënat e mbledhura nga përgjigjdhënësit, 46 vizitorë e përcaktojnë kuriozitetin si motivin kryesor që ka influencuar vendimet e tyre për të vizituar qarkun Shkodër, pikërisht dy muzetë e marrë në studim. Kjo e dhënë vërteton hipotezën e dytë e cila e përcakton kuriozitetin si motivin kryesor në kërkesën turistike mbi formën e turizmit të 'errët' në rastin e qarkut të Shkodrës. Kurioziteti është një ndër motivet më të njohura që nxit vizitorët të ndryshëm drejt vendeve me vlera të veçanta, kurioziteti është gjithashtu një pjesë e pandarë e qenies njerzore në të përditshmen. Nga ana tjetër, 25 përgjigjdhënës, kanë përcaktuar historinë si motivin kryesor. Historia

gjithashtu përbën një element mjaft të rëndësishëm në nxitjen e turistëve, e shkuara që paraqesin dy muzetë apo vlerat historike që mbart i tërë qarku, përbëjnë motiv të mjaftueshëm për të nxitur udhëtime. Ndërsa 12 përgjigjdhënës shprehen se është edukimi/njohuria ajo që i nxit për të udhëtuar. Nevoja për të mësuar gjëra të reja, për t'u njohur me të panjohurën është mjaftueshëm motiv për të nxitur udhëtime, ndonëse në një përqindje të vogël është interesante që edhe edukimi është pjesë e motiveve që nxisin vizitorët drejt qarkut të Shkodrës si pjesë e turizmit të 'errët'. Këto përfundime vërtetojnë gjithashtu hipotezën e parë të ngritur, edukimi, historia dhe kurioziteti janë motivues në vendimmarrjen e vizitorëve për të udhëtuar drejt qarkut të Shkodrës.

Konkluzione të përgjithshme

Turizmi i 'errët' është një formë e turizmit që e gjejmë shumë herët në histori dhe që vjen sot në trajta të ngjashme. Muzeu i 'Dëshmisë dhe Kujtesës' dhe muzeu 'Dioqezan' janë dy shembujt e marrë në studim të cilët lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me periudhën komuniste dhe formën e turizmit të 'errët'. Kjo formë e turizmit, jo shumë e njohur në qarkun Shkodër përbën potencial të madh turistik për zhvillimin e turizmit në vend. Nga rezultatet e marra nga metodat sasimore, u vu re që janë motive të ndryshme ato që nxisin vizitorët drejt qarkut Shkodër dhe është kurioziteti, motivi kryesor që i nxit ata drejt dy muzeve dhe historisë së komunizmit. Është mjaft e rëndësishme bashëpunimi me organizatat e huaja, projekte të ndryshme mund të ndikojnë pozitivisht në rimëkëmbjen e objekteve të shkatërruara dhe kthimin e tyre në potencial. Ndërgjegjësimi gjithashtu është i rëndësishëm për qytetarët, të cilët duhet të jenë të parët të informuar dhe të gatshëm për të ndihmuar në një zhvillim të vendit, jo vetëm, por edhe të ndërgjegjësuar mbi gabimet e së shkuarës dhe përmirësimin e këtyre gabimeve në të ardhmen. Raste të ndryshme, shembuj të ndryshëm nëpër botë na paraqesin ide të reja zhvillimi dhe menaxhimi të pasurive historike, kulturore të tilla. Mjafton që të jemi ata që kuptojmë dhe punojmë për një të ardhme më të sigurt, ide më innovative dhe kulturore më të pasuruar.

Rekomandime të përgjithshme

- Të krijohen burime të sakta informacioni mbi konceptin e turizmit të 'errët' në qarkun Shkodër, apo edhe më gjerë në të gjithë Shqipërinë, për rëndësinë e saj dhe zhvillimin turistik që sigurohet nga kjo formë.
- Të implementohen praktika të qëndrueshme menaxhimi nga personat përgjegjës të këtyre institucioneve.

- Të punohet mbi strategjitë e promovimit, media luan një rol të rëndësishëm në shtimin e ndërgjegjësimit për këto dy muze dhe historinë që mbartin.
- Të investohet më tepër në ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kulturore e historike që zotëron qarku i Shkodrës, apo më gjerë Shqipëria.
- Të studiohet dhe të punohet më tepër mbi kënaqësinë konsumatore, motivimet dhe dëshirat e tyre në lidhje me turizmin e 'errët'.
- Të ndërmerren projekte të ndryshme, ide inovative, duke i kthyer këto muze dhe vende të cilat nuk janë aktive, në potencial turistik për qarkun Shkodër.
- Bashkëpunimin me universitete dhe studentë që shprehin vullnetin e lirë për të punuar mbi formën e turizmit të 'errët', promovimin e tij dhe menaxhimin e institucioneve përkatëse.

Rekomandime për kërkim në të ardhmen

- Ky punim mund të përdoret në të ardhmen për studime dhe kërkime më të thelluara në fushën e turizmit të 'errët', qoftë në rastin e qarkut të Shkodrës, por edhe më tej.
- Në studime më të thelluara mund të punohet mbi identifikimin e faktorëve të tjerë nxitës të kërkesës dhe të shihen lidhje që mund të ekzistojnë mes këtyre nxitësve.
- Më tej në të ardhmen mund të bëhen krahasime të këtij studimi me vende tjera të ndryshme, ku nga ky krahasim mund të shihen raste të suksesshme të menaxhimimit të institucioneve apo muzeve të një forme të tillë. Gjithashtu mundet që nga ky krahasim të maten nxitësit e kërkesës, nëse janë të ngjashëm në çdo rast apo secili rast ka specifika të ndryshme.
- Kombinimin e formave të tjera të turizmit në qarkun Shkodër me turizmin e 'errët', krijimin e paketave turistike të kombinuara me qëllim promovimin e kësaj forme të turizmit, por edhe duke promovuar format tjera të turizmit në qarkun Shkodër.

Bibliografia

- Anketë, OSBE., (2016): "Njohuritë dhe perceptimet e publikut për të shkuarën komuniste në Shqipëri dhe pritshmëritë e tyre për të ardhmen". (30-82)
- Ashworth, G., & Tumber, J., (1990): "The tourist historic city" Great Britain (35-53)
- Bushati, A., (2011): "Ditari i Ferrit" (Kujtime burgu). (Parathënie)

- Dervishi, K., (2015): “Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste”. (4-6)
- Gashi, R., (2017): “Llojet e burgjeve dhe kampeve të punës dhe pozita e personave të dënuar në Shqipëri gjatë periudhës së diktaturës komuniste” (29-32).
- Hoxha, Ç., (1948): “Fillimet e diktaturës komuniste në Shqipëri”. Instituti i studimit të kërkimeve dhe pasojat e komunizmit. (8-62-95-129).
- Lennon, J., & Foley, M., (2000): “Dark tourism, the attraction of death and disaster”.
- LIGJ Nr. 93/2015 PËR TURIZMIN
- Mirdita, P., (2016): “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës” nga vend vuajtjeje dhe torturash, në muze për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist, Shkodër.
- Mirdita, P., (2016): “Vendi i dëshmisë dhe kujtesës”. (10-57)
- Pepa, P., (2009): “Dosja e diktaturës”. (41, 62-63)
- Saunders., M., & Lewis., P., & Thornhill., A., (2007), ‘Research Methods for Business Students’, Fourth Edition.

Web-bibliografi

- Albania & Dark Tourism., <http://www.dark-tourism.com/index.php/albania-en> , aksesuar me 20 maj 2017.
- Bittner, M., (2011): “Dark Tourism, Evaluation of Visitors Experience after Visiting Thanatological Tourist Attractions”. http://www.dgt.uns.ac.rs/turizam/arhiva/vol_1504_2.pdf Volume 15, (148-158) aksesuar me 7 maj 2017.
- Bunkart.al, aksesuar me 13 qershor 2017.
- Harries, K., (2016): “An investigation into students motivation for visiting location of death and disaster, using the case studies of Ground Zero and World War II concentration camp Auschwitz”. (9-14) <https://repository.cardiffmet.ac.uk/handle/10369/8243>, aksesuar me 17 prill 2017.
- Isaac, R., & Çakmak, R., (2013) “Understanding visitor's motivation at sites of death and disaster: the case of former transit camp Westerbork, the Netherlands”. <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/13683500.2013.776021>, aksesuar me 13 maj 2017.
- Kirspile, I., (2014): “Dark Tourism; is it right to visit victims sites and disaster zones just because of human curiosity”. England University of Wolver Hampton. <http://www.independent.co.uk/travel/news-and-advice/dark-tourism-important-alt-right-politics-north-korea-auschwitz-rwanda-a7585601.html> , aksesuar me 29 maj 2017.
- Light, D., (2017): “Progress in dark tourism & thonatourism research: An uneasy relationship with heritage tourism”. United Kingdom <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0261517717300092> , aksesuar me 29 maj 2017
- Muzeu i memories info, <http://muzeumemories.info/> , aksesuar me 1 qershor 2017.
- Novelli, M., (2005): “Niche Tourism, contemporary issues, trends & cases”. (48-57) http://www.academia.edu/22040814/Niche_Tourism_Contemporary_issues_trends_and_cases_Senior_Lecturer_in_Tourism_Development_and_Management_Centre_for_Tourism_Policy_Studies_University_of_Brighton, aksesuar me 15 maj 2017.
- Shkreli, E., (2016) “Një guidë për presekutimin komunist, që e kaluara të mos harrohet”. <http://www.panorama.com.al/nje-guide-per-persekutimin-komunist-qe-e-shkuara-te-mos-harrohet/> , aksesuar me 5 maj 2017.

- Stone, P., (2012): “Towards a model of mortality meditation”. (1567-1583)
<http://isiarticles.com/bundles/Article/pre/pdf/134.pdf> , aksesuar me 3 maj 2017.
- Yuill, S., (2003): “Dark tourism; Understanding visitor motivation at sites of death and disaster”. Texas A&M University
<http://oaktrust.library.tamu.edu/bitstream/handle/1969.1/89/etd-tamu-2003C-RPTS-Yuill-1.pdf>, aksesuar me 1 maj 2017.

ROLI I ARSIMIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK: RASTI I BALLKANIT PERËNDIMOR

Ardita Boriçi⁷, Jetmir Muja⁸

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik,
Departamenti i Administrim-Biznesit*

Abstrakt

Arsimimi konsiderohet një ndër elementët kryesorë të zhvillimit (rritjes) ekonomik të një vendi, njëkohësisht faktor kyç në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Rëndësia e kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike është e njohur tashmë, si bazë për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe të shpejtë. Kapitali njerëzor është shumë i rëndësishëm për vendet në tranzicion dhe vendet në zhvillim, pasi kërkon një përdorim të mirë të

⁷ Diplomuar në korrik të vitit 1994 pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe në 1999 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Në dhjetor, 2010 i jepet grada Doktor i Shkencave Ekonomike nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, ndërsa në korrik, 2016, po ky institucion i akordon titullin Profesor i Asociuar. Ka marrë pjesë dhe ka përfunduar me sukses shumë kualifikime dhe punë kërkimore të zhvilluara në institucione të ndryshme universitare, të tilla si: Universiteti i Firences në Itali, Universiteti i Jenes në Gjermani, Universiteti i Bratislaves në Sllovaki, Universiteti i Gonzages në USA, etj. Ka punuar si lektore pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës që nga viti 2000, si dhe është ftuar për të dhënë leksione pranë Univeritetit të Bratislaves në Sllovaki dhe atij të Gonzages ne USA. Aktiviteti i saj akademik është i gjerë, me pjesëmarrje në konferenca, aktivitete dhe publikime shkencore kombëtare e ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me problemet ekonomike.

⁸ **Jetmir Muja MSC** – Lindi në vitin 1992 në Ulqin, Mal i Zi. Në korrik 2014 përfundoi bachelor në Administrim-Biznes pranë fakultetit ekonomik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” si studenti më i mirë i departamentit. Në korrik të vitit 2016 mori titullin Master i Shkencave në Administrim-Biznes pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe përsëri është shpallur studenti më i mirë i departamentit. Në vitin 2014 dhe 2016 është vlerësuar me çmimin “Sadetin & Mirjeta Beqiri Excellence Award” për performancë të jashtëzakonshme akademike në fushën e administrim- biznesit. Pavarësisht moshës së re e pret një e ardhme e begatë profesionale dhe akademike. Adresa email: jet.muja@hotmail.com

njohurive për të menaxhuar ndryshimin në mjedisin punues dhe ndërtimin e një ekonomie stabël. Asnjë vend nuk mund të arrijë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm pa investuar në kapitalin njerëzor. Edukimi rrit produktivitetin dhe kreativitetin e njerëzve, nxit sipërmarrje të reja dhe inovacione teknologjike. Punimi synon të tregojë lidhjen që ekziston në mes arsimimit dhe zhvillimit ekonomik dhe si rritja e cilësisë së nivelit arsimor mund të ndikojë në rritjen ekonomike në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Fjalët kyçe: arsimimi, zhvillimi ekonomik, rritja, kapitali njerëzor, nivelet e arsimit.

The role of education in the economic development: Western Balkan case

Abstract

Education is considered to be one of the key elements of country's economic development, and a key factor in the development of human capital. The importance of human capital in economic growth is known as the basis for a steady and rapid economic growth. Human capital is very important for countries in transition and developing countries as it requires a good use of knowledge to manage change in working environment and building a stable economy. No country can achieve sustainable economic development without investing in human capital. Education enhances people's productivity and creativity, promotes entrepreneurship and technological innovations. This paper seeks to show the relationship between education and economic development and how can an increase in the quality of education affect economic growth in the case of Western Balkan countries.

Key words: education, economic development, growth, human capital, education levels.

1. Hyrje

Arsimimi është shtylla për një shoqëri të emancipuar e bashkëkohore. Zhvillimi dhe rritja ekonomike e një vendi tashmë nuk mund të shihet pa investime në kapitalin njerëzor. Investimi në kapitalin njerëzor mund të ketë pak ndikim në rritjen ekonomike nëse njerëzit nuk e përdorin

arsimimin për të shfrytëzuar mundësitë që paraqiten në tregjet konkurruese dhe të hapura (Ozturk, 2001). Sipas Karagoz & Tsounis (2008) është bindëse të thuhet që standardet jetësore janë rritur në mënyrë proporcionale me arsimimin dhe se ekziston një lidhje domethënëse në mes rritjes ekonomike dhe mënyrës në të cilën arsimimi ka mundësuar zhvillimin e njohurive. Prandaj në një ekonomi të hapur vendet mund të përdorin arsimimin si një mjet për zhvillimin ekonomik.

Disa ekonomistë shtojnë pyetjen nëse vendet mund të jenë të varfëra për shkak se ata kanë mangësi në kapitalin njerëzor. Schultz (1961) vërejtë se vendet e pasura të shkatërruara pas Luftës Dytë Botërore ishin në gjendje të punësojnë shuma masive të kapitalit të ri fizik, ndërsa vendet më të varfra nuk ishin në gjendje për të shfrytëzuar me sukses sasi më të vogla të kapitalit fizik. Ai ndërtoi teorinë që thekson se aftësia e një vendi për të përdorur kapitalin fizik në mënyrë produktive është në funksion me nivelin njerëzor dhe nëse kapitali njerëzor nuk rritet së bashku me kapitalin fizik, atëherë zhvillimi ekonomik nuk mund të vazhdojë. Breton (2013) përmbledh me tej teorinë e Schultz se kapitali njerëzor me shumë gjasa mund të bëhet pengesë për zhvillimin, sepse investitorët e huaj janë të etur të investojnë në kapitalin fizik më shumë se në kapitalin njerëzor.

Ekonomistët gjithnjë e më shumë po e pranojnë që investimi në arsim, apo në kapitalin njerëzor është një element i rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik. Studimet ekonometrike ofrojnë dëshmi të forta dhe të qëndrueshme që punëtorët më të arsimuar janë më produktivë dhe përfitojnë paga më të larta (Psacharopoulos & Patrinos, 2004). Gylfason (2001) thekson që një rritje në nivelin e edukimit apo një edukim më i mirë është kusht paraprak për një zhvillim ekonomik të shpejtë të vendeve. Gjetjet e Stevens & Weale (2004) tregojnë që nivele të larta të GDP për frymë janë të lidhura me nivele të larta të ndjekjes së shkollave fillore. Në studimin në fjalë rritja ekonomike dhe regjistrimi në shkolla janë analizuar për vitet 1960-1995 në të cilin janë përfshirë rreth 100 shtete, të cilat sugjerojnë që një rritje me 1% në normën e regjistrimit në shkollat fillore rrit GDP-në me 0.35% në afatgjatë (Stevens & Weale, 2004). Në respekt me edukimin, rritja ekonomike është e lidhur me normën mesatare të arritjeve në shkolla të mesme apo të larta (Barro, 2000).

Pavarësisht faktit që mënyra në të cilën arsimimi ndikon rritjen ekonomike nuk është përcaktuar qartë, mund të themi që arsimimi është ndër elementët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Pikërisht, ky është qëllimi i punimit, të tregojë rëndësinë që ka arsimimi në zhvillimin ekonomik të vendit, kryesisht vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në vazhdim do të diskutojmë për faktorët përcaktues të zhvillimit ekonomik

të një vendi, duke treguar rolin e arsimit si një përcaktues kryesor në rritjen dhe zhvillimin ekonomik bazuar nga literatura ekzistuese dhe rëndësinë që ka arsimimi në performancën ekonomike të vendit.

2. Faktorët e zhvillimit ekonomik

Termi zhvillim ekonomik lidhet me përpjekjet e shtetit për të përmirësuar mirëqenien ekonomike, sociale dhe politike të njerëzve. Zhvillimi ekonomik është i lidhur ngusht me rritjen ekonomike. Rritja ekonomike ka të bëjë me rritjen e nivelit të outputit, ndërsa zhvillimi ekonomik është i lidhur me rritjen e outputit së bashku me përmirësimin e mirëqenies sociale dhe politike të njerëzve brenda një vendi.

Todaro dhe Smith (2009) theksojnë që rritja ekonomike është baza e zhvillimit ekonomik, kurse qëllimi i zhvillimit ekonomik në formën më të thjeshtë synon të rrisë mirëqenien e popullsisë. Rritja ekonomike mund të përcaktohet si rritja e aftësisë së një ekonomie për të prodhuar të mira dhe shërbime brenda një periudhe kohore. Performanca ekonomike e një vendi matet nga rritja vjetore në Produktin Kombëtar Bruto (PKB)⁹ një matës alternativ i Produktit Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa sot Banka Botërore ka zëvendësuar PKB për frymë me të Ardhurat Kombëtare Bruto për frymë për të krahasuar mirëqenien në mes shteteve (Dang & Pheng, 2015).

Ekzistojnë studime edhe teori të ndryshme të cilat mundohen të shpjegojnë rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendeve. Ndër të parët që u mundua të shpjegonte këtë proces është Adam Smith i cili theksoi që rritja ekonomike varet nga tre faktorë: toka, puna dhe kapitali (i referohet kapitalit fizik) (Smith, 1976).

Teoriticientët e viteve 1950 dhe në fillimin e viteve 1960, procesin e zhvillimit ekonomik e shihnin si një proces i cili kalon në disa faza, ku investimet luajnë rolin kryesor. Edhe pse Rostow (1990), Harrod (1948), Domar (1947) kishin të drejtë në lidhje me rëndësinë e rolit të investimeve me normën e rritjes ekonomike, ky nuk është kushti i vetëm që një vend të zhvillohet (Dang & Pheng, 2015).

Zgjerimi i formulimit të Harrod–Domar, modeli neoklasik i rritjes ekonomike i Solow thekson rëndësinë e tre faktorëve të rritjes së prodhimit: rritja e sasisë dhe cilësisë së punës (përmes rritjes së popullsisë dhe edukimit), rritja e kapitalit (përmes kursimeve dhe investimeve) dhe

⁹ PKB është produkti i brendshëm bruto (PBB) plus të ardhurat e pranuar nga rezidentët jashtë vendit minus të ardhurat e marra nga jorezidentët. PBB llogaritet si vlera e prodhimit total përfundimtar e të gjithë produkteve dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve të një shteti përgjatë një viti.

përmirësimet në teknologji (Solow, 1956). Ekonomistët neoklasikë kanë bërë përpjekje për hartimin e politikave të liberalizimit, stabilizimit dhe privatizimit si elemente bazë të agjendës së zhvillimit të vendit (Dang & Pheng, 2015).

Teoritë e reja të rritjes ekonomike, një ndër to teoria endogjene e rritjes ekonomike i lidhin ndryshimet teknologjike me zhvillimin e njohurive Romer (1986), Lucas (1988), Aghion & Howitt (1992). Teoria e re e rritjes thekson se rritja ekonomike rezulton nga rritja e kthimit në përdorimin e njohurive në vend të punës dhe kapitalit. Kjo teori i ka lejuar ekonomistët të argumentojnë se teknologjia shkakton kthime rritëse të shkallës dhe se kapitali mund të përdoret në mënyrë më eficiente. Literatura e rritjes endogjene ka prodhuar dy qasje të ndryshme të mënyrës së përfshirjes së kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike. Qasja e parë e sheh kapitalin njerëzor si motorin e rritjes ekonomike (Lucas, 1988). Qasja e dytë vë theksin në rolin e kapitalit njerëzor në procesin e inovacionit dhe adoptimit të teknologjive të reja (Romer, 1986).

Për më tepër, ekzistojnë faktorë të tjerë të cilët ofrojnë stimuj për rritje ekonomike që vendet në zhvillim hasin probleme, të tillë si: infrastruktura e dobët, struktura institucionale joadekuate, tregje të papërsosura të kapitalit dhe mallrave (Cornwall & Cornwall, 1994). Për këtë arsye, hartuesit e politikave duhet t'u kushtojnë vëmendje të gjithë faktorëve që përcaktojnë ndryshimet dhe ndikimet e tyre në normën e rritjes agregate dhe zhvillimin ekonomik të vendeve.

3. Arsimimi dhe zhvillimi ekonomik

3.1. Rëndësia e arsimimit në zhvillimin ekonomik

Më shumë arsimim dhe një arsimim më i mirë janë parakusht për një zhvillim të shpejtë ekonomik të vendit. Arsimimi stimulon rritjen ekonomike dhe përmirëson jetën e njerëzve përmes disa kanaleve: duke rritur eficientën e forcës punëtore, duke rritur demokracinë, duke krijuar kushte më të mira për një qeverisje të mirë, duke përmirësuar shëndetin, duke rritur barazinë (Gylfason, 2001).

Studime të ndryshme vërtetojnë lidhjen në mes arsimimit dhe zhvillimit ekonomik. Asteriou dhe Agiomirgianakis (2001) përdorin shkallën e regjistrimit në shkollë fillore, të mesme dhe universitet për të testuar lidhjen në mes arsimimit dhe rritjes ekonomike matur me GDP të vendit. Gjetjet e tyre tregojnë një marrëdhënie pozitive afatgjatë në mes rritjes në numrin e të regjistruarve në të gjithë nivelet e arsimimit kryesisht në dy nivelet e para dhe rritjes në normën e GDP-së (Asteriou & Agiomirgianakis, 2001).

Gjetjet e Hanushek dhe Wößmann (2007) tregojnë që vitet e ndjekjes së shkollës janë statistikisht domethënëse me normën e rritjes afatgjatë. Kjo marrëdhënie pozitive është më e lartë për vendet jo anëtare në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), sesa për vendet anëtare të OECD, ku tregon që kthimet më të larta të arsimimit mund të vërehen në vendet në zhvillim.

Duke analizuar shkakësinë dhe kointegrimin në mes arsimimit dhe GDP-së në rastin e Kinës, zhvillimi ekonomik është rezultat i arsimimit fillor dhe shkak i arsimimit të lartë (Liu, 2006). Gjetjet e Gylfason (2001) tregojnë që një rritje në normën e regjistrimit në shkollat e mesme shoqëroret me një rritje në GNP për frymë.

Studime tjera tregojnë lidhjen në mes arsimimit të lartë dhe zhvillimit ekonomik. Një lidhje e tillë vërehet në studimin e kryer në Rumani, ku evidenca tregon një lidhje afatgjatë në mes arsimimit të lartë dhe GDP-së për frymë gjatë periudhës në mes viteve 1980 dhe 2008 (Dănăciță, Belaşcu, & Ilie, 2010). Duke përdorur testet e shkakësisë-Granger dhe të kointegrimit, De Meulemeester dhe Rochat (1995) pohojnë se ekziston një marrëdhënie domethënëse në mes arsimimit të lartë dhe zhvillimit ekonomik për këto katër shtete: Suedinë (1910-1986), Britania e Madhe (1919-1987), Japoninë (1885-1975) dhe Francën (1899-1986). Gjetjet e Karagoz dhe Tsounis (2008) tregojnë gjithashtu që ekziston një lidhje në mes arsimimit të lartë dhe rritjes ekonomike për vendet e Ballkanit.

Psacharopoulos (1994) tregon se me arsimimin kemi kthim më të lartë në nivelin individual dhe shoqëror, kthime të cilat janë të reflektuara edhe në nivel ekonomie. Duke u nisur nga mikroperspektiva, arsimimi rrit kapitalin njerëzor të gatshëm për punë, i cili rrit produktivitetin e punës duke gjeneruar kështu nivel outputi më të lartë argumentuar në teorinë neoklasike të rritjes (Mankiw, Romer, & Weil, 1992). Rritja e produktivitetit përmirëson mirëqenien ekonomike për popullatën në përgjithësi (Hirschey, 2008). Ozturk (2001) thekson që arsimimi rrit jo vetëm produktivitetin dhe kreativitetin e njerëzve, por nxit sipërmarrjen dhe avancimet teknologjike. Nisur nga makroperspektiva rritja mesatare e numrit të regjistrimit në shkolla është e shoqëruar me rritje të njohurive njohëse dhe rritje në të ardhurat kombëtare (Breton, 2011). Gjetjet e OECD (2008) tregojnë që të ardhurat rriten me rritjen e nivelit arsimor dhe që personat me arsim të lartë kanë më shumë mundësi të punësohen sesa personat me arsim të mesëm.

3.2. Arsimi dhe zhvillimi ekonomik në Ballkanin Perëndimor

Kthimet më të larta nga arsimi mund të vërehen në vendet në zhvillim (Hanushek & Wößmann, 2007). Shtetet e Ballkanit Perëndimor¹⁰ si vende në zhvillim duhet të investojnë më shumë në arsimimin e brezave si një mjet për rritjen ekonomike. Gjetjet e Asteriou dhe Agiomirgianakis (2001) tregojnë që rritja e shpenzimeve qeveritare në arsim shoqërohet me rritje ekonomike të vendit. Modelet e reja të rritjes promovojnë rolin e qeverisë dhe politikave publike në investime plotësuese për formimin e kapitalit njerëzor dhe inkurajimin e investimeve të huaja private në industri intensive të dijes, siç janë softueri kompjuterik dhe telekomunikacioni (Meier, 2001).

Karagoz dhe Tsounis (2008) për vendet e Ballkanit tregojnë një marrëdhënie të fortë në mes arsimimit të lartë dhe rritjes ekonomike. Në Greqi, gjetjet e Gylfason (2001) tregojnë një lidhje të dyfishtë në mes arsimimit dhe rritjes ekonomike. Nga njëra anë arsimimi mundëson rritjen ekonomike, ana tjetër rritja ekonomike do të rrisë interesimin për ndjekjen e studimeve të larta, të cilat në afatin e gjatë ndikojnë në rritjen e mëtejshme ekonomike të vendit.

Nivelet e larta të arsimimit pa aspektin e cilësisë nuk kontribuojnë në mirëqenien e shtetit (Asteriou & Agiomirgianakis, 2001). Pa përmirësimin e cilësisë së shkollave, vendet në zhvillim do e kenë të vështirë të përmirësojnë performancën ekonomike afatgjatë (Hanushek, 2013). Për këtë arsye sistemi arsimor duhet të dizajnohet në përputhje me nevojat e ekonomisë (De Meulemeester & Rochat, 1995). Në këtë mënyrë vendet e Ballkanit Perëndimor mund të përdorin sistemin arsimor për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik.

Breton (2011) tregon sesi ndjekja e shkollës shoqërohet me zhvillim të njohurive dhe rritje të të ardhurave personale të individëve, njëherazi dhe me zhvillim ekonomik të vendit. Gjetjet e OECD (2008) tregojnë që me rritjen e arsimimit rriten mundësitë për punësim. Tabela 1-1 pasqyron rritjen e punësimit në përqindje sipas nivelit arsimor, ku shohim që kemi një rënie të punësimit të personave me kualifikim të ulët. Rënie e punësimit vërehet në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor edhe në personat me kualifikim të mesëm, përjashtim bën Serbia dhe Maqedonia. Nga ana tjetër, numri i punonjësve me kualifikim të lartë është rritur në tërë rajonin, nga ku norma më të larta vërehen në Mal të Zi dhe Maqedoni.

¹⁰ Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Serbia.

Tabela 1-1. Rritja e punësimit sipas nivelit arsimor mes viteve 2010-2016 (në %).

	Arsim i ulët	Arsim i mesëm	Arsim i lartë
Shqipëria	-12.9	0.2	34.0
Bosnja dhe Hercegovina	-23.2	-2.8	10.1
Kosova	-12.8	-5.0	20.2
Mali i Zi	4.9	-7.0	45.1
Maqedonia	-9.6	11.6	40.4
Serbia	-11.7	11.9	34.8
Kroacia	-42.4	-5.1	19.7

Burimi: Banka Botërore, 2017.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një popullsi të shkolluar. Tabela 1-2 pasqyron të dhënat në lidhje me popullsinë me shkollë të mesme, vitet mesatare të shkollimit dhe GDP për frymë për vendet e Ballkanit Perëndimor në krahasim me nivelin botëror. Nga tabela shohim që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përqindje më të lartë të ndjekjes së shkollës së mesme sesa niveli botëror, përjashtim bën Maqedonia. Kroacia ka përqindjen më të madhe të popullsisë me të paktën shkollë të mesme, ndërsa Mali i Zi ka normën më të lartë të viteve mesatare të shkollimit të popullsisë. GDP për frymë është poshtë nivelit botëror për pjesën më të madhe të vendeve, përjashtim bën Mali i Zi dhe Kroacia. Bosnja dhe Hercegovina ka normën më të ulët të viteve mesatare të shkollimit dhe të GDP-së për frymë në Ballkanin Perëndimor.

Tabela 1-2. Popullsia me shkollë të mesme, vitet mesatare të shkollimit dhe GDP për frymë për vendet e Ballkanit Perëndimor në krahasim me nivelin botëror.

	Popullsia me shkollë të mesme (të paktën e ka filluar) në %	Vitet mesatare të shkollimit	GDP për frymë në \$
Shqipëria	90.3	9.6	10,397
Bosnja dhe Hercegovina	78.0	9.0	10,024
Mali i Zi	89.2	11.3	15,010
Maqedonia	47.8	9.4	12,725
Serbia	86.7	10.8	12,863
Kroacia	95.8	11.2	20,430
Niveli botëror	64.9	12.3	14,600

Burimi: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, 2016.

Vendet e Ballkanit Perëndimor mund ta përdorin arsimimin si një mjet për zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Nga tabela 1-2 kuptojmë që ekziston një lidhje në mes arsimit dhe zhvillimit ekonomik, nga ku vërehet që vendet me vite mesatare të shkollimit më të larta kanë GDP për frymë më të lartë. Kjo lidhje përforcon arsyetimin për investime në arsimim si motor të rritjes. Më shumë arsimim dhe një arsimim më i mirë tentojnë të zhvendosin avantazhin konkurrues nga prodhimi primar drejt industrive përpunuese dhe shërbimeve, duke rritur njohuritë dhe duke nxitur rritjen (Gylfason, 2001).

4. Kufizimet e punimit

Edhe pse punimi është përgatitur me kujdes dhe trajton një çështje të rëndësishme për të cilën nuk janë realizuar shumë studime në Ballkanin Perëndimor, ne jemi të vetëdijshëm që ekzistojnë kufizime. *Së pari*, të dhënat empirike të pasqyruara për krahasim në mes vendeve janë të vlerësuara në një pikë kohore si pasojë e mungesës së të dhënave të marra në konsideratë ndër vite. *Së dyti*, ekzistojnë elemente të tjera, të cilat mund të tregojnë lidhjen në mes arsimimit dhe zhvillimit ekonomik që nuk janë marrë në konsideratë, si vitet mesatare të shkollimit të popullsisë dhe të ardhurat mesatare familjare. *Së treti*, si pasojë e mungesës së të dhënave nuk është realizuar një analizë empirike e detajuar për të treguar lidhjen që ekziston në mes arsimimit dhe zhvillimit ekonomik.

Pavarësisht kufizimeve autorët do të punojnë në mbledhjen e të dhënave që në të ardhmen të realizojnë një punim për të kapërcyer kufizimet e mësipërme.

5. Konkluzione

Arsimimi është një ndër elementët kyç të zhvillimit ekonomik të vendit. Studime të realizuara në vende të ndryshme vërtetojnë lidhjen statistikore në mes arsimimit dhe rritjes ekonomike Asteriou & Agiomirgianakis (2001), De Meulemeester & Rochat (1995), Liu (2006), Dăncăică, Belaşcu, & Ilie (2010), Gylfason (2001), Karagoz & Tsounis (2008).

Psacharopoulos (1994) tregon se me arsimimin kemi kthim më të lartë në nivelin individual dhe shoqëror, kthime të cilat janë të reflektuara edhe në nivel ekonomie. Hanushek & Wößmann (2007) argumentojnë që

kthimet më të larta të arsimimit mund të vërehen në vendet në zhvillim.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një popullsi që i afrohet mesatares botërore në lidhje me numrin e viteve mesatare të shkollimit. Gjithnjë e më shumë në këto vende po kërkohet forcë punëtore me kualifikim të lartë. Meqë popullsia në këto vende tenton të shkollohet gjithnjë e më shumë, vendet mund të përdorin sistemin arsimor për të plotësuar nevojat ekonomike.

Arsmimi jo vetëm që mundëson punësim më të lehtë dhe të ardhura më të larta individuale, përdorim më të mirë të tokës dhe burimeve natyrore, tërheqjen e investimeve të huaja në industri të caktuara, por njëherazi nxit sipërmarrjen dhe inovacione teknologjike.

Referenca

- Aghion, P., & Howitt, P. (1992). A model of growth through creative destruction. *Econometrica*, 60(2), 323–351.
- Asteriou, D., & Agiomirgianakis, G. M. (2001). Human capital and economic growth: time series evidence from Greece. *Journal of Policy Modeling*, 23(5), 481-489.
- Barro, R. J. (2000). Education and economic growth. Harvard University.
- Breton, T. R. (2011). The quality vs. the quantity of schooling: What drives economic growth? *Economics of Education Review*, 30(4), 765-773.
- Breton, T. R. (2013). The role of education in economic growth: theory, history and current returns. *Educational Research*, 55(2), 121-138.
- Cornwall, J., & Cornwall, W. (1994). Growth theory and economic structure. *Economica*, 237-251.
- Dănăciță, D. E., Belășcu, L., & Ilie, L. (2010). The interactive causality between higher education and economic growth in Romania. *International Review of Business Research Papers*, 6(4), 491-500.
- Dang, G., & Pheng, L. S. (2015). *Theories of economic development*. Springer: Singapore.
- De Meulemeester, J. L., & Rochat, D. (1995). A causality analysis of the link between higher education and economic development. *Economics of Education Review*, 14(4), 351-361.
- Domar, E. D. (1947). Expansion and employment. *The American Economic Review*, 37(1), 34-55.

- Gylfason, T. (2001). Natural resources, education, and economic development. *European economic review*, 45(4), 847-859.
- Hanushek, E. A. (2013). Economic growth in developing countries: The role of human capital. *Economics of Education Review*, 37, 204-212.
- Hanushek, E. A., & Wößmann, L. (2007). The role of education quality for economic growth.
- Harrod, R. F. (1948). *Towards a dynamic economics, some recent developments of economic theory and their application to policy*. London: Macmillan.
- Hirschey, M. (2008). *Managerial Economics (bot. i 12)*. Cengage Learning.
- Karagoz, M., & Tsounis, N. (2008). *Higher Education and Economic Development in the Balkan Countries: A Panel Data Analysis*.
- Liu, K. (2006). The interactive causality between education and economic growth in China.
- Lucas, R. E. (1988). On the mechanics of economic development. *Journal of monetary economics*, 22(1), 3-42.
- Mankiw, N. G., Romer, D., & Weil, D. (1992). A contribution to the empirics of economic growth. *Quarterly Journal of Economics*, 107(2), 407-437.
- Meier, G. M. (2001). The old generation of development economists and the new. *Frontiers of development economics*, 13-50.
- OECD. (2008). *Education at a glance 2008*.
- Ozturk, I. (2001). The role of education in economic development: a theoretical perspective. *Journal of Rural Development and Administration*, 33(1), 39-47.
- Psacharopoulos, G. (1994). Returns to investment in education: A global update. *World development*, 22(9), 1325-1343.
- Psacharopoulos, G., & Patrinos, H. A. (2004). Returns to investment in education: a further update. *Education economics*, 12(2), 111-134.
- Romer, P. M. (1986). Increasing returns and long-run growth. *Journal of political economy*, 94(5), 1002-1037.
- Rostow, W. W. (1990). *The stages of economic growth: A non-communist manifesto*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Schultz, T. W. (1961). Investment in human capital. *The American economic review*, 1-17.
- Smith, A. (1976). *An inquiry into the nature and causes of the wealth of nations*. Oxford: Clarendon Press.
- Solow, R. M. (1956). A contribution to the theory of economic growth. *The quarterly journal of economics*, 70(1), 65-94.

- Stevens, P., & Weale, M. (2004). Education and economic growth. *International handbook on the economics of education*, 27, 205-311.
- Todaro, M., & Smith, S. (2009). *Economic development (bot. i 10)*. Boston: Addison Wesley.
- United Nations Development Programme. (2016). *Human Development Report 2016 Human Development for Everyone*.
- World Bank. (2017). *Western Balkans Labor Market Trends 2017*.

FAKTORËT NDIKUES NË CILËSINË E INFORMACIONIT KONTABËL

Erion Shala,¹¹

Professional Partners sh.p.k, Shkodër

Elidiana Bashi¹²

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i
Financë-Kontabilitetit*

Abstrakt

Informacioni kontabël është një output i përdorshëm dhe i dobishëm për një numër të madh aktorësh apo grupesh interesi. Problematika e këtij informacioni është se për më shumë se dy dekada është konceptuar thjesht si raportim i detyrueshëm i synuar për pjesën fiskale duke ulur

¹¹ Jam diplomuar në vitin 2014 me diplomën bachelor në degën financë – kontabilitet pranë universitetit Luigj Gurakuqi dhe në vitin 2016 jam diplomuar në master Kontabilitet po në këtë universitet. Eksperiencia ime profesionale shtrihet gjatë 4 viteve të fundit pranë një zyre që ofron shërbime kontabiliteti dhe konsulence. Fillimet e mia kanë qenë të përqendruara në problematikat e biznesit të vogël kryesisht në lidhje me aspektet tatimore, kurse dy vitet e fundit jam përqendruar në aspektet kontabël dhe fiskal kryesisht për bizneset e mëdha. Aspektet profesionale të mia nuk kufizohen vetëm në pjesën e shërbimeve të mbuluara nga zyra ime, por kam mbajtur leksione të hapura pranë Fakultetit Ekonomik në lidhje me evazionin fiskal dhe pjesën fiskale që duhet të mbulojnë ekonomistët për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe cikël leksionesh pranë një OJQ në lidhje me përdorimin e sistemeve të informacionit kontabël në Shqipëri. Gjithashtu një pjesë e rëndësishme kryesisht vitin e fundit ka pasur menaxhimi i eksportit dhe konkretisht krijimi i modeleve të përshtatura për biznese specifike me qëllim lehtësimin e hyrjes në tregje të huaja.

¹² Në mars, 2013, lektore finance me kohë të plotë Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Më parë lektore finance me kohë të plotë universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe punonjëse e auditit të brendshëm pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë – dega Shkodër. Pjesëmarrëse në shumë konferenca ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe botuese e shumë publikimeve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Që nga viti 2009, ka fituar gradën shkencore “Doktor në financë” nga universiteti shtetëror i Tiranës. elidianapema@yahoo.com

përdorueshmërinë e tij nga aktorë të tjerë dhe rrjedhimisht cunguar cilësinë e tij. Informacioni kontabël është cilësor dhe i besueshëm në qoftë se është i përgatitur në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe është shumë i rëndësishëm për marrjen e vendimeve të suksesshme. Qëllimi i studimit është gjetja e faktorëve që ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël dhe ndërtimi i një modeli të përshtatshëm për paraqitjen e marrëdhënies ndërmjet faktorëve ndikues tek cilësia e informacionit kontabël si dhe dhënia e konkluzioneve dhe rekomandimeve rreth përmirësimit të saj. Për të realizuar këtë qëllim janë mbledhur të dhëna primare nëpërmjet anketimeve me pyetësorë. Kjo metodë cilësore e mbledhjes së të dhënave paraqet edhe kufizimet e veta duke qenë se sasia e informacionit është e kufizuar në një numër të vogël të të anketuarve. Pas mbledhjes së të dhënave u vijua me analizën e tyre dhe u nxorën statistika përshkruese të informacionit dhe u bë analizë statistikore e tyre. Nga të dhënat e përfituara nga analiza u arrit në përfundimin që madhësia e biznesit, përdorimi i levës financiare dhe rritja e kontrolleve tatimore ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël.

Fjalët kyçe të përdorura - informacion kontabël, raportim financiar, kontabilitet financiar, legjislacion tatimor etj.

Factors influencing the quality of accounting information

Abstract

Accounting information is an usable and useful output for a wide range of actors or stakeholders. The problem about this information is that for more than two decades it was simply conceived as mandatory reporting aimed for the fiscal authorities thus reducing its usability by other stakeholders and consequently decreasing its quality. The information is qualitative and reliable if it is prepared in accordance with the national accounting standards and it is very important for successful decision making. The aim of this study is finding the factors that influence the quality of accounting information and building an appropriate model that show the connection between these factors and quality of accounting information and reaching some conclusions and giving some recommendations about its improvement. To reach this aim we have collected information from primary sources through questionnaires. This qualitative method of data gathering has its own limitations because the

quantity of information is restricted in a small number of surveyed. The data collection was followed by their data analysis and descriptive statistics of the was extracted and was statistically analyzed. From the data obtained from the analysis it was concluded that the size of the business, the use of financial leverage and increase tax audits affect the quality of accounting information.

Keywords Used - accounting information, financial reporting, accounting, fiscal legislation etc.

Hyrje

Kontabiliteti në vetvete ka për qëllim prodhimin e raporteve dhe pasqyrave të cilat janë të përdorshme dhe të dobishme për një numër të madh aktorësh apo grupesh interesi. Duke qenë se informacioni kontabël ka një shumëllojshmëri përdorimesh ai është i vlefshëm për vendimmarrje qoftë nga ana e menaxhërve p.sh., përcaktimi i kostos, vendosja e marzheve të fitimit dhe ndihma në politikat e vendosjes së çmimeve; nga ana e kreditorëve p.sh., bankat të cilat nëpërmjet informacionit kontabël arrijnë të vlerësojnë besueshmërinë si dhe aftësinë paguese të njësisë ekonomike në rastet e paraqitjes së raporteve financiare për kredidhënie; nga organet fiskale të cilat vlerësojnë se detyrimi tatimor i vetëdeklaruar nga firma është i saktë dhe në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Problematika e informacionit kontabël është se për më shumë se dy dekada është konceptuar thjesht si raportim i detyrueshëm i synuar për pjesën fiskale. Rrjedhimisht ky informacion kontabël bëhej i papërdorshëm për disa grupe interesi të tilla si bankat apo pronarët, sepse në fillimet e tyre pasqyrat financiare nuk kishin as një format standard të përcaktuar ligjërisht që të lejonte punën me këto pasqyra.

Legjislacioni tatimor përcakton të detyrueshme për njësitë ekonomike që trajtohen si biznes i madh të mbajnë libra dhe regjistrime të mirëfillta kontabël ndryshe nga biznesi i vogël, i cili ka për detyrim ligjor dorëzimin vetëm të një deklarate vjetore të tatimit të thjeshtuar. Rrjedhimisht pritet që biznesi të jetë subjekt i rregullimeve të shumta ligjore dhe i kontroleve më të rrepta nga ana e administratës tatimore. Pritet që biznesi i madh të ketë një cilësi më të madhe të informacionit kontabël i cili të jetë i përdorshëm për një kategori më të madhe përdoruesish.

Format e ndryshme të pronësisë që ekzistojnë mund të ndikojnë direkt ose indirekt në cilësinë e informacionit kontabël të ofruar. Njësitë ekonomike me një konflikt të mundshëm të agjencisë pritet të japin një

kuadër më të gjerë informacioni që nuk ndalet tek kërkesat minimale ligjore duke rezultuar në një cilësi më të lartë të këtij të fundit.

Në mungesën e një tregu financiar njësitë ekonomike shqiptare mbulojnë nevojën për financim nga institucionet bankare. Këto institucione kanë rregullore të përcaktuara qartë mbi likuiditetin dhe aftësinë paguese që duhet të ketë kredimarrësi si dhe kërkojnë informacione shtesë në varësi të fushës ku operon biznesi. Në këto kushte lind nevoja për një informacion gjithëpërfshirës për qëllime financimi i cili i jep informacion të mjaftueshëm edhe punonjësit të bankës.

Faktor i jashtëm i cili mundet të ndikojë në cilësinë e informacionit kontabël është trysnia e ushtruar nga ana e administratës tatimore. Në kushtet e kontrollove të shumta dhe të detajuara tatimore cilësia e informacionit kontabël nevojitet të jetë mjaft e lartë me qëllim shmangien e penaliteteve të ndryshme nga ana e administratës tatimore.

1.1 Pyetja kërkimore

Nga sa thamë më sipër informacioni kontabël ka njohur përmirësim me kalimin e viteve dhe me futjen e përmirësimin e vazhdueshëm të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Por për të pasur një përmirësim të mëtejshëm ne duhet të evidentojmë faktorët që ndikojnë në mënyrë direkte në cilësinë e informacionit kontabël dhe ndërhyrjet e ardhshme me qëllim përmirësimin e këtij informacioni duhet të jenë të synuara pikërisht në këto elemente.

Duke pasur parasysh elementet e mësipërme pyetja kërkimore është: *“Cilët janë faktorët që ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël të njësive ekonomike që operojnë në qytetin e Shkodrës?”*

Duke u nisur nga pyetja kërkimore, bagazhi i njohurive, formimi akademik dhe praktik kemi ngritur për testim hipotezat e mëposhtme:

Hipoteza e parë H_0 : Rritja e madhësisë së njësive ekonomike ndikon në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël rreth saj.

Hipoteza e dytë H_0 : Shpërndarja e pronësisë në një numër më të madh pronarësh ndikon në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël.

Hipoteza e tretë H_0 : Përdorimi i levës financiare është faktor ndikues në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël

Hipoteza e katërt H_0 : Cilësia e informacionit kontabël rritet me rritjen e kontroleve të ushtruara nga ana e administratës tatimore.

1.2 Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është gjetja e faktorëve që ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël dhe ndërtimi i një modeli të përshtatshëm për

paraqitjen e marrëdhënies ndërmjet faktorëve ndikues dhe cilësisë si dhe dhënia e konkluzioneve dhe rekomandimeve rreth përmirësimit të cilësisë së informacionit.

1.3 Objektivat e studimit

Ky studim ka si objektiv të përcaktojë:

1. Faktorët që ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël.
2. Efektet që mund të ketë ndryshimi i këtyre faktorëve në rritjen apo zvogëlimin e cilësisë së informacionit.

1.4 Kufizimet e studimit

Kufizimet kryesore të studimit janë:

1. Kontabiliteti është një fushë komplekse dhe si e tillë për të bërë një analizë të detajuar të faktorëve që ndikojnë në cilësinë e informacionit nevojitet më shumë kohë në dispozicion.
2. Aksesit i informacionit – Mënyra më e përshtatshme është nëpërmjet pyetësorëve të drejtuar menaxherëve të njësive ekonomike gjë që kërkon kohë dhe bën që sasia e informacionit që mund të përfitohet të mos jetë shumë e madhe.
3. Mostra – Ky është një problem mjaft i rëndësishëm i studimit. Numri i të anketuarve është 50 dhe është relativisht i vogël në krahasim me popullatën e marrë në shqyrtim.

Rishikimi i literaturës

Informacioni kontabël konsiderohet të ketë një cilësi të mirë në qoftë se është në gjendje të plotësojë kushtet që informacioni të jetë i saktë, i plotë, i qëndrueshëm, në kohë dhe unik (Baltzan, 2012). Sipas (Gelinas, 2012) informacioni cilësor është informacioni i cili jep përfitime për vendimmarrësit. Përdoruesit kanë kritere të ndryshme për cilësinë e informacionit më qëllim përcaktimin e cilësisë së vendimmarrjes duke vënë theksin në rëndësinë, kohën, saktësinë dhe plotësinë e informacionit. Informacion cilësor është informacioni që është i përshtatshëm për përdorimin nga konsumatorët apo përdoruesit. Cilësia e informacionit ka karakteristika që mund të plotësojnë apo tejkalojnë pritshmëritë e klientëve apo përdoruesve të informacionit. (Eppler, 2006) shpjegon që cilësia e informacionit është një term që përshkruan karakteristikat e informacionit që e bëjnë këtë të fundit të dobishëm për përdoruesit. Përcaktimi i cilësisë së informacionit është i lidhur me katër dimensione ku cilësia e informacionit nënkupton që ai të jetë i saktë, i plotë, i qëndrueshëm dhe aktual apo në kohë.

Rëndësia për përmirësimin e kuptimit tonë të praktikave të deklarimit të kompanive tregohet nga pjesa institucionale që luan informacioni i deklaruar nga një kompani. Kjo ndihmon në rregullimin e marrëdhënieve që ekzistojnë ndërmjet një njësie ekonomike dhe mjedisit të saj. Informacioni kontabël përdoret për të ndërtuar një marrëdhënie ndërmjet organizatës dhe mjedisit të saj që ka për qëllim nxjerrjen e përfitimeve nga ajo (Buzby, 1975).

Një informacion më cilësor kontabël ndikon në uljen e pasojave ekonomike, të tilla si: ulja e kostove të kapitalit që lindin nga asimetria e informacionit (Leuz, 2000), rritjen e efikasitetit të alokimit të kapitalit (Bushman, 2006) si dhe rritjen e transparencës për grupet e interesit qofshin ato investitorë apo shteti.

Përveç studimeve të cilat përcaktojnë se çfarë karakteristikash cilësore duhet të ketë informacioni kontabël në mënyrë që të jetë cilësor, në kuadër të studimit tonë na vijnë në ndihmë studimet që përcaktojnë se cilët janë faktorët që ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël.

Sipas (Ball, 2005) struktura e pronësisë është një faktor ndikues në cilësinë e informacionit kontabël. Sipas tij në vendet me një mbrojtje të fuqishme ligjore të aksionerëve ne presim që interpretimi të shkojë drejt një paraqitjeje të saktë të informacionit tek aksionerët. Kryesisht në rastet kur pronësia është e shpërndarë në më shumë aksionerë pritet që cilësia e informacionit kontabël të jetë e lartë me qëllim shmangien e asimetrisë së informacionit dhe konflikteve të mundshme të agjencisë.

Përdorimi i levës financiare është një element tjetër që mund të ndikojë në cilësinë e informacionit kontabël të dhënë nga njësi ekonomike. Qëllimi i informacionit kontabël siç thamë në pjesën e mëparshme është që të japë një pamje të qartë për përdorues të ndryshëm qoftë brenda njësisë ekonomike ashtu edhe jashtë saj. Leva financiare nënkupton përdorimin e borxhit si mjet financimi dhe në mënyrë që të marrë një kredi pranë bankave, njësi ekonomike duhet të ketë fillimisht një nivel të lartë transparence dhe cilësisë së raporteve financiare të ofruara. Investitorët si përdorues të jashtëm të informacionit nuk do t'i besojnë informacionit kontabël me cilësi të dobët dhe kjo gjë do t'i nxisë në alokimin e fondeve të tyre në investime të tjera (Kieso, 2007).

Madhësia e njësisë ekonomike përcakton gjithashtu cilësinë e informacionit kontabël sepse ndërveprimet e njësisive më të mëdha ekonomike me shoqërinë dhe me grupet e ndryshme të interesit janë më të shumta dhe kanë një rëndësi më të madhe ekonomike. Si rezultat ato i nënshtrohen presioneve relativisht të larta politike dhe rregulluese nga grupet që kanë interesa të jashtme (Belkaoui, 1989). Për më tepër,

organizatat më të mëdha tentojnë të favorizojnë kanalet formale të komunikimit, të tilla si raportimi financiar, në mënyrë që të shpërndajnë informacion në lidhje me aktivitetet e firmës (Cowen, 1987).

Sipas (La Porta, 1998) rritja e trysnisë ligjore ndikon në cilësinë e deklarimeve që bëjnë njësitë ekonomike. Sipas tij në kushtet kur rregullimi ligjor në lidhje me deklarimin e informacionit kontabël rritet kemi një rritje të transparencës dhe cilësisë së këtij të fundit. Ky model arsyetimi mundet të na vijë në ndihmë në lidhje me studimin tonë. Kjo sepse kuadri ligjor sidomos ai tatimor është në ndryshim të herëpashershëm me qëllim arritjen e një standardi ligjor i cili është i ngjashëm me atë të vendeve të Evropës.

Metodologjia

3.1 Popullata dhe krijimi i mostrës

3.1.1 Popullata

Popullata përbehet nga të gjithë njësitë ekonomike të regjistruara sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe që kanë detyrim raportimin vjetor të tatimit mbi fitimin apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Këtu përfshijmë:

1. Personat fizikë të regjistruar si biznes i vogël që nuk kalojnë qarkullimin vjetor prej 8 milionë lekësh.
2. Personat fizikë dhe ato juridikë të cilët kalojnë qarkullimin vjetor prej 8 milionë lekësh. Mbi këtë kufi lind detyrimi i dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore sipas formatit të miratuar nga standardet kombëtare të kontabilitetit.

3.1.2 Krijimi i mostrës

Duke pasur parasysh numrin e madh të subjekteve që operojnë në qytetin tonë dhe mungesës së një infrastrukture të përshtatshme për mbledhje në nivel përgjithësues të të dhënave u mendua të ndiqej një metodë kampionimi jo probabilitar përkatësisht kampioni konvenient. Mostra konveniente është një metodë e përzgjedhjes së të anketuarve për shkak të disponueshmërisë apo aksesit të lehtë ndaj tyre. Avantazhet e kësaj teknike të përzgjedhjes së mostrës janë disponueshmëria dhe shpejtësia me të cilën mund të përzgjedhen të dhënat si dhe kostoja e ulët për të arritur këtë kampion. Mostra fillestare përbëhet nga 50 subjekte të anketuar ku pjesa më e madhe janë klientë të zyrës kontabël në të cilën unë punoj. Nga mostra fillestare prej 50 subjektësh të cilët pranuan t'i përgjigjeshin pyetësorit, 5 prej tyre u përjashtuan si pyetësorë të pavlefshëm për shkak se pyetësorët e tyre kishin pyetje të papërgjigjura, të cilat nuk mund të jenë pjesë e studimit. Mostra përfundimtare prej 45 subjektësh përbëhet si nga persona juridikë ashtu edhe nga persona fizikë.

3.2 Metodologjia

Pas përzgjedhjes së mostrës u vijua me përcaktimin e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave. Baza e të dhënave që do të përdoret në këtë studim do të jenë të dhëna primare të marra direkt nga subjektet e përzgjedhura nga mostra.

3.3 Metodat

Metoda e mbledhjes së të dhënave është një metodë cilësore. Metodatat cilësore janë të përshtatshme në studimin tonë për shkak se këto metoda synojnë të japin përgjigje se pse dhe si ndikojnë faktorë të ndryshëm në cilësinë e informacionit kontabël. Në rastin tonë si metodë cilësore e mbledhjes së të dhënave u përdor metoda e anketimit nëpërmjet pyetësorit.

3.4 Kuadri konceptual

Kuadri konceptual është një mjet analitik i cili na vjen në ndihmë për të bërë dallime konceptuale dhe na shërben për të krijuar një ide të qartë dhe vizuale për mënyrën se si lidhen variablat me njëri-tjetrin dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet tyre. Kuadri konceptual për studimin tonë është si vijon:

Figura 1 - Kuadri konceptual



Sipas kuadrit konceptual të shfaqur më sipër vërehet qartë lidhja që kanë variablat e pavarur me variablin e varur. Variablat e pavarur janë madhësia e firmës, shpërndarja e pronësisë, përdorimi i levës financiare dhe rritja e kontrolleve financiare kurse variabli i varur është cilësia e informacionit kontabël.

3.7 Modeli statistikor

Kuadri i mësipërm konceptual përkthehet në të dhëna të përdorshme për të arritur përfundime nëpërmjet ekuacionit të regresionit. Ekuacioni i regresionit përbëhet nga variabli i varur që do të shënohet si CIK (Cilësia e informacionit kontabël) dhe do të ketë variabla të pavarur MF (Madhësia e firmës), SP (Shpërndarja e pronësisë), LF (përdorimi i levës financiare), KF (Rritja e kontrolleve financiare). Këto variabla lidhen në ekuacionin e regresionit si më poshtë:

$$CIK = \alpha + \beta_1 MF + \beta_2 SP + \beta_3 LF + \beta_4 KF$$

Ku α është konstante ndërsa β_1 , β_2 , β_3 , β_4 , β_5 janë koeficientët e variablave.

3.8 Teknikat e përdorura për analizën e të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave lind e nevojshme gjetja e një rruge të përshtatshme për analizën e tyre. U mendua që analiza të kryhej nëpërmjet analizës përshkruese (Deskriptive) me ndihmën e tabelave dhe grafikëve si dhe nëpërmjet analizave më të ndërlikuara statistikore dhe futjen e të dhënave të përfituara nga pyetësi në ekuacionin e regresionit. Gjetja dhe përdorimi i variablave të përdorur në këtë ekuacion janë të sugjeruara nga studimet e konsultuara gjatë rishikimit të literaturës dhe në bazë të disa përshtatjeve që janë menduar të përshtatshme për vendin tonë.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave të grumbulluara me anë të pyetësorëve u realizua nëpërmjet Excel dhe paketës statistikore GRETL.

ANALIZA DHE REZULTATET E STUDIMIT

4.1. Karakteristikat e të anketuarve

Nga 45 subjekte 28 të anketuar ishin persona fizikë dhe pjesa tjetër prej 17 subjektësh ishin persona juridikë. Kjo përsa i përket formës juridike të krijimit të tyre. Trajtimi fiskal ndryshon nga forma juridike. Kjo për shkak se një subjekt mund të ketë formë juridike si person fizik, por fiskalisht trajtohet si biznes i madh. Rrjedhimisht ndër të anketuarit 26 persona fizikë trajtoheshin fiskalisht si biznes i vogël ku nga këto 8 ishin nën qarkullimin


vjetor prej 2 milionë lekësh dhe 18 ishin në nivelin 2 – 8 milionë lekësh qarkullim vjetor. Pjesa e mbetur prej 19 subjektsh trajtoheshin fiskalisht si biznes i madh.

Figura 2 - Klasifikimi ligjor dhe fiskal i të anketuarve



Përveç formës ligjore, fiskale dhe vitit të krijimit, objekt studimi në pjesën e parë të pyetësorit ishte edhe fusha e veprimtarisë në të cilën operon njësi ekonomike. Kjo fushë në pamje të parë duket më pak e rëndësishme, por ka rëndësi sepse fusha të ndryshme të veprimtarisë përdorin mënyra të ndryshme financimi dhe vendimmarrje të cilat mund të shërbejnë si variabël i jashtëm ndikues në variablat e pavarur të përzgjedhur. Në totalin prej 45 subjektsh të anketuara, 24 prej tyre, pra rreth 53 % ishin subjekte që operonin në fushën e tregtisë.

Figura 3 - Shpërndarja e të anketuarve sipas fushës së veprimtarisë.




Të pyetur rreth rëndësisë së informacionit që i jepnin menaxherët apo kontabilistët informacionit kontabël në vendimmarrjen rreth ecurisë së biznesit vetëm 3 biznese mendonin se informacioni kontabël ishte pak i rëndësishëm, 11 biznese apo 24.44% mendonin se ishte disi i rëndësishëm dhe peshën kryesore e mbanin 16 biznese apo 35.56 % që mendonin se informacioni kontabël ishte i rëndësishëm dhe 15 biznese apo 33.33 % që mendonin se ishte shumë i rëndësishëm.

Tabela 1 - Niveli i rëndësisë së informacionit kontabël sipas menaxhereve.

Pak i rëndësishëm	Disi i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Total
3	11	16	15	45
6.67 %	24.44%	35.56%	33.33%	100%

Figura 4 - Niveli i rëndësisë së informacionit kontabël sipas menaxhereve.



Pjesë e analizës është edhe studimi statistikor nëpërmjet ekuacionit linear të regresionit. Ky ekuacion na vjen në ndihmë në përcaktimin e lidhjes së variablave të pavarur me variablin e varur. Pyetjet e pyetësorit të ndërtuara me shkallë 5 – she likert kërkon që të anketuarit t'i japin rëndësi nga 1 deri te 5 informacionit kontabël. Për variablin e parë të pavarur që është madhësia e biznesit llogarisim vlerën e P-së dhe shohim në qoftë se ky variabël është statistikisht i rëndësishëm për variablin e varur. Nga paketa statistikore e programit shohim që vlera e p-së është më e vogël se 0.05 që

tregon se variabli i pavarur që është madhësia e biznesit ndikon tek variabli i varur që është cilësia e informacionit. Pra supozimi që madhësia e biznesit ndikon në cilësinë e informacionit është i saktë.

Model 1: OLS, using observations 1-45

Dependent variable: Cilesia e informacionit


	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	2.04486	0.329715	6.2019	<0.0001	***
Madhesia e biznesit	0.859813	0.141019	6.0971	< 0.0001	***
Mean dependent var	3.955556	S.D. dependent var	0.928233		
Sum squared resid	20.33271	S.E. of regression	0.687644		
R-squared	0.463674	Adjusted R-squared	0.451201		
F(1, 43)	37.17513	P-value(F)	2.64e-07		
Log-likelihood	-45.97752	Akaike criterion	95.95505		
Schwarz criterion	99.56837	Hannan-Quinn	97.30206		

rjedhimisht arrijmë në përfundimin që **vërtetohet hipoteza bazë pra :**

H₀: Rritja e madhësisë së njësisë ekonomike ndikon në rritjen e cilësisë së informacioni kontabël rreth saj.

Një element i cili është qëllim studimi gjatë analizës së të dhënave është sa ndikon kredia bankare në cilësinë e informacionit kontabël. Fillimisht për këtë ishte e rëndësishme të përcaktohej në qoftë se të anketuarit kishin pasur më parë kredi bankare, sepse aplikimi për kredi bankare nënkuptonte që kishin dorëzuar një informacion cilësor kontabël, i cili shpeshherë kërkon të dhëna më të detajuara se sa informacioni i kërkuar nga ana tatimore. Nga anketimi i bërë u arrit në përfundimin që 27 subjekte nuk kishin pasur më parë kredi bankare kurse 18 kishin pasur ose kishin aktualisht kredi bankare.

Përveç ekzistencës së kredisë bankare të anketuarit u pyetën rreth rëndësisë që kishte informacioni kontabël në akordimin e kredisë. Dihet se një ndër kërkesat kryesore për akordimin e një kredie bankare është dorëzimi i pasqyrave financiare dhe se informacioni duhet të jetë sa më cilësor në mënyrë që të tejkalojë elementet minimale të përcaktuara sipas kriterëve të bankës. Rjedhimisht subjektet që kanë pasur kredi të mëparshme pritet të kenë një cilësi më të lartë të informacionit kontabël me qëllim plotësimin e kriterëve të vendosura nga banka.

Figura 5 - Ekzistenca e kredisë bankare.

Model 1: OLS, using observations 1-45
 Dependent variable: Cilësia e informacionit

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	-0.827896	0.372748	-2.2211	0.0317	**
Ekzistenca levës financiare	e 0.286297	0.0855142	3.3479	0.0017	***

Mean dependent var	0.400000	S.D. dependent var	0.495434
Sum squared resid	8.566884	S.E. of regression	0.446352
R-squared	0.206770	Adjusted R-squared	0.188323
F(1, 43)	11.20874	P-value(F)	0.001700
Log-likelihood	-26.53017	Akaike criterion	57.06034
Schëarz criterion	60.67367	Hannan-Quinn	58.40735

Të dhënat e mësipërme dalin nga përpunimi formulës së regresionit për përdorimin e levës financiare. Fillimisht janë koduar të dhënat në mënyrë që të ketë një lidhje logjike ndërmjet variablave të varur dhe të pavarur. Variabli i pavarur është ekzistenca e levës financiare kurse variabli i varur është cilësia e informacionit kontabël. Supozimi bazë mbi të cilin u ndërtua

modeli i kodimit të pyetësorit ishte se në qoftë se njësitë ekonomike rrisin përdorimin e levës financiare pra të financimit të jashtëm nëpërmjet borxhit, atëherë do të rritet edhe cilësia e informacionit kontabël si pasojë. Nga llogaritjet e bëra kemi që vlera e P-së është 0.17% e cila është dukshëm nën vlerën 5% që është pragu maksimal mbi të cilën një variabël i pavarur të jetë statistikisht i rëndësishëm për variablin e varur. Pra nga sa u tha më sipër **vërtetohet hipoteza bazë që:**


H₀: Përdorimi i levës financiare është faktor ndikues në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël

Nëpërmjet modelit statistikor vërtetohet që një rritje në përdorimin e levës financiare ndikon në përmirësimin e cilësisë së informacionit. Këtu kanë ndikim politikat e bankës të cilat kërkojnë shpeshherë një informacion më të zgjeruar se sa ai i detyrueshëm fiskal duke përfshirë të ardhurat ditore, hyrjet e daljet, specifikime mbi marzhet e produkteve etj. Kjo ndikon në mënyrë direkte që ato subjekte të cilët aplikojnë për kredi të jenë të nxitur të rrisin cilësinë e informacionit kontabël që ato posedojnë në mënyrë që në një moment të dytë të jetë i përdorshëm edhe nga përdorues të jashtëm si bankat.

Pyetësi kishte për qëllim marrjen e një morie informacionesh në të cilat përfshihen edhe informacionet në lidhje me pronësinë. Sipas legjislacionit shqiptar ka disa forma juridike në të cilat krijohen njësitë ekonomike, por u drejtua një pyetje e cila kishte për qëllim të dinte se si ishte e shpërndarë pronësia në njësitë ekonomike të anketuara. U vendosën tri mundësi të ndryshme ku e para ishte me një pronar, e dyta ishte me dy pronarë ku mundësia e konfliktit është më e vogël, sepse asimetria e informacionit është shumë e vogël në këto kushte dhe opsioni i fundit ishte me më shumë se dy pronarë ku probabiliteti i konfliktit është më i lartë për shkak se asimetria e informacionit pritet të jetë më e lartë. Për të shmangur asimetrinë e informacionit cilësia e informacionit kontabël duhet të jetë detyrueshëm e lartë për shkak se asambleja e aksionerëve ka mundësinë të ketë nën vëzhgim të vazhdueshëm situatën e firmës. Nga të dhënat e marra rezultoi që 31 njësi ekonomike ishin me një pronar, 6 ishin në bashkëpronësi dhe 8 ishin në bashkëpronësi. Po të rikthehemi në pjesën ku analizuar formën ligjore të krijimit arritëm në rezultatin që 28 ishin njësi ekonomike të regjistruara si persona fizikë dhe 17 ishin firma të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara. Po t'i krahasojmë me të dhënat e pronësisë arrijmë në përfundimin që përveç 28 njësive ekonomike që ishin të regjistruara si person fizik i vetëpunësuar kemi edhe 3 njësi ekonomike të tjera të regjistruara si person juridik që janë në pronësi të

vetëm një personi. Pjesa tjetër prej 14 njësive të regjistruara si sh.p.k. janë në bashkëpronësi ndërmjet dy ose më shumë personave.

Figura 6 - Krahasimi i numrit të njësive ekonomike sipas formës juridike dhe shpërndarjes së pronësisë.



Pyetja për shpërndarjen e pronësisë na shërben të marrim një informacion shtesë rreth faktit në qoftë se përdoret informacioni kontabël për të eliminuar asimetrinë e informacionit. Të anketuarit u pyetën se sa rëndësi i jepnin informacionit kontabël për rregullimin e marrëdhënieve me ortakët e tyre. Kjo pyetje ka dhënë përgjigjet më të ndryshme të konstatuara gjatë gjithë pyetësorit, por shumica e përgjigjeve ishin se informacioni kontabël nuk i vjen në ndihmë për të rregulluar marrëdhëniet ndërmjet palëve.

*Model 1: OLS, using observations 1-45
Dependent variable: Cilësia e informacionit kontabël*


	Coefficient	Std. Error	t-ratio	p-value	
const	4.3871	0.167401	26.2071	<0.0001	***
Shpërndarja pronësisë	e -0.387097	0.300124	-1.2898	0.2040	
Mean dependent var	4.266667	S.D. dependent var	0.939052		
Sum squared resid	37.35484	S.E. of regression	0.932050		
R-squared	0.037246	Adjusted R-squared	0.014857		
F(1, 43)	1.663558	P-value(F)	0.204018		
Log-likelihood	-59.66273	Akaike criterion	123.3255		
Schwarz criterion	126.9388	Hannan-Quinn	124.6725		

Kjo gjë u vërtetua edhe nga të dhënat e përfituara nga programi statistikor. Vlera e P-së është më e madhe se 5% sepse është 20 %. Kjo vlerë përfundimtare tregon se variabli i pavarur është statistiki i parëndësishëm. Pra hipoteza bazë **bie poshtë dhe vërtetohet hipoteza alternative që:**

H₁: Shpërndarja e pronësisë në një numër më të madh pronarësh nuk ndikon në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël.

Pjesa e fundit e pyetësorit kishte të bënte me kontrollet tatimore dhe efektin e tyre në informacionin kontabël. Si fillim të anketuarit u pyetën për numrin e kontrolleve tatimore që mesterisht kalonin çdo vit. Nga përgjigjet e marra vetëm 3 subjekte nuk kishin kaluar asnjë kontroll tatimor. Pjesa tjetër pranonin që kishin kaluar kontrolle tatimore të paktën një herë ku një pjesë e mirë e të anketuarve pranonin që mesatarisht kishin dy kontrolle në vit. Përveç këtyre kishte edhe subjekte që kishin kaluar 4 – 5 kontrolle tatimore në vit të tipeve të ndryshme.

Figura 73 - Numri i kontrolleve tatimore në vit.



Përveç numrit të kontrolleve tatimore objekt interesi ishte edhe lloji i kontrollit tatimor. Në varësi të kontrollit tatimor ndryshon edhe dokumentacioni që duhet të përgatitet edhe pse kohët e fundit verifikimet në vend kërkojnë një sërë dokumentacionesh që lidhen ngusht me pjesën e cilësisë së informacionit kontabël, si: libri i arkës, lëvizjet e magazinës, ditari analitik i shitjeve, blerjeve etj. Nga përgjigjet e marra u konstatua se

14 subjekte kishin kaluar kontroll të plotë tatimor që përfshin kontrollin e plotë të të gjithë dokumentacionit për një periudhë të caktuar. Informacioni kontabël në këtë kontroll është mjaft i gjerë dhe duhet të jetë i një cilësie të lartë që të shmangen penalitetet. 17 subjekte kishin kaluar vizitë fiskale e cila është një kontroll i përqendruar në një kategori të caktuar detyrimi. Në krahasim me kontrollin e plotë informacioni tatimor i kërkuar në këtë kontroll është më i ulët, por gjithsesi për llojin e caktuar të detyrimit duhet të jetë i detajuar. Pjesa e mbetur prej 14 subjektesh, kishin kaluar një verifikim në vend, i cili kryesisht në vitin e kaluar ka qenë i shpeshtë dhe nuk kërkonte sasi të mëdha informacioni kontabël deri kohët e fundit ku verifikimet në vend janë bërë më specifike dhe kërkojnë më shumë informacion.

Figura 8 - Kategoria e kontrolleve më të shpeshta.



Përveç evidentimit të numrit dhe llojit të kontrolleve të kaluara çdo vit qëllimi i pyetësorit ishte edhe evidentimi i lidhjes që kanë kontrollet tatimore me cilësinë e informacionit kontabël. Përgjigjet e marra theksonin se informacioni kontabël është i rëndësishëm në kushtet e kontrollit tatimor. 5 subjekte u përgjigjën që informacioni kontabël është disi i rëndësishëm në kushtet e kontrolleve tatimore, 16 u përgjigjën që informacioni kontabël është i rëndësishëm në kushtet e kontrollit tatimor dhe pjesa tjetër prej 24 personash u përgjigjën që informacioni kontabël ishte shumë i rëndësishëm në kushtet e kontrollit tatimor.

Figura 9 - Rëndësia e informacionit kontabël në kushtet e kontrollit tatimor.



Nëpërmjet programit statistikor u përpoqëm të përcaktonim në qoftë se kontrollet tatimore ndikojnë në cilësinë e informacionit kontabël. Nga llogaritjet e bëra vlera e P-së del nën vlerën 5 % dhe rrjedhimisht rritja e kontrolleve tatimore ndikon në cilësinë e informacionit kontabël.

Model 1: OLS, using observations 1-45
Dependent variable: Cilësia e informacionit kontabël

	<i>Coefficient</i>	<i>Std. Error</i>	<i>t-ratio</i>	<i>p-value</i>	
const	3.2565	0.544262	5.9833	<0.0001	***
Kontrollet tatimore	0.285095	0.130895	2.1780	0.0349	**
Mean dependent var	4.422222	S.D. dependent var	0.690484		
Sum squared resid	18.89341	S.E. of regression	0.662859		
R-squared	0.099361	Adjusted R-squared	0.078415		
F(1, 43)	4.743856	P-value(F)	0.034934		
Log-likelihood	-44.32563	Akaike criterion	92.65126		
Schwarz criterion	96.26458	Hannan-Quinn	93.99827		

Nga sa u tha më sipër arrijmë në përfundimin *që aprovohet hipoteza bazë që:*

H₀: Cilësia e informacionit kontabël rritet me rritjen e kontrolleve të ushtruara nga ana e administratës tatimore.

Logjikisht rritja e trysnisë nga ana e administratës tatimore në lidhje me cilësinë e informacionit kontabël të dorëzuar nga subjektet dhe kontrolli i herëpashershëm i tyre ndikon që njësitë ekonomike të japin një cilësi më të lartë të informacionit kontabël duke qenë se ky i fundit është i domosdoshëm gjatë kontrolleve tatimore siç vërehet edhe nga përgjigjet e pyetjes së fundit.

Përmbledhja e rezultateve

Table 2 – Variablat

Variabli i pavarur	Vlera e P-së	Ndikimi mbi hipotezën bazë
Madhësia e biznesit	0.0001	Aprovohet
Ekzistenca e levës financiare	0.0017	Aprovohet
Shpërndarja e pronësisë	0.2040	Refuzohet
Kontrollet tatimore	0.0349	Aprovohet

Vlerat e koeficientëve β janë si më poshtë:

$$\beta_1 = 1.14$$

$$\beta_2 = 0.46$$

$$\beta_3 = ?$$

$$\beta_4 = 0.55$$

Për shkak se variabli i pavarur për shpërndarjen e pronësisë refuzohet duke qenë se $P > 5\%$, ky variabël nuk llogaritet dhe përjashtohet nga ekuacioni i regresionit.

Përfundime

Duke shqyrtuar të dhënat e përfituara gjatë studimit qoftë gjatë rishikimit të literaturës ashtu edhe gjatë analizimit të të dhënave arritëm në përfundimet që:

1. Informacioni kontabël ka një shumëllojshmëri përdorimesh dhe është i vlefshëm për vendimmarrje qoftë nga ana e menaxherëve ashtu edhe nga grupet e tjera të interesit.
2. Përcaktimi i cilësisë së informacionit është i lidhur me katër dimensione ku cilësia e informacionit nënkupton që ai të jetë i saktë, i plotë, i qëndrueshëm dhe aktual apo në kohë.
3. Të pyetur rreth rëndësisë që i japin menaxherët informacionit për vendimmarrjen rreth ecurisë së biznesit pjesa më e madhe e të anketuarve mendonin se informacioni kontabël është i rëndësishëm në vendimmarrjen e përditshme dhe rrjedhimisht një informacion cilësor është i vlefshëm për këtë vendimmarrje.
4. U vërtetua statistikisht që me rritjen e madhësisë së biznesit rritet edhe cilësia e informacionit kontabël.
5. Duke pasur parasysh rritjen e numrit të artikujve që ofron njësia ekonomike një informacion cilësor kontabël i vjen në ndihmë menaxherëve për përcaktimin e saktë të kostos dhe të çmimit të shitjes.
6. Përdorimi i levës financiare nga njësitet ekonomike ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël. Kjo për shkak se bankat kanë kritere të përcaktuara qartë në lidhje me informacionin kontabël

që duhet të paraqesë njësia ekonomike në rastin e kredimarrjes dhe detyrimisht do të duhet një informacion i saktë dhe i plotë kontabël për aprovimin e cilësisë.

7. Shpërndarja e pronësisë nuk është faktor përcaktues i cilësisë së kapitalit. Siç duket në njësitë ekonomike në qytetin e Shkodrës asimetria e informacionit është e ulët dhe informacioni kontabël nuk përdoret në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet pronarëve.
8. Pothuajse të gjitha subjektet kishin kaluar të paktën një kontroll tatimor të kategorive të ndryshme gjatë vitit.
9. Ushtrimi i shpeshtë i kontrolleve tatimore ndikon pozitivisht në rritjen e cilësisë së informacionit kontabël duke qenë se ky informacion është i detyrueshëm të dorëzohet në kushtet e kontrollit tatimor.

Bibliografia

- Ball, R. a. (2005). Earnings quality in U.K. private firms. *Journal of Accounting and Economics*.
- Baltzan, P. (2012). *Business Driven Information Systems*. New York: McGraw Hill.
- Belkaoui, A. a. (1989). Determinants of the corporate decision to disclose. *Accounting, Auditing and Accountability Journal*.
- Bushman, R. P. (2006). *Capital allocation and timely accounting*. University of North Carolina and University of Chicago.
- Buzby, S. (1975). Company size, listed versus unlisted stocks, and the extent of financial. *Journal of Accounting Research*, 16 - 37.
- Cowen, S. F. (1987). The impact of corporate characteristics on social responsibility : A typology and frequency based analysis'. *Accounting, Organizations and Society*.
- Eppler, M. (2006). *Managing Information Quality: Increasing the Value of Information in Knowledge-Intensive*. Germany: Springer Berlin-Heidelberg.
- Gelinas, J. (2012). *Accounting Information Systems*. South Western: Cengage Learning.
- Kieso, D. (2007). *Intermediate Accounting*. USA: John Wiley and Sons Inc.

- La Porta, R. L.-D.-S. (1998). Law and finance. *Journal of Political Economy*.
- Leuz, C. a. (2000). The economic consequences of increased disclosure. *Journal of Accounting Research*.

DISKRIMINIMI NDAJ GRAVE DHE PUNËSIMI INFORMAL

Emirjeta Bejleri Mema¹³

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti Ekonomik, Departamenti i
Administrim- Biznesit*

Albiona Koka¹⁴

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti Ekonomik ka përfunduar
studimet Master Profesional dega Administrim- Biznes*

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të studiohet ndikimi që jep diskriminimi gjinor në tregun e punës dhe impakti që ka në rritjen e punësimit informal. Diskriminimi prek të dyja gjinitë, por ne vendosëm të studiojme vetëm gjininë femërore, sepse në të gjitha studimet që janë bërë nga studiues apo organizata të huaja dhe shqiptare ka rezultuar se femrat janë më të diskriminuara në të gjitha aspektet. Por në rastin konkret ne do

¹³ Dr. Emirjeta BEJLERI (MEMA) është pedagoge me kohe të plotë e Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Shqipëri. Në vitin 1997 ka kryer studimet e larta bachelor në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Më pas në vitin 2002 ka përfunduar studimet e Masterit në Administrim-Biznes, Universiteti i Illinoisit Jugor (Southern Illinois University), U.S. ku është nderuar për Rezultate të Shkëlqyera – Anëtare e Shoqatës së Nderit Phi Kappa Phi e përzgjedhur nga Southern Illinois University at Carbondale. Aktualisht zotëron titullin Ph.D. në Shkenca Ekonomike, titull i fituar në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, Shqipëri në vitin 2009. Ka kryer një sërë trajnimesh e specializimesh në fusha të ndryshme ekonomike pranë disa universiteteve perëndimore, si: Coimbra Group Universities Splitit Kroaci, Qendra Trainuese CEFAL Bologna Itali, Central European University Budapest Hungari, Universiteti i Grazit Austri, Universiteti "La Sapienza" Rome Itali, Universiteti i Trentos Itali. Ka realizuar mjaft botime shkencore dhe ka qenë pjesëmarrëse në një sërë konferencash kombëtare dhe ndërkombëtare.

¹⁴ Albiona Koka ka kryer studimet pranë Fakultetit Ekonomik Shkodër në degën Administrim-Biznesi në vitin 2012. Nga viti 2012- 2014 ka ndjekur dhe përfunduar studimet në Master Profesional për Administrim- Biznes pranë po këtij institucioni. Aktualisht punon në biznesin e saj familjar "Smart Games". Është njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe spanjolle.

shohim diskriminimin në vendin e punës dhe arsyet që i drejtojnë gratë në tregun informal.

Studimi u realizua me anë të pyetësorëve të vetadministruar të cilët iu shpërndanë grave të punësuar në biznese private të mesme dhe të vogla dhe të vetëpunësuar, gra të cilat dihet që përgjithësisht kanë një nivel të ulët arsimor. Mostra që u përzgjedh për analizë e përberë nga 250 gra dhe vajza të moshave të ndryshme, por vetëm 227 pyetësorë të shpërndarë ishin të vlefshëm. Mund të përdorej një moster edhe më e madhe me përfshirjen e më shumë grave me nivele edhe më të larta arsimimi pra kjo mostër nuk ishte thjesht rastësore, por e përzgjedhur posaçërisht për një kategori të veçantë grash, për t'i dhënë kuptimin e duhur këtij studimi. Është e rëndësishme të theksohet që ky studim përbën thjesht një hap fillestar në këtë drejtim, pasi ne mendojmë që në të ardhmen të zgjerohet më tej, jo vetëm nga ne, por edhe nga studiues të tjerë, duke u shtrirë më gjerësisht edhe në qytete të tjera të vendit tone, por edhe numër më të madh grash për të krijuar një tablo më të qartë.

Pas analizimit të pyetësorëve u vërtetua që shumica e grave janë ndjerë të diskriminuara si në punën aktuale ashtu edhe në punët paraardhëse. Arsyet që i detyronin ato të bënin një punë të tillë ishin arsimimi i ulët dhe niveli ekonomik i ulët. Pothuajse të gjitha gratë ishin të mendimit se diskriminimi gjinor e pengon rritjen dhe zhvillimin e grave në karrierë duke i çuar drejt një pune të padenjë dhe informale.

Fjalët kryesore (kyçe)- diskriminim gjinor, diskriminim në punë, sektori informal, punësim informal, vetëpunësim.

Discrimination against women and informal employment

Abstract

The aim of this article is to study the impact that provides gender discrimination in the labor market and the influence that has on the growth of informal employment. Discrimination affects both genders but we decided to study only the female gender because all the studies that have been made by Albanian researchers or foreign organizations showed that women are discriminated. But in this case we will see discrimination in the workplace and the reasons that drove women toward the informal market.

The study was conducted by means of self-administered questionnaires which were distributed to women who are employed in private small and medium businesses and self-employed, women who are

generally known to have a low educational level. The sample that was selected for analysis was composed of 250 women and girls of different ages but only 227 questionnaires, of the distributed questionnaires, were valid. It was possible to use an even bigger sample with the inclusion of more women with higher levels of education, but it is important to stress that this sample was not just random but specifically selected for a particular category of women to give the proper meaning to this study. It is important to note that this study is simply an initial step in this direction, as we think that in the future it will be further expanded, not only by us but also by other researchers, extending even more widely in other cities of our country but also including a wider sampler to create a clearer picture.

We confirmed, after analyzing the questionnaires, that most women felt discriminated at the actual work as well as at any previous work. The reasons that forced them to do a specific work were low education and low economic level. Almost all the women were of the opinion that gender discrimination hinders the growth and development of women's career by leading them toward an undignified and informal work.

1. Hyrje

Ky punim kërkimor u realizua duke u bazuar në një temë shumë aktuale me të cilën ne ndeshemi çdo ditë. Diskriminimi gjinor është një term shumë i gjerë, por ne vendosëm të studiojme vetëm gjininë femërore duke qenë se është edhe më e prekur nga ky fenomen. Diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim të bazuar në gjini, që ka për efekt ose qëllim të kompromentojnë ose të asgjësojnë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër (USAID, 2005)¹⁵. Ndërsa punësimi informal i referohet një pune apo një veprimtarie në prodhimin dhe komercializimin e mallrave dhe shërbimeve ligjore të cilat nuk janë të regjistruara ose janë të pambrojtura nga shteti. Punëtorët informale janë të përjashtuar nga sigurimet shoqërore, përfitimet dhe mbrojtjen e ofruar nga kontrata formale e punës (OECD, 2009)¹⁶. E konsiderojme si shumë të rëndësishëm studimin

¹⁵ USAID. (2005, DHJETOR). *Raport për vlerësimin e zbatimit të konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas në Shqipëri*. SHQIPËRI: Nisma për të Drejtat e Grave (WLR).

¹⁶ OECD. (2009). *Is Informal Normal? Toward More and Better Jobs*. OECD's Internet site.

për diskriminimin ndaj grave dhe punësimin informal, pasi edhe vetë ne jemi pjesë e kësaj shoqërie.

Pyetja kryesore e hulumtimit: A është diskriminimi gjinor një ndër faktorët më të rëndësishëm që i çon gratë drejt punësimit informal?

Pyetjet ndihmëse: Çfarë është diskriminimi gjinor? Cilat janë format me të cilat shfaqet ai? Çfarë është punësimi informal? Cilat janë arsyet që i çojnë gratë drejt punësimit informal? Cilat janë format me të cilat ato bëhen pjesë e punësimit informal?

Qëllimi i këtij studimi është të studiohet ndikimi që jep diskriminimi gjinor në tregun e punës dhe impakti që ka në rritjen e punësimit informal. Synimi ynë nuk është të nxjerrë në pah masën që ka diskriminimi gjinor në vendin tone, por ndikimin që ka ai dhe kë prek më shumë. Diskriminimi prek të dyja gjinitë, por ne vendosëm të studiojmë vetëm gjininë femërore, sepse në të gjitha studimet që janë bërë nga studiues apo organizata të huaja dhe shqiptare ka rezultuar se femrat janë më të diskriminuara në të gjitha aspektet. Por në rastin konkret ne do të shohim diskriminimin në vendin e punës dhe arsyet që i drejtojnë gratë në tregun informal.

Për të arritur qëllimet e mësipërme u krijua një pyetësor i cili iu drejtua grave. Pas analizimit të pyetësorëve u vërtetua që shumica e grave janë ndjerë të diskriminuara si në punën aktuale ashtu edhe në punët paraardhëse. Arsyet që i detyronin ato të bënin një punë të tillë ishin arsimimi i ulët dhe niveli ekonomik i ulët. Pothuajse të gjitha gratë ishin të mendimit se diskriminimi gjinor e pengon rritjen dhe zhvillimin e grave në karrierë duke i çuar drejt një pune të padenjë dhe informale.

2. Diskriminimi gjinor

Diskriminim është atëherë kur dikush dallohet nga të tjerët dhe trajtohet keq, duke mos e quajtur të barabartë dhe duke ia kufizuar ose duke ia mohuar fare të drejtat që i takojnë (Thomaj J, 1980, f. 341)¹⁷.

Çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bëhet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, origjinës shoqërore, ka efektin e anulimit ose të dëmtimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin në punësim dhe profesion (ILO, 2011)¹⁸.

Diskriminimi është dallimi ose përjashtimi që i bëhet një personi, në raport me të tjerët, në jetën e përditshme, një sjellje e dukshme me anë të së

¹⁷ Thomaj J, L. X. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Mihal Duri.

¹⁸ ILO. (2011). *Gender Discrimination at Work*. Geneva.

cilës njerëzit trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme, në bazë të racës, klasës, seksit apo statusit kulturor të tyre. Ai pakëson mundësitë për të pasur qasje mbi burimet, shërbimet shëndetësore, arsimimin, fuqizimin apo pushtetin. Format e diskriminimit mund të jenë të hapura dhe të fshehta, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të kryera me anë të veprimeve ose mosveprimeve. Edhe kur ne preferojmë një person, midis të tjerëve ose kur ndaj një personi vendosim kufizime dhe ndaj disa të tjerëve jo, kur janë në kushte të barabarta, jemi përpara diskriminimit ose trajtimit të pabarabartë të personave. Gjithashtu diskriminimi gjinor prek të dyja gjinitë, por në të shumtën e rasteve më të diskriminuara janë gjinia femërore dhe këtë e vërtetojnë të gjitha studimet që janë bërë në lidhje me këtë fenomen, nga organizata të huaja dhe shqiptare, të cilat kohët e fundit po i kushtojnë një vëmendje të veçantë mbrojtjes së grave nga diskriminimi gjinor.

Të drejtat e grave shkelen në mbarë globin pavarësisht nga përkatësia kombëtare kulturore, fetare apo pozita në shoqëri. Femrat në botë diskriminohen si në arsim, ashtu edhe në punë dhe në aspekte të tjera. Disa kërkime të fundit mbi pabarazitë gjinore në tregun e punës zbulojnë se edhe pse shkalla e papunësisë së grave është e lartë, ekziston edhe një çështje e fshehur, ajo e pjesëmarrjes së grave në tregun informal të punës si dhe puna e padukshme që gratë bëjnë për t'u kujdesur për anëtarët e tjerë të familjes dhe mirëmbajtur shtëpinë. Edhe pse janë bërë studime dhe kërkime lidhur me situatën e grave në tregun e punës, ka shumë pak të dhëna që flasin për punësimin e grave në tregun informal. Sipas disa statistikave të publikuara nga Amnesty International rezulton se në botë:

- 60% e fëmijëve pa shkollim fillestar janë femra.
- 2/3 e të rriturve analfabetikë janë të gjinisë femërore.
- 50% e peshës botërore të punës kryhet nga gratë dhe vajzat dhe vetëm 1/3 e punës së tyre paguhet.
- Të ardhurat e grave dhe vajzave nga puna e paguar përbëjnë 75% të të ardhurave të meshkujve.

Një çështje që përbën diskriminim dhe që prek drejtpërdrejt gjininë femërore është hendeku gjinor në paga. Në disa studime të kryera në lidhje me këtë fenomen ka rezultuar se femrat paguhën më pak se meshkujt edhe brenda të njëjtë profesioni. Instituti për Hulumtime të Politikave të Grave ka deklaruar se nëse ritmi i ndryshimit në raportin vjetor të të ardhurave do të

vazhdojë me të njëjtin ritëm si nga viti 1960, do të duhen edhe 45 vjet për burrat dhe gratë, para deri në 2058, për të arritur barazi¹⁹.

Të drejtat e grave janë trajtuar gjerësisht nga instrumentet ndërkombëtare përfshirë konventat, rezolutat dhe deklaratat. Deklarata Universale për të drejtat e Njeriut (1948) i referohet qartësisht në nenet 2 dhe 21, të drejtave të grave. E njëjta gjë, aplikohet në Marrëveshjen mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966) në nenet 2 dhe 25. Për më tepër, barazia e grave afirmohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW 1979).

Pavarësisht nga zhvillimi i shpejtë ekonomik e social i vendit si dhe progresi në çështjet gjinore, gratë vazhdojnë të jenë pjesë e grupeve vulnerabël të shoqërisë. Për shkak të diskriminimit të tyre në aspekte të ndryshme, përparimi i tyre në karrierën profesionale është i vështirë. Ato shumë rrallë kanë pozicione drejtuese dhe pjesëmarrja e tyre në politikë dhe vendimmarrje është ende mjaft e ulët. Gjatë tranzicionit ato u bënë shpesh objekt dhe viktima të trafikimit njerëzor. Rehabilitimi i tyre është një fushë ku aktualisht kontribuon vetëm sektori joqeveritar dhe mbështetja e strukturave shtetërore mbetet shumë e vogël.²⁰

Në termat e zhvillimit njerëzor dhe social ekonomik, disa pabarazi janë rritur dhe thellohen midis popullsisë mashkullore e femërore. Nevojiten statistika të detajuara mbi gjendjen e grave, sepse gjithë të dhënat janë të pjesshme dhe ka një mungesë të madhe informacioni për çështjet e grave. Mungesa e studimeve zyrtare i ka shtyrë shoqatat dhe rrjetet e shoqërisë civile që të bëjnë vetë sondazhe për të ndriçuar realitetin e dhunshëm ndaj grave shqiptare.

“Diskriminimi gjinor në punë ka një efekt negativ në tregun e punës në përgjithësi, kjo sepse ndarja gjinore në punë shkakton mungesën e fleksibilitetit në tregun e punës dhe bën që punëdhënësit shpeshherë të ndjekin politika punësimi që janë të bazuara në stereotipe gjinore dhe paragjykime në vend të kualifikimeve personale dhe cilësive të individit. Ndarja në tregun e punës bën që gjysma e fuqisë punëtore të mos i shfrytëzojnë talentet e tyre duke çuar kështu në një zhvillim jo të plotë, jo efikas dhe të paqëndrueshëm” (UNEGE 2011-Hendeku gjinor i pagave në Shqipëri).

¹⁹ Institute for Women’s Policy Research. (September de 2013). *The Gender Wage Gap* Recuperado el 2012, de <http://www.iwpr.org/publications/pubs/the-gender-wage-gap-2012-1/>

²⁰SOROS. (2010). *Programi gruas*. Tiranë.

Studiues dhe veprimtarë të shoqërisë civile mendojnë se vitin e fundit janë thelluar mendësitë e vjetra kundër grave dhe ndasitë gjinore. Diskriminimi i gruas është përkeqësuar si në familjen e vet, në familjen e burrit dhe në shoqëri. Përveç dhunës në familje, gratë shqiptare dhunohen edhe në punë, ku marrin paga dhe mbrojtje minimale. Hulumtimi i fundit i Forumit Ekonomik Botëror tregon se cilat janë vendet më të mira e cilat më të këqijat për gratë. Në këtë raport përfshihen 135 vende, që përbëjnë 90 për qind të popullsisë botërore ku Shqipëria u rendit në vendin e 91 në listë për barazi gjinore. Vendin e parë e mbante Islanda kurse vendin e fundit e mbante Pakistani dhe Jemeni.

3. *Punësimi informal*

“Punësimi informal përfshin të gjitha vendet e punës në sektorin informal apo të gjithë personat, të cilët gjatë një periudhe të caktuar, janë të punësuar të paktën në një ndërmarrje të sektorit informal, pavarësisht nga statusi i tyre”. (ILO, 2000)

Punësimi informal përfshin futjen në tregun e punës të personave të cilët mund të jenë të deklaruar, por mund të jenë të paregjistruar. Ai përfshin gjithashtu persona të vetëpunësuar në rrugë informale nga punëdhënës që për të maksimizuar të ardhurat e tyre paguajnë në cash punonjësit e paregjistruar dhe në këtë mënyrë deklarojnë më pak të ardhura në shtet për t’i shpëtuar taksimit.

Krahasuar me burrat gratë jetojnë më gjatë, fitojnë më pak dhe shköputen më shumë nga puna për t’u kujdesur për fëmijët dhe prindërit e moshuar. Ndonëse studimet tregojnë se gratë priren të kursejnë një përqindje paksa më të lartë të rrogës sesa burrat, por kohët e fundit, për shkak të fitimeve më të pakta, ato kanë dalë në bilanc më të ulët në krahasim me burrat. Gratë kanë zënë vend tashmë në zyra që prej dy dekadash dhe bëjnë të njëjtën punë me burrat: në sektorin e shitjeve, marketingut, financës, planifikimit dhe në çdo fushë tjetër të botës së korporatave. Por ende, pavarësisht nga ky progres, gratë fitojnë më pak se burrat për të njëjtën punë (Romans, 2012)²¹.

Në ekonominë informale niveli i të ardhurave ndryshon sipas gjinisë dhe llojit të aktivitetit ku punëtori është i përfshirë të cilat reflektojnë dhe në të ardhurat vjetore. Të ardhurat vjetore individuale të punonjëseve femra janë më të ulëta në krahasim me burrat. Punëtorët që marrin punë me pagesë për copë kanë pagese më të ulët se punëtorët e rastit dhe punëtorët e

²¹ Romans, C. (2012). Si të flasim në gjuhën e parasë. (V. Bako, Trans.) Tiranë: Botimet DRITAN.

vetëpunësuar që patjetër kanë pagesë më të ulët se punonjësit me pagë të rregullt. Pjesa më e madhe e punonjësve me pagesë për copë janë gratë të punësuar në shtëpi ku shumica punojnë në industri të ndryshme veshjesh. Këto gra kanë relativisht pagesë shumë të ulët dhe nuk kanë profesione që të kualifikohen për profesione të ndryshme. Ato vazhdojnë të jenë të angazhuara në punë me bazë në shtëpi, pavarësisht të ardhurave të ulëta dhe mungesës së mundësive me të mira, siç janë mungesa e aftësive për t'u arsimuar dhe përgjegjësia që kanë për t'u kujdesur për familjen.

Një pjesë e fuqisë punëtore është në sektorin e paorganizuar ose joformal. Këta punëtorë janë të angazhuar në aktivitete ekonomike me produktivitet të ulët të cilat reflektojnë në të ardhura më të ulëta. Ata janë të angazhuar edhe në aktivitete me kontrata më pak të qëndrueshme të punësimit dhe më pak përfitime të sigurimeve shoqërore. Ndërsa pagat dhe fitimi i punonjësve të sektorit formal rishikohet periodikisht për të luftuar inflacionin, e kundërta ndodh në pjesën me të madhe të punëtorëve në sektorin e paorganizuar. Në këtë mënyrë mund të argumentojmë se nuk është informaliteti në vetvete, por natyra e punës dhe marrëdhënia me varfërinë që e bën dallimin thelbësor midis burrave dhe grave në ekonominë informale. Femrat janë më të prekshme, sidomos në kontekstin e ndryshimit ekonomik, për shkak të resurseve të varfëra në arsim, aftësi dhe të ardhura. Këto disavantazhe pak a shumë strukturore të krijuara mes gjinisë mashkullore dhe femërore, bëjnë që gratë ta kenë më të vështirë për të kapërcyer informalitetin dhe varfërinë²².

Punësimi informal aplikohet më shumë në industritë tekstile dhe fasone, kompanitë e përpunimit të peshkut, kompanitë e ndërtimit etj. Një përqindje e konsiderueshme e punonjësve që punojnë në këto lloj biznesesh nuk sigurohen nga punëdhënësit, pasi duke mos i deklaruar të gjithë punonjësit, kompanitë deklarojnë më pak të ardhura në mënyrë që të taksohen më pak. Kjo situatë prek drejtpërdrejt punonjësit, pasi nuk mbështeten me sigurime shoqërore e shëndetësore, por gjithashtu dëmton edhe veprimtarinë ekonomike të vendit duke rritur informalitetin ekonomik.


Një situatë e tillë bën që punësimi informal në vend të rritet duke ndikuar kështu në rritjen e informalitetit, i cili lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë ekonomike të vendit tonë. Për ta parandaluar këtë, shteti duhet të përdorë mekanizma efikase, në mënyrë që të jenë sa më efektive për një zhvillim të mirë të tregut të punës. (*Instituti Shqiptar i Shkencave, 2010*).

²² Unni, J., & Rani, U. (2008). Gender, Informality and Poverty. European Investment Fund, 9-11.

4. *Analizimi dhe organizimi i të dhënave*



Studimi u realizua me anë të pyetësorëve të vetadministruar të cilët iu shpërndanë grave të punësuar në biznese private të mesme dhe të vogla dhe të vetëpunësuarra gra të cilat dihet që përgjithësisht kanë një nivel të ulët arsimor. Mostra që u përzgjedh për analizë e përberë prej 250 grash dhe vajza të moshave të ndryshme, por vetëm 227 pyetësorë të shpërndarë ishin të vlefshëm. Mund të përdorej një moster edhe më e madhe me përfshirjen e më shumë grave me nivele edhe më të larta arsimimi pra kjo mostër nuk ishte thjesht rastësore, por e përzgjedhur posaçërisht për një kategori të veçantë grash, për t'i dhënë kuptimin e duhur këtij studimi.

Lidhur me pyetjen e parë të pyetësorit prej sa kohësh qëndroni në këtë punë, përgjigjet e marra jepen në grafikun e mëposhtëm. Ky grafik nuk ka shumë për t'u analizuar sepse i përket një pyetjeje të përgjithshme e cila lidhet me eksperiencën në këtë punë. Të shprehura në vlerë janë: më pak se një vit punojnë 5 gra, 1 vit punojnë 20 gra, 2 vite punojnë 30 gra, 3 vite punojnë 63 gra dhe më shumë se 3 vite punojnë 109 gra.





Figurë 1. Përqindja e viteve të punës të punonjëseve

Përsa i përket nivelit të arsimimit të grave të punësuar siç mund të vihet re edhe nga Figura 1 niveli arsimor i punonjëseve është pothuajse i ulët. Kjo është një ndër arsyt kryesore që i detyron ato të punojnë në këtë lloj pune të vështirë. Të shprehura në vlerë nga 227 të anketuarat, asnjëra prej tyre nuk ka arsim të lartë. Përqindja e grave me arsim tetëvjeçar është 46.46% ose 105 gra kurse me arsim të mesëm janë 53.54% ose 122 gra.


Figure 2. Përqindja e nivelit arsimor të punonjëseve.*Figure 3. Përqindja e punonjëseve që kanë fëmijë.*

Shumica e këtyre grave janë nëna dhe kjo është një arsye më shumë që i motivon ato të punojnë dhe për më tepër të marrin përsipër edhe punë të cilat mund të jenë të papërshtatshme dhe sfilitëse për to. Të shprehura në vlerë 144 nga të anketuarat janë nëna ndërsa 83 prej tyre jo. Të qenurit kryefamiljare është një sfidë e dyfishtë për të përballuar jetesën. Aq më tepër kur nuk të favorizojnë dhe kushtet e mira ekonomike. 14.96 % e këtyre punonjëseve janë kryefamiljare dhe sigurisht jeta është më e vështirë se për 85.04 % tjetër. Të shprehura në vlerë 34 veta janë kryefamiljare.

*Figurë 4. Përqindja se sa nga këto gra janë kryefamiljare.*

Figurë 5. Përqindja e grave që kanë një punë të dytë.

Pamjaftueshmëria e të ardhurave nga puna aktuale për të përballuar koston e jetesës, bën që disa nga këto femra të zgjedhin të bëjnë edhe një punë të dytë me orë jo të plota. Normalisht që punë të papaguar bëjnë të gjitha, duke u kujdesur për familjen e për të mirëmbajtur shtëpinë, por punë të paguar të dytë, bëjnë 18.90 % ose në vlerë 43 veta nga 227 që kanë marrë pjesë në anketim. Llojet e punëve të dyta mund të jenë nga më të ndryshmet. Por në këtë studim, si alternativë zgjedhjeje u vendosën punët më të aplikueshme. Kështu nga ato që kryejnë një punë të dytë 25% merren me punë artizanale nga të cilat nxjerrin të ardhura, 20.84% janë punëtores kontraktuar me orë (p.sh., punonjëse shtëpiake, babysitter) dhe të tjera janë 54.16%.

**Figure 6. Përqindja e llojit të punës së dytë të punonjëseve.**

Shumica nga këto gra marrin të ardhurat nga punësimi në këtë biznes në Cash, duke mos përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ç'ka do të thotë se ato janë pjesë e informalitetit. 25.2 % e

tyre refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetje. Kjo nënkupton se përqindja e atyre që e marrin rrogën cash mund të jetë më e madhe se 41.73 %. Nga 170 përgjigjet e marra rezulton se 95 gra paguhen në cash (para në dorë) dhe 75 gra paguhen nëpërmjet bankës (me kartë elektronike).




Figura 7. Përqindja e mënyrës se si punonjëset e marrin pagën.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave siç vihet re edhe nga grafiku, niveli i të ardhurave familjare të tyre është i ulët. Të shprehura në vlerë, 173 nga të anketuarat kanë nivel të ulët të të ardhurave, 54 veta kanë të ardhura të mesme dhe ashtu siç edhe pritej asnjëra nga punonjëset nuk kishte të ardhura të larta. Niveli i varfërisë është i lartë dhe kjo është arsyeja kryesore që i çon njerëzit drejt punësimit informal.




Figure 8. Përqindja e nivelit të të ardhurave të punonjëseve.

Figure 9. Përqindja që tregon sa nga punonjëset janë të siguruara.



Duke qenë se biznesi privat është edhe më i prekuri nga informaliteti pritej që një pjesë e mirë e këtyre punonjëseve të ishin të pasiguruara. Kështu 54.33% e tyre janë të pasiguruara në punë, por kjo shifër mund të jetë edhe më e madhe, pasi 18 nga punonjëset refuzuan t’i përgjigjeshin kësaj pyetje. Të shprehura në vlerë, 86 gra janë të siguruara, 123 gra janë të pasiguruara kurse pjesa tjetër abstenuan. Edhe pse lufta ndaj informalitetit sa vjen e bëhet më e madhe përsëri këto shifra të lënë për të dëshiruar. Qeveria duhet të përdorë mekanizma sa më efikase për të reduktuar informalitetin në të kundërt kjo gjë do ketë pasoja të rënda në tregun e punës, por dhe në veprimtarinë ekonomike të vendit në përgjithësi.





Figure10. Përqindja që tregon se sa nga punonjëset janë të gatshme të lënë punën aktuale për një punë tjetër.

Në lidhje me pyetjen “Nëse do të ofrohej një mundësi punësimi tjetër, do të largohesh nga puna aktuale?” shihet shumë qartë dhe nga grafikuse niveli i kënaqësisë në punë është shumë e ulët. Nga 227 të anketuarat 164 prej tyre janë të gatshme ta lënë punën aktuale për një punë tjetër të ofruar, 50 nuk e lënë punën dhe sipas gjykimit tonë kjo shifër duhet të jetë pjesë e punonjëseve të siguruara në punë, ndërsa 13 prej tyre ishin në dilemë për

zgjedhjen që do të bënin. Që punonjëset të jenë të kënaqura me punën ato duhet të motivohen dhe shpërblehen nga puna që bëjnë.



Figurë 11. Përqindja e punonjësve të diskriminuara në punë.

Një përqindje e konsiderueshme e punonjësve ka pranuar se është ndjerë e diskriminuar në punë. Kjo besohet më së shumti për faktin e të mosqenurit pjesë e skemës së sigurimit shoqëror dhe shëndetësor. Por diskriminimi ka edhe elementë të tjerë (kushtet e punës, komunikimi, klima në punë) përveçse statusit të punësimit. Të shprehura në vlerë, 154 gra kanë pranuar se janë diskriminuar në punën aktuale, ndërsa 73 kanë pohuar që nuk janë ndjerë të diskriminuara.





Figure 12. Përqindja e diskriminimit të punonjësve në raport me gjininë mashkullore.

Normalisht që në raport me gjininë mashkullore ne ndihemi të diskriminuara në punë dhe shkak kryesor është hendeku gjinor që ekziston në paga dhe kjo tashmë është vërtetuar edhe nga studime të tjera. Në këtë rast një përqindje shumë e lartë e grave është shprehur pozitivisht. Të shprehura në vlerë, 175 gra janë ndjerë të diskriminuara në raport me gjininë mashkullore për shkak të disnivelit të pagës ndërsa 52 jo.

Figurë 13. Përqindja se sa nga punonjëset mendojnë se diskriminimi gjinor e pengon rritjen dhe zhvillimin e femrave në karrierë në Shqipëri.



Diskriminimi gjinor është një fenomen që ka lindur shekuj më parë e që vazhdon të ndjehet dukshëm edhe në ditët e sotme. Ai ka bërë që femrat në raport me gjininë tjetër të mbeten më pak të zhvilluara në karrierë, pasi u është mohuar kjo e drejtë, por raporti mes dy gjinive sa vjen dhe ngushtohet sepse edhe njerëzit tashmë po emancipohen dhe po ndërgjegjësohen për barazinë gjinore. Në këtë anketim të bërë në lidhje me këtë temë ka rezultuar se 131 gra mendonin se diskriminimi gjinor e pengon rritjen dhe zhvillimin e grave në karrierë, 70 prej tyre mendonin të kundërtën, ndërsa 27 veta nuk dinin se si të përgjigjeshin (kanë abstenuar).




Figure 14. Përqindja se sa nga punonjëset janë dakort se diskriminimi gjinor e rrit punësimin informal.

Edhe në grafik shihet qartë se diskriminimi gjinor është një ndër faktorët më të rëndësishëm që e rrisin punësimin informal. Femrat në përgjithësi, por sidomos femrat në zonat rurale janë shumë të prekura nga ky fenomen. Kjo për arsye se dhe mentaliteti është më i ndryshëm dhe emancipimi më i ulët. Shumë nga këto femra e kanë të ndaluar të arsimohen e të

emancipohen në shoqëri. Gjithashtu janë edhe nivelet e ulëta ekonomike që e ndalojnë këtë. Kjo gjë çon në rritje të nivelit të papunësisë dhe domosdoshmerisht gratë janë të detyruara të punojnë në sektorin informal. Nga anketimi i bërë rezulton se 156 gra mendojnë se diskriminimi gjinor është një ndër faktorët më të rëndësishëm që e rrisin punësimin informal, 21.26 % e tyre ose 48 veta mendonin që nuk është, ndërsa 23 veta ose 10.24 % u shprehen se nuk e dinin.

Konkluzione

Diskriminimi ndaj gruas dhe pabarazia mes gjinive ka spikatur që në zhvillimet e para të njerëzimit. Çdo ditë nëpër institucione apo ndërmarrje private dhe shtetërore hasim në një numër të konsiderueshëm punonjës meshkuj si drejtorë dhe udhëheqës e ndërkohë femrat fatkeqësisht janë varëset e tyre edhe pse shpeshherë janë ato që e mbulojnë gjithë punën me profesionalizmin, energjinë dhe sigurinë që i karakterizon.

Është e rëndësishme të theksohet që ky studim që ne kemi realizuar përbën thjesht një hap fillestar në këtë drejtim, pasi ne mendojmë që në të ardhmen të zgjerohet më tej, jo vetëm nga ne, por edhe nga studiues të tjerë, duke u shtrirë më gjerësisht edhe në qytete të tjera të vendit tonë, por edhe në numër më të madh grash me nivele edhe më të larta arsimimi për të krijuar një tablo më të qartë.

Diskriminimi gjinor ka ekzistuar shumë dekada më parë, si dhe është një fenomen me të cilin ndeshemi edhe në ditët e sotme i cili ka ndikim të madh në lidhje me zhvillimin mes gjinive. Tek gjinia femërore ai ka ndikim më të madh, duke sjellë tek ajo pasoja negative dhe duke e penguar shumë rritjen dhe zhvillimin e saj në shoqëri.

Diskriminimi gjinor është i dukshëm sidomos në tregun e punës në të cilin femrat diskriminohen në lidhje me pagat. Femrat gjithashtu bëjnë punë të papaguar më shumë se meshkujt dhe ky raport është shumë i thellë. Kujdesi për fëmijët dhe përgjegjësia për të mirëmbajtur shtëpinë përbëjnë punën e papaguar të grave. Kjo gjë është e trashëguar që nga dekadat e mëparshme dhe tregon mentalitetin e ulët që ne kemi në ndarjen e përgjegjësisë.

Edhe pse ligji dhe shoqatat e ndryshme të ndërtuara në funksion të të drejtave të grave dhe kundër diskriminimit të tyre, po bëjnë një bashkëpunim, fushata dhe ligje në favor të tyre, mbetet për të thënë ka akoma shumë punë për të arritur në një stabilitet dhe për t'i dhënë gruas vendin që i takon në shoqëri, institucione dhe në familje gjithashtu.

Punësimi informal ashtu si edhe në shumë vende të tjera të botës edhe në vendin tonë është i pranishëm në tregun e punës dhe në shifra

vërtet alarmante. Në Shqipëri, Inspektoriati i Punës ka zbuluar një numër të konsiderueshëm punëtorësh, që firmat nuk u paguajnë sigurimet shoqërore dhe i punësojnë në të zezë. Sindikalistët gjithashtu thonë nga ana e tyre se punësimi informal është po aq shqetësues sa edhe papunësia. Ata pohojnë se shumë firma punojnë me dy bilance dhe me dy listë-pagesa për punëtorët.

Punësimi informal prek të dyja gjinitë, por kohët e fundit vihet re një rritje e pjesëmarrjes së grave në punësimin informal. Arsyet janë të ndryshme, por ato më kryesore dhe të evidentuara në vendin tonë janë: Niveli i lartë i papunësisë, pamundësia për t'u arsimuar e për të marrë një profesion të caktuar, përkujdesi që gratë kanë për fëmijët, bën që ato të punojnë me orë të shkurtuara dhe në të shumtën e rasteve në punë informale. Nevojat e gruas si femër, nënë dhe bashkëshorte, i shtyjnë ato të punësohen qoftë edhe informalisht duke kërkuar në njëfarë mënyre pavarësi ekonomike, nevojë për integrim në shoqëri për barazi gjinore.

Puna informale është përsëri e pranishme në ndërmarrjet private dhe këtë fakt e vërtetuan edhe gjatë studimit që u bë në lidhje me këtë temë. Ka punonjës të përgjithshëm dhe njëkohësisht të pasiguruar, në këtë mënyrë bizneset deklarojnë më pak të ardhura dhe taten më pak duke kontribuar më pak në buxhetin e shtetit.

Politika të ndryshme po aplikohen për të vendosur rregull në tregun e punës dhe për të luftuar informalitetin. Shpresojmë shumë që gjinia femërore të zëjë vendin që i takon në shoqëri, pasi ashtu siç ka thënë edhe *Hilary Clinton, 2014 – « Kur gratë kanë sukses, bota ka sukses; kur gratë dhe vajzat lulëzojnë, të tëra shoqëritë lulëzojnë. Ashtu si të drejtat e grave janë të drejta të njeriut, edhe progresi i grave është progres njerëzor. »*

Referenca

- ILO. (2011). *Gender Discrimination at Work*. Geneva.
- INSTAT. (2013). *Femrat dhe meshkujt në Shqipëri*. Tiranë.
- Institute for Women's Policy Research. (September de 2013). *The Gender Wage Gap*. Recuperado el 2012, de <http://www.iwpr.org/publications/pubs/the-gender-wage-gap-2012-1/>
- OECD. (2009). *Is Informal Normal? Toward More and Better Jobs*. OECD's URL: <http://www19.iadb.org/intal/intalcdi/PE/2009/03433.pdf>
- Refleksione. (2013). *Monitorimi i strategjisë së punësimit në këndvështrimin gjinor*. Tiranë: Shoqata Refleksione.
- Romans, C. (2012). *Si të flasim në gjuhën e parasë*. (V. Bako, Trad.) Tiranë: Botimet DRITAN.60-61.
- Thomaj J, L. X. (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Mihal Duri.

- USAID. (2005). *Raport për vlerësimin e zbatimit të konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas në Shqipëri*. SHQIPERI: Nisma për të Drejtat e Grave (WLR).
- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (2013). *Mbrojtja e Pakicave në Shqipëri sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*. OSCE , 7-9.

SHPENZIMET PUBLIKE DHE DEFICITI BUXHETOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Agim Berisha²³

Kolegji Biznesi, Fakulteti Ekonomik; Prishtinë-Kosovë

Abstrakt

Buxheti paraqet instrumentin kryesor të financimit publik. Buxheti është një nga instrumentet më të rëndësishme ekonomike të cilën e ka në dispozicion qeveria e Kosovës. Përfshirja e shpenzimeve në procesin buxhetor i paraprinë apo përcakton edhe plotësimin e nevojave publike. Ekonomia e Kosovës që nga paslufta e deri më sot ballafaqohet me probleme ekonomike, me nivel të lartë të papunësisë, nivel të ulët të rritjes ekonomike dhe varësinë e ekonomisë së Kosovës nga importi. Po ashtu në kuadër të buxhetit, viteve të fundit vërehet tejkalimi i shpenzimeve publike ndaj të hyrave publike, përkatësisht deficiti buxhetor.

Përmes këtij studimi synojmë, që konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna të merren në konsideratë dhe t'u shërbejnë sadopak akterëve në fushën e financave publike.

Fjalët kyçe: Shpenzimet publike, buxheti, deficiti buxhetor.

²³ Dr. Sc. Agim Berisha është i lindur më 15.12.1973 në fshatin Dejnë-Komuna e Rahavecit. Ka kryer Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës dhe studimet pasdiplomike-Magjistraturën në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë. Studimet e Doktoraturës në Universitetin Bujqësor të Tiranës-Fakulteti Ekonomisë dhe Agrobiznesit në drejtimin: Financë-Kontabilitet në vitin 2013. Në vitin 2002 punësohet në Shkollën e Mesme "Xhelal Hajda-Toni" në Rahavec, profesor i lëndëve ekonomike. Prej vitit 2005 punon në Kolegjin "BIZNESI", ku dhe tani punon, profesor i lëndëve ekonomike, ndërsa që nga viti 2009 punësohet në MBPZHR, aktualisht në pozitën e auditorit të brendshëm. Ka kryer disa trajnime në fushën e financave publike.

Public expenditures and budget deficit in the Republic of Kosovo

Abstract

The budget is the main instrument of public funding. The budget is one of the most important economic instruments available to the Government of Kosovo. Including expenditure in the budget process precedes or determines the fulfillment of public needs. The Kosovo economy since the post-war has faced economic problems, with a high level of unemployment, a low level of economic growth and the dependence of Kosovo's economy on imports. Also, within the budget, over the past few years, it is noticed the overrun of public expenditures on public revenues, namely the budget deficit. Through this study we intend that the conclusions and recommendations given be taken into consideration and serve some of the stakeholders in the field of public finances.

Key words: Public expenditures, budget, budget deficit.

Hyrje

Në këtë punim paraqiten shpenzimet publike duke përfshirë strukturën e shpenzimeve publike sipas kategorive ekonomike, si dhe deficitin buxhetor në Republikën e Kosovës.

Objektivat kryesore në kuadër të punimit janë:

- Analiza e ecurisë së shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës viteve të fundit.
- Analizimi i trendit të deficitit buxhetor në Republikën e Kosovës viteve të fundit.

Qëllimi i studimit:

Qëllimi i studimit është analizimi i ecurisë së shpenzimeve publike, duke pasqyruar shpenzimet publike sipas kategorive ekonomike viteve të fundit në Republikën e Kosovës. Po ashtu, analizimi i financimit të deficitit buxhetor dhe pjesëmarrja e deficitit buxhetor në Bruto Produktin Vendor-BPV në Republikën e Kosovës.

Pytjet kërkimore të punimit:

Cili është trendi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike në strukturën e shpenzimeve buxhetore?

Sa është deficitit buxhetor dhe pjesëmarrja e tij në Bruto Produktin Vendor (BPV-në)?

Hipoteza 1:

Rritja e shpenzimeve publike dhe deficitit buxhetor ndikon në rritjen e borxhit publik.

Metodologjia e përdorur

Në funksion të objektivave në kuadër të studimit përdoret kryesisht metoda e analizës dhe metoda krahasimore duke shqyrtuar në dinamikë çështjet që lidhen me shpenzimet publike dhe deficitin buxhetor në Republikën e Kosovës. Deri te finalizimin i punimit, materiali i paraqitur ka mbështetje si vijon:

- a) Studime dhe literaturë vendëse dhe të huaj, si dhe raporte e publikime nga Ministria e Financave dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës, ku trajtohen çështje të shpenzimeve publike dhe të deficitit buxhetor në Republikën e Kosovës.
- b) Është përdorur burimi statistikor vendas, metoda e analizës dhe sintezës, tabelore dhe grafike veçmas, metoda krahasuese, etj.

Rishikimi i literaturës

Shpenzimet që kryen shteti për përmbushjen e objektivave dhe funksioneve të tij, njihen edhe si të dala publike (Sharku, Gentiana, Leka, Brikena, Bajrami, Enklava, 2013). Shpenzimet publike janë të lidhura ngusht me të hyrat publike, sepse pikërisht të hyrat publike janë burimi i financimit të nevojave shtetërore me anë të shpenzimeve publike (Komoni, Sabahudin, 2008). Shpenzimet publike, pra paraqesin shpenzimin e mjeteve financiare për nevojat publike të cilat janë krijuar me mbledhjen e të hyrave publike. Shpenzimet publike financohen nga të hyrat publike të mbledhura me anë të tatimeve, taksave, doganave, si dhe të ardhurat e siguruar nga veprimtaria e pronësia e shtetit.²⁴ Prandaj, shpenzimet publike janë ato të dala, të cilat shteti i realizon në interes publik, me qëllim të përmbushjes së nevojave shoqërore (Brajshori, Behxhet, 2014).

Duhet theksuar se në kohën e sotme buxheti ka një rol të rëndësishëm makroekonomik që synon të ekuilibrojë jetën ekonomike të vendit. Aktualisht debalanci buxhetor i shtetit shihet si diçka serioze vetëm kur shoqërohet me çekuilibër ekonomik. Kur të ardhurat e buxhetit të shtetit janë më të mëdha se shpenzimet, atëherë diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve quhet suficit i buxhetit të shtetit. Në rastet kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat, diferenca përbën deficitin e buxhetit të

²⁴ Tafa (Bungo), Dr.Genta, *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*, adel print, Tiranë, 2009, f. 344.

shtetit.²⁵ Në këtë kuadër, ka teori që sot argumentojnë se në rrethana të caktuara dhe brenda kufijve të arsyeshëm deficitit buxhetor mund të konsiderohet si një mënyrë e mirë për të luftuar rënien ekonomike. Deficitit rritet në një recesion dhe bie në një bum, madje pa asnjë ndryshim në politikën fiskale (Baumol, J. William, Blinder, S. Alan, *Economics: Principles and Policy*, Eleventh Edition, 2010).

Struktura e shpenzimeve publike

Në kuadër të politikave qeveritare, çështje mjaft e rëndësishme konsiderohet çështja e shpenzimeve qeveritare. Për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale duhet kushtuar vëmendje, sa shpenzimet e ngarkojnë buxhetin dhe ku orientohet shpenzimi i tyre. Në këtë aspekt, në veçanti, mbetet e rëndësishme mënyra e shpenzimit të mjeteve buxhetore dhe orientimi i shpenzimeve qeveritare për qëllime produktive. Përcaktimi i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike është përgatitur duke marrë për bazë kategorizimin ekonomik të shpenzimeve, në bazë të standardeve ndërkombëtare për Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ).

Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike ndahen në:

1. Paga dhe medijtje,
2. Mallra dhe shërbime,
3. Shpenzimet komunale,
4. Subvencionet dhe transfertat,
5. Shpenzimet kapitale.

Shpenzimet buxhetore klasifikohen sipas karakterit ekonomik, sipas karakterit funksional dhe sipas programeve. Pra, shpenzimet mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme, por ajo më me rëndësi konsiderohet sipas kriterit ekonomik, pasi jep mundësi për një analizë të buxhetit dhe të rolit që kanë pasur politikën makro-fiskale në ekonominë e vendit. Në fakt, tregon qëllimin e përdorimit të të ardhurave buxhetore. Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet ndahen në:²⁶

- Shpenzime korrente dhe
- Shpenzime kapitale.

Shpenzime operative publike quhen ato shpenzime të cilat krijohen në bazë të autorizimeve përkatëse nga organet vendimmarrëse, të cilat kanë karakter të ushtrimit të aktiviteteve operative qeveritare dhe legjislative. Pra, shpenzimet rrjedhëse përfshijnë shpenzimet për mallra dhe shërbimet që janë të domosdoshme për kryerjen e operacioneve të qeverisë. Në këtë

²⁵ Salko, Dr. Drini, *Bazat e financës*, Tiranë, 2010, f. 276.

²⁶ Sharku, Gentiana, Leka, Brikena, Bajrami, Enklava, Financa, Tiranë, 2013, f. 373.


kategori përfshihen: Shpenzimet për paga të administratës publike, shpenzimet operative dhe për mirëmbajtje (mallra dhe shërbime), subvencionet dhe transfertat, pagesat e interesave për kreditë etj. Shpenzimet kapitale publike ndryshe quhen edhe investimet publike.

**Tabela 1-1: Struktura e shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës
-në milion euro**

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017 Proj.	2018 Proj.	2019 Proj.
Shpenzimet totale	1,480	1,564	1,732	2,001	2,064	2,160
Shpenzimet rrjedhëse	1,058	1,149	1,221	1,275	1,310	1,348
Pagat dhe mëditjet	489	525	549	572	597	622
Mallrat dhe shërbimet	208	205	207	225	228	232
Subvencionet dhe transfertet	361	418	466	473	479	492
Rezerva	0.00	0.00	5	9	9	6
Kredidhënia për NP	0.00	-2	-7	-11	-15	-14
Nga të cilat: Kreditë për NP	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Nga të cilat: Kthimet nga NP	0.00	-2	-7	-11	-15	-14
Shpenzimet kapitale	411	404	500	722	753	810
Të financuara nga buxheti i rregullt	0.00	0.00	485	530	558	605
Ekzistuese të financuara nga IFN	0.00	0.00	0.00	22	24	28
Të financuara nga huazimi i brendshëm	0.00	0.00	0.00	100	100	100
Të financuara sipas klauzolës së investimeve	0.00	0.00	15	105	105	105
Të financuara nga mjetet e likuidimit	0.00	0.00	0.00	87	90	100
Shpenzimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve	11	13	12	12	12	12

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 19.

Figura 1-1: Struktura e shpenzimeve publike në Republikën e Kosovës



**Tabela 1-2: Shpenzimet publike në Kosovë sipas realizimit në vitin 2016.
-në 000 euro**

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi 2016
Shpenzimet buxhetore	1,719,463	1,657,550
Pagat dhe rroga	548,764	543,763
Mallrat dhe shërbimet	206,971	202,779
Nga të cilat: Komunalitë	24,953	23,362
Subvencionet dhe transferet	465,723	474,672
Shpenzimet kapitale	500,022	443,572

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 40.




Figura 1-2: Shpenzimet publike në Kosovë sipas realizimit në vitin 2016.

Shpenzimet e përgjithshme publike në vitin 2016 nga 1.7 miliard euro janë realizuar në vlerë prej 1.6 miliard euro, nga të cilat në kategorinë e pagave dhe meditjeve 543.7 milion euro, shpenzime kapitale 443.5 milion euro, subvencione dhe transfere 474.6 milion euro, ndërsa në mallra dhe shërbime 202.7 milion euro.

1.Shpenzimet publike në paga dhe meditje

Në këtë kategori përfshihen të gjitha pagesat që u bëhen të punësuarëve në bazë të punës së rregullt, punës jashtë orarit, punës së vazhdueshme, punës gjatë natës, festave, shpërblimeve, honoraret, bonuset dhe kompensimet e tjera, të cilat i përfiton i punësuarit në bazë të shërbimeve të ofrura. Në shumën e kompensimeve bëjnë pjesë edhe të gjitha ndalesat e tjera që i punësuarit është i obliguar t'i paguaj, si p.sh., tatimet në të ardhura personale, kontributet pensionale.

Në shpenzimet publike kategoria e pagave dhe meditjeve përbën pjesën më të rëndësishme të shpenzimeve rrjedhëse buxhetore.


Tabela 1-3: Shpenzimet publike në kategorinë paga dhe medijtje sipas realizimit në vitin 2016.

-në 000 euro

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Buxheti i realizuar në %
Shpenzimet buxhetore	1,719,463	1,657,550	97%
Pagat dhe rroga	548,764	543,763	99%

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 40.

Figura 1-3: Shpenzimet publike në kategorinë paga dhe medijtje sipas realizimit në vitin 2016.



Shpenzimet në paga dhe medijtje në vitin 2016 kanë pasur ecuri në rritje krahasuar me vitin 2015, duke u rritur shpenzimet në këtë kategori nga 525 milionë euro sa ishte në vitin 2015 në 549 milionë euro në vitin 2016. Kategoria e shpenzimeve në paga dhe medijtje në vitin 2016 ka arritur të realizohet në vlerën prej 543.7 milionë euro, krahasuar me buxhetin e planifikuar në këtë kategori prej 548.7 milionë euro, apo shprehur në përqindje prej 99%.

2. Shpenzimet publike në mallra dhe shërbime

Në këtë kategori përfshihen të gjitha shpenzimet të cilat kanë karakterin operativ, nuk mbartin gjendje në periudhat e ardhshme dhe si të tilla nuk kapitalizohen. Kjo do të thotë se afati përdorimit të tyre është më pak se një vit. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve përfshin blerjet e materialeve, furnizimeve për zyrë, qirasë, lëndës djegëse, riparimeve dhe mirëmbajtjes, printimit, shpenzimeve të udhëtimit, shpenzimeve të transportit dhe të telekomunikimit, shërbimet e ndryshme konsulente, arsimit i vazhdueshëm dhe trajnime, shpenzime të përfaqësimit, interesi, etj.


Tabela 1-4: Shpenzimet publike në mallra dhe shërbime sipas realizimit në vitin 2016.

-në 000 euro

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Buxheti i realizuar në %
Shpenzimet buxhetore	1,719,463	1,657,550	97%
Mallrat dhe shërbimet	206,971	202,779	98%

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 40.

Figura 1-4: Shpenzimet publike në mallra dhe shërbime sipas realizimit në vitin 2016.



Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2016 kanë ndjekur pothuajse të njëjten ecuri sikur të vitit 2015, megjithatë shuma e përgjithshme ka pasur rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak. Kjo kategori në vitin 2016 ka arritur të realizohet në vlerë prej 202.7 milionë euro, apo shprehur në përqindje prej 98 % të planit të buxhetit të vitit 2016.

3. Subvencionet dhe transferet

Të gjitha transferet e mallrave dhe shërbimeve për përfituesit individ të cilët nuk janë të punësuar në organizata buxhetore, personave juridikë që nuk janë organizata buxhetore, qeverive e tjera ose për organizatat ndërkombëtare trajtohen si subvencione dhe transfere. Grantet e tilla mund të pasojnë me transfer të pasurive fikse që janë pronë e qeverisë, me transferin e mallrave që mbahen në stoqe, konstruktimin e pasurive fikse ose blerjen dhe transferin e njëkohshëm të pasurive fikse, ose të mallrave dhe shërbimeve për konsumim të tashëm. Shembuj janë transferet e ushqimit, rrobave, batanijeve dhe barnave si ndihmë urgjente pas katastrofave natyrore, transferet e makinerisë dhe pajisjeve tjera, sigurimin

direkt të ndërtimit të ndërtesave dhe strukturave tjera dhe transferet e pajisjeve ushtarake të të gjitha llojeve.

Këto lloje të shpenzimeve mund t'i definojmë edhe si pagesa të pakthyeshme apo të pakompensueshme. Nga ky aspekt kemi këtë përkufizim: Subvencionet përfshijnë të gjithë transferet e njëanshme, të pakthyeshme në të paguara nga fondet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në llogari të industrisë private dhe publike. Subvencionet përjashtojnë transferet për qëllime kapitale, d.m.th. për qëllim të mundësimit që pranuesit të përvetësojnë pasuri kapitale. Subvencionet përfshijnë koston e mbulimit të deficiteve operative të parasë së gatshme të ndërmarrjeve publike dhe industrisë private. Transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për qeveritë e tjera, institucionet joprofituese, familjet dhe individët. Transferet për individët përfshijnë programet e mirëqenies sociale siç janë pensionet. Transferet për institucionet joprofitabile përfshijnë mbështetjen që i jepet institucioneve kulturore, sportive dhe joqeveritare, ku nuk kërkohet asgjë specifike si kthim për këto pagesa, dhe ku institucioni joprofitues nuk financohet dhe nuk kontrollohet kryesisht nga qeveria.


Tabela1-5:Shpenzimet publike në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave sipas realizimit në vitin 2016.

-në 000 euro

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Buxheti i realizuar në %
Shpenzimet buxhetore	1,719,463	1,657,550	97%
Subvencionet dhe transferet	465,723	474,672	102%

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 40.

Figura 1-5: Shpenzimet publike në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave sipas realizimit në vitin 2016.



Subvencionet dhe transfertat në vitin 2016 kanë pasur ecuri në rritje krahasuar me vitin 2015, ngase kjo kategori u rrit nga 418 milionë euro sa ishte në vitin 2015 në 466 milionë euro në vitin 2016. Pra, kjo kategori në vitin 2016 ka arritur të realizohet në vlerën prej 474.6 milionë euro, nga 465.7 milionë euro sa ishin të planifikuara, apo shprehur në përqindje prej 102 % të planit të buxhetit të vitit 2016.

4. Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale janë pagesat që bëhen nga buxheti i Kosovës për blerje të mirave materiale të cilat kapitalizohen gjatë periudhave të ardhshme të angazhimit. Kjo do të thotë se kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit. Këtij përkufizimi i shtohet se vlera e tyre blerëse individuale që duhet të jetë më e madhe se 1000 €. Ky limit është i përcaktuar në bazë të politikave të vlerësimit të pasurisë kapitale të qeverisë. Në këtë kategori bëjnë pjesë: toka, ndërtesat, infrastruktura rrugore, makineritë, mjetet transportuese, programet kompjuterike, pajisjet, mobiljet, etj. Transferet kapitale janë pagesa të qeverisë të cilat bëhen për përfituesit fizikë dhe juridikë, që iu dedikohet që këto para të i përdorin për të blerë apo për të ndërtuar një pasuri fikse. Transferet e pasurisë kapitale janë pagesat që bëhen sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore të cilat nuk bazohen në një të drejtë juridike të përfituesit të këtyre fondeve, por bëhen me qëllim që t’iu mundësohet pranuesve të përvetësojnë një pasuri kapitale.

Tabela 1-6: Shpenzimet publike në kategorinë e shpenzimeve kapitale sipas realizimit në vitin 2016.

-në 000 euro

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Buxheti i realizuar në %
Shpenzimet buxhetore	1,719,463	1,657,550	97%
Shpenzimet kapitale	500,022	443,572	89%

Burimi: Ligji Nr. 05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 40.

Figura 1-6: Shpenzimet publike në kategorinë e shpenzimeve kapitale sipas realizimit në vitin 2016.



Shpenzimet kapitale gjatë periudhës 2014-2015 kanë pasur ecuri në rënie, duke u rritur në vitin 2016. Në vitin 2015 shpenzimet kapitale ishin në vlerën prej 404 milionë euro duke pasur rritje në vitin 2016 duke arritur në vlerën prej 500 milionë euro sipas buxhetit të planifikuar. Pra, kjo kategori në vitin 2016 ka arritur të realizohet në vlerën prej 443.5 milionë euro, kundrejt buxhetit të planifikuar prej 500 milionë euro, apo shprehur në përqindje prej 89 % të planit të buxhetit të vitit 2016.

Financimi i deficitit buxhetor

Kur një qeveri nuk arrin të balancojë buxhetin e saj, asaj i duhet të marrë para hua duke emetuar obligacione në mënyrë që të kompenzojë mungesën.²⁷ Deficiti i buxhetit të qeverisë është i barabartë me shpenzimet qeveritare minus të ardhurat e qeverisë, e cila nga ana tjetër është e barabartë me sasinë e borxhit të ri që duhet të lëshojë qeveria për të financuar operacionet e saj.²⁸ Për të mbuluar deficitin buxhetor, qeveritë janë të detyruara të marrin hua. Qeveria për të financuar deficitin buxhetor

²⁷ Mankiw, N. G. & Taylor, M. P., Economics/ Macroeconomics, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012, f. 557.

²⁸ Mankiw, N. G., Macroeconomics, seventh edition, 2009, f. 472.

mund të marrë hua brenda vendit dhe jashtë vendit. Qeveritë i financojnë deficitet buxhetore duke marrë hua në tregun e obligacioneve dhe akumulimi i huamarrjeve të kaluara nga qeveria quhet borxh qeveritar.

Nisur nga kjo, përdorimi i huamarrjes për të financuar shpenzimet publike, nënkupton tatime më të ulëta për qytetarët gjatë viteve të deficitit, por tatime më të larta në të ardhmen, të ardhurat nga të cilat do të përdoren për shlyerjen e borxhit dhe pagimin e interesave.

Pra, nëse deficioni buxhetor vazhdon për shumë vite me radhë, tatimpaguesit e tanishëm do të shtyejnë barrën e pagimit të tatimit për mallrat dhe shërbimet publike që ata marrin, tek tatimpaguesit e brezit të ardhshëm. Me fjalë tjera, deficitet mund të ulin edhe standardin jetësor të gjeneratave të ardhshme duke kontribuar në uljen e investimeve dhe uljen e rritjes ekonomike. Nuk duhet ngatërruar deficitin buxhetor me borxhin shtetëror. Borxhi kombëtar është huamarrja e akumuluar nga të gjitha deficitet e kaluara, përjashtuar huatë e shlyera. Borxhi shtetëror apo publik, siç quhet ndryshe, paraqet vlerën e akumuluar të huave, të cilat shteti i ka huazuar për t'i financuar deficitet e kaluara. Borxhi shtetëror për një periudhë të caktuar kohore është i barabartë me deficitin buxhetor të të njëjtës kohë. Me fjalë tjera borxhi kombëtar përbëhet nga deficitet e akumuluar minus suficitet gjatë gjithë historisë së vendit.²⁹

Qeveria përmes Ministrisë së Financave, përveç legjislacionit bazë mbi borxhin publik ka hartuar Rregulla dhe Procedura përkatëse, për të rritur transparencën e menaxhimit dhe përcaktimin e përgjegjësive menaxhuese.

Tabela 1-7: Deficioni buxhetor ndaj BPV-së në Republikën e Kosovës në periudhën 2014-2017


-në milionë euro

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017 Proj.
Të hyrat publike	1,345	1,470	1,634	1,725
Shpenzimet publike	1,480	1,564	1,732	2,001
Financimi vjetor nga huamarrja	121	187	184	361
Stoku i borxhit të brendshëm	257	378	478	578
Garancionet shtetërore	0.00	10.00	40.00	44.00
BPV	5,568	5,568	6,031	6,410
Deficioni si % e BPV-së	-2.3%	-1.4%	-1.6%	-1.5%

Burimi: Ligji Nr.05/L-125, Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, f. 19.

²⁹ Salko, dr. Drini, *Bazat e financës*, Tiranë, 2010, f. 276.

Figura 1-7: Deficiti buxhetor ndaj BPV-së në Republikën e Kosovës në periudhën 2014-2017.



Për të mbuluar deficitin buxhetor, shteti duhet të hyjë borxh, që shprehet negativisht në rrjedhat ekonomike. Nga këndvështrimi ekonomik, në Republikën e Kosovës, deficiti buxhetor vazhdon të mbahet në nivelet e përcaktuara përmes rregullës fiskale nën 2% të BPV-së. Deficiti buxhetor kryesisht financohet nga huamarrja e brendshme dhe huamarrja e jashtme. Këto dy koncepte, deficiti dhe borxhi janë të lidhura ngusht ndërmjet njëra-tjetrës. Marrëdhënia ndërmjet borxhit dhe deficitit ose suficitit mund të shpjegohet me një analogji të thjeshtë. Ndërsa ju futni ujë në një vaskë ("të drejtuar një deficit"), vëllimi i grumbulluar i ujit në vaskë ("borxhi") rritet. Përndryshe, nëse e lëshoni ujin nga vaska ("të drejtuar një suficit"), niveli i ujit ("borxhi") bie. Analogjikisht, deficitet buxhetore rrisin borxhin kombëtar, ndërsa nga suficiti buxhetor pëson rënie. (Baumol, J. William, Blinder, S. Alan, Economics: Principles and Policy, Eleventh Edition, 2010).

Në qoftë se në mënyrë të vazhdueshme bëhet huamarrja, madhësia e borxhit rritet me kalimin e kohës. Kur qeveria ka një deficit buxhetor, borxhi i saj rritet dhe kur ka një tepriçë buxhetore, borxhi i saj zvogëlohet.³⁰

Përfundimi

Shpenzimet qeveritare si kategori përfaqësojnë shpenzimet publike për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve për qytetarët. Lartësia e shpenzimeve

³⁰ Parkin Powell Matthews, Economics, Sixth edition, f. 559.

publike është e lidhur ngusht me të hyrat publike. Kjo do të thotë se shteti i pranon paratë publike nga individit për qëllime kolektive dhe për plotësimin e nevojave publike.

Konkluzione:

- Shpenzimet publike në vijueshmëri kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ecuri në rritje;
- Në strukturën e shpenzimeve publike pjesëmarrje më të madhe vazhdojnë të kenë shpenzimet rrjedhëse kundrejt shpenzimeve kapitale.

Rekomandime:

- Të përmirësohet struktura e shpenzimeve publike duke reduktuar shpenzimet rrjedhëse dhe rritjen në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
- Shpenzimet publike duhet të orientohen kryesisht në financimin e investimeve publike dhe projekteve zhvillimore.
- Deficiti buxhetor të mbahet në nivelet e përcaktuara përmes rregullës fiskale duke mos tejkaluar 2-3 % të BPV-së, si dhe mjetet e siguruara nga huamarrja e brendshme dhe huamarrja e jashtme duhet të përdorën për t'i financuar projektet strategjike të cilat kanë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit.

Literatura

- Agjencia e Statistikave e Kosovës, *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017*, Prishtinë, 2017.
- 2. Baumol, J. William, Blinder, S. Alan, *Economics: Principles and Policy*, Eleventh Edition, 2010.
- 3. Brajshori, Dr.Behxhet, *Financat Publike*, Prizren, 2014.
- 4.Tafa (Bungo), Dr.Genta, *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*, adel print, Tiranë, 2009.
- Parkin Powell Matthews, *Economics*, Sixth edition.
- Mankiw, N. G. & Taylor, M. P., *Economics/ Macroeconomics*, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012.
- 7.Mankiw, N. G. & Taylor, M. P., *Macroeconomics*, Printed in the United States of America, First Printing 2009.
- 8. Mankiw, N. G, *Macroeconomics*, seventh edition, 2009.
- 9. Komoni, Dr.Sabahudin, *Financat Publike*, Prishtinë, 2008.
- 10. Salko, Dr. Drini, *Bazat e financës*, Tiranë, 2010.
- 11 Sharku, Gentiana, Leka, Brikena, Bajrami, Enklava, *Financa*, Tiranë, 2013.
- 12.Ligji, Nr.05/L-125, *Për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017*.

MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE NË QYTETIN E ELBASANIT

Matilda Toska³¹

*Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës,
Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Marketingut*

Abstrakt

Në ditët e sotme, çështja e mjedisit ka hyrë me prepotencë të madhe në axhendën e qeverisë, në axhendën e pushtetit vendor, në kronikat e masmedias, si dhe brenda bisedave dhe diskutimeve që bëhen në familje dhe shoqëri. Arsytet pse çështja e mjedisit ka marrë një rëndësi dhe një jehonë kaq të madhe, janë të ndryshme dhe duhet të kërkohen si në një kontekst të ngushtë (natyra dhe personaliteti njerëzor), ashtu dhe në një kontekst të gjerë (traditat, kultura dhe shoqëria).

Punimi ka për qëllim të nxjerrë në pah impaktin ekonomik dhe mjedisor të menaxhimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit.

Metodat që janë përdorur gjatë këtij punimi janë metoda sasiore dhe metoda cilësore. Mënyra e grumbullimit të të dhënave është fokusuar në mënyrën e mbledhjes së të dhënave primare dhe të dhënave sekondare.

Gjatë këtij studimi është evidentuar që kostoja e menaxhimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit nuk mbulohet totalisht nga taksat e mbledhura për këtë qëllim, por mbulohet pjesërisht nga buxheti i Bashkisë. Përsa i përket kufizimeve në këtë studim nuk dihet akoma impakti që do të ketë termovlerësuesi i ndërtuar rishtazi, kjo sepse akoma nuk është vënë në punë me efikasitet të plotë (aktualisht është në fazë testimi).

Përsa i përket impaktit praktik ky studim ka efekt evidentues dhe mbetet kompetencë e pushtetit vendor marrja parasysh e sugjerimeve të paraqitura në këtë studim.

³¹ Jam diplomuar në vitin 2007 në profilin Financë në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin "Aleksandër Xhuvani". Në vitin 2013 kam përfunduar Masterin Shkencor Bankë – Financë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Nga viti 2016 e në vazhdim jam pedagoge e jashtme në departamentin Marketing, Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu". Kam një pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga universitete të ndryshme, seminare e trajnime të shumta.

Originaliteti i këtij punimi qëndron në faktin se studimi prek aspekte të gjithanshme, si ekonomike ashtu dhe mjedisore. Duke parashtruar si problematikën aktuale ashtu dhe pritshmëritë e mundshme.

Fjalët kyç: mjedisi, impakti ekonomik, impakti mjedisor, manaxhim, mbetje urbane.

Integrated waste management in the city of Elbasan

Abstract

Nowadays, the issue of the environment has come with great opposition into the agenda of the Government, the agenda of local government, the mass media chronicles, and also the conversations and discussions that take place in the family and society. The reasons why the issue of the environment has become so important and echoed are different and should be sought both in a narrow context (nature and personality) and in a broader context (traditions, culture and society). The paper aims to highlight the economic and environmental impact of urban waste management in the city of Elbasan. The methods used in this paper are quantitative and qualitative methods. The data collection method is focused on the way of collecting primary and secondary data. During this study, it is evidenced that the cost of urban waste management in the city of Elbasan is not fully covered by the taxes collected for this purpose, but is partially covered by the municipal budget. Regarding the limitations in this study, it is not known yet the impact that the newly constructed termo-estimator will have, because it is not yet fully operational (currently it is in the testing phase). As far as practical impact is concerned, this study has an evident effect and it remains the competence of local government to take into account the suggestions presented in this study. The originality of this paper lies in the fact that it affects all aspects of economy as well as environment by presenting both the current problem and the expected expectations.

Key words: environment, economic impacts, environmental impact, management, urban waste.

1. Gjeografia dhe morfologjia

Qyteti Elbasanit ka një sipërfaqe prej 1.29 km² dhe një popullsi prej 128 051 banorë³². Shtrihet në qendër të Shqipërisë dhe kufizohet: në veriperëndim me Tiranën, në verilindje e lindje me Librazhdin, në juglindje me Gramshin, në jug me Beratit dhe Kuçovën, në jugperëndim me Lushnjën. Shtrihet në fushën me të njëjtin emër, në krahun e djathtë të rrjedhës së mesme të Shkumbinit në lartësi 120 m nga niveli detit. Është rreth fushor e pjesërisht kodrinor-malor. Lartësia mesatare është 440 m. Maja më e lartë është mali i Jeronishtit (1883 m). Malet ndodhen në verilindje, lindje e juglindje (si Labinot, Shpati). Kodrat ndodhen në veriperëndim, perëndim dhe jugperëndim si kodrat e Dumresë, Sulovës dhe Llixhës. Fushat ndodhen në pjesën qendrore, si: fusha e Elbasanit, Cërrikut, Gostimës. Klima e qytetit të Elbasanit karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Reshjet bien kryesisht në stinën e dimrit dhe të vjeshtës me një mesatare prej 1490 mm në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C. Për sa i përket relievit 38% e përbëjnë malet, 28% e përbëjnë fushat dhe 34% e përbëjnë kodrat. Qarku përshkohet nga dy lumenj: Shkumbini e Devolli. Në pasuritë hidrografike të Qarkut të Elbasanit hyjnë edhe rezervuarët dhe liqenët. Rrethi i Elbasanit ka një sipërfaqe ujore rreth 650 ha të cilat përbëhen nga liqene natyrore dhe rezervuare.

2. Ekonomia dhe industrinë

Ekonomia në Bashkinë e Elbasanit, është një ekonomi e shumëllojshme, që varion në mënyrë tejet të lartë, si nga përmasa, ashtu dhe për nga sektorët përbërës. Bujqësia ka patur rritje të mëdha këto dy vitet e fundit, kjo falë ngritjes së serave, kultivimit pothuajse total të tokave të punueshme, plantacioneve të ullirit dhe druve të tjerë frutorë. Efekti i lënies së tokës djerrë, pothuajse është zhdukur. Elbasani ka qenë gjatë sistemit, qyteti më i industrializuar i vendit me kompleksin e madh të ish – Kombinatit Metalurgjik, Fabrikën e Çimentos, Rafinerinë e naftës në Cërrik etj. Nga ajo lavdi e dikurshme kanë mbijetuar vetëm pjesë të veçanta të industrisë. Fabrika e Çimentos punon aktualisht me kapacitet të reduktuar. Puna është reduktuar vetëm në bluarjen e klinker-it dhe paketimin e çimentos, pasi klinkeri vjen i gatshëm nga fabrika e Fushë Krujës. Rafineria e Naftës së Cërrikut, tashmë është kthyer në një gërmadhë që kujton funksionin që ka

³² <http://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx>

pas kryer dikur. Por aktualisht ka rreth 1 vit që ka filluar punë një rafineri naftë në zonën e ish -kombinatit metalurgjik. Uzina e Ferrokromit, pjesë e shoqërisë “Balfin Group”, vazhdon punën normalisht. Shoqëria turke Kurum International sh.a., ka vite që operon në shkrirjen e çelikut. Pjesë përbërëse e kompleksit të saj janë: fabrika e gëlqeres, uzina e çelikut, prodhimi i oksigjenit, uzina e petëzimit dhe tashmë mund të konsiderojmë si entitet në vete, investimin e fundit të bërë nga kjo shoqëri, seleksionimi i metalit. Ish-fabrika e konservimit tani ka mbetur një grumbull magazinash ku kryhen aktivitete të ndryshme më të vogla prodhuese ose tregtuese. Sektori i tretë dhe turizmi, ofrojnë punësimin kryesor. Dy janë zonat turistike në bashkinë e Elbasanit: zonat turistike malore Gjinar dhe zona turistike me burimet e veta termale e Treganit (Llixha). Dominues në sektorin e tretë mbetet biznesi i vogël, sidomos bar, restorante, hotele, pishina etj. Kriza globale ka ndikuar shumë mbi industrinë aktuale dhe në përgjithësi në të gjithë sistemin prodhues të bashkisë, duke ndikuar negativisht në fenomenin e papunësisë, uljes së të ardhurave, tensioneve sociale dhe shoqërore, rritjen e numrit të të miturve të detyruar të braktisin shkollën për të punuar në ndihmë të familjes.

3. Situata e përgjithshme dhe burimet e ndotjes

Kur flasim për ndotjen duhet të kemi parasysh se tri janë elementet kryesore që dëmtohen: toka, uji, ajri.

Ndotja këto 20 vitet e fundit kishte arritur nivelet maksimale. Kjo lidhet si me faktorët psikologjikë dhe kulturorë, ashtu dhe me situatën e re socio – ekonomike të krijuar. Me shtimin e produkteve në qarkullim mbas viteve '90, u shtua dhe sasia e ambalazhit të përdorur dhe që detyrimisht përfundon si mbetje e ngurtë urbane. Shtimi i ambalazheve u shoqërua dhe me shkatërrimin e industrisë ricikluese ekzistuese (fabrikat e qelqit, plasmasit, letrës). Operatorët e rinj industrialë që hynë në treg nuk i kushtonin rëndësi mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu dhe shteti, duke u përqendruar në problemet e mëdha ekonomike dhe sociale, u disinteresua totalisht për problemet e mjedisit. Tashmë ka një ndërgjegjësim të aparatit shtetëror në rang qendror apo vendor. Mjafton të kujtojmë përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit mjedisor, projekte dhe bashkëpunime të ndryshme në fushën e mjedisit, iniciativa të ndryshme në shkallë vendi (siç ishte iniciativa e datës 20 prill 2012 e në vazhdim “Për një Shqipëri të pastër”), ndërsa në nivel vendor përmendim ndërtimin e termovlerësuesit, Landfill-it të ri dhe mbylljen e fushës së vjetër të mbetjeve urbane.

Ndotja e tokës: Toka mund të ndotet për shkak të operatorëve të ndryshëm ekonomikë të mëdhenj (industrinë që depozitojnë mbetjet industriale dhe skorjet e ndryshme), të vegjël (vajërat lubrifikantë të përdorur të grumbulluar nga serviset, pesticidet e përdorura pa kriter nga fermerët, etj.), nga individët me përdorimin e produkteve dhe hedhjen në tokë dhe jo në vendet e caktuara për grumbullimin të ambalazheve të ndryshme që nuk janë të biodegradueshëm. Një problem përbën dhe prodhimi dhe hedhja pa kriter e mbetjeve inerte të dala nga ndërtimet, mbushja me to e tokave prodhuese me qëllim ndryshimin e destinacionit të përdorimit dhe të gjeomorfologjisë. Duhet theksuar se ndotja e tokës mund të vijë edhe nga aktivitete kriminale (eko – mafiet), si depozitimi dhe braktisja në vende të papërshtatshme të lëndëve radioaktive, kimike, biologjike etj.

Ndotja e ujit: ashtu si në rastin e tokës edhe në rastin e ujit, burimet e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore janë të ndryshëm. Industrinë mund të shkarkojnë direkt në lumenj dhe përrenj, mbetjet e lëngëta të procesit prodhues. Gjithashtu mund të lenë në ambiente të hapura mbetje të ngurta, që për shkak të agjentëve atmosferikë (shiu, bora), treten dhe penetrojnë në terren duke ndotur kështu ujërat nëntoksore. Burim tjetër ndotje janë konglomeratet urbane. Të gjitha qendrat urbane të mëdha e të vogla, duhet të pajisen me depuratorë të ujërave të zeza. Aktualisht nuk ka asnjë depurator për trajtimin e tyre dhe ujërat e zeza të qytetit të Elbasanit derdhen direkt në lumin Shkumbin duke ndotur kështu, një nga basenet ujore kryesore të Shqipërisë së mesme. Në zona periferike vihet re se shpesh ujërat e zeza kalojnë në kanale sipërfaqësore dhe jo në tubacione, duke u bërë kështu burim sëmundjesh dhe ndotjeje të ujit të pijshëm. Edhe aktivitetet bujqësore të fermerëve me përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimikë kanë ndikimin e vet në ndotjen e ujit.

Ndotja e ajrit: Të akuzuarit e përhershëm të ndotjes së ajrit në Elbasan, janë operatorët e mëdhenj industrialë. Jo pa arsye qytetarët kanë pasur këtë përshtypje dhe psikozë të krijuar ndaj këtyre operatorëve. Agjentët ndotës kryesorë janë gazrat e dëmshëm (CO, SO_x, Nox) dhe grimcat e rënda (PM10). Operatori më i madh industrial i zonës dhe i akuzuari kryesor është Kurum International sh.a. Ky operator trashëgoi një teknologji të vjetëruar nga ish-Kombinati Metalurgjik. Gjithashtu, kur është bërë studimi i “Trëndafilin të erërave” për ndërtimin, nuk është parashikuar (ose nuk është dashur të parashikohej), se për shkak të afërsisë me Elbasanin, era do të sillte në qytet të gjithë tymin. Kjo ka qenë dhe arsyeja pse Elbasani ka qenë një nga hot-spotet e nxehta përse i përket ndotjes së ajrit dhe sëmundjeve (si leuçemia, sëmundjet e aparatit frymëmarrës) të lidhura direkt me ndotjen. Aktualisht ka një përmirësim të vazhdueshëm të situatës.

Por jo i gjithë faji për ndotjen e ajrit është i operatorëve industrialë. Me rritjen e numrit të automjeteve në qarkullim, është rritur ndjeshëm shkarkimi i gazrave të prodhuar nga djegia e karburanteve fosile. Këto karburante kanë fuqi kalorifike të ulët (rritet konsumi dhe emisioni i gazrave) dhe % të lartë squfuri dhe metalesh të rënda (pasi rafinimi nuk është bërë siç duhet). Mund të përmendim gjithashtu dhe uljen e cilësisë së ajrit, që vjen si pasojë e djegies gjatë verës të fondit pyjor. Impakti mjedisor këtu është dopio, një për arsye të shkarkimit të tymrave dhe gazrave dhe dy, për arsye të reduktimit të mushkërisë së gjelbër që thith CO₂ dhe çliron O₂.

4. Menaxhimi i mbetjeve urbane në Elbasan

4.1 Mbledhja e padiferencuar e mbetjeve urbane sot

Aktualisht, firma që ka fituar tenderin dhe që bën pastimin e qytetit, është Victoria Invest International Group. Kjo firmë me mjetet dhe personelin e saj, bën grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane.

Grumbullimi:

Grumbullimi i padiferencuar i mbetjeve të ngurta urbane, kryhet me ndihmën e konteinerëve metalikë. Në konteinerë përfundon praktikisht çdo gjë, jo vetëm mbetjet e gjeneruara nga privatët, por dhe ato të gjeneruara nga bizneset. Këto konteinerë, zbrazen me ndihmën e mjeteve speciale vetëngarkues. Pas kryerjes së operacioneve të nevojshme, punonjësit në bazë të një grafiku të paracaktuar, me radhë bëjnë larjen e kazanëve si dhe dizinfektimin e tyre dhe të vendit përreth kazanit. Më poshtë do të japim specifikimet cituar nga dokumenti i Bashkisë, “Specifikime teknike Elbasan” (Shtojca 1)³³

Ky shërbim do të kryhet gjatë natës nga ora 24 – 08.

Sasia e mbetjeve urbane që do të transportohet çdo ditë është 100 ton/ditë, nga të cilat mesatarisht 80 ton/ditë do të transportohen nga konteinerët me mjete teknologjike dhe 18 ton/ditë me mjete të thjeshta direkt nga familjarët dhe pikat e hapura.

Autoriteti kontraktor për kohëzgjatjen e këtij tenderi për vitin 2016 që fillon: ka parashikuar dhe vlerësuar vendosjen e 650 copë kontinierqve me volum 1.1m³ nga operatori sipërmarrës që do të realizojë këtë shërbim.

³³ <http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/2123>

Theksojme se kontenieret do të sigurohen nga vetë operatori i shërbimit dhe vendosja e tyre do të bëhet në përputhje me planvendosjen dhe hartën në të cilat janë vendosur të gjitha koordinatat.

Nga këtu ndërtojmë tabelën e mëposhtme:

Tabela 1-3

Elbasani				
Banorë(2016)	Mbetje urbane ditore të prodhuara	Mbetje urbane vjetore të prodhuara	Mbetje urbane kg/person në ditë	Mbetje urbane kg/person në vit
128.418	100 ton	36.500 ton	0,77 kg/person	284,22kg/person

Pra çdo qytetar elbasanas, prodhon mesatarisht gati 1 kg në ditë mbetje urbane (përfshirë dhe foshnjat e sapolindura). Kjo e dhënë na jep idenë e impaktit të madh mjedisor, që ka ç' do njëri prej nesh. Ulja e përdorimit të ambalazheve, ndryshimi i stilit të jetesës dhe mënyrës së konsumit, ndërgjegjësimi i çdo kujt prej nesh, do të përkthehet në ulje të prodhimit për frymë të mbetjeve urbane, kosto më e ulët për menaxhimin e tyre, impakt më i vogël mjedisor, shëndetësor dhe ekonomik.

Transporti:

Më tej mbetjet urbane transportohen me ndihmën e mjeteve motorike vetëngarkuese për në Landfill-in e ri.

Në rrugica të ngushta lagjeje, ku praktikisht është e pamundur vendosja e kazanëve dhe tranzitimi i mjeteve vetëngarkuese për ngritjen dhe boshatisjen e kazanëve, përdoret një metodë tjetër grumbullimi. Zakonisht bëhet fjalë për lagje me shtëpi banimi private (jo banesa kolektive), ku mbetjet mbahen në shtëpi dhe firma Victoria Invest dërgon një mjet të saj më të vogël që bën mbledhjen e mbetjeve derë më derë. Meqenëse bëhet fjalë për ngarkimin të qeseve të vogla me mbeturina, nuk del e nevojshme përdorimi i mjeteve vetëngarkuese.

Largimi i mbetjeve urbane konsiston në: zbrazjen e kontenierëve në makinat teknologjike, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura për rreth kontenierëve, fshirjen me krah të sipërfaqes me rreze 3 m të VGM dhe rivendosjen e kontenierëve në vendin e caktuar në mënyrë të rregullt dhe estetike. Më pas makina teknologjike kryen transportin e mbeturinave për në Landfill-in e ri.

Kontenierët do të përpunohen çdo ditë edhe në rastet kur nuk janë të mbushur plotësisht.

Në përfundim të këtij procesi përfshihet dhe dezinfektimi i kontenierëve dhe i zonës përreth me gëlqere me 5% përmbajtje klori.

Depozitimi:

Mbetjet urbane të grumbulluara, depozitohen pranë Landfill-it të ri, ku pasi seleksionohen nga punonjësit e firmës koncesionare përfundojnë, pjesa e riciklueshme shkon për industrinë e riciklues, ndërsa pjesa tjetër përfundon në termovlerësuesin që prodhon energji elektrike nga djegia e tyre.

4.2 Diferencimi i mbetjeve në Elbasan

Në vendet perëndimore, diferencimi vjen që në burim (aty ku prodhohet) dhe menaxhohet nga shoqëritë publike ose private që merren me mbetjet urbane. Praktikisht 90% e mbetjeve urbane janë të riciklueshme.

Tek ne ndoshta është pak herët për ta vënë në zbatim, por jo për ta menduar dhe programuar një politikë të tillë. Në bashkinë Lezhë, ka vite që ka filluar mbledhja e diferencuar e mbetjeve urbane. Edhe pse në hapat e parë, ajo ka patur sukses. Një formë e parë diferencimi të mbetjeve, ka filluar edhe në qytetin e Elbasanit. Arsytet ekonomike kanë shtyrë disa subjekte private të seleksionojnë dhe grumbullojnë materiale të ndryshme: letra, plastika, materiale ferrozë. Seleksionimi dhe grumbullimi bëhet ose direkt nëpër kazanët e shpërndarë nëpër qytete duke i bërë të dallueshëm me anë të ngjyrave ose pranë vendit të depozitimit, ku punonjësit e specializuar nëpërmjet një transportieri apo tavoline pune bëjnë seleksionimin sipas llojeve të mbetjeve.

5. Diferencimi i mbetjeve – eksperiencia e huaj

Kam marrë si shembull, pastrimin e mbetjeve urbane në një bashki në Itali, në Monza (Rajoni i Lombardisë).

Që nga viti 1994, Bashkia e Monzës ka aktivizuar mbledhjen e diferencuar të mbetjeve urbane. Firma që bën pastrimin e rrugëve të qytetit dhe evadimin e mbetjeve urbane në Monza, është firma private Sangalli Giancarlo & C. S.r.l.³⁴ Kjo firmë ka vënë në dispozicion mjetet dhe personelin e saj për grumbullimin dhe evadimin e mbetjeve urbane, pastrimin dhe larjen e qytetit, mirëmbajtjen, vendosjen e thasëve të zinj dhe

³⁴http://www.sangallimpresa.it/index.php?option=com_contact&view=contact&id=2&Itemid=93&lang=it

evadimin tek koshat e vegjël (nëpër sheshe, rrugë, lagje). Mbetjet urbane mbahen nëpër shtëpi nga qytetarët dhe gjatë javës në ditë të caktuara ato nxirren jashtë. Mbetjet diferencohen që në shtëpi dhe zakonisht përdoren thasë plasmasi me ngjyra të ndryshme për identifikimin e llojit të mbeturinës. Sipas grafikut, në ditën e caktuar duhet të dalë thesi me ngjyrën e caktuar. Mbetjet ushqimore futen në thasë të biodegradueshme. Kontenitori i qelqeve dhe mbetjeve ushqimore janë prej plastike. Në fillim të çdo viti, bashkia u shpërndan qytetarëve, thasët e plasmasit dhe grafikun e nxjerrjes së mbeturinave të ndryshme. Zakonisht në darkë, mbetjet nxirren jashtë, pranë derës dhe në mëngjes kalon mjete i operatorit që i ngarkon dhe i evadon. Me grumbullimin e taksës së pastrimit, merret Zyra e Taksave vendore pranë bashkisë. Taksa e pastrimit përlllogaritet në bazë të metrave katrorë dhe numrit të personave që banojnë në të. Bizneset paguajnë në bazë të metrave katrorë të objektit ku kryhet aktiviteti dhe llojit të aktivitetit. Megjithatë, ka polemika për mënyrën arbitrare të grumbullimit të taksës së pastrimit. Po diskutohet një formë tjetër e mbledhjes së taksës, nëpërmjet pagesës së thasëve të mbetjeve që konsumon një familje në vit. Praktikisht çdo familje të paguajë sa mbetje prodhon. Megjithatë situata vazhdon kështu dhe duket që sistemi funksionon mirë. Operatori pastrimit, menaxhon një vend depozitimi mbetjesh urbane, termi i përdorur “*platformë ekologjike*”, ku qytetarët dhe bizneset mund të hedhin vetë, mbetjet nga krasitja e pemëve/korja e barit, mobiljet e vjetra, elektroshtëpiaket, qelqurinat, hidrosanitare, kartonat, gjëra metalike, ambalazhe të ndryshme, goma të përdorura, etj.

Aty ka konteinerë dhe në çdo konteiner, hidhet mbetja e caktuar. Pasi mbushen konteinerët, ato largohen drejt destinacionit ku do të riciklohen.



Platforma ekologjike Monza

Lind pyetja, ku përfundojnë mbetjet urbane, kur atje nuk ka një landfill?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, më poshtë japim listën dhe destinacionin e mbetjeve të riciklueshme:

- mbetje ushqimore (të riciklueshme) – groposen në gropa, ku lihen të dekompozohen dhe kthehen në pleh organik (plehu i shitur me thasë në supermerkatë),
- qelqi (i riciklueshëm) – grumbullohet nga industritë përpunuese të qelqit dhe rifutet në qarkullim,
- letra dhe kartoni (i riciklueshëm) - grumbullohet nga industritë përpunuese të letrës dhe rifutet në qarkullim,
- mobiljet, druri (i riciklueshëm) - grumbullohet nga industritë përpunuese të letrës ose drurit dhe rifutet në qarkullim,
- plastika (e riciklueshme) - grumbullohet nga industritë përpunuese të plastikës dhe rifutet në qarkullim,
- hekurishtet, elektroshtëpiaket (të riciklueshme) - grumbullohen nga fonderitë, etj.
- mbeturinat inerte (riciklueshme) - përdoren nga firmat e ndërtimit kur kanë punime ndërtimi, për mbushje,
- gomat e përdorura (riciklueshme) -grumbullohen nga industritë kimike, për riveshje ose prodhim vajrash lubrifikantë.

Mbetjet e tjera të pariciklueshme, si: rroba, ambalazhe të përziera (që zakonisht futen nëpër thasë të zinj), pra pjesa e padiferencuar e mbetjeve urbane, dërgohet në inceneratorë ku digjen. Vitet e fundit janë ngritur dhe funksionojnë inceneratorë të teknologjisë së fundit, termi i përdorur “*termo vlersues*”. Vetë termi, jep kuptimin e funksionit të saj. Ideja është që në natyrë asgjë të mos shkojë dëm. Meqenëse djegia shkaktonte shkarkime të CO₂ në ajër dhe kjo djegie ishte e pashmangshme, u mendua që asaj t'i jepej një vlerë ekologjike dhe ekonomike. Janë ndërtuar këto *termo valorizatorë* ku nga djegia, prodhohet ujë i ngrohtë (që me tubacione nëntokë shkon në qytet për ngrohjen e pallateve) dhe energji elektrike. Pra kompensohet dioksidi i karbonit të prodhuar nga djegia e mbetjeve urbane me dioksidin e karbonit që do të prodhonin kaldajat e pallateve në rast se do të ishin me ngrohje autonome dhe termocentralet për prodhimin e energjisë elektrike (nga këtu termi: *termo-vlerësues*). Siç shihet, një menaxhim i mirë i grumbullimit, riciklimit apo asgjësimit të mbetjeve urbane, jo vetëm që mund të jetë miqësor me mjedisin, por ka dhe një rikthim të madh ekonomik. Jo më kot, në përfundim, industritë përpunuese dhe ricikluese të mbetjeve urbane, janë nga industritë më të fuqishme.


6. Analiza ekonomike e menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Elbasanit.

Nga informacioni i marrë në Bashkinë Elbasan³⁵ mbi mbledhjen e tarifës së pastrimit, rezulton një total si më poshtë:

Tabela 2-2

Tarifë pastrimi	Njësia matëse	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Nga biznesi	000/lekë	31.182	40.578	65.736
Nga popullata	000/lekë	17.913	20.289	22.934
Totali	000/lekë	49.095	60.867	88.670

Grafiku 1. (sipas tabelës 2-2)



Burimi: Shtojca 1, Specifikime teknike, Bashkia Elbasan.

Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2015 me riorganizimin e ri, Bashkisë Elbasan iu bashkangjitën edhe ish -komunat: Bradashesh, Gracen, Labinot Fushë, Labinot-Mal, Shushicë, Tregan, Gjinar, Zavalinë, Gjergjan, Paper, Shirgjan, Funar. Kjo shpjegon rritjen e menjëhershme të të ardhurave të grumbullara nga bizneset gjatë vitit 2016. Tarifa e grumbulluar nga popullata i përket qytetit të Elbasanit, pasi tarifa e pastrimit nga ana e

³⁵ Shkresë dt. 11/09/2017.

Bashkisë mbliidhet nëpërmjet UKE sh.a. që e shtrin aktivitetin e tij vetëm në qytetin e Elbasanit. Duke marrë si referencë vitin 2014 shohim se trendi i rritjes së të ardhurave të grumbulluara nga popullata ka qenë i njëtrajtshëm, +13% (shih tabelën e mëposhtme):

Tabela 3-3

Tarifë pastrimi	Ndryshimi nga njëri vit në tjetrin	Viti 2014/2014	Viti 2015/2014	Viti 2016/2015
Nga biznesi	%	100	130	162
Nga popullata	%	100	113	113
Totali	%	100	124	146

Rritja e të ardhurave të grumbulluara nga bizneset nga viti 2015 në krahasim me vitin 2014 ka pasur një rrije prej 30%. Këtu ka ndikuar dhe ulja e shkallës së informalitetit të bizneseve që operonin në territorin e qytetit të Elbasanit. Ndërsa në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 ka pasur një rritje akoma më të madhe prej 62% (ndikimi i tarifave të pastrimit të paguar nga bizneset në territorin e ish-komunave). Meqenëse bashkia nuk disponon të dhëna mbi sasinë e të ardhurave të grumbulluara nga bizneset brenda qytetit të Elbasanit dhe atyre të grumbulluara nga bizneset në ish-komunat, për efekt përlogaritje, do t'i referohemi trendit rritës nga viti 2014 në vitin 2015:

40.578 (nga bizneset 2015) * 130% (raporti nga bizneset 2015/2014) = $52751(000/leke)$. Nga kjo dalim në konkluzionin se sasia e të ardhurave të grumbulluara nga Bashkia Elbasan si tarifë pastrimi brenda territorit të qytetit është e barabartë: 52751 (nga bizneset) + 22934 (nga popullata) = $75685(000/leke)$. Nga kontrata³⁶ e lidhur në vitin 2016 nga Bashkia Elbasan për pastrimin e qytetit dhe evadimim e mbetjeve urbane me operatorin ekonomik "Victoria Invest" rezulton se bashkia paguan një shumë prej $89,657,581$ lekësh (përfshirë tvsh). Kjo do të thotë se aktualisht bashkia po e mbulon këtë shërbim me të ardhura të tjera në vlerën prej $13.972.581$. Meqenëse shuma totale e grumbulluar për vitin 2016 si tarifë pastrimi kap vlerën $88.670(000/lekë)$, kjo do të thotë që aktualisht Bashkia e Elbasanit arrin ta mbulojë këtë shërbim me tarifën e grumbulluar nga bizneset që ndodhet në territorin e ish-komunave.

³⁶ <http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/2123>

7. Konkluzioni final

Arsyet që më shtynë në zgjedhjen e kësaj teme ishin të motivuara si nga pragmatizmi ashtu edhe nga idealizmi. Duke parë dëmtimet e mëdha të mjedisit që ka shkaktuar dora e njeriut, efektet e drejtpërdrejta dhe ato indirekte që kanë sjellë dhe vazhdojnë të sjellin në jetën tonë, nuk kishte si të rrija indiferente ndaj këtij argumenti. Gjithashtu, nuk duhet harruar rëndësia që paraqet argumenti. Investimi në mjedis, është investimi më afatgjat i mundshëm. Ndërkohë që investimet e tjera (ashtu si produkti) kanë një cikël jete relativisht të shkurtër (hyrje, rritje, maturim, rënie), mjedisi vazhdon të ruajë efektet dhe avantazhet për një kohë shumë të gjatë. Gjithashtu edhe humbja, në rast se investimi rezulton i gabuar, do të ketë pasoja afatgjata.

Mund të flasim për menaxhimin e mbetjeve urbane, si menaxhim operacional, përse i përket operacioneve të përditshme për pastrimin e qytetit, transportin, evadimin dhe përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane. Mund të flasim për menaxhimin e mbetjeve urbane si menaxhim strategjik, pasi efektet e menaxhimit, do të ndikojnë për një kohë të gjatë dhe do të trashëgohen nga brezat e ardhshëm. Për këtë arsye, del e nevojshme një planifikim i mirë. Planet, projektet, politikat e ndjekura, qëllimet, procedurat, duhet të hartohen dhe ndiqen në përputhje me rëndësinë dhe impaktin e përgjithshëm që paraqet kjo fushë.

Nga studimi i kryer rezulton se aktualisht kostot për manaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Elbasan, nuk mbulojnë nga tarifa e paguar nga qytetarët dhe bizneset që operojnë në qytetin e Elbasanit, por pjesërisht mbulohet nga burime të tjera (tarifa e paguar nga bizneset që operojnë në territorin e ish-komunave që i janë bashkangjitur bashkisë së madhe).

8. Sugjerime

Një pjesë e sugjerimit do të fokusohet mbi përmirësimin e shërbimit aktual, ndërsa pjesa tjetër do të fokusohet mbi sugjerimin për politikat e ardhshme. *Edukimi dhe ndërgjegjësimi:*

Vendosa këtë argument në radhë të parë, sepse, sipas mendimit tim është fillesa nga ku duhet të tentohet të ndryshohet situata. Nëse nuk ndryshojmë ne, nëse nuk ndryshon mentaliteti dhe përjasja jonë mbi argumentin, atëherë çdo politikë, projekt, apo investim, do të dështonte ende pa filluar. Për këtë arsye, ne e shohim si investim parësor, investimin në ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Për këtë arsye, sugjerohet një fushatë masive duke përdorur sistemin shkollor (brezi i ardhshëm), mediat e shkruara lokale e kombëtare, mediat audio – vizive lokale e kombëtare, internetin, social network-ët, postera dhe afishime, organizim aktiviteteve me tematikë mjedisin, vendosjen e rregullave të qarta dhe përdorimin e masave shtrënguese, krijimin e ndonjë çmimi vjetor për komunitetin ose rrugicën / lagjen më “virtuoze”, ndërmarrjen e aksioneve të herëpashershme pastrimi të territorit nga hedhjet e mbeturinave me përfshirjen e qytetarëve, bizneseve të ndryshme, institucioneve të interesuara, nxënësve dhe studentëve, ku të përdoren dhe veshje me logo ose shprehje që bëjnë apel për ndërgjegjësimin e opinionit publik.

Gjithashtu si pjesë e ndërgjegjësit të opinionit publik, mund të shohim dhe ndërgjegjësimin e njerëzve mbi ndryshimin e stilit të jetës dhe ndryshimin e mënyrës së konsumimit të produkteve. Fakti që po kthehemi në një shoqëri konsumi, interneti, publiciteti në televizion e gazeta, shumëllojshmëria e produkteve në qarkullim, po na shtojnë drejt konsumit të një sasive përherë e më të madhe të produkteve që paraqiten nga ana e tyre me ambalazhim përherë e më të sofistikuar dhe konsistent. Kjo përkthehet në sasi më të madhe mbetjeve urbane për t'u ricikluar. Pra këtu ka vend për të përmirësuar stilin e jetesës, për të ndryshuar tipin e produkteve që do të konsumojmë, duke ulur kështu sasinë e mbeturinave të prodhuara për frymë.

Grumbullimi dhe transporti:

Duke parë gjendjen reale të kazanëve të mbetjeve urbane, do të sugjeronim një zëvendësim të tyre me kazanë më të rinj, mundësisht të jenë të pajisur dhe me kapak për mbylljen pas përdorimit, duke evituar kështu erën dhe pamjen jo të këndshme, duke evituar kontaktin e kafshëve të rrugëve (qen, mace) me mbetjet urbane e që më pas mund të kthehen në mbartës epidemie. Gjithashtu dhe mjetet që kryejnë transportin e mbetjeve urbane, duhen modernizuar, të jenë më pak të zhurmshme natën (duke kufizuar ndotjen akustike) dhe të rishikohet grafiku i pastrimit të kazanëve. Mbi funksionimin e tanishëm, në përputhje me politikën mjedisore të ndjekur aktualisht nga bashkia (e detyrueshme duke parë situatën ekonomiko – financiare, sociale, kulturore), përsa i përket grumbullimit dhe evadimit të mbetjeve urbane, ka pak për të sugjeruar.

Për të ardhmen duhet të fillohet të mendohet seriozisht organizimi i mbledhjes së diferencuar të mbetjeve të ngurta urbane. Në fillim mund të vendosen kazanë të mëdhenj në rrugë me ngjyra të ndryshme për të qenë më të evidentueshëm sipas llojit të mbetjes që duhet të hidhet brenda dhe më pas, në një moment të dytë, të eliminoheshin dhe ato, dhe mbetjet të

mbaheshin në shtëpi nga qytetarët. Kështu do të evitoheshin shumë probleme në lidhje me spektaklin e shëmtuar viziv e olfativ, do të eliminohej një burim potencial infeksionesh, do të shtohej sasia e grumbulluar e mbetjeve të riciklueshme. Kjo do të thotë rritje në mënyrë eksponenciale të efikasitetit në menaxhimin e mbetjeve urbane, rritje efikasiteti që do të sillte si rezultat përfitime ekonomike, ulje të gjithanshme të kostove, përmirësim të situatës së përgjithshme mjedisore e shëndetësore, rritje të mirëqenies së përgjithshme.

Përsa i përket analizës ekonomike, ashtu siç pamë më lart, aktualisht shërbimi i marrë nga qytetarët e Elbasanit nuk mbulohet nga tarifa që paguajnë ata për këtë shërbim. Sugjerohet ose një rritje e vogël e tarifës së shërbimit ose gjetje e zgjidhjeve alternative për të ulur sasinë ditore të mbetjeve të gjeneruara që njëkohësisht përkthehet në faturën më të vogël që duhet paguar.

Bibliografia

- AEA Segnali 2014- Benessere e ambiente, Pubblicato 18.08.2014, ISBN: 978-92-9213-471-6.
- AEA Segnali 2015- Vivere ai tempi del cambiamento climatico, Pubblicato 22.09.2015, ISBN: 978-92-9213-681-9.
- Agenzia Europea dell'ambiente, Finanziamenti per il clima: risorse per un 'Europa a basse emissioni di carbonio e resiliente al cambiamento climatico, articolo pubblicato 01.02.2017 e ultima modifica 06.07.2017.
- Agenzia Europea dell'ambiente, L'ambiente in Europa: Stato e prospettive nel 2015 – relazioni di sintesi ISBN: 978-92-9213-517-1.
- Environmentally Sound Management of Solid Wastes and Sewage-Related Issues, United Nations Environment Programme, 2011.
- National Waste & Recycling Association "History of Solid Waste Management" Washington, D.C.R, 2013
- Qendra rajonale e mjedisit (REC), Shqipëri, Adresari i OShC-ve shqiptare për mjedisin, 2013.
- "Raport gjendja mjedisit 2016" Ministria e mjedisit, Agjencia kombëtare e mjedisit.
- Revista "Mjedisi sot", nr. 153, datë 19.06.2017.
- SENiOR-A :Manual për ekonominë e gjelbër dhe qëndrueshmërinë mjedisore.
- Shkresë dt. 11/09/2017.
- Shtojca 1, Specifikime teknike, Bashkia Elbasan.

Webgrafia

- <http://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx>
- <http://openprocurement.al/sq/tender/view/id/2123>
- <http://akm.gov.al/assets/ndotja-e-ajrit--nga-mjetet-e-transportit.pdf>
- http://www.sangallimpresa.it/index.php?option=com_contact&view=contact&id=2&Itemid=93&lang=it

TREGU I PUNËS I TË RINJVE NË SHQIPËRI

Romina Radonshiqi³⁷

Lektore, Univeristeti "Aleksander Moisiu"

Durrës

Abstrakt

Bota është zhvilluar me punë, shoqëria njerëzore pranon rëndësinë e punës në zhvillimin e qytetërimit. Në qendër të historisë sociale, ekonomike është bota e punës. Zhvillimi i shoqërisë, civilizimi, raporti mes të rinjve dhe të moshuarve e një sërë faktorësh të tjerë ndikojnë drejtpërdrejt në formimin dhe zhvillimin e tregut të punës. Ky studim në mënyrë të qartë thekson rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre të zvogëluar në fuqinë punëtore në shtetin e Shqipërisë. Objektivi i këtij studimi është të vlerësojë dhe të analizojë situatën e tregut të punës të të rinjve në Shqipëri. Edhe pse nuk është shteti i vetëm me këtë problem, Shqipëria është përballur me këtë pengesë për mjaft kohë dhe është në fakt një nga vendet më të prekura nga periudha e tranzicionit, ku mundësitë financiare dhe siguria e punës janë të rralla, veçanërisht për të rinjtë. Ky studim përpiket t'i japë përgjigje pyetjes kërkimore se cilët janë faktorët që ndikojnë në papunësinë e të rinjve. Mungesa e të dhënave ose të dhënat jo reale, e bëjnë të vështirë një vlerësim të saktë të tregut të punës. Të rinjtë në Shqipëri

³⁷ Ka lindur më 11.04.1987 në Durrës. Romina është doktoreshë Shkencash në Ekonomi, në profilin menaxhim i përgjithshëm, ka kryer studimet master në Administrim financiar dhe bachelor në Shkenca Administrimi. Ajo punon si lektore në Univeristetin "Aleksandër Moisiu" prej vitit 2012. Ajo është autore e shumë artikujsh shkencor në revista shkencore ndërkombtare, si në: Azi, Itali, Austri, Angli, Gjermani, Slloveni, Rumani, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri etj. Romina Radonshiqi është autore e tri librave të botuara në Gjermani nga shtëpia e botimit Lap Lambert:

1. The Impact Of The Human Resource In Development Of The Organization, Lap Lambert Academic publishing, Germany 05.03.2013, ISBN 978-3-659-36195-1.

2. Personal budget management and the impact on individuals, Lap Lambert Academic publishing, Germany, June 4, 2015, ISBN 978-3-659-71848-9.

3. Fiscal Policy, Lap Lambert Academic publishing, Germany 2016-03-02., ISBN 978-3-659-85348-7

Ajo është antare në bordin editorial të revistës ndërkombtare Noble International Journal of Business and Management Research.

ende dëshirojnë të jenë të punësuar në sektorin qeveritar, edhe pse nuk ka më siguri të punës, sepse punësimi në këtë sektor është kryesisht politik. Punëdhënësit preferojnë të punësojnë njerëz në moshë sepse ata zakonisht kanë më shumë përvojë dhe investimet e punëdhënësit janë shumë më të sigurta, në këtë mënyrë dhe ata përfitojnë nga këto investime më shpejt se nëse do të trajnonin të rinjtë pa përvojë pune.

Fjalët kyçe: Ekonomiks i punës, tregu i punës, të rinjtë, qeveria, punëdhënës.

Youth labor market in Albania

Abstract

The world is developed by working, the human society recognizes the importance of work in the development of civilization. In the center of social and economic history, it is exactly the world of work. The development of society, civilization, the relationship between young people and the elderly; and a variety of other factors, directly affect the formation and development of the labour market.

This study clearly emphasizes the importance of youth and its diminished role in Albanian workforce. The objective of this study is to evaluate and analyze the labor market situation of young people in Albania. Although, it, not the only state facing this problem, Albania has been facing this obstacle for a long time and is actually one of the countries that have been infected by the transition period. This study tries to answer the question: what are the factors that affect youth unemployment? Lack of data and unreal data makes it difficult an accurate assessment of the labour market. The financial security and job opportunities are rare, especially for the youth. Young people still wish to be employed in the government sector, even though there is no job certainty. As for the employers, they prefer to employ older people as they usually have more experience and the employer's investments are much safer and they benefit from those investments quicker than employing the inexperienced youth.

Keywords: Labour economics, labour market, youth, government, employer.

1. Çfarë studion ekonomiksi i punës

Punëzënia e plotë dhe stabiliteti i çmimeve janë dy nga objektivat qendrore makroekonomike të çdo qeverie (Mancellari. A, Haderi. S, Kule. Dh, Qirici. S, 2002: 250). Ekonomiksi i punës studion mënyrën e organizimit, funksionimit të tregjeve të punës si dhe proceset dhe pasojat që ndodhin në tregun e punës, ekonomiksi i punës është një degëzim i shkencës ekonomike, ai merret gjithashtu dhe me studime të mënyrës së sjelljes së pjesëmarrësve në tregun e punës si dhe me politikat shtetërore, firmat, punonjësit që kanë të bëjnë me punësimin dhe pagesën, përdorimin sa më racional dhe eficient të faktorit punë (Qirici S. 2005:10).

Ekonomiksi i punës nëpërmjet kategorive, ligjeve dhe parimeve me të cilat ai operon, përqendrohet në studimin e mënyrës së sjelljes të të gjithë agjentëve ekonomikë që veprojnë në tregun e punës (Ehrenberg. R and Smith. R., 2012: 1), deri dhe në studimin e ndryshimeve që ndodhin në forcën punëtore në nivelin e ekonomisë kombëtare në përgjithësi.

Objekti i studimit të ekonomiksit të punës ka evoluar me kalimin e kohës, prandaj e ndajmë ekonomiksin e punës në “Ekonomiksin e vjetër” të punës dhe “Ekonomiksin e ri”. Ata dallojnë nga njeri-tjetri për nga problemet që trajtonin. “Ekonomiksi i vjetër”, ka si objekt studimin e historisë së lëvizjes punëtore, përshkruan rolin dhe vendin e sindikatave të punës, me çështjet gjyqësore në lidhje me konfliktet në punë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit etj., pra ka karakter përshkruar dhe historik (Qirici S. 2005: 7).

Me zhvillimet ekonomike- sociale gjatë shekullit XX ndryshoi dhe mënyra se si studiohej tregu i punës. Përfitimet e ekperiencës dhe rritja e problematikave në punë solli revolucion në fushën e objektit të studimit të ekonomiksit të punës. Ekonomistët filluan të përdornin gjerësisht metodat analitike, sasiore dhe cilësore, ku një vend të dukshëm zinte përdorimi i shkencave të ekonometrisë. Ekonometria është një lëndë ndërdisiplinore që përfshin njohuri të matematikës, statistikës dhe të teorive ekonomike, pra të ekonomiksit. Natyrisht kjo nuk do të thotë se materiali përshkruar dhe historik nuk përfshihet në ekonomiksin e punës, por raportet janë në favor të metodave analitike (Greene. W. H, 2003).

Objekt diskutimi i ekonomiksit të punës janë dhe politikat shtetërore të punësimit si dhe politikat e ndryshme që kanë të bëjnë me reduktimin e papunësisë. Çdo politikë shtetërore në lidhje me punësimin ka influencë në nivelin e punësimit dhe të pagave. Qeveria siç e dimë është një ndër agjentët kryesorë në ekonominë e tregut, rrjedhimisht dhe në tregun e punës (Lipsey R. and Chrystal A. 2007: 234). Nxjerrja ose vendosja e ligjeve të

pagës minimale, sistemi i taksave dhe tatimeve influencojnë në rezultatet dhe pasojat në tregjet e punës.

Tregjet ku shitet dhe blihet faktori punë karakterizohen nga disa tipare të veçanta që i dallojnë ato dukshëm nga tregjet e mallrave dhe shërbimeve.

Tregjet e punës ndyshojnë nga tregjet e tjera sepse kërkesa për punë është një kërkesë e rrjedhur. Shumë shërbime pune, në vend që të jenë produkte finale, janë inpute për prodhimin e të mirave të tjera (Uruci. E, 2004: 372).

Në këtë kuptim mund të themi se transaksionet që kryhen në tregjet e punës janë krejtësisht të ndryshme nga këmbimet që realizohen në tregjet e mallrave dhe shërbimeve. Puna nuk është një mall, puna e një personi nuk është vetëm diçka që shitet në këmbim të të ardhurave. Puna përfaqëson një individ, një profesion, një karrierë që është një aspekt i rëndësishëm i identitetit, vetëvlerësimit dhe prestigjit.

Shitësi i punës, para se të marrë një vendim për të ofruar orë pune në treg, pra të shesë fuqinë e tij punëtore, është i interesuar të dijë vendin se ku do të shkojë të punojë, ambientin fizik dhe shoqëror të punës, sasinë e pagës dhe mënyrën e pagesës (Mancellari. A, Haderi. S, Kule. Dh, Qirici. S, 2002: 205), mundësinë për të bërë karrierë në vendin e punës si dhe shumë faktorë të tjerë monetarë dhe jomonetar që lidhen me punën. Ndryshe nga tregjet e mallrave dhe shërbimeve ku transaksionet bëhen për një periudhë relativisht të shkurtër, punësimi paraqet një lidhje reciproke të qëndrueshme dhe relativisht të vazhdueshme midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Sipas organizatës nderkombëtare të punës, marrëdhënia e punës është lidhja ligjore ndërmjet punëdhënësve dhe punonjësve dhe ekziston kur një person kryen punë ose shërbime në kushte të caktuara në këmbim të shpërblimit³⁸. Në këto kushte aplikimi i instrumenteve të ngjashme (kërkesës dhe ofertës) që ekonomiksi i përdor në analizën e tregjeve të mallrave dhe shërbimeve, duhet të marrë parasysh specifikat e faktorit punë dhe funksionin specifik të tregjeve të punës ku koncepti i kapitalit njerëzor është një tipar integral i ekonomisë bashkëkohore të punës. Ashtu si ekonomia tradicionale e tregut të produkteve dhe shërbimeve dhe tregu i punës ka komponentët mikro dhe makro. Komponentët mikro përfshijnë vendimet e marra nga firmat dhe individët në tregun e punës. Komponentët makro përfshijnë tendencat e përgjithshme

³⁸http://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/labour-law/WCMS_CON_TXT_IFPDIAL_EMPREL_EN/lang--en/index.htm

dhe efektet në tregun e punës si një e tërë (Dornbusch. R and Fischer. S., 2000 :1).

2. Pjesëmarrësit në tregun e punës

Pjesëmarrësit në tregun e punës janë (Borjas. G 2013: 3):

1. **Punonjësit**- individët ose familjet janë ato që marrin vendime kur të bëhen pjesë e tregut të punës, sa duhet të arsimohen, cilin profesion duhet të zgjedhin që të jenë konkurrenca në treg. Nëse ato janë duke kërkuar një punë, sa ore duan ato të punojnë dhe me çfarë page. Të gjitha këto vendime që një individ merr do të ndikojnë drejtpërdrejt në financat familjare dhe si rrjedhim dhe në planifikimin e pensionit.

2. **Firmat**- janë pjesëmarrës potencialë në tregun e punës ato marrin vendime në lidhje me numrin e punonjësve që do të rekrutojnë, orët e punës, nivelin e pagës, krijimin e kushteve të punës deri në daljen e tyre në pension. Firmat janë blerësit konkurrenca të punës në tregun e punës.

3. **Qeveria**- është një aktor shumë i rëndësishëm në tregun e punës, pasi ofron politika nxitëse për punësim me anë të politikave të saj makroekonomike, ofron trajnime, harton politika të sigurimit dhe kompensimit të punonjësve, harton ligje për mbrojtjen e punonjësve dhe bizneseve dhe daljes në pension.

Shumë ekonomistë të punës shpjegojnë se fjala "punë" nuk duhet të kuptohet ekskluzivisht e lidhur me disiplinën e "ekonomisë". Ata përkrahin një qasje ndërdisiplinare që përfshin njohuritë e ofruara nga disipinat e sociologjisë, shkencave politike, psikologji, teoria sjelljes organizative.

Ekonomia e punës ka përfshirë diskriminimin gjinor dhe racor; marrëdhëniet e menaxhimit dhe punës; ekonominë demografike; shpenzimet personale ose shoqërore në arsimim, kujdesin shëndetësor, trajnimet e ndryshme pra investimet e kapitalit human dhe shume çështje që lidhen me sjelljen në vendin e punës.

3. Tregu i punës së të rinjëve

Shqipëria është përballur me një periudhë të vështirë zhvillimi ekonomik-social. Këto transformime kanë ndikuar në proceset demografike të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit dhe kanë rezultuar në ndryshime të mëdha në përmasat dhe përbërjen e popullsisë³⁹. Popullsia e

³⁹http://www.instat.gov.al/media/316719/t__rinjt__n__shqip_ri_sfdat_n__koh_t_q__ndryshojn_.pdf

Shqipërisë është mes popullsive më të reja në Evropë. Sipas Instat (2016) Raporti gjinor i popullsisë së Shqipërisë është 102,6 meshkuj për çdo 100 femra. Moshë mesatare e popullsisë është 34.7 vjeç⁴⁰. Kjo fazë e jetës shënon një periudhë me përvoja dhe ngjarje të rëndësishme, sidomos ato në lidhje me përfundimin e shkollimit, tranzicionin nga shkolla në tregun e punës.

Zvogëlimi i papunësisë është sfida kryesore e të gjitha vendeve botërore, mirëpo rrethanat historike e kanë rënduar dhe më shumë këtë sfidë në vendin tonë (Mustafa. I., 2013:9). Të rinjtë në Shqipëri përbëjnë një përqindje të lartë nëse i krahasojmë me të rriturit për këtë arsye. Ata përballen me problemet e punësimit duke ndikuar më pas në uljen e mirëqenies. Një i ri i papunë do të thotë shkatërrim i tij social dhe varfëri. Të rinjtë të cilët janë për herë të parë në tregun e punës e kanë shumë të vështirë të përballen me sfidat që ofron punësimi.

Kërkesat e shoqërisë janë në rritje, ato që punojnë e kanë më të lehtë të përballojnë jetesën dhe ndonjëherë dhe luksin, por për të rinjtë e papunë gjetja e një pune ka një rëndësi vitale për të përballuar jetesën dhe për të ngritur një të ardhme me baza të sigurta.

Çështja e punësimit të rinisë në Shqipëri kërkon qasje parandaluese dhe trajtuese të cilat adresojnë njëherazi si kërkesën, ashtu edhe ofertën për punë, për realizimin e të cilave nevojitet angazhimi i përhershëm i dikastereve të qeverisë, institucioneve të tregut të punës, duke përfshirë edhe organizatat e punëdhënësve e të punëmarrësve, si dhe shoqërinë civile⁴¹ (ILO 2010).

Sipas ILO (2013) papunësia e të rinjve dhe punësimi është përhapur jo vetëm për shkak të deficiteve nga ana e kërkesës (mundësive për punë të pamjaftueshme), por edhe se ata nuk kanë aftësitë, përvojën e punës, aftësitë e kërkimit të punës dhe burimet financiare për të gjetur punë. Si rezultat i kësaj, normat e papunësisë së të rinjve priren të jenë dy deri tre herë më e larta se për të rriturit.⁴²

⁴⁰ http://www.instat.gov.al/media/322938/pop_1_janar_2016.pdf

⁴¹ http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@sro_budapest/documents/publication/wcms_168326.pdf


⁴² http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/publ/documents/publication/wcms_190112.pdf

Tabela 1-1: Bilanci i forcave të punës 2011-2016(%)

Grupmosha	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shqipëria						
15-29	54.8	46.6	38.7	41.9	44.5	45.7
30-64	76.7	73.8	71.1	72.3	74.5	76.1
15-64	68.5	64.9	59.6	61.5	64.2	66.2
15+	60.3	57.3	52.4	53.7	55.7	57.5
Meshkuj						
15-29	62.2	54.1	47.9	51.2	52.8	51.7
30-64	85.2	84.2	82.9	84.5	85.2	85.8
15-64	76.4	73.4	70.2	72.2	73.4	74.1
15+	67.9	65.5	61.7	63.5	64.3	65.0
Femra						
15-29	47.0	37.7	30.1	32.0	35.4	38.8
30-64	68.6	64.4	60.7	61.2	64.6	66.8
15-64	60.8	56.4	50.1	51.3	55.1	58.3
15+	52.9	49.2	44.0	44.4	47.2	49.9

Burimi: INSTAT (2016)

Tabela 1-1, na orienton se në vitin 2015 për çdo 100 të rinj, vetëm 45 janë ose të punësuar ose punëkërkues, ndërkohë që në grupmoshën 30-64 raporti është 75 të punësuar ose punëkërkues dhe 25 jashtë forcave të punës, të cilët mund të jenë për shkaqe të ndryshme, si: paaftësia për punë, invaliditeti, dekurajuar etj., ndërsa për sa i takon përkatësisë gjinore vërejmë që meshkujt janë më prezent në forcat e punës, por në rastin e të klasifikuarve si të rinj, pesha e femrave është shumë e ulët, referuar vitit 2015, për 100 femra vetëm 36 janë punëkërkuese dhe të punësuar. Nga pikëpamja personale ashtu sikurse e kemi theksuar edhe më lart pjesa më e dëmshme e shoqërisë dhe kompromentuesi më i madh i një tregu pune jo eficient është shkalla e ulët, e pjesëmarrjes dhe kjo sidomos kur nuk ndodh për shkaqe jokualifikimi.

Grafiku 1-1: Norma e rritjes së popullimit, respektivisht 15-29, 30-64.

Burimi: INSTAT (2016)

Burimet kryesore që gjenerojnë kërkesën për punë në Shqipëri janë:

- Sektori shtetëror.
- Sektori privat jobujqësor.
- Sektori privat bujqësor.

Tabela 1-2: Sektorët e punësimit 2000-2015.

Emërtimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të punësuar (I+II+III)	1,068,190	920,569	920,144	926,225	931,217	932,102	935,058	939,000	901,708	910,325	904,364	947,799	959,350	916,916	925,339	972,621
I. Sektori shtetëror	191,166	188,965	186,065	181,417	176,065	175,015	169,000	167,100	166,543	166,430	166,338	165,100	164,400	163,900	163,885	164,020
Buxhetorë	122,299	120,114	118,162	117,220	118,000	119,993	122,000	125,200	125,500	125,320	126,500	128,200	128,734	129,212	129,065	129,092
Jo-buxhetorë	68,868	68,851	67,903	64,197	58,065	55,022	47,000	41,900	41,043	41,110	39,838	36,900	35,666	34,688	34,820	34,928
II. Sektori privat jo-bujqësor	116,024	205,267	207,742	211,169	213,000	214,935	224,058	229,900	238,975	237,231	241,836	256,288	268,690	290,763	318,571	360,230
III. Sektori privat bujqësor	761,000	526,337	526,337	533,639	542,152	542,152	542,000	542,000	496,190	506,664	496,190	526,412	526,260	462,253	442,883	448,371

Burimi: INSTAT (2015)

Nga të dhënat administrative të marra nga INSTAT sipas sektorëve, por edhe nga pikëpamja historike shihet qartë që aktualisht, ndikimin më të madh në tregun e punës e ka sektori bujqësor. Është pikërisht ky sektor që angazhon me punë numrin më të madh të të punësuarve.

4. Të rinjtë në Shqipëri

Në ditët sotme, në tregun e punës, duhet pranuar se ka një çekuilibër të dyfishtë: në planin sasior, numri i punëkërkuesve të

regjistruar, siç e dinë të gjithë, është shumë më i lartë se ofertat e posteve të propozuara.

Në planin cilësor për fat të keq ky çekuilibër është në drejtim të kundërt: aftësitë janë të pakta dhe të pamjaftueshme krahasuar me nevojat. Kështu, është e rëndësishme për kompaninë, që të mbajnë fort punonjësit e saj, të cilët demonstrojnë aftësi, si dhe të tjerët, të cilëve duhet t'u propozojnë plane për zhvillimin e karrierës, por në asnjë mënyrë t'i shtyjnë ata të shkojnë diku tjetër, ose tek konkurrentët. Prandaj është i rëndësishëm krijimi i mekanizmave për ruajtjen e personelit, por mbi të gjitha ekzistenca e një fryme të menaxhimit dhe të një kulture kompanie që krijojnë një "moral" për çdo punonjës.

Në ditët e sotme punësmi është i vështirë jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën. Tregu i punës së të rinjëve e justifikon papunësinë për këtë kategori si mungesë përgatitjeje të studentëve të sapodiplomuar ose mungesë kualifikimi, në aplikimin ashtu siç duhet aty ku duhet për një vend pune.

Të rinjtë në Shqipëri e kanë të vështirë të përballen sepse ata nuk kanë shumë informacion dhe nuk njihen mirë me kulturën e punës, kjo për arsyen se nga arsimimi kanë marrë më shumë njohuri teorike dhe jo praktike, të cilat mund t'u shërbejnë në punësim. Një i ri i cili ka referenca të mira dhe është produktiv në punë e ka më të lehtë të gjejë një vend pune. Realiteti i punësimit në Shqipëri kërkon që punonjësi të jetë fleksibël jo vetëm në pozicionin e punës ashtu dhe në orare.

Të rinjtë të cilët duan një pozicion pune me pagesë të lartë duhet të zotërojnë disa aftësi të veçanta duke përfshirë këtu dhe njohuri të mira të gjuhëve të huaja me qëllim që të bëjnë diferencën në treg dhe për këtë duhet të kesh aftësi të veçanta.

Të rinjtë në momentin që aplikojnë në një pozicion pune nuk duhet të mendojnë vetëm për pagesën e lartë dhe pozicionin, por ata duhet të përpiqen të përfitojnë sa më shumë njohuri në vendin e punës, sepse sot është e vështirë të gesh një punë dhe akoma më e vështirë ta mbash vendin e punës. Një i ri, duhet të punojë me seriozitet, në mënyrë që punëdhënësi të njohë aftësitë e tij dhe ta shohë si një element të nevojshëm në organizatën e tij.

Përfundime dhe rekomandime

- Tregu i punës në Shqipëri është i paorganizuar, të rinjtë e papunë kanë mungesë të informacionit në gjetjen e kërkesave të reja të vendeve të lira të punës, ndaj mënyra dominuese për marrjen e informacionit mbeten akoma lidhjet personale dhe rekomandimet nga të njohurit.

- Të rinjtë nuk kanë besim në institucionet e sektorit publik dhe privat të punësimit, të rinjtë i besojnë punësimit nga familja dhe të afërmit duke krijuar një sistem nepotik dhe duke çenuar meritokracinë.
- Të rinjtë në analizimin e tregut të punës nuk përpiqen të kuptojnë mundësitë reale që i ofron tregu, por ato udhëhiqen nga dëshirat e tyre. Ata duhet të njohin më mirë mekanizmat e tregut të punës në mënyrë që të marrin masa mbrojtëse në moment ku ato mbeten të papunë.
- Shqipëria duhet të krijojë politika të kualifikimeve profesionale dhe t'i implementojë ato, ku partner të kësaj politike të jenë vetë punëdhënësit.
- Shqipëria duhet të jetë më afër bashkëpunimit mes punëdhënësve dhe institucioneve arsimore.
- Qeveria duhet të zhvillojë politika për eliminimin e punësimit informal, për ristrukturimin e zhvillimit të përgjithshëm makroekonomik.
- Kriza aktuale e papunësisë kërkon një reagim të menjëhershëm dhe efikas nga të gjithë aktorët kryesorë sociale, duke përfshirë anëtarët e vetë shoqërisë.

Referenca

- Borjas. G (2012), *Labour economic*, 6 edition, Mc Graw- Hill Irwin: 3.
- Dornbusch. R and Fischer. S., (2000), *Makroekonomia*, Dituria, Tiranë: 1.
- Ehrenberg. R., & Smith., R (2012), *Modern Labor Economics, theory and public policy*, 11 edition Pearson Education: 1.
- Greene. W. H (2003), *Econometric analysis*, fifth edition Pearson Education: 1
<http://stat.smmu.edu.cn/DOWNLOAD/ebook/econometric.pdf>
- Lipsey R. and Chrystal A. (2007), *Economics*, Oxford University Press, eleventh edition: 117, 234.
- Mancellari. A, Haderi. S, Kule. Dh, Qirici. S, (2002), *Hyrje në ekonomi*, Pegi Tiranë: 205, 250.
- Mustafa. I., (2013), *Menaxhimi i biznesit dhe punësimit në ekonominë bashkëkohore*, Instituti i financave të Kosovës IFK, Prishtinë, 2013:19.
- Qirici. S (2005): *Ekonomiksi i punës*, Morava, Tiranë: 7, 10, 102.
- Uruci E (2004), *Mikroekonomia*, Toena, Tiranë: 372.
- Varian. H.(2000), *Mikroekonomia trajnim modern*, Onufri, Tiranë: 60
http://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/labour-law/WCMS_CON_TXT_IFPDIAL_EMPREL_EN/lang--en/index.htm
http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@sro-budapest/documents/publication/wcms_168326.pdf
http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/publ/documents/publication/wcms_190112.pdf
http://www.instat.gov.al/media/316719/t_rinjt_n_shqip_ri_sfdat_n_koh_t_q_ndrysh_ojn_.pdf
http://www.instat.gov.al/media/322938/pop_1_janar_2016.pdf
<http://www.tcu.gov.on.ca/eng/labourmarket/currenttrends/docs/guide.pdf>

TAVANET PËRFUNDIMTARE TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PER VITIN BUXHETOR 2018 – BASHKIA SHKODËR

Klodiana Perdja⁴³

Bashkia Shkodër

Abstrakt

Viti buxhetor 2018 po afron dhe qëllimi kryesor i punimit është të tregojë një informacion të përgjithshëm për burimet e financimit të shpenzimeve për Bashkinë Shkodër. Si burim kryesor i sigurimit të dhënave është informacioni i marrë nga drejtorja e analizës dhe programimit buxhetor dhe drejtorja e të ardhurave pranë Bashkisë Shkodër. Nga grumbullimi, paraqitja dhe analiza e informacionit u arrit në përfundimin që Bashkia Shkodër, me pesë burimet e financimit në dispozicion, parashikon që të mbulojë 13 programet e parashikuara. Bashkia Shkodër mbi bazën e programit të transparencës të lejon që çdo person i interesuar të ketë akses online në faqen zyrtare të saj për t'u njohur me informacionin e disponueshëm për programin buxhetor afatmesëm 2018 – 2020.

Kufizimi kryesor në lidhje me punimin është pamundësia për të bërë një krahasim me qytetet e tjera ose me kryeqytetin. Mendoj se në të ardhmen mund të realizohet një krahasim i tillë duke përdorur edhe burime të tjera të kërkimit.

Qëllimi kryesor i punimit është të evidentojë dhe të bëjë të qartë për lexuesin se cilat do të jenë prioritetet në investimet që do të kryhen gjatë vitit 2018 në territorin e Bashkisë Shkodër.

Mendoj se tema është aktuale dhe secili që lexon punimin mund të jetë i interesuar për t'u njohur më shumë rreth funksioneve kryesore të Bashkisë Shkodër të përcaktuara me ligj dhe të përkthyer në formën e

⁴³ Specialiste e buxhetit, Departamenti i Analizës dhe Programimit të Buxhetit, Bashkia Shkodër Asistent Ligjërues, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Ekonomisë, Shkodër, Shqipëri.

programeve dhe gjithashtu mund të marrë informacion edhe për mënyrën e financimit të tyre.

Rezultatet e punimit do t'u shërbejnë jo vetëm personave që kanë lidhje me fushën e ekonomisë, por edhe të gjithë banorëve të qytetit të Shkodrës, si dhe më gjerë.

The final upper limits of revenues and expenses for the budgeting year 2018-Shkodra Municipality

Abstract

The budget year 2018 is approaching and the main purpose of the paper is to provide general information of the funding sources of the expenditures for the Municipality of Shkodra. As the main source of data collection is the information obtained from the Directory of Analysis and Budget Programing and the Directory of Revenues at the Municipality of Shkodra.

From the collection, presentation and analysis of information it was concluded that Municipality of Shodra, with the five sources of funding available, it is able to cover 13 planned programs. The Municipality of Shkodra on the basis of the Transparency Program allows any interested person to have online access to the website to get acquainted with the information available for the mid-term budget program 2018 - 2020.

The main limitation regarding the work is the inability to make a comparison with other cities or with the capital city. I think that in the future such a comparison can be made using other sources of research.

The main purpose of the paper is to identify and make clear to the reader which will be the investments priorities that should be made during the year 2018 in the territory of the Municipality of Shkodra.

I think that the topic is related to the current situation, and anyone who read the paper may be interested to know more about the key functions of the Shkodra Municipality as defined by law and translated into the form of programs and and can also get information on how to finance them.

The results of the work will serve not only to those who are related to the economy fiels but to all residents of the city of Shkodra, but also wider.

Key words: revenue streams, source of funding, unconditional transfer, income, specific and conditional transfer.

1. Burimet e të ardhurave

Bashkia Shkodër përfshin një territor rreth 50 herë më të madh dhe një popullsi dy herë më të madhe prej rreth 203,633 banorë të regjistruar. Bashkia e re e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.

Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 56% të popullsisë (113,501 banorë), ndërsa për sa i përket njësisve administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e rrethinave me 23,616 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë Guri i Zi me 11725 banorë, Postrina me 11682 banorë, Bërdica me 9569 banorë, Velipoja me 9543 banorë dhe Dajçi me 8961 banorë. Tri njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5951 banorë, Pulti me 3207 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5878 banorë⁴⁴. Në bazë të nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4 parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë e qeverisjes vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Të ardhurat, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime bazë, si më poshtë:

- a. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jotatimore (nga tarifatat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore), donacione.
- b. Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja që i janë transferuar bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Bashkia ka të drejtën e ushtrimit të nivelit të taksës dhe mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen dhe administrimin e tyre brenda kufijve dhe sipas kriterëve të përcaktuara. Ajo gjithashtu ka të drejtë për të përjashtuar nga pagimi i taksës kategori të caktuara apo grupe në nevojë.⁴⁵ Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin që me burimet e veta financiare, të rrisin financimin për ushtrimin e funksioneve dhe

⁴⁴ <http://www.bashkiashkoder.gov.al/>

⁴⁵ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, neni 35.


kompetencave të deleguara në mënyrë që të ngrihet niveli i shërbimit në një shkallë më të lartë në interes të komunitetit.⁴⁶

Të ardhurat nga burimet e veta njësisia e qeverisjes vendore i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm.

Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore duhet të jetë i balancuar, që nënkupton që të ardhurat totale të siguruara nga të gjitha burimet e financimit duhet të jenë të barabarta me shpenzimet të cilat parashikohen që të kryhen gjatë vitit buxhetor. Buxheti vendor duhet të jetë i balancuar në termat e arkëtimeve dhe të pagesave. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet parashikohen në terma bruto. Buxheti i njësisë të qeverisjes vendore mund të ketë deficit vetëm për shpenzimet kapitale të cilat financohen me hua.⁴⁷

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Figura 1-1. Burimet e të ardhurave për vitin 2018, Bashkia Shkodër



Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave

Duke u bazuar në grafikun e mësipërm shpenzimet e planifikuara për vitin 2018 për Bashkinë Shkodër parashikohen që të financohen 25 % me të ardhurat e veta, 22 % me burim financimi transfertën e pakushtëzuar, 13 % burim financimi transfertën specifike, 40 % burim financimi transfertën e

⁴⁶ Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, pika 13.


⁴⁷ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6.

kushtëzuar dhe 0.01 % e totalit të shpenzimeve të parashikuara kanë si burim financimi donacionet.

Transferta e pakushtëzuar është një fond i caktuar që i jepet pushtetit vendor me qëllim kryerjen dhe përballimin e funksioneve dhe veprimtarive të tij. Së bashku me të ardhurat nga taksat që administrohen dhe mbliidhen nga njësitë e qeverisjes vendore, ato përbëjnë burimin kryesor të financimit të Buxhetit Lokal. Shuma e transfertës të pakushtëzuar përcaktohet me anën e një formule të paracaktuar. Formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë për çdo njësi dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9 – vjeçare dhe të mesme në çdo bashki.

Transferta specifike parashikohet për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara në njësitë e qeverisjes vendore. Transferta e kushtëzuar parashikohet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara


Figura 1-2. Të ardhurat nga burimet e veta për vitin 2018, Bashkia Shkodër.



Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave

Të ardhurat nga burimet e veta sigurohen me dy mënyra; nëpërmjet të ardhurave tatimore nga taksat vendore dhe nëpërmjet të ardhurave jotatimore. Të ardhurat nga tatimet ose nga taksat vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Rreth 53 % a të ardhurave nga burimet e veta sigurohen nga të ardhurat tatimore dhe 47 % e të ardhurave sigurohen nga të ardhurat jotatimore.


Figura 1-3. Të ardhurat tatimore nga taksat vendore për vitin 2018, Bashkia Shkodër



Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave

Të ardhurat nga tatimet dhe taksat vendore sigurohen nga burime të ndryshme. Pjesa më e madhe e të ardhurave nga tatimet dhe taksat vendore, rreth 65% sigurohet nga dy burime kryesore: të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (37%) dhe të ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (28%). Një pjesë e konsiderueshme e burimeve të kësaj të ardhure është edhe taksa vjetore e mjeteve të përdorura, e cila siguron rreth 21% të të ardhurave nga taksat vendore. Burimet e tjera të të ardhurave zënë një pjesë relativisht të vogël: të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel, taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, taksa e rentes minerare, të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe taksa e tabelës sigurojnë në total 14 % të të ardhurave me burim nga taksat vendore.


Figura 1-4. Të ardhurat jotatimore për vitin 2018, Bashkia Shkodër



Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave

Të ardhurat jotatimore ndahen në dy grupe të mëdha: të ardhurat nga tarifat vendore, që përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave dhe të ardhura të tjera.

Figura 1-5. Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2018, Bashkia Shkodër.




Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave

Më shumë se gjysma e të ardhurave nga tarifat vendore sigurohen nga tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave. Të ardhurat nga tarifa e shërbimit administrativ të Bashkisë Shkodër përbën burimin e dytë të të ardhurave nga tarifa vendore me rreth 18 %.

Të ardhurat që sigurohen nga tarifa për ndriçimin publik, nga tarifa për gjelbërim, nga tarifa për KUB, dhe nga tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës sportit, sigurojnë në total 29 % të të ardhurave nga tarifat vendore.

Figura 1-6. Të ardhurat të tjera për vitin 2018, Bashkia Shkodër.



Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të ardhurave.

Bashkia Shkodër siguron të ardhurat e tjera nga gjashtë burime kryesore ku pjesën më të madhe të tyre e zënë të ardhurat nga kundravajtjet administrative me rreth 47%. Si burim i dytë i të ardhurave të tjera konsiderohen të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë me rreth 27% dhe burimi i tretë i të ardhurave të tjera janë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve që sigurojnë rreth 21 % të të ardhurave të tjera. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime, të ardhura të tjera dhe të ardhurat nga sponsorizimet, përbejnë në total rreth 6 % të të ardhurave të tjera.

2. Burimet e financimit për çdo program

Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes mund të ndahen në tri grupe kryesore:


- Shpenzimet për funksionet e veta,
- Shpenzimet për funksionet e përbashkëta,
- Shpenzimet për funksionet e deleguara.⁴⁸

Bashkia Shkodër ushtron funksione, kompetenca dhe funksione të deleguara. Në çdo rast që qeverisja qendrore i transferon njësive të vetëqeverisjes vendore funksionet e delegura, i transferon gjithashtu edhe fondet e mjaftueshme për të financuar koston e këtyre funksioneve, në mënyrën dhe nivelin e përcaktuar me ligj.

Bashkia Shkodër aktualisht realizon 13 programe kryesore të cilat janë: Planifikim, manaxhim dhe administrimi, planifikim urban, infrastruktura rrugore, programi i shërbimeve publike, transportit publik dhe lëvizshmëria, zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi, bujqësia dhe zhvillimi rural, mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave, arsimi parauniversitar dhe edukimi, strehimi dhe shërbimet sociale, kultura dhe shërbimet rekreacionale, rinia dhe sportet dhe program i emergjencave civile.

⁴⁸ Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 113.

Figura 1-7. Burimet e financimit per çdo program për vitin 2018, Bashkia Shkodër




Burimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e analizës dhe programimit buxhetor.

Tabela e mësipërme tregon mënyrat e financimit të secilit program. Program i parë: planifikimi, menaxhimi dhe administrimi, ka si burim kryesor financimi transfertën e pakushtëzuar. Programi i dytë, i pestë dhe i gjashtë; përkatësisht planifikimi urban, transporti publik dhe lëvizshmëria, zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi financohen tërësisht nga të ardhurat e veta. Program i tretë: infrastruktura rrugore ka tri burime financimi, por si burim kryesor janë të ardhurat e veta. Program i shërbimeve publike gjithashtu financohet në pjesën më të madhe nga të ardhurat e veta. Bujqësia dhe zhvillimi rural është funksion i deleguar nga qeverisja qendrore dhe financohet nga transfertat specifike. Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve dhe kullotave ka dy burime financimi, por më shumë se gjysma e financimit sigurohet nga të ardhurat e veta. Shpenzimet për programin e arsimit parauniversitar dhe edukimin financohet me rreth 60 % nga transfertat specifike dhe pjesa tjetër e shpenzimeve ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar, të ardhurat dhe një pjesë shumë të vogël transfertën e kushtëzuar. Programi i strehimit dhe shërbimit social financohet me rreth 90 % nga transfertat e kushtëzuar nga qeverisja qendrore. Programet kultura, shërbimet rekreative, rinia dhe sportet kanë dy burime financimi: transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat. Në programin kultura dhe shërbimet rekreative, 65 % e financimit total është me të ardhurat e veta dhe pjesa tjetër me transfertë të pakushtëzuar. Në programin rinia dhe sportet, financimi me transfertën e pakushtëzuar

është 85 % e financimit total dhe pjesa tjetër si burim financimi ka të ardhurat. Program i emergjencave civile ka tri burime financimi: transfertën e pakushtëzuar, të ardhurat dhe transfertën specifike, ku transfertja specifike përbën më shumë se 60 % të financimit total për këtë program. Fondi rezervë krijohet totalisht me transfertën e pakushtëzuar. Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Fondi rezervë mund të përdoret vetëm me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.⁴⁹

Figura 1-8. Burimet e financimit për tri klasa kryesore të shpenzimeve për vitin 2018, Bashkia Shkodër.



Mjetet monetare nga transfertja e pakushtëzuar përdoren rreth 47 % për financimin e shpenzimeve korente, 32% për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për personelin dhe 21% përdoren për financimin e shpenzimeve kapitale.

Pothuajse e njëjta shpërndarje e përdorimit të mjeteve monetare është edhe për fondet të cilat sigurohen nga të ardhurat e veta, taksat ose tarifat. Rreth 48 % përdoret për financimin e shpenzimeve korente, 37% për paga dhe sigurime shoqërore dhe rreth 15 % për financimin e shpenzimeve kapitale.

⁴⁹ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6.

Transferta specifike përdoret vetëm për financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve korente, përkatësisht 72% dhe 28%.

Transferta e pakushtëzuar përdoret me rreth 97% për financimin e shpenzimeve korente. Për paga dhe sigurime shoqërore përdoret 2% dhe për shpenzime kapitale 1%.

Donacionet kanë destinacion vetëm financimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore.

3. Konkluzione

- Burimi kryesor i financimit të shpenzimeve për Bashkinë Shkodër janë të ardhurat e veta dhe burim kryesor i të ardhurave të veta janë të ardhurat nga tatimet dhe taksat.
- Njësitë e qeverisjes vendore i sigurojnë të ardhurat nga pushteti qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe transfertës së kushtëzuar.
- Për financimin e funksioneve të reja të deleguara nga qeverisja qendrore, njësitë e qeverisjes vendore përdorin transfertën specifike.
- Pjesa më e madhe e mjeteve monetare, të siguruara nga të gjitha burimet e financimit, destinohen për financimin e pagave dhe shpenzimeve korente.

4. Rekomandime

- Rritjen e nivelit të financimeve nga burimet e tjera, sidomos nëpërmjet donacioneve të cilat kanë një përqindje shumë të vogël në raport me të ardhurat totale.
- Programet në lidhje me transportin publik dhe lëvizshmërinë, zhvillimin ekonomik lokal dhe turizmin nuk duhen të financohen vetëm nga të ardhurat e veta, por edhe nga transfertat e qeverisjes qendrore.
- Është e nevojshme që të sigurohen më shumë të ardhura nga sponsorizimet.
- Për çdo burim financimi mendoj se duhet të rritet përqindja që duhet të përdoret për financimin e shpenzimeve kapitale.

Bibliografia

- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji nr.10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

**EFEKTIVITETI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM
PUBLIK.
“NJË RAST STUDIMI NË SEKTORIN PUBLIK
SHQIPTAR”**

Renato Çardaku⁵⁰

Ekonomist tek: Agi Glass-Tophane, Shkodër

Abstrakt

Auditimi i brendshëm është një nga proceset më të rëndësishme që ndikon në përmirësimin e veprimtarive të njësive ku ai ushtrohet. Për të siguruar funksionet e tij është kusht që ai të jetë sa më i pavarur dhe sa më efektiv.

Rëndësia e një auditimi të brendshëm sa më objektiv dhe efektiv merr një tjetër vlerë në sektorin publik. Ai luan një rol të jashtëzakonshëm në manaxhimin e fondeve publike dhe transparencën financiare të institucioneve e aq më tepër me reformen e re administrativo-territoriale.

Qëllimi i këtij punimi është që të theksojë rëndësinë e auditimit të brendshëm në organet e vetëqeverisjes vendore duke marrë si rast studimi Bashkinë Shkodër, e cila me reformën e re merr një tjetër dimension zhvillimi.

Efektiviteti i auditimit të brendshëm sipas shumë autorëve të fushës ndikohet nga disa faktorë siç janë: cilësia e auditimit të brendshëm, mbështetja e manaxherëve (titullarëve) dhe vendosja organizative. Funksioni i auditimit të brendshëm vlerësohet nga aftësia e tij për të bërë

⁵⁰ Lindur më 01.11.1992 në Shkodër. Arsimin 8-vjeçar e ka kryer në shkollën jopublike “Cor Jesu” Shkodër në vitet 1999-2007 ndërsa gjimnazin në shkollën jopublike “Atë Pjetër Meshkalla” Shkodër, në vitet 2007-2011. Në vitet 2011-2014 kreu studimet Bachelor në Financë-Kontabilitet në Universitetin “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 2016 u Diplomua “Master i Shkencave në Kontabilitet” po në Universitetin e Shkodrës. Në periudhën 18.08.2014-16.11.2014 ka kryer praktikën e punës në Studion e Kontabilitetit “Albanian Tax and Consulting”, Tiranë me Certifikatë Trajnimi në Financa 5. Në periudhën 01.04.2015-01.08.2017 ka kryer në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit Intership “Nxitje punësimi” në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër. Aktualisht punon ekonomist tek “Agi Glass” në Shkodër.

gjetje dhe për të dhënë rekomandime që do ta ndihmojnë manaxhimin e lartë drejtues për të vepruar më me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Si në çdo rast studimor përgjithësimet e konkluzioneve janë të limituara. Koha jo e gjatë në dispozicion të punimit, burimet e kufizuara financiare, aksesit jo i plotë në informacione janë gjithashtu një tjetër kufizim i punimit.

Ky është një nga studimet e pakta që bëhet në këtë fushë dhe mund t'i shërbejë si botës akademike, si dhe vetë Institucionit të Bashkisë e Shkodër për përmirësime të mëtejshme.

Fjalët kyçe: auditim i brendshëm publik, efektivitet, cilësi e auditimit, mbështetja e titullarëve (manaxheriale), vendosje organizative.

The effectiveness of public internal audit “A case study of Albanian public sector”

Abstract

Internal Audit is one of the most important processes that affects the improvement of the activities of the units where it is exercised. To ensure its functioning is a condition for it to be as independent and as effective as possible.

The importance of a more objective and effective internal audit takes on another value in the public sector. It plays an extraordinary role in managing public funds and financial transparency of institutions, and much more with the new administrative-territorial reform.

The purpose of this paper is to emphasize the importance of internal audit in the local self-governments by taking as a case study the Municipality of Shkodra which with the new reform takes another development dimension.

The effectiveness of internal audit by many authors of the field is influenced by several factors such as: the quality of internal audit, support of managers and organizational placement. The internal audit function is assessed by its ability to make findings and provide recommendations that will help top management to operate more efficiently and economically.

As in every case study generalization of the findings are limited. Time no longer available to the paper, limited financial resources incomplete access to information are also another limitation of the work.

This is one of the few studies done in this area and can serve as the academic world as well as the Municipality of Shkodra for improvements in certain fields in the future.


Keywords: public internal audit, effectiveness, audit quality, support of superiors, organizational setting.

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. <i>Numri i taksapaguesve sipas grupeve për vitin 2015</i>	149
Tabela 2. <i>Klasifikimi i bizneseve sipas xhiros vjetore për vitin 2015</i>	150
Tabela 3. <i>Klasifikimi i të ardhurave për Bashkinë Shkodër (000 lekë) për vitin 2016</i>	150
Tabela 4. <i>Plani dhe Fakti i burimeve të veta për Bashkinë Shkodër (qendër) për vitin 2015</i>	151
Tabela 5. <i>Plani dhe Fakti i burimeve të veta për ish-komunat (njësitë administrative) për vitin 2015</i>	151
Tabela 6. <i>Numri dhe lloji i auditimeve (plani dhe fakti) të zhvilluara nga NJAB 2015</i>	152
Tabela 7. <i>Gjetjet kryesore sipas sistemeve dhe numri i rekomandimeve përkatëse (2015)</i>	152
Tabela 8. <i>Pasqyra Nr.1-Formular për punonjësit e Njësisë së Auditimit</i> .	153

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: <i>Modeli Konceptual i Punimit</i>	146
Figura 2: <i>Krahasimi i numrit të bizneseve ndërmjet 2014-2015</i>	150
Figura 3. <i>Krahasimi i planifikimit të të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2015 dhe 2016</i>	151
Figura 4: <i>Krahasimi i buxheteve për njësinë e Auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër për vitet 2015 dhe 2016</i>	154

Figura 4: Modeli konceptual i punimit.

Rishikimi i literaturës

Fjala “auditor -që në shqip do të thot - auditues” përdoret për të treguar atë që kontrollon dhe verifikon, pra individin apo grupin e punës, ndërsa “auditing - që në shqip do të thotë– “auditim” përdoret për të treguar atë që lidhet me procesin, pra me rolin, misionin, qëllimin dhe funksionin e kësaj veprimtarie.⁵¹

Auditimi publik lindi, mbijetoi dhe vazhdon të ekzistojë edhe sot mbi bazën e funksioneve të zyrtarëve publikë të ngarkuar me auditimin e shpenzimeve qeveritare dhe u zyrtarizua për herë të parë në Angli në vitin 1285 me një dekret të Eduardit I. Ky dekret përcakton se të gjithë administratorët e parave publike auditohen nga audituesit.⁵²

Për veprimtarinë e auditimit, moment mjaft të rëndësishëm përbën mbajtja e kontabilitetit sipas mënyrës së regjistrimit të dyfishtë që u bë

⁵¹. Njësia qendrore e harmonizimit për auditimin e brendshëm.

⁵² Njësia qendrore e harmonizimit për auditimin e brendshëm.

nga familja e mjekëve “Florence” në Itali në vitin 1397. Mbajtja e kontabilitetit sipas kësaj forme është konsideruar si shpikje, duke i dhënë kështu shtetit të Italisë të drejtën për ta quajtur “Atdheun e kontabilitetit”. Epoka e zhvillimit dhe modernizimit të kontabilitetit fillon nga viti 1494 e në vazhdim, kur një monark i quajtur Luca Pacioli publikoi librin e parë mbi kontabilitetin. Ai njihet si “Babai i Kontabilitetit” sepse informacioni dhe libri i tij dimensional u shpërnda plotësisht.

Krijimi dhe stabilizimi i një strukture të pavarur për auditimin e shpenzimeve të thesarit me përshkrimin e përgjegjësive zyrtare për herë të parë u bë në Angli nga Mbretëresha Elizabeth I në vitin 1559.⁵³

Neni 2 i Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” e përkufizon auditimin publik si më poshtë:

“Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavaruar që i jep siguri objektive dhe ofron këshillim për manaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit të qeverisjes”. Ky përkufizim sipas ligjit është shumë i ngjashëm me përkufizimin që i bën Instituti i Audituesve të Brendshëm (The Institute of Internal Auditors). Ky përkufizim tregon se auditimi i brendshëm ka ndryshuar gjatë viteve, ai ka kaluar nga një theks i veçantë i përgjegjësive në të kaluarën tek përmirësimi i rezultateve në të ardhmen për të ndihmuar të audituarit që të veprojnë në mënyra më efikase dhe eficiente (Nagy, A.L., Cenker, W.J., 2002), (Goodwin, J., 2004). Duke qenë se ky përkufizim është i vlefshëm si për auditimin e brendshëm, por edhe për atë të jashtëm (Goodwin, J., 2004), në këtë punim është marrë në studim si shembull për t’u analizuar auditimi i brendshëm në sektorin publik (njësitë e vetëqeverisjes vendore).

Auditimi i brendshëm është efektiv nëse nga procedurat e tij plotëson rezultatin e synuar që njësia kishte supozuar (buxhetuar) të arrinte (Sawyer, L.B., 1995). Ndërsa sipas (Van Gansberghe, C.N., 2005) puna e një audituesi nuk është mbaruar akoma derisa defektet të zbulohen dhe korrigjimet të jenë bërë. (Van Gansberghe, C.N., 2005) shpjegon se efektiviteti i auditimit të brendshëm në sektorin publik mund të vlerësohet nga masa me të cilin ai kontribuon në ofrimin e një angazhimi auditimi sa më efektiv dhe eficient, pasi vetëm kështu arrihet të drejtohet kërkesa për

⁵³ Njësia qendrore e harmonizimit për auditimin e brendshëm.

përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Bazuar në konkluzionet e një forumi konsultativ që u mbajt në Kenia për përmirësimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik të vendeve në zhvillim, ai identifikoi disa faktorë që ndikojnë në efektivitetin e auditimit në sektorin publik. Sipas (Van Gansberghe, C.N., 2005) këta faktorë janë: perceptimi dhe pronësia, organizimi dhe mënyra e qeverisjes, legjislacioni, përmirësimi profesional dhe burimet që kanë në dispozicion audituesit. Gjithashtu, po sipas tij, një auditim i brendshëm efektiv duhet të ndërmarrë procedura vlerësimi në mënyrë të pavarur të operacioneve financiare, sistemeve dhe procedurave në mënyrë që të arrijë në rekomandime të vlefshme dhe që të zbatohen si të nevojshme. Unë mendoj se këta faktorë janë shumë të rëndësishëm dhe për vendin tonë si një vend në zhvillim dhe ku tradita e auditimit të brendshëm është e re dhe se kërkesat për përmirësimin e tij të vazhdueshëm nuk mungojnë.

Nga ana tjetër (Dittenhofer, M., 2001) ka vëzhguar se në qoftë se ndërmerret një auditim i brendshëm cilësor ai do të kontribuojë në përshtatshmërinë e procedurave dhe operacioneve të të audituarit dhe në këtë mënyrë auditimi i brendshëm do të kontribuojë në efektivitetin e të audituarit dhe të organizatës si një e tërë. Një tjetër studiues i fushës së auditimit (Xiangdong, W., 1997) përdor konfliktin e agjencisë për të shpjeguar rolin që luan në ekonomi auditimi i brendshëm dhe pikat në të cilat ai ka avantazhe krahasuar me auditimin e jashtëm në aspektin e marrjes më të shpejtë të informacionit dhe gjetjes së problemeve në fazat më të hershme. Nga ana tjetër (Spraaakman, G., 1997), aplikon teorinë e kostos ekonomike të transaksionit për të theksuar rëndësinë e auditimit të brendshëm nëpërmjet rekomandimeve të tij të cilat janë shumë të rëndësishme për manaxhimin e institucioneve dhe organizatave publike.

Cilësia e auditimit të brendshëm percaktohet nga kapaciteti i departamentit të auditimit të brendshëm për të zbuluar gabimet dhe për të dhënë rekomandime të vlefshme. Auditimi i brendshëm duhet të provojë se është një vlerë e shtuar për organizatën dhe ndikon në rritjen e vlerësimit të organizatës (emrit të mirë). Auditimi i brendshëm duhet të vlerësojë punën e tij dhe të angazhohet në përmirësime të vazhdueshme të tij (Ziegenfus, D.E., 2000).

Duhet të kemi parasysh që gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk i shërbejnë sa dhe si duhet organizatës (entit që auditohet) në qoftë se manaxhimi (drejtimi) i organizatave apo i enteve publike nuk angazhohet në zbatimin e tyre. (Adams, M.B., 1994) përdor konfliktin e agjencisë për të shpjeguar që është në interesin e manaxhimit që të ketë një drejtori (njësi) auditimi fortësisht efikase. Sipas tij implementimi i

rekomandimeve është mbi të gjitha, i rëndësishëm për vetë drejtimin e organizatës dhe sipas (Van Gansberghe, C.N., 2005) drejtuesit e organizatës duhet të shihen si klientë që përfitojnë nga një shërbim auditimi të brendshëm. Pra, si rezultat, implementimi i rekomandimeve të auditimit dhe mbështetja e tyre nga manaxhimi drejtues i organizatave është jetik për efektivitetin e auditimit të brendshëm.

Vendosja e organizative i referohet profilit të organizatave, organizimit të brendshëm dhe statusit buxhetor të njësisë së brendshme të auditimit. Vendosja organizative i referohet gjithashtu politikave dhe procedurave që drejtojnë operacionet e të audituarit. Të gjitha këto përbëjnë kontekstin në të cilin auditimi i brendshëm operon. Pra, në këtë menyrë, vendosja organizative, mund të ushtrojë ndikim në nivelin e efektivitetit të auditimit të brendshëm që mund të arrihet.

Rezultatet e rastit studimor

Background

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.212, datë 30/03/2013 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësisë të auditit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1 germa a thuhet se veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të kryhet ndër të tjera në njësitë qendrore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, shoqëritë tregtare me mbi 50% kapital publik, autoritetet e përbashkëta të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose u garantohet financimi nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Në këto organizma, sipas këtij vendimi, duhet të ngrihen njësi të auditimit të brendshëm.

Sipas ligjit (Ligji 10296, 08.07.2010), i ndryshuar, “njësi të qeverisjes së përgjithshme” janë njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale. Pra, Bashkia Shkodër, është njësi e qeverisjes së përgjithshme dhe si e tillë e ka kusht ligjor ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm

Tabela 4. Numri i taksapaguesve sipas grupeve për vitin 2015.

	Familjet	Biznesi i vogël	Biznesi i madh	Institucione
Bashkia Shkodër	31,230	3,661	1,025	50

Burimi: Bashkia Shkodër (2015)

Numri total i punonjësve në Bashkinë Shkodër për vitin 2016 do të jetë 930 punonjës. Plani i të ardhurave për Bashkinë Shkodër për vitin 2016 është 1,655,453,000 lekë të rinj.


Tabela 5. Klasifikimi i bizneseve sipas xhiros vjetore për vitin 2015.

Kategoria	Biznes i vogël		Biznes i madh
	Xhiro 0-5 milion lekë	Xhiro 5-8 milionë lekë	Mbi 8 milionë lekë
Nr.i bizneseve	3,401	260	1,025

Burimi: Bashkia Shkodër (2015)

Në 4-mujorin e parë të 2016-s (janar-prill), sipas të dhënave të siguruara nga drejtoria e të ardhurave në Bashkinë Shkodër, rezulton të jenë regjistruar në Bashkinë Shkodër 366 biznese me xhiro nga 0-5 milion lekë/vit, 16 me xhiro 5-8 milionë lekë/vit dhe 22 biznese me xhiro mbi 8 milionë lekë/vit.

Figura 5: Krahasimi i numrit të bizneseve ndërmjet 2014-2015.



Burimi: Bashkia Shkodër (2016)

Tabela 6. Klasifikimi i të ardhurave për Bashkinë Shkodër (000 lekë) për vitin 2016.

Të ardhurat	Nga burimet e veta vendore		TA trashëg.vit.mëpar.	Nga burimet qendrore		
	TA taksa+tarifa	TA jotatimore		Trans.pakusht.	Trans.specifike	Trans.kusht
		565,355	233,842	21,892	490,679	306,941

Burimi: Bashkia Shkodër (2016)

Tabela 7. Plani dhe fakti i burimeve të veta për Bashkinë Shkodër (qendër) për vitin 2015.

Llojet e të ardhurave	Plani	Fakti	Realizimi i planit vjetor	Realizimi në %
Të ardhurat nga taksa vendore	218,900,000	206,883,374	12,016,626	95%
Të ardhurat nga tarifatat vendore	129,340,000	138,327,925	8,987,925	107%
Të ardhura jotatimore	21,900,000	21,596,837	303,163	99%
TOTALI I BURIMEVE TË VETA	370,140,000	366,808,136	3,331,864	99%


Burimi: Bashkia Shkodër (2016)

Tabela 8. Plani dhe fakti i burimeve të Veta për ish-komunat (njësitë administrative) për vitin 2015.

Llojet e të ardhurave	Plani	Fakti	Realizimi i planit vjetor	Realizimi në %
Të ardhurat nga taksa vendore	161,975,454	101,895,966	60,079,488	63%
Të ardhurat nga tarifatat vendore	44,466,060	13,301,950	31,164,110	30%
Të ardhura jotatimore	7,314,520	680,992	6,633,528	9%
TOTALI I BURIMEVE TË VETA	213,756,034	115,878,907	97,877,127	54%

Burimi: Bashkia Shkodër (2016)

Figura 6. Krahasimi i planifikimit të të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2015 dhe 2016.



Burimi: Bashkia Shkodër (2016)

Cilësia e auditimit të brendshëm

Cilësia e auditimit të brendshëm, e cila demonstrohet nga aftësia e njësisë së auditimit të brendshëm për të bërë gjetje të sakta dhe për të dhënë rekomandime të duhura, është një nga komponentët më të rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e auditimit të brendshëm në organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore. Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm kërkojnë që puna e audituesve të brendshëm të planifikohet dhe të realizohet në atë mënyrë që audituesit të arrijnë në gjetjet e sakta dhe të japin rekomandimet e duhura për përmirësime të mëtejshme.

Tabela 9. Numri dhe lloji i auditimeve (plani dhe fakti) të zhvilluara nga NJAB 2015.

Lloji i auditimit	PLANI				TOTAL PLANI	TOTAL FAKTI
	I plotë	I përputhshmërisë	Performance	Financiare		
Numri		2	1	2	13	7

Burimi: NJAB-Bashkia Shkodër (2015)

Tabela 10. Gjetjet kryesore sipas sistemeve dhe numri i rekomandimeve përkatëse (2015.)

Gjetjet	SISTEMET				
	Proceset organizative	Programimi dhe zbatimi i buxhetit	Pagesat	Prokurimet	Kontabiliteti dhe raportimi financiar
Nr.rekomandimeve	21	7	17	22	2

Burimi: NJAB-Bashkia Shkoder (2015)

Gjatë vitit 2015 nga angazhimet e auditimit të kryera janë konstatuar dëme me karakter financiar me vlerë 90'584'000 lekë.

Ekspertiza e stafit

Standardet Ndërkombëtare të auditimit të brendshëm në lidhje me aftësitë e stafit përbërës kërkojnë që audituesit e brendshëm të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e duhura profesionale për kryerjen e përgjegjësisë të tyre. Edhe neni 11 i Ligjit 114/2015 “Për auditimin e

brendshëm në sektorin publik” përcakton kriteret që duhet të zotërojnë kandidatët që duhet të punësohen në njësitë e auditimit të brendshëm.

Pika 2 e VKM 212 datë 30.03.2012 përcakton numrin minimal të audituesve që duhet të ketë një njësi e auditimit të brendshëm. Sipas vendimit numri minimal i audituesve duhet të jetë tre duke përfshirë edhe drejtuesin e njësisë.

Tabela 11. Pasqyra Nr.1-Formular per punonjësit e njësisë së auditimit.

Pozicioni aktual	Data e emërimit	Arsimimi (specifiko degën dhe fakultetin)	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi si AB
Përgjegjës	01.04.1996	Fakulteti i Ekonomisë Agrare, dega administratë	19	19	2005
Audite	16.08.2000	Fakulteti i Drejtësisë, Juridik	18	14	2008
Audite	31.12.2013	Fakulteti i Drejtësisë, Juridik	4	1	2013

Burimi: NJAB-Bashkia Shkodër (2016)

Fusha e shërbimit e audituesve

Nga hulumtumi i raporteve të auditimit dhe i materialeve të tjera që siguroam rezultoi se audituesit e brendshëm përfshihen në disa lloje auditimesh. Konkretisht nga hulumtimi i **Pasqyrës Nr.2 “Realizimi i programit nga njësia e auditimit të brendshëm”- për periudhën janar-dhjetor të vitit 2015** rezulton se audituesit janë angazhuar në **4 auditime të plota, 2 të performancës, 1 financiare**. Po ashtu duke hulumtuar edhe **“Planin vjetor të objekteve për t’u audituar nga NJAB për vitin 2016”** shohim që në **6-mujorin e parë** audituesit planifikojnë **1 auditim të plotë** dhe **7 të tjera (pa e specifikuar)**, ndërsa në **6-mujorin e dytë** planifikojnë **6 auditime të plota** dhe **1 të përputhshmërisë**.

Planifikimi dhe buxheti

Planifikimi konsiderohet gjerësisht si një nga detyrat më vitale të aktivitetit të auditimeve të brendshme të njësive publike. Ai përfshin përgatitjen e planit strategjik, planit vjetor dhe programet individuale të detyrave për auditimet. Nga ana tjetër hartimi i planeve strategjike dhe


vjetore të auditimeve është edhe një kërkesë ligjore, kjo e përcaktuar në ligjet 114/2014 dhe sipas (UMF Nr.12, 05.06.2012).

Plani vjetor i auditimit përfaqëson dokumentin bazë, sipas të cilit realizohet veprimtaria e auditimit të brendshëm gjatë vitit të ardhshëm. Plani vjetor është pjesë e planit strategjik i cili rishikohet çdo vit duke u bazuar në objektivat dhe prioritetet e organizatës si dhe në treguesit e realizimit të objektivave të NJAB. Në planin vjetor përcaktohen numri i angazhimeve, lloji i auditimit bazuar në qëllimin, madhësinë dhe kompleksitetin e subjektit që do të auditohet.

Pas përcaktimit të fushave prioritare, identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, NJAB programon veprimtaritë që do të kryhen. Kjo pjesë përfshin përcaktimin e llojit të auditimit, numrin e angazhimeve, periudhën që do të auditohet, kohën e kryerjes së angazhimit si dhe nevojat për burime njerëzore në ditë-njeri.

Në këtë studim u hulumtuan “Plani strategjik i objekteve për t’u audituar nga NJAB nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe 2015-2019”, “Plani vjetor i objekteve për t’u audituar nga NJAB për vitet 2016 dhe 2015”, “Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të stafit të NJAB për vitet 2016 dhe 2015”, “Planifikimi vjetor i kostove të njësisë së auditimit të brendshëm për vitet 2016 dhe 2015”, “regjistri i riskut për vitin 2016” si dhe “Raporti i punës për vitin 2015”.

Figura 7: Krahasimi i buxheteve për njësinë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër për vitet 2015 dhe 2016.



Burimi: Bashkia Shkodër (2016.)

Puna në terren dhe rishikimi i cilësisë

Puna në terren është pjesa më e vështirë dhe më e rëndësishme e misionit të auditimit. Pasi janë përcaktuar qartë sistemet dhe fushat që do të auditohen, janë përcaktuar dhe ndarë detyrat, çdo audit duhet njekohësisht të verifikojë dokumentacionin ligjor dhe teknik të organizatës dhe njekohësisht të plotësojë letrat e punës për të dokumentuar misionin e auditimit. Manuali i auditimit të brendshëm përcakton qartë letrat e punës standarde që duhen plotësuar nga audituesit për të dokumentuar punën e tyre audituese. Puna në terren ka edhe veçantitë e saja në lidhje me llojin e auditimit që do të ushtrohet dhe me njësinë që do të auditohet.

Sigurimi i cilësisë ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet rishikimit duhet të sigurohet nëse puna e auditimit të brendshëm është kryer në përputhje me standardet më të larta. Sigurimi i cilësisë, në vetvete, përfshin si rishikimin direkt të punës së auditimit nga një anëtar i stafit që ka më shumë eksperiencë, po ashtu edhe pjesëmarrjen e një anëtari më me eksperiencë në takime të rëndësishme me manaxhimin e organizatës.

Nga hulumtimi i “Pyetësit të vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm nga NJAB në Bashkinë Shkodër për vitin 2015” rezulton se NJAB e bën rishikimin e cilësisë në të gjitha fazat e punës audituese, rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga drejtuesi i NJAB ose nga një person i autorizuar prej tij. Nga hulumtimi që ne bëmë rezulton se komentet apo vlerësimet e procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë janë pjesë e dosjes së auditimit.

Komunikimi i audituesit

Standardet e Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm kërkojnë që audituesit të kenë komunikime të sakta, objektive, koncize, konstruktive, të plota dhe në kohë. Komunikimi i mirë është tipar thelbësor i një auditimi të mirorganizuar.

Nga hulumtimi i pyetësit të vetëvlerësimit për vitin 2015 tregon se njësia e auditimit të brendshëm plotëson kriteret sipas manualit të auditimit, por ka vend për përmirësime të mëtejshme.

Mbështetja menaxheriale.

Mbështetja menaxheriale është një tjetër faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në efektivitetin e punës audituese. Duhet të kemi parasysh që gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk i shërbejnë sa dhe si duhet organizatës (entit që auditohet) në qoftë se

manaxhimi (drejtimi) i organizatave apo i enteve publike nuk angazhohet në zbatimin e tyre. (Adams, M.B., 1994).

Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër, në periudhën gusht-dhjetor 2015 i është kërkuar nga kryetarja e bashkisë dhe i është ofruar mbështetje e plotë nga ana e saj, auditimi i disa subjekteve të cilat kanë pasur nevojë emergjente në monitorimin e tyre. Mund të përmendim këtu Shoqërinë e Klubit “Vllaznia”, apo Njësinë e Prokurimit në Bashkinë Shkodër. Nga hulumtimi i raportit të punës audituese për vitin 2015 i njesisë së auditimit të brendshëm rezulton se rekomandimet e lëna nga audituesit janë kërkuar të zbatohen në mënyrë detyruese nga kryetarja e bashkisë. Çdo përfundim i punës audituese është nënshkruar nga kryetarja e bashkisë.

Po sipas raportit të punës audituese për vitin 2015 rezulton se në përgjithësi rekomandimet e lëna nga audituesit janë pranuar nga subjektet e audituara. Për të gjitha misionet e auditimit të kryera, rekomandimet janë lënë në bashkëpunim me drejtuesit e subjekteve të audituara. Për të gjitha subjektet e audituara me kërkesën e kryetares së bashkisë janë përsëritur rekomandimet në përfundimin e auditimit. Drejtuesit e subjekteve të audituara kanë përpiluar planin e veprimit.

Struktura organizative

Struktura apo vendosja organizative e njesisë së auditimit të brendshëm i referohet ndër të tjera statusit të njesisë së auditimit në organigramën e institucionit ku ajo është e vendosur, shkallës së lirisë që njësia ka për të përdorur buxhetin që ka në dispozicion dhe politikave apo procedurave që ajo përdor.

Statusi organizativ dhe organizimi i brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër, sipas (VKM NR.848, 17.12.2014) grupohet në njësi organizative. Sipas ligjit 114/2015 ajo raporton drejtpërdrejt tek kryetarja e bashkisë. Sipas VKM nr.212 datë 30.03.2012 ajo përbëhet nga 3 anëtarë, 1 përgjegjës (drejtuesi i njesisë) dhe 2 audite. Neni 18 i ligjit 114/2015 siguron pavarësinë individuale të audituesve ku ndër të tjera ndalohet a) punësimi i një audituesi në njësinë publike ku ai ka qenë i punësuar gjatë 3 viteve të fundit me përjashtim të funksionit të audituesit të brendshëm, b) punësimi në funksione drejtuese gjatë 3 viteve të fundit në njësinë publike që do të auditohet të bashkëshortit/bashkëshortes, të të afërmeve me lidhje gjinie deri në shkallën

e dytë sipas përcaktimeve të bëra në kodin civil dhe c) zotërimi nga audituesi, bashkëshortja/bashkëshorti, të afërmit me lidhje gjinie deri në shkallën e dytë sipas përcaktimeve të bëra në kodin civil, i aksioneve ose pjesëve të kapitalit në njësinë publike që do të auditohet.

Politikat organizacionale dhe procedurat

Në mënyrë që të realizohet një auditim sa më efektiv, duhet që të ekzistojnë politika dhe procedura të qarta me të cilat realizohet puna audituese dhe të cilat duhet që të jenë të matshme për të vlerësuar punën e një audituesi. Nga ana tjetër, rezultatet e një shërbimi auditimi të brendshëm kontribuojnë në përmirësimin e këtyre politikave dhe procedurave.

Në rastin tonë politikat dhe procedurat që përdoren gjatë një shërbimi auditimi janë ato që përdoren në auditimin e brendshëm publik në vendin tonë të përcaktuara në (Manuali i Auditimit të Brendshëm, 2010) dhe që shumë prej tyre i përshkruam në këtë punim.

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

Auditimi i brendshëm në Bashkinë Shkodër merr një rëndësi më të veçantë tani që me reformën e re administrativo-territoriale. Numri i bizneseve ka pësuar rritje në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 dhe konkretisht me 43.57% bizneset me xhiro vjetore nga 0-8 mln lekë dhe më 36.67% ato me mbi 8 mln lekë/vit. Ky është një tregues mjaft i rëndësishëm për të theksuar rëndësinë e auditimit të brendshëm në manaxhimin e fondeve publike.

Buxheti i të ardhurave për vitin 2016 është 1,655,453,000 lekë të rinj dhe i atyre nga burimet e veta në shumën 799,197,000 lekë, shumë kjo 36.87% më e lartë krahasuar me buxhetimin e të ardhurave nga burimet e veta në vitin 2015.

Për vitin 2015 ishin planifikuar 13 auditime dhe në fakt u realizuan vetëm 7 gjatë vitit 2015 u bënë 69 rekomandime dhe dëmi financiar i konstatur është në vlerën e 90'584'000 lekë. Sipas raportit të vitit 2015, shmangia nga plani i auditimeve ka ndodhur për shkak të organizimit dhe ristrukturimit të shumë drejtorive që ishin planifikuar të auditoreshin.

Sipas planit vjetor të objekteve për t'u audituar për vitin 2016 janë 15 auditime ndërsa sipas planit strategjik janë 16 të tilla.

Sipas pasqyrës së formularit për punonjësit e njësisë së auditimit (Tabela Nr.8) në njësisë e auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër punojnë 3 punonjës, 1 përgjegjës dhe 2 audite. Në vlerësojmë se niveli i tyre akademik dhe eksperiencia e tyre si auditues është në nivele shumë të kënaqshme dhe punësimi i tyre është edhe në përputhje me legjislacionin e fushës.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton që audituesit angazhohen në disa lloje auditimesh. Po ashtu rezulton që ata nuk angazhohen vetëm në auditimin e veprimtarive të përditshme, por edhe në projektet e veçanta.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton që buxheti/ gjithsej dhe buxheti/person nga viti 2015 në krahasim me vitin 2016 është rritur me 0%. Pra edhe pse planifikimi i numrit të auditimeve është rritur dhe numri i objekteve për t'u audituar gjithashtu buxheti ka mbetur po i njëjti.

Auditimi i brendshëm në Bashkinë Shkodër është i organizuar në formën e njësisë së brendshme dhe jo në drejtori, pra nuk ka statusin më të lartë të mundshëm.

Çdo përfundim i punës audituese është nënshkruar nga kryetarja e bashkisë. Nga hulumtimi i raportit të punës për vitin 2015 rezulton se rekomandimet e lëna nga audituesit janë kërkuar të zbatohen në mënyrë detyruese nga kryetarja e institucionit.

Rekomandime

Rekomandoj që të ketë më shumë angazhim dhe efikasitet në realizimin e numrit të auditimeve pasi me reformën e re territoriale, përgjegjësia është rritur dhe përgjegjshmëria duhet të rritet gjithashtu.

Rekomandoj që duhet t'i kushtohet më shumë seriozitet hartimit të planeve të auditimit (strategjik dhe vjetor) dhe të mos ketë anomali në shifrat ndërmjet dy planeve. Në këtë mënyrë efektiviteti i auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër do të rritej.

Rekomandoj që në auditime specifike të kontraktohen specialistë të fushave duke kontribuar kështu në rritjen e efektivitetit të auditimit të brendshëm.

Duke pasur parasysh se bashkia është rritur dhe përgjegjësitë janë shtuar rekomandoj rritje të numrit të audituesve dhe shtim të grupeve të punës.

Rekomandoj që njësia të shndërrohet në drejtori duke i shtuar kështu numrin e punonjësve, kompetencat dhe pse jo edhe pavarësinë. Me këtë numër të punonjësve kaq të ulët në krahasim me volumin e punës unë gjykoj që çënohet efektiviteti i auditimit të brendshëm dhe efica e tij.

Rekomandoj që të rritet numri i audituesve me formim të mirëfilltë ekonomik për vetë faktet që paraqitëm në këtë punim.

Gjykoj se duhet të ketë rritje të buxhetit.

Rekomandoj përmirësim të procedurave dhe të dokumentacionit që ushtrohet në punën në terren. Vlerësoj që këto përmirësime të kryhen sa më shpejt.

Siç edhe e tregon Raporti i KLSH mbështetja menaxheriale (e titullarëve) ka vend për rritje të mëtejshme.

BIBLIOGRAFI

- Adams, M.B. (1994). "Agency theory and the internal audit". *Managerial Auditing Journal* , 9, 8-12.
- Dittenhofer, M. (2001). "Internal audit effectiveness: an expansion of present methods". *Managerial Auditing Journal* , 443-500.
- Goodëin, J. (2004). "A comparison of internal audit in the private and public sectors". *Managerial Auditing Journal* , 19, 640-650.
- Ligji 10296. (08.07.2010). *Për manaxhimin financiar dhe kontrollin*.
- Ligji 114. (2015).
- Manuali i auditimit të brendshëm. (2010).
- Nagy, A.L., Cenker, W.J. (2002). "An assessment of the newly defined internal audit function". *Managerial Auditing Journal* , 17, 130-137.
- Sawyer, L.B. (1995). "An internal; audit philosophy". Në *Internal Auditor* (fv. 46-55).
- Spraaqman, G. (1997). "Transaction cost economics: a theory of internal audit". *Managerial Auditing Journal* , 17, 323-330.
- UMF Nr.12. (05.06.2012).
- Van Gansberghe, C.N. (2005). *Internal auditing in the public sector. a consultative forum in Nairobi, Kenya, shores up best practices for government audit professionals in developing nations* ,.
- VKM 212. (30.03.2012).
- VKM NR.848. (17.12.2014).

- Xiangdong, W. (1997). "Development trends and future prospects of internal auditing". *Managerial Auditing Journal* , 12, 200-204.
- Ziegenfus, D.E. (2000). "Developing an internal auditing department balanced scorecard". *Managerial Auditing Journal* , 15, 12-19.

STRUKTURA OPTIMALE E KAPITALIT: EVIDENCË NGA QYTETI I SHKODRËS

Emirjona Gruda⁵⁴

Ekonomiste pranë njësisë ekonomike Durraj-1 Sh.p.k.

Abstrakt

Faktorët që influencojnë vendimin e njësive ekonomike për strukturën e kapitalit janë diskutuar shpesh në literaturën dhe studimet e huaja, ndërsa në vendin tonë, sidomos në qytetin e Shkodrës, studime të tilla janë të rralla.

Qëllimi i këtij punimi është studimi i këtyre faktorëve për të vërejtur nëse përkrahin ndonjëherë nga teoritë që synojnë të shpjegojnë vendimet e njësive ekonomike në lidhje me strukturën e kapitalit.

Për përmbushjen e këtij qëllimi është shqyrtuar një literaturë e gjerë në lidhje me teoritë e strukturës së kapitalit dhe faktorëve influencues makroekonomikë si dhe karakteristikat e njësive. Për të realizuar studimin janë shqyrtuar të dhënat e publikuara nga njësitet ekonomike në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Janë grumbulluar të dhëna panel me shtrirje në kohë, për vitet 2009-2014 dhe me shtrirje në hapësirë, për 50 njësi ekonomike në qytetin e Shkodrës, në Shqipëri. Për përpunimin është përdorur një model statik i të dhënave panel, Fixed effects, duke nxjerrë përfundime në lidhje me faktorët dhe mënyrën se si ato ndikojnë në vendimin e njësive për financim. Gjatë studimit vihet re se faktorët kanë një mbështetje mikse, për të dy teoritë kryesore, por kryesisht dominon teoria pecking order. Ky studim mund të përdoret nga njësitet ekonomike, por edhe nga studiues të tjerë për krahasime në të ardhmen ose duke realizuar një punim më të gjerë në shkallë vendi.

⁵⁴ Emirjona Gruda: Diplomuar në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, dega Master Shkencor Kontabilitet në vitin 2017. E certifikuar me nivelin C1 Anglisht, Toeik Listening and Reading. Punon me kohë të plotë ekonomiste pranë njësisë ekonomike Durraj-1 sh.p.k. nga viti 2016 e në vazhdim, ku punon me programin Financa 5. Ka ndjekur studimet në Fakultetin Ekonomik në Shkodër, në degën Financë-Kontabilitet. E certifikuar me rezultatin shkëlqyeshëm për programin ALFA.

Fjalë kyçe: Strukturë kapitali, raporte borxhi, faktorë specifikë të njësive, faktorë makroekonomikë, teoritë trade off dhe pecking order.

Optimal Capital Structure: Evidence from Shkodra City

Abstrakt

The determinants that influence the company decision for the structure of the capital have been widely discussed in foreign studies and literature, but in Albania, especially in the city of Shkodra, studies like this are quite rare.

The aim of this micro thesis is to study these factors in order to observe if they support any of the theories that intend to explain the decision of the companies about the capital structure.

To fulfill this aim a wide literature has been discussed about the theories of capital structure plus the firm specific and macroeconomic determinants.

For this research we examine the data published from the companies to QKB. Panel data have been gathered both in time series, for the years 2009-2014, also in space series, for 50 companies in the city of Shkodra, in Albania. In order to study data a static model of panel data has been used, called Fixed effects, to conclude about the determinants and the way that they influence in the decision of the companies. During this research it has been observed that the determinants have a mixed support for both of the main theories, but mostly dominates pecking order theory. This study can be used from the companies also from other researchers to make comparisons in the future or maybe to extend this research in country level.

Key words: Capital structure, debt reports, firm specific determinants, macroeconomic determinants, Trade off and pecking order theory.

Përcaktimi i problemit

Studime dhe teori pafund janë realizuar për t'i dhënë përgjigje pyetjes së strukturës optimale të kapitalit për njësitë ekonomike. Ky studim nuk është i vetmi i realizuar, por, megjithatë, në Shqipëri dhe në qytetin e Shkodrës, është ende në fillesa. Problemi qëndron pikërisht në kombinimin borxh dhe kapital për financimin e njësive. Ky studim do të përpiqet të studiojë faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin e njësive ekonomike të qytetit të Shkodrës për caktimin e strukturës së kapitalit, asaj optimale.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij punimi është studimi i faktorëve ekonomikë për të vërejtur nëse përkrahin ndonjëherë nga teoritë që synojnë të shpjegojnë vendimet e njësive ekonomike në lidhje me strukturën e kapitalit.

Ky qëllim do realizohet përmes analizës së strukturës financiare të njësive ekonomike që operojnë në qytetin e Shkodrës.

Objektivat specifike

1. Të studiohet struktura financiare e përgjithshme e njësive ekonomike të qytetit të Shkodrës.
2. Të analizohen ato karakteristika të njësive ekonomike që ndikojnë në zgjedhjen e strukturës së kapitalit.
3. Të arrihen përfundime në bazë të analizave dhe modeleve të realizuara duke pranuar ose hedhur poshtë hipotezat.

Pyetja kryesore e hulumtimit

Studimi i realizuar përqendrohet në pyetjen kryesore të hulumtimit:
Si e arrijnë njësitë ekonomike të qytetit të Shkodrës strukturën e tyre optimale të kapitalit?

Qëllimi i studimit është pikërisht arritja e një përgjigjeje duke përdorur dy grupe faktorësh ekonomikë. Faktorët makro do të jenë GDP, inflacioni, interesi i kredidhënies, ndërsa karakteristika të vetë njësive, do të jenë madhësia, struktura e aktiveve, likuiditeti, rritja dhe përfitueshmëria.

Hipotezat e kërkimit

Në realizimin e këtij studimi janë testuar hipotezat e mëposhtme në mënyrë që të përcaktohet lidhja mes levës financiare dhe variablave të pavarura të kompanive të zgjedhura nga qyteti i Shkodrës.

H01: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes madhësisë dhe levës financiare.

H11: Ekziston një lidhje sinjifikative mes madhësisë dhe levës financiare.

H02: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes strukturës së asetëve dhe levës financiare.

H12: Ekziston një lidhje sinjifikative mes strukturës së asetëve dhe levës financiare.

H03: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes përfitueshmërisë dhe levës financiare.

H13: Ekziston një lidhje sinjifikative mes përfitueshmërisë dhe levës financiare.

H04: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes rritjes dhe levës financiare.

- H14: Ekziston një lidhje sinjifikative mes rritjes dhe levës financiare.
H05: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes likuiditetit dhe levës financiare.
H15: Ekziston një lidhje sinjifikative mes likuiditetit dhe levës financiare.
H06: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes GDP dhe levës financiare.
H16: Ekziston një lidhje sinjifikative mes GDP dhe levës financiare.
H07: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes interesit të kredidhënies dhe levës financiare.
H17: Ekziston një lidhje sinjifikative mes interesit të kredidhënies dhe levës financiare.
H08: Nuk ekziston një lidhje sinjifikative mes inflacionit dhe levës financiare.
H18: Ekziston një lidhje sinjifikative mes inflacionit dhe levës financiare.

Rëndësia e studimit

Realizimi i këtij studimi qëndron pikërisht tek njohuritë e shtuara duke ndihmuar përmes analizës dhe rezultateve të studimit të kuptohet diçka më tepër për strukturën optimale të kapitalit për kompanitë e qytetit tim, Shkodrës. Ky studim mund të shërbejë fare mirë për realizimin e një analize të mëtejshme në vitet në vazhdim duke krahasuar rezultatet në perioda kohore të ndryshme ose për të realizuar një analizë të mëtejshme për qytete të tjera duke arritur në konkluzione për të gjithë Shqipërinë. Në këtë mënyrë do mund të krahasohemi edhe me shtete të tjera të Ballkanit apo Evropës.

Kufizimet e studimit

Ky është një studim i limituar fillimisht përse i përket vendit për të cilin është zhvilluar studimi, qyteti i Shkodrës, duke përjashtuar të gjitha qytetet e tjera. Limitimi qëndron edhe në faktorët e studiuar për të treguar ndikimin që kanë tek vendimi i kompanisë për strukturën e kapitalit. Bazuar tek literatura vihet re se autorë të ndryshëm studiojnë variabla, faktorë të ndryshëm, megjithatë variablat e studiuar në model janë të pranishme tek pjesa më e madhe e studimeve të realizuara. Një tjetër limitim që mund të përmendet lidhet me shtrirjen në kohë që ka studimi nga viti 2009 deri në 2014-ën. Në studime të tjera të ardhme mund të rritet numri i viteve i marrë në shqyrtim. Vështirësi janë hasur edhe në sigurimin e të dhënave duke qenë se kishte probleme sidomos përse i përket vitit 2008-2010. Gjatë këtij studimi janë përdorur vlerat e librit për shkak të mungesës së një burse funksionale dhe tregjeve aktive ndaj edhe ky është një nga kufizimet e studimit, pasi fare mirë mund të kishim përdorur

vlerësimin e tregut. Megjithatë këto kufizime nuk kanë ndikuar në nxjerrjen e rezultateve të studimit. Madje ky studim mund të përdoret në të ardhmen për të krahasuar qytetin e Shkodrës me qytete të tjera të Shqipërisë e më gjerë.

Metodologjia e ndjekur

Metodologjia e ndjekur gjatë këtij studimi është e bazuar tek metoda deduktive e kërkimit. Kjo pasi studimi merr të gatshëm modelet dhe i aplikon duke përdorur të dhënat e njësive ekonomike të qytetit të Shkodrës duke nxjerrë rezultatet e këtij aplikimi. Në këtë studim janë përdorur metodat sasiore duke përdorur të dhëna nga burime sekondare bruto dhe të përpunuara. Studimet në lidhje me konceptet teorike, faktorët influencues, etj., si dhe studimet në lidhje me modelet e trajtuara janë të grumbulluara nga librat, faqet e internetit, revistat shkencore etj.

Burime sekondare të papërpunuara në lidhje me faktorët makroekonomikë janë siguruar nga Banka Botërore.

Burime të tjera sekondare janë të dhënat e publikuara nga njësitë ekonomike përmes pasqyrave financiare të cilat janë përpunuar duke u transformuar në raportet e nevojshme për realizimin e studimit. Janë marrë të dhëna nga 50 njësi ekonomike për periudhën 2009-2014. Mbi të dhënat e përpunuara janë ndërtuar 3 modele duke studiuar raportet e borxhit total dhe atij korent e afatgjatë që të kuptohet më mirë se si ndikojnë faktorët në vendimin e njësive për zgjedhjen e mënyrës së financimit.

Teoritë kryesore

Pecking Order sugjeron që burimet e brendshme duhet të jenë preferenca e parë për financimin e kompanisë, përpara se të konsiderojë burimet e jashtme (Myers & Majluf, 1984) (Donaldson, C. 1961).

Vetëm kur burimet e brendshme janë të pamjaftueshme kompanitë duhet të konsiderojnë burimet e jashtme, duke zgjedhur huatë afatshkurtëra përpara borxheve afatgjata dhe pas këtyre krijimin e kapitalit të ri. Arsyeja e kësaj renditjeje lidhet me faktin se burimet e brendshme të financimit janë më të lira dhe nuk do të ketë ndërhyrje nga jashtë. Me radhë, më pas, renditet borxhi i jashtëm duke qenë se konsiderohet më pak i kushtueshëm dhe me më pak kufizime, më pak i rrezikshëm, krahasuar me krijimin e kapitalit të ri.

Teoria Trade-Off e vë theksin tek ekzistenca e një strukture optimale të kapitalit që kompanitë duhet të arrijnë në mënyrë që të maksimizojnë vlerën e tyre (Jensen & Meckling, 1976). Kryesisht fokusohet në kostot dhe përfitimet që vijnë nga përdorimi i borxhit.

Kompanitë caktojnë një nivel target për raportin borxh-kapital që balancon avantazhet në taksa që vijnë nga përdorimi i borxhit shtesë kundrejt kostove të mundshme të falimentimit.

Popullimi i synuar është gjithë qyteti i Shkodrës, pasi aty alokohen pjesa më e madhe e institucioneve, njësive ekonomike, aktiviteteve, etj. Duke qenë se popullata është shumë e madhe është zgjedhur një kampion që na lejon të bëjmë përgjithësime për popullatën.

Përsa i përket metodës së analizës së të dhënave, metoda e përdorur është ajo e analizës së regresionit. Më saktësisht bëhet fjalë për analizën e regresionit përmes përdorimit të të dhënave panel me shtrirje në hapësirë dhe në kohë përmes modelit Fixed effects.

Për të vërtetuar hipotezat e ngritura në kapitullin e mëparshëm janë marrë në studim 50 njësi ekonomike që operojnë në qytetin e Shkodrës. Këto njësi kanë mbi 8 vite aktivitet në treg dhe periudha e marrë në studim në lidhje me të dhënat është 6 vite, 2009 – 2014, për arsye se të dhënat e viteve të mëparshme nuk ishin të disponueshme.

Pasqyrat financiare të këtyre njësive ekonomike u siguruan nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Për përzgjedhjen e kampionit të studimit u pa vendndodhja si dhe aktiviteti i njësive ekonomike në mënyrë që rezultatet e studimit të përgjithësoheshin për të gjitha njësitë e tjera.

Kemi gjithsej 300 observime, por mungojnë shumë të dhëna. Mungesat më shumë i përkasin vitit 2008 dhe 2009 të cilat nuk janë të hedhura në sistem dhe sigurimi i tyre nga arkivat paraqiste vështirësi.

Variablat e pavarur janë përfitueshmëria, madhësia, rritja, likuiditeti, struktura e asetëve, GDP, inflacioni dhe interesi i kredidhënies. Në vend që të krahasohet secili variabël i një viti me me vitin e mëparshëm llogaritet një mesatare për secilin variabël për çdo njësi ekonomike dhe krahasohen të gjitha variablat me mesataren. Mesatarja llogaritet për variablat e varura dhe të pavarura për secilën njësi ekonomike.

$$(Y_{it} - \bar{Y}_i) = \beta_1 (X_{it} - \bar{X}_i) + (\varepsilon_{it} - \bar{\varepsilon}_i)$$

Për të bërë analizën statistikore fillimisht ndërtojmë tabelën e të dhënave statistikore në lidhje me këto variabla.

Tabela I-1 Të dhënat statistikore të variablave të ekuacionit të regresionit të shumëfishtë.

Summary Statistics, using the observations 1:1 - 50:6
(missing values were skipped)


Variable	Mean	Median	S.D.	Min	Max
DR	0.663	0.711	0.317	0.00930	1.99
CLR	0.507	0.509	0.342	0.000600	1.99
LDR	0.153	0.00	0.249	0.00	0.978
Liquidity	3.00	0.585	8.11	0.00700	70.2
SOA	0.283	0.182	0.271	0.00	0.978
AVProf	0.0705	0.0390	0.148	-0.508	1.18
Growth	0.118	0.00	0.616	-1.00	1.99
GDP	0.0232	0.0217	0.00967	0.0111	0.0371
INFacioni	0.0198	0.0187	0.0135	0.00219	0.0449
INT	0.112	0.117	0.0157	0.0866	0.128
I_Size	17.6	17.6	1.43	13.3	20.8

Burimi: Analiza e të dhënave sekondare.

Nga tabela I-1 arrijmë të kuptojmë se raporti i borxhit total i njësive ekonomike paraqitet me një mesatare prej 66.3%, ku detyrimet korente zënë pjesën më të madhe 50.7%, ndërsa ato afatgjatë 15.3%. Likuiditeti paraqitet mesatarisht në nivele të larta, që do të thotë se njësitë ekonomike mbajnë para mesatarisht për të mbuluar të paktën 3 herë detyrimet e tyre korente. Struktura e aseteve tregon se njësitë ekonomike mbajnë 28.3% të aseteve të tyre totale si asete fikse.

Në figurën I-1 më poshtë janë paraqitur të dhëna përshkruese në lidhje me raportet e borxhit mes njësive ekonomike të studiuara ndër vite. Vihet se se mesatarisht ndër vite njësitë kanë preferuar borxhin më shumë se kapitalin, duke u financuar mbi 60% me borxh. Nga viti në vit vihet re një rënie në nivelin e borxhit të përdorur ku vendin kryesor e zë financimi me borxh afatshkurtër kundrejt atij afatgjatë. Përsa i përket këtyre të fundit mund të shihet qartë se njësitë e kanë rritur përdorimin e borxhit afatgjatë nga viti në vit duke reduktuar financimin me borxh afatshkurtër.


Figura I-1 Raportet mesatare të borxhit total, korent dhe afatgjatë ndër vite.



Burimi: Analizë e të dhënave sekondare.

Në figurën më poshtë janë paraqitur njësitë ekonomike të studiuara të shpërndara sipas llojit të aktivitetit që realizojnë. Kryesisht njësitë i përkasin sektorit të tregtisë, prodhimit dhe ndërtimit.

Figura I-2 Shpërndarja e njësive ekonomike të studiuara sipas llojit të aktivitetit.




Burimi: Analizë e të dhënave sekondare.

Grafiku më poshtë paraqet të dhëna të përpunuara në lidhje me raportet e borxhit total, korent dhe afatgjatë të ndarë sipas sektorëve. Njësitë tregtare dhe ato prodhuese financohen kryesisht me borxh mbi 60% dhe preferojnë

borxhin afatshkurtër, ndërsa ndërtimi është më i balancuar në përdorimin e borxhit dhe kapitalit, por sërish borxhi korent është më i preferuar.

Figura I-3 Raportet e borxhit sipas llojit të aktivitetit të njësive të studiuara.



Burimi: Analizë e të dhënave sekondare.

Analiza e modelit të regresionit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është analizimi i strukturës financiare të njësive ekonomike në qytetin e Shkodrës. Për këtë arsye studiohet lidhja mes karakteristikave të njësive dhe vendimit të tyre për strukturën e kapitalit. Për të realizuar këtë ndërtohen 3 modelet, ku variabla të varur janë raporti i borxhit total, borxhit korent dhe atij afatgjatë. Do realizojmë testin e multikolinearitetit dhe më pas do përdorim modelin ordinary least square (OLS), fixed ose random effects përmes programit Gretl. Do realizojmë testet për të kuptuar cilin model duhet të përdorim mes pooled OLS, fixed apo random për të vazhduar me trajtimin e të dhënave tona panel.

Testi i multikolineariteti

Ndërtojmë matricën e korrelacionit për të parë nëse nëpërmjet variablave të pavarura kemi probleme të multikolinearitetit.

Tabela I-2 Matrica e korrelacionit të variablave të pavarur.

Correlation coefficients, using the observations 1:1 - 50:6

(missing values were skipped)

5% critical value (two-tailed) = 0.1133 for n = 300

Liquidity	SOA	AVProf	Growth	GDP	
1.0000	-0.0428	0.2173	-0.0278	-0.0642	Liquidity
	1.0000	-0.1111	-0.0341	0.0341	SOA
		1.0000	0.0487	0.1348	AVProf
			1.0000	-0.0435	Growth
				1.0000	GDP
		INFacioni	INT	I_Size	
		-0.0504	-0.0628	-0.0270	Liquidity
		0.0237	0.0245	-0.0173	SOA
		0.1302	0.1309	-0.0407	AVProf
		-0.0701	-0.0266	0.0150	Growth
		0.9336	0.8064	-0.0929	GDP
		1.0000	0.7313	-0.0823	INFacioni
			1.0000	-0.0923	INT
				1.0000	I_Size

Burimi: Analizë e të dhënave sekondare

Koeficienti i korrelacionit merr shenjë pozitive ose negative duke treguar lidhjen mes dy variablave. Në momentin që kemi shenjë negative themi se ekziston lidhje negative mes dy variablave dhe nëse njëra rritet, tjetra do të pësojë rënie. Shenja pozitive e koeficientit tregon për ekzistencën e një lidhjeje pozitive mes variablave, ku rritja e njërës sjell rritje tek variabli tjetër. Fortësia e lidhjes varion sipas 3 intervaleve:

- 0% - 25%, lidhja konsiderohet e dobët;
- 25% - 75%, lidhja konsiderohet mesatare;
- 75% - 100%, lidhja konsiderohet e fortë.

Nga tabela shihet qartë se disa nga koeficientët e korrelacionit ndodhen jashtë intervalit [-0.7; +0.7], dhe siç pritej bëhet fjalë për GDP, inflacionin dhe interesin e kredidhënies. Këto variabla duhet të studiohen të veçuara nga njëra-tjetra në modelin e zgjedhur përndryshe do ndikojnë tek variabli i pavarur.

Një nga testet që përdoret kryesisht për të përcaktuar cilët variabla kanë multikolinearitet është Faktorët Influencues në Variancë (VIF).

Vlera mininale= 1.0

Vlerat > 10.0 mund të tregojnë probleme kolineariteti.

Tabela I-3: Testi VIF për kolinearitët

VIF	
Liquidity	1.063
SOA	1.024
AvProf	1.089
Growth	1.017
GDP	14.281
Inflac.	11.998
INT.	2.580
L_Size	1.013

Burimi: Analizë e të dhënave sekondare.

Nga testi VIF i realizuar vihet re qartë se GDP dhe inflacioni kanë probleme kolineariteti pasi paraqiten me vlera mbi 10, ndërsa interesi i kredihënies paraqitet i ulët që do të thotë nuk paraqet probleme dhe do të përfshihet në model.

Testi i zgjedhjes së modelit të regresionit

Nëpërmjet një modeli të thjeshtë pooled OLS realizohen testet për të zgjedhur mes tri modeleve, të vazhdohet me pooled OLS, fixed apo random effect. Përdoren 50 njësitë për të testuar dhe zgjedhur testin më të mirë.

Pooled OLS dhe Fixed effects

$F(49, 180) = 16.2424$ me p-value $9.51279e-045$

Një vlerë p e ulët hedh poshtë hipotezën nul që modeli pooled OLS është më i mirë, duke favorizuar modelin fixed effects.

Pooled OLS dhe Random effects

Breusch-Pagan test statistic:

LM = 233.58 me p-value = $\text{prob}(\text{chi-square}(1) > 233.58) = 9.87558e-053$

Një vlerë p e ulët hedh poshtë hipotezën nul që modeli pooled OLS është më i mirë, duke favorizuar modelin random effects.

Fixed dhe Random effects

Hausman test statistic:

H = 12.715 me p-value = $\text{prob}(\text{chi-square}(6) > 12.715) = 0.0477909$

Një vlerë p e ulët hedh poshtë hipotezën nul që modeli random effects është më i mirë, duke favorizuar modelin fixed effects. Në përfundim të testeve të realizuara arrijmë në konkluzionin se modeli më i mirë për trajtimin e të dhënave tona panel është modeli fixed effects ndaj ky model do të përdoret në vazhdim të studimit.

Tabela I-4: Rezultatet e modeleve të trajtuara.

Variablat varura	Modeli CLR		Modeli LDR		Modeli DR	
	Koef.	t	Koef.	t	Koef.	T
Konstante	0.427348	0.9655	0.00830339	0.02097	0.435578	1.240
Liquidity	-0.0111713	-6.445 ***	0.00511445	3.299 ***	-0.00605729	-4.403 ***
SOA	-0.295433	-3.353 ***	-0.0128799	-0.1634	-0.307300	-4.394 ***
AvProf	-0.677619	-5.457 ***	-0.152455	-1.373	-0.828596	-8.408 ***
Growth	-0.00267534	-0.1323	-0.00292248	-0.1615	-0.00539910	-0.3363
INT	4.24150	5.644 ***	-2.05303	-3.055 ***	2.16964	3.638 ***
l-Size	-0.0135332	-0.5802	0.0215525	1.033	0.00810600	0.4379
R^2	0.803886		0.720756		0.861863	

Burimi: Analiza e të dhënave sekondare.

Koeficienti i determinacionit R^2 tregon se 86.18% e variablit të varur, raporti i borxhit total, shpjegohet nga variablat e pavarur, më pak se 15% shpjegohet nga variabla të tjera. Rezultatet e testit F me 1% nivel rëndësie rezultojnë në vlerën $p=1.02e-53$. Këto të dhëna tregojnë se modeli është i përshtatshëm për të parashikuar koeficientin e variablave të pavarura. Variablat statistikisht domethënëse më nivel rëndësie 1% janë likuiditeti, struktura e asetëve, përfitueshmëria dhe interesi i kredidhënies, ndërsa rritja dhe madhësia paraqiten jostatistikisht domethënëse.

Koeficienti i determinacionit R^2 tregon se 80.38% e variablit të varur, raporti i borxhit korent shpjegohet nga variablat e pavarur, pothuajse 20% shpjegohet nga variabla të tjera. Rezultatet e testit F me 1% nivel rëndësie rezultojnë në vlerën $p=8.29e-41$. Këto të dhëna tregojnë se modeli është i përshtatshëm për të parashikuar koeficientin e variablave të pavarura. Variablat statistikisht domethënëse më nivel rëndësie 1% janë likuiditeti, struktura e asetëve, përfitueshmëria dhe intersi i kredidhënies, ndërsa rritja dhe madhësia paraqiten jostatistikisht domethënëse. Janë të njëjtat rezultate

si në rastin e borxhit total dhe është e pritshme, pasi shikuar se kryesisht njësitë ekonomike preferonin borxhin korent ndaj atij afatgjatë.

Koeficienti i determinacionit R^2 tregon se 72.07% e variablit të varur, raporti i borxhit afatgjatë shpjegohet nga variablat e pavarur, pothuajse 30% shpjegohet nga variabla të tjera. Rezultatet e testit F me 1% nivel rëndësie rezultojnë në vlerën $p=3.12e-28$. Këto të dhëna tregojnë se modeli është i përshtatshëm për të parashikuar koeficientin e variablave të pavarura. Variablat statistikisht domethënëse më nivel rëndësie 1% janë likuiditeti dhe interesi i kredihënies, ndërsa struktura e asetëve, përfitueshmëria, rritja dhe madhësia paraqiten jostatistikisht domethënëse. Shohim që krahasuar me dy modelet e tjera variablat, struktura e asetëve dhe përfitueshmëria nuk paraqiten sinjifikativ.

Tabela I-5: Tabelë përmbledhëse e lidhjeve sipas teorive dhe sipas studimit me modele.

	Teoria Trade - off	Teoria Pecking order	Modeli CLR	Modeli LDR	Modeli DT
Liquidity	+	-	-	+	-
SOA	+	+	-	-	-
AvProf.	+	-	-	-	-
Growth	-	+	-	-	-
Size	+	+	-	+	+
INT	+	-	+	-	+

Burimi: Përmbledhje e teorive dhe analizës praktike.

Nga matrica e korrelacionit rezultuan me lidhje të fortë më njëri-tjetrit faktorët makroekonomikë GDP, inflacioni dhe interesi i kredihënies. Në bazë të testit VIF ishte e dukshme që duhej të studiohej vetëm variabli interesi i kredihënies duke eliminuar 2 variablat e tjerë, pasi do të ndikonin në model. Më poshtë paraqiten gjetjet me konkluzionet përkatëse.

Konkluzione

Pranohet H01. Në të tri modelet lidhja me madhësinë nuk paraqitet statistikisht domethënëse, pra nuk ndikon në shpjegimin e raporteve respektive të borxhit. Teoritë supozonin se njësitë e mëdha ekonomike kishin nevojë për më shumë fonde për t'u financuar dhe kur burimet e

brendshme të mos mjaftonin do të drejtoheshin tek burimet e jashtme, pra borxhi. Madhësia mund të konsiderohet se ka lidhje pozitive duke qenë se firmat e mëdha janë më shumë të diversifikuara dhe kanë më pak mundësi dështimi krahasuar me ato të voglat. Si rrjedhojë do të jenë më tërheqëse për bankat për t'i dhënë borxh këtyre kompanive të mëdha ndaj me rritjen e madhësisë rritet edhe borxhi, pra lidhja është pozitive.

Pranohet H12. Në studimin tonë struktura e asetëve shfaqet me lidhje negative sinjifikative në modelin e borxhit korent dhe total, ndërsa në modelin afatgjatë nuk paraqitet sinjifikative lidhja. Kolaterali redukton kostot e agjencisë me huadhënësit duke qenë se këta të fundit janë më të sigurtë se në rast falimentimi mund të shesin kolateralin. Kolaterali redukton problemin e asimetrisë së informacionit ndaj edhe teoria pecking order tregon për lidhjen pozitive që ekziston.

Pranohet H13. Njësitë ekonomike të Shkodrës me rritjen e raporteve të kthimit nga asetet e zvogëlojnë raportin e borxhit korent dhe duke qenë se pjesa më e madhe e borxhit total e përbën borxhi korent si rrjedhojë zvogëlohet edhe borxhi total. Njësitë që fitojnë më shumë mbajnë këto fitime të pashpërndara duke preferuar financimin e brendshëm kundrejt atij të jashtëm me borxh. Edhe në modelin e borxhit afatgjatë vihet re se me rritjen e këtij raporti njësitë e zvogëlojnë financimin me borxh duke rritur kështu përdorimin e kapitalit për financim, kemi rritje të fitimit të pashpërndarë në periudha afatgjata, për këtë arsye shfaqet kjo lidhje.

Kjo për arsyen kryesore se burimet e brendshme konsiderohen më të lira dhe nuk janë subjekt i ndërhyrjeve nga jashtë. Borxhi i jashtëm shihet si më i lirë dhe me më pak kufizime sesa krijimi i kapitaleve të reja nga jashtë për financimin e kompanisë.

Pranohet H04. Në të tri modelet lidhja e rritjes me raportet e borxhit nuk paraqitet statistikisht domethënëse. Teoria pecking order parashikonte një lidhje pozitive mes rritjes së një njësie ekonomike dhe raporteve të saj të borxhit, por në studimin e realizuar vihet re se ato njësi që janë në rritje i zvogëlojnë raportet e tyre të borxhit duke u bazuar kryesisht në financimin me kapital. Njësitë që kanë mundësi rritjeje pritët që të jenë më pak të bazuara në financimin me borxh për shkak të asimetrisë së informacionit. Këto njësi janë më të rrezikshme ndaj huadhënësit e rrisin koston e borxhit për të përballuar riskun me të cilin përballen. Kjo sjell një preferencë më të paktë ndaj financimit me borxh.

Sipas teorisë pecking order ekziston një lidhje pozitive mes mundësive të kompanisë për rritje dhe përdorimit të levës financiare. Kompanitë me rritje relativisht të madhe do të fillojnë të kërkojnë burime të tjera financimi dhe

investimi duke u drejtuar fillimisht drejt borxhit afatshkurtër dhe më pas atij afatgjatë (Michaelas, 1999).

Sipas teorisë së kostove të agjencisë kompanitë me mundësi rritjeje duhet të përdorin më pak borxh për të zvogëluar problemet e agjencisë (Myers, 1977). Myers diskuton në lidhje me asimetrinë e informacionit duke supozuar se kompanitë me norma të larta të përdorimit të borxhit për financim mund të kenë tendencën që të realizojnë veprime në dëm të interesit të huadhënësve. Për t'u siguruar se kjo nuk do të ndodhë këta të fundit vendosin kushte duke kufizuar liritë e kompanisë si dhe rrisin koston e borxhit për të përballuar riskun me të cilin përballen. Për këto arsye kompanitë që kanë mundësi rritjeje pritjet që të jenë më pak të bazuara në financimin me borxh, pra një lidhje negative mes rritjes dhe levës financiare.

Pranohet H15: Në të tri modelet lidhja e likuiditetit me raportet e borxhit paraqitet statistikisht domethënëse. Tek njësitë e studiuara pjesa kryesore e borxhit total përbëhet nga borxhi korent dhe likuiditeti mat aftësinë e njësive për shlyerjen e detyrimeve korente ndaj lidhja është e pritshme që të jetë negative. Një njësi likuide në periudha afatshkurta nuk bazohet në financim me borxh, ka mjete të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e saj, përdorë burimet e brendshme, nuk drejtohet drejt borxhit. Ndërsa në periudha afatgjata njësitë e rrisin përdorimin e borxhit, nuk mjaftohen vetëm me burimet e brendshme të financimit.

Pranohet H17: Në të tri modelet lidhja e normës së interesit të kredihënies paraqitet statistikisht domethënëse, duke marrë shenjë pozitive për borxhin korent dhe total, ndërsa për atë afatgjatë merr shenjë negative. Teoria trade off parashikon lidhjen pozitive dhe në periudha afatshkurta njësitë do të rrisin nivelin e borxhit edhe nëse rriten interesat e kredive, pasi përfitojnë nga shpenzimet e zbritshme, që i njihen nga tatimet. Ndërsa në periudha afatgjata teoria pecking order parashikon lidhjen negative, pasi tani njësitë mundohen të shmangin problemet me falimentimin kur normat janë të larta.

Rekomandime

Vendimi i njësive ekonomike për mënyrën e financimit që duhet të ndjekin është një çështje mjaft delikate. Teoria pecking order paraqitet më dominuese në caktimin e strukturës së kapitalit për njësitë e studiuara të qytetit të Shkodrës. Në vendimin e njësive ndikojnë si faktorë të brendshëm edhe ato të jashtëm, ndaj të dy këto grupe janë studiuar në këtë punim. Në mbështetje të përfundimeve të arritura më lart nga trajtimi teorik dhe

analiza e të dhënave empirike është e nevojshme që të jepen disa rekomandime.

- Fillimisht besoj se është thelbësore që të gjendet një zgjidhje që të jenë të disponueshme të gjitha pasqyrat financiare të njësive ekonomike, në mënyrë që të interesuarit t'i shfrytëzojnë ato. Kjo mund të arrihet përmes kërkesës së QKB-së ndaj njësive ekonomike për hedhjen e informacionit të munguar.
- Njësitë ekonomike të Shkodrës mund të konsiderojnë burime alternative financuese si p. sh. leasing. Leasing është një burim që sjell shumë avantazhe, pasi njësive nuk i kërkohet që të paguajnë menjëherë tërë shumën, por në fund të një periudhe disavjeçare, gjithashtu njihet edhe shpenzimi i qirasë që kontribuon duke zvogëluar taksat. Paraqitet si një llogari jashtë bilancit ndaj nuk do të pengojë në financime shtesë nga institucionet financiare.
- Thelbësore është që të zhvillohen institucionet dhe tregjet financiare, tregjet e kapitalit në mënyrë që të ofrohet një varietet më i madh produktesh në një mjedis konkurrues, duke bërë të mundur minimizimin e informacionit asimetrik. Vetë mungesa e këtyre tregjeve ndikoi tek punimi, pasi ishte e detyrueshme përdorimi i vlerave të librit.
- Rekomandimi im lidhet me dhënien e një rëndësie më të madhe borxhit afatgjatë duke qenë se sjell një efekt të rëndësishëm në ekonominë e vendit duke ndihmuar në zhvillimin e saj. Duhet të motivohet përdorimi i borxhit afatgjatë duke ofruar më shumë lehtësira për ato njësi që guxojnë, kështu do të rritet ekonomia e vendit.

Kufizimet e studimit dhe nxitja e studimeve të mëtejshme.

Ky studim është ndër të parët e këtij lloji të realizuar për qytetin e Shkodrës, ndaj jemi munduar të marrim në studim njësi ekonomike të të gjitha llojeve të aktiviteteve. Kjo është bërë me qëllim për të përgjithësuar rezultatet e studimit. Gjatë punës janë hasur edhe vështirësi të cilat kanë të bëjnë me:

- U hasën vështirësi në gjatë procesit të grumbullimit të të dhënave.
- Mungesën e të dhënave për disa vite 2008 – 2010, sidomos 2009.
- Pamundësinë për të studiuar të gjithë faktorët e mundshëm që ndikojnë në model.
- Mungesën e tregjeve aktive duke mos pasur mundësi për përdorimin e vlerësimit të tregut.

Këto kufizime nuk kanë ndikuar në nxjerrjen e rezultateve të studimit. Madje ky studim mund të përdoret në të ardhmen për të krahasuar qytetin e Shkodrës me qytete të tjera të Shqipërisë e më gjerë.

Bibliografia

- Donaldson, C. (1961). Corporate debt capacity: A study of corporate debt policy and the determinants of corporate debt capacity. Boston: Division of research, University Harvard.
- <http://www.worldcat.org/title/corporate-debt-capacity-a-study-of-corporate-debt-policy-and-the-determination-of-corporate-debt-capacity/oclc/220579>
- Hans, D., Degoeij, P., & Kappert, P. (2009). The impact of firm and industry characteristics on small firm's capital structure: evidence from duch panel data.
- https://www.researchgate.net/publication/226913654_The_impact_of_firm_and_industry_characteristics_on_small_firms'_capital_structure
- Jensen, M. C., & Meckling, W. H. (1976). Theory of the firm: Managerial behaviour, agency costs and ownership structure. *Journal of Financial Economics* , 305–360. http://uclafinance.typepad.com/main/files/jensen_76.pdf
- Michaelas, N. F. (1999). Financial Policy and Capital Structure Choice in U.K. SMEs: Empirical Evidence from Company Panel Data. *Small business economics*.
- <https://link.springer.com/article/10.1023/A:1008010724051>
- Myers, S. C. (1977). “The determinants of corporate borrowing”. *Journal of Financial Economics* , 147-175.
- <http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/0304405X77900150>
- Myers, S. C., & Majluf, N. (1984). Corporate financing and investment decision when firms have information that investors do not have. *Journal of Financial Economics* , 187–221.
- <https://pdfs.semanticscholar.org/77de/0d5a47ff0ccbff22255155f1009265af270c.pdf>
- Titman, S., & Wessels, R. (1988). The Determinants of Capital Structure Choice. *Journal of Finance* .
- <http://epge.fgv.br/we/MD/FinancasCorporativas/2006?action=AttachFile&do=get&target=titmanwessels.pdf>

Faqet e internetit:

1. Banka Botërore, Norma e rritjes së GDP

<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG?locations=AL>

2. Banka Botërore, Norma e inflacionit

<http://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.DEFL.KD.ZG?locations=AL>

3. Banka Botërore, Norma e interesit të kredihënies

<http://data.worldbank.org/indicator/FR.INR.LEND?locations=AL>

PORTOFOLI MODEL I EKONOMISË SHQIPTARE “AL INDEX - 100”

Ilijana Gjergji⁵⁵

Financiere në “Ej & Bi Telecom”, Shkodër

Abstrakt

Rëndësia e punimit qëndron në vlefshmërinë e studimit dhe gjetjes së një portofoli model tregu për ekonominë shqiptare, si një temë pak e lëvruar nga studiuesit shqiptarë. Ky studim synon të nxisë institucionet përkatëse për ingranimin e tregut financiar në përngjasim të tregjeve financiare botërore duke nxitur bizneset për një listim masiv në bursë.

Burimi kryesor i të dhënave është QKB-ja, pasi aty janë të deklaruar informacionet kontabël në periudha të ndryshme kohore. Në këtë punim, i cili u finalizua me 100 firma të përfshira, të cilat krijuan “AL Index-100”, paraqitet një tentativë për krijimin e një Portofoli- Index për ekonominë shqiptare. Parametrat e këtij portofoli rezultuan të ngjashme me indekset botërore. Kufizim i këtij punimi është fakti që në ndërtimin e portofolit si kthim firme, më i fundit (ROE) është marrë viti 2015, referuar legjislacionit dhe kohës kur prezantohet ky punim.

Gjithashtu nëpërmjet implementimit të këtij portofoli tregu dhe me gjithë avantazhet që sjell ai të bëhet e mundur që aplikimet e ndryshme financiare të transmetuara me shumë përkushtim nga pedagogët tanë, ne si studentë sot, të kemi mundësinë t’i aplikojmë realisht për vendin tonë në një të nesërme të afërt si financierë të vërtetë.

⁵⁵ Ilijana Gjergji MSC – Lindi në vitin 1993 në Shkodër. Në korrik të vitit 2014 u diplomua në Bachelor Financë Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Nga muaji prill, 2015 e në vazhdim është e punësuar si financiere në “Ej & Bi Telecom”, një firmë private në qytetin e Shkodrës. Gjithashtu ka eksperiencë si ekonomiste dhe konsulente financiare në biznese të vogla e të mesme. Në nëntor të vitit 2015 filloi studimet në Ciklin e Dytë të Studimeve dhe në korrik të vitit 2017 mori titullin Master i Shkencave në Financë po në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Njëkohësisht gjatë periudhës 01 prill 2016 – 30 korrik 2017 ka qenë e angazhuar me “Institutin për kërkime shkencore dhe zhvillim” Ulqin- Montenegro, në cilësinë e bashkëpunëtores profesionale për fushën ekonomike dhe pjesëmarrësit vullnetarë në redaktimin e punimeve shkencore të autorëve nga fushat e ndryshme të studimit, të konferencave shkencore të mbajtura në vitin 2016 dhe 2017.

Fjalët kyçe: Portofol tregu, aktivitet ekonomik, diversifikim, performancë portofoli, risk portofoli, bursë.

Model portofolio of Albanian Economy “Al Index-100”

Abstract

The importance of the work lies in the validity of the study and the finding of a model portfolio for the Albanian economy, as a topic for which there are few or no concluded studies by albanian academics. This paper aims to encourage the respective institutions for the promotion of the financial market similar to the global financial markets by encouraging businesses for a massive listing in the stock market.

The main source of data is National Business Center, as there are published all the financial statements for different periods of time. In this paper, which was finalized with 100 involved companies, founders of “AL Index-100”, is represented an attempt for the creation of an Index-Portfolio for the Albanian economy. The parameters of this portfolio resulted similar with the global indexes. Constraint of this paper is the fact that in the portfolio building as the latest firm return (ROE) is taken the year 2015, referring to the legislation and the time when this paper is presented.

Furthermore, through the implementation of this market portfolio and with all the advantages that brings to be enabled that different financial applications transmitted with dedication from our professors, we as students today, to have the opportunity to truly apply for our country in the near future as real accountants.

Key words: Market portfolio, economic activity, diversification, portfolio performance, portfolio risk, stock.

1. Hyrje

Kur krahasohen portofolet e investitorëve me portofolin e tregut, asetet e përfshira në portofol janë të listuara në një prej bursave ndërkombëtare. Aktualisht bursa e Tiranës nuk ka funksion aktiv. Por së fundmi Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licencoi më datë 3 korrik 2017 shoqërinë “Bursa shqiptare e titujve, ALSE” sh.a., (Albanian Stock Exchange) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend. Bursa e parë private shqiptare do të hapë dyert për publikun këtë vjeshtë. Në vitin e parë të aktivitetit, bursa do të përqendrohet kryesisht në tregtimin e titujve

qeveritarë, ndërkohë që pritet të licencohet edhe regjistri i titujve dhe të përgatitet gjithë infrastruktura e nevojshme për të mundësuar tregtimin e titujve të kompanive private. Prandaj në këtë studim i kam marrë të dhënat nga pasqyrat financiare të deklaruara në QKB, në pamundësi për të marrë çmimet e tregut të titujve. Me këto zhvillime të reja sa interesant dhe i realizueshem është ndërtimi i një portofoli index për ekonominë shqiptare?

Ky portofol mund të shërbejë si model, për investitorët në vendin tonë, se si të investojnë në Shqipëri. Duke ditur avantazhet e portofolit të tregut, nisur nga tregjet botërore, një portofol i tillë për vendin tonë shihet si një domosdoshmëri. Gjithashtu reduktohet edhe koha e investimit, shpenzimet e krijimit të portofolit individual për një investitor që dëshiron t'i marrë të gatshme nga tregu me bindjen se është modeli më i mirë i diversifikueshëm.

Ky studim kërkimor do të shtojë vlerat në fushën e dijes, si dhe do t'iu shërbejë studentëve dhe analistëve për të kontribuar në procesin e tyre të studimit. Do të zgjojë bindjen të sipërmarrësit që listimi në bursë do të krijojë mundësi të reja financimi, investimi e krahasimi. Firmat do të jenë në gjendje të dinë nëse kthimet e portofoleve të tyre janë më të mira se tregu apo nën nivelin e tregut dhe të marrin masat e duhura për t'u përmirësuar.

Pyetja kërkimore - Punimi synon që të ndërtojë një model portofoli tregu për ekonominë shqiptare. Pas ndërtimit të tij ky punim do t'u japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

- Në përngjasim të indekseve botërore a mund të ndërtohet një portofol-indeks për ekonominë shqiptare që të mund të shërbejë si një barometër i tregut?
- A gjenden në ekonominë shqiptare tituj të korreluar perfekt negativisht?

Qëllimi i punimit - është që të ndërtojë portofolin e tregut të titulluar: "AL Index-100" i cili do të shërbejë si një barometër për ekonominë shqiptare. Gjatë punimit do të studioj parametrat e një portofoli dhe të tregoj për secilin a është brenda intervaleve të duhura.

2. Rishikimi i literaturës

Përfitimi dhe risku i kompanive shikohet në shumë dimensionë dhe profile dhe është i pashkëputur nga struktura financiare. Studiuesit përdorin mënyra të larmishme, ndër të cilat janë disa tregues financiarë të gjeneruar nga të dhënat me natyrë kontabël, të tillë si: kthimi nga kapitali i vet, fitimi për aksion, marzhi i fitimit operativ, shkalla e levës financiare, kthimi nga aktivet, kthimi nga investimet etj.

Një tregues domethënës për të përcaktuar normën e skontimit të aksioneve të një kompanie është treguesi financiar ROE, (Velez-Pareja, 2000), me formulën:

Formula 1:
$$ROE = \frac{EAN}{\text{Kapital Aksioner}}$$

Gjithashtu është vërtetuar që ekziston një lidhje e qëndrueshme dhe e rëndësishme statistikore e treguesit ROE me normën e skontimit të aksioneve për kompanitë e listuara në bursë (Hevert, 2014). Vlerësimi i përfitueshmërisë së aksioneve të listuara në bursë që bëhet sipas modelit të vlerësimit të çmimit të mjetit kapital (CAPM), njihet edhe me termin vlerësimi në kushte eficientë tregu, nga ku titulli financiar pozicionohet sipas lidhjes risk-kthim (Traynor, 1961; Sharpe, 1964 dhe Lintner, 1965).

Aplikimi i modelit CAPM në vende që nuk kanë tregje kapitali ose i kanë jolikuid siç është rasti i Shqipërisë, është i pamundur. Përpara financierëve në Shqipëri shtrohet pyetja se çfarë modeli të përdorin?

Hevert (2014), pohon se se një tregues i mirë i vlerësimit të normës së skontimit të aksioneve të një kompanie, në mungesë të vlerësimit CAPM është raporti ROE. Për më tepër shumë konsulentë financiarë të vendeve me tregje financiare të zhvilluara, për të bërë vlerësime që përftohen nga modeli CAPM i referohen fillimisht raportit ROE si një mënyrë komode dhe e përafuar vlerësimi (Graham dhe Harvey, 2001). Referuar studiuësve të mësipërm si kthim të një firme në punimin tim kam përdorur raportin ROE, si treguesin më domethënës për të vlerësuar aktualisht kthimin e një firme rezidente në Shqipëri.

Portofoli i tregut ka pasur gjithashtu një ndikim të madh në teorinë dhe praktikën e menaxhimit të investimeve siç shpjegohet nga Dimson dhe Mussavian (1999). Ata pohojnë se tani është e zakonshme për të parë një portofol të menaxhuar në përngjasim të portofolit të tregut (siç është rasti i indeksit S&P 500) duke ndjekur kështu rrjedhimisht strategjinë pasive të investimit. Roll (1977) thekson se portofoli i tregut i përcaktuar në CAPM teorike, është një indeks i shumë asetëve dhe klasave njëherësh. Të njëjtin veprim mund të bëjnë edhe investitorët individualë dhe institucionalë në Shqipëri: Në qoftë se nuk kanë kohën, buxhetin apo background-in e duhur financiar, por nga ana tjetër, duan të përfitojnë nga lëvizjet e tregut dhe të arrijnë pak a shumë një kthim të sigurt, thjesht mund të ndjekin tregun me anë të strategjisë pasive.

3. Ndërtimi i portofolit të tregut

Sipas publikimeve të Instat për vitin 2015 bazuar në Rregjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve rezulton se 152 288 është numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2015 krahasuar me 112 537 ndërmarrje aktive gjatë vitit 2014. Në kushtet e mungesës së një tregu financiar, paraqitet e vështirë çështja e ndërtimit të një portofoli për ndërmarrjet shqiptare. Përpara ndërtimit të tij na shtrohen këto çështje:


- Çfarë karakteristikash individuale duhet të plotësojë secili titull për t'u përfshirë në portofolin e tregut për Shqipërinë?
- Si duhet t'i përzgjedh titujt dhe si duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit?
- Sa duhet të jetë numri i titujve të ndryshëm që duhet të përfshihen në portofol?

Përshkrimet kryesore nga RSN-ja shërbejnë si një tablo ku unë duhet të fokusohem për punimin tim, sepse portofoli i ndërtuar i tregut duhet të jetë përfaqësues i ekonomisë shqiptare.

S&P 500 është një indeks i formuar nga 500 firma të kuotura të ekonomisë amerikane. Indeksi i tregut belg përfaqësohet nga 200 tituj të kuotuar. Në përngjasim të tyre do të ndërtohet edhe indeksi për ekonominë shqiptare që të mund të shërbejë si një barometër i tregut. **Për indeksin shqiptar kam vendosur të përfshij 100 tituj dhe ky do të quhet: "AL Index-100".**

Në publikimin e Instat paraqiten ndërmarrjet aktive sipas ndarjes 2 shifrore të aktivitetit ekonomik, të kategorizuara në 99 grupime. Për ndërtimin e portofolit kam përdorur 60 grupimet më përfaqësuese. Kriteret që kam zgjedhur që një firmë të përfshihet në portofolin e tregut janë të ilustruara nëpërmjet figurës së mëposhtme:

Figurë 1- Kriteret për t'u përfshirë në portofolin e tregut.



Burimi: Ilustrim nga autori.

Skema e mësipërme i përgjigjet çështjes së parë, se çfarë karakteristikash duhet të përfshijë secili titull për t'u përfshirë në portofolin e tregut.

3.1 Prezantim i Portofolit AL Index-100

S&P 500 është një indeks i cili përfshin sektorë të ndryshëm në përbërjen e tij. Sektorët janë të përcaktuar sipas GISC (Global Industry Standart Classification). Një kusht i rëndësishëm për ndërtimin e portofolit të duhur është të krijojmë një portofol gjithëpërfshirës.

Fjala diversifikim ka kuptimin e një vullneti të mirë praktik. Një grumbull titujsh të bashkuar përbëjnë një fuqi më të madhe dhe më rezistente ndaj risqeve sesa një titull i vetëm. Diversifikimi quhet efikas kur reduktimi i riskut arrihet në masën maksimale të mundshme ose edhe mund të reduktohet tërësisht për një nivel të dhënë të kthimit të shpresuar⁵⁶.

Duke u nisur nga shprehja e njohur “*Mos i vendos të gjitha vezët në një shportë*”, do të përdoret diversifikimi, i cili do të na ndihmojë të harmonizojmë nivelin e riskut dhe kthimit që do të mbartë portofoli i tregut. Diversifikimi është një strategji e cila shërben për të ulur ekspozimin ndaj riskut, duke kombinuar lloje të ndryshme investimesh, të cilat ecin në drejtime të ndryshme. Dimensionet e diversifikimit që do të pasqyroj në studim përfshijnë:

3.2 Diversifikimi sektorial

Objektivi kryesor i këtij diversifikimi është reduktimi i riskut makroekonomik të portofolit. Duke u nisur nga fakti që sektorë të ndryshëm kanë reagime të ndryshme përsa i përket kthimit dhe riskut, një diversifikim i tillë rrit qëndrueshmërinë e portofolit. Një portofol i kompozuar sipas këtij modeli na jep mundësinë e një rezultati të riskut specifik më të ulët se shumica e risqeve specifike individuale të titujve që formojnë atë, sepse kemi të bëjmë me firma të cilat janë me prejardhje nga sektorë të ndryshëm, me madhësi të ndryshme, me diferenca në fazat e ciklit të jetës së ndërmarrjes, me kthime të ndryshme, me efekt të levës të ndryshme, me aksionerë, menaxherë e prespektiva të ndryshme.

Fitimet nga tregtia janë të bazuara në avantazhin krahasues, i cili konsiston në krahasimin e kostove oportune të dy prodhuesve të një malli. Në qoftë se prodhuesi X, për prodhimin e të mirës Y ka kosto oportune më të ulët në krahasim me të tjerët, themi se ky prodhues ka avantazh krahasues në prodhimin e të mirës Y. Gjithashtu kur secili person i specializuar prodhon të mirën, për të cilën ai ose ajo ka një avantazh

⁵⁶ Bundo Sh. 2016, *Teoria dhe drejtimi i portofolit*, 4^o. Tiranë, albPAPER, 236.

krahasues, do të ketë një rritje të prodhimit të përgjithshëm në ekonomi⁵⁷. Nisur nga ky ligj i pranuar nga mikroekonomia, kam kryer përzgjedhjen e firmave sipas aktivitetit ekonomik të ndarë në 60 grupime. Për një diversifikim më efikas në portofol kam përfshirë firma me karakteristikat e mëposhtme:

Firma me faza të ndryshme të ciklit të jetës, duke ditur avantazhet dhe pritshmëritë e secilës faze, **firma nga sektorë të ndryshëm sepse pritet që të kenë edhe kthime të ndryshme**. Kombinimi i firmave me **leva financiare të ndryshme** sugjerohet nga studiuesit financiarë si një mjet efikas diversifikimi. Përveç këtyre, nëse përfshijmë firma, të cilat kanë **aksionerë dhe menaxherë të ndryshëm** që vijnë nga vende dhe kultura të ndryshme, do të sjellin risi në menaxhim dhe në strategjitë e firmës.

Në tabelën e mëposhtme ilustron përbërja e portofolit sipas diversifikimit sektorial. Peshën më të madhe e ka industria përpunuese me 20%, që pasohet më pas nga aktivitetet financiare me 15%, telekomunikacioni dhe nxjerrja e naftës dhe aktivitetet minerale me nga 10%.

Tabela 1- Përbërja e portofolit sipas diversifikimit sektorial

Nr.	Emërtimi i sektorit	Pesha
1	Prodhimi bimor, shtazor, pyjet	5%
2	Nxjerrja e naftës dhe aktivitetet minerale	10%
3	Industria përpunuese	20%
4	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	4%
5	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	1%
6	Ndërtimi dhe aktivitetet arkitekturore	6%
7	Tregtia me shumicë dhe pakicë	8%
8	Transporti tokësor, ujqor, ajror dhe aktivitetet mbështetëse & posta	6%
9	Akomodimi, shërbim ushqimi dhe pije	5%
10	Telekomunikacioni	10%
11	Aktivitetet financiare	15%
12	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	1%
13	Arsimi	1%
14	Kujdesi shëndetësor	4%
15	Aktivitete krijuese, arti, lojëra fati	5%
	Totali	100%

Burimi: Llogaritje të autorit.

⁵⁷ Kraja Y., Cikël leksionesh, Mikroekonomia, f. 35.

3.3 Diversifikimi gjeografik

Përgjithësisht përdoret për diversifikimin ndërkombëtar, por në këtë punim do të përdoret për diversifikimin rajonal për Republikën e Shqipërisë. Firmat e zgjedhura në portofol duhet të përfaqësojnë edhe gjeografikisht ekonominë e vendit.

Tirana zë përqindjen më të madhe 48%, e ndjekur pastaj nga Durrësi me 9%, Shkodra 5%, Saranda 4% etj. Në pamje të parë duket sikurse portofoli ka të vendosur pothuajse 50% të madhësisë së tij në Tiranë, por 12 prej këtyre firmave kanë shtrirje kombëtare, siç janë: Albtelecom, OSHEE, Banka Kombëtare Tregtare, Digitalb, Sigal Uniq Group Austria, Fondi Besa, Posta Shqiptare, Turgut Ozal Education, Lc Waikiki Retail Al Sh.p.k, Kastrati Sh.A., Plus Communication, Raiffeisen Bank Sh.A. Në regjistrin statistikor të ndërmarrjeve për vitin 2015, nga 152 288 biznese aktive për gjithë Shqipërinë, 54 237 i përkasin Tiranës, domethënë 35.6% kundrejt totalit⁵⁸. Edhe në portofolin e zgjedhur është zgjedhur afërsisht kjo peshë, konkretisht 36%.

3.4 Madhësia e portofolit dhe diversifikimi

Referuar librit “Teoria dhe drejtimi i portofolit”, Sherif Bundo (2016) do të ilustrojë në vijim llogaritjen e madhësisë së portofolit në bazë të diversifikimit. Varianca e përqindjeve të kthimit të një portofoli Pf të kompozuar me N tituj, që kanë peshë të barabartë në strukturën e portofolit, shprehet me ekuacionin vijues.

Formula 2:

VAR është varianca mesatare e përqindjeve të kthimeve të N titujve, dhe COV është mesatarja e kovariancës që ekziston ndërmjet tyre.

Kur numri i titujve shkon drejt infinitit, varianca e portofolit tenton drejt kovariancës mesatare, që përbën kufirin limit të diversifikimit. Nëpërmjet shembullit të mëposhtëm do të ilustroj nëse numri 100 simbolizon madhësinë e përshtatshme të portofolit që do të krijohet për parashikimin e ekonomisë shqiptare. Sipas llogaritjeve kemi që:

⁵⁸ Publikim i Instatit “Regjistri i ndërmarrjeve 2015”, f. 26.

Tabela 2- Vlerat e parametrave

Specifikimi	Vlera
Korrelacioni mesatar	0,0579
Varianca e tregut	0,0079
Devijimi standard i tregut	0,0889
Varianca mesatare e kthimeve të titujve individualë	0,8816
Devijimi standard mesatar i kthimeve të titujve individualë	0,9389

Burimi: Llogaritje të autorit

Me këto parametra të llogaritur gjejmë kovariancën mesatare me formulën e mëposhtme:

Formula 3:
$$= 0.9389 \times 0.9389 \times 0.0579 = 0.051$$

Tabela 0- Ecuria e devijimit standard dhe variancës së kthimeve të portofolëve.

Portofoli me N tituj	Varianca	Indeksi %	Devijimi standard	Indeksi %
1	0,9326	100	0,9657	100
2	0,4663	50,0000	0,6829	70,7107
3	0,3279	35,1562	0,5726	59,2927
10	0,1341	14,3749	0,3661	37,9142
20	0,0925	9,9217	0,3042	31,4988
30	0,0787	8,4373	0,2805	29,0471
40	0,0718	7,6952	0,2679	27,7401
50	0,0676	7,2498	0,2600	26,9255
60	0,0648	6,9530	0,2546	26,3685
70	0,0629	6,7409	0,2507	25,9633
80	0,0614	6,5819	0,2478	25,6552
90	0,0602	6,4582	0,2454	25,4129
100	0,0593	6,3592	0,2435	25,2175

Burimi: Llogaritje të autorit.

Nga rezultatet e tabelës së mësipërme vërejmë që sa më shumë rritet numri i titujve në portofol, aq më shumë ulet varianca. Siç edhe shihet diversifikimi i prodhon shumë shpejt efektet e tij. Kështu nga një portofol me 1 titull, në krahasim me një portofol me 3 tituj varianca ka rënë me

35%. Ndërsa kur kalojmë nga portofoli me 10, 20 e me radhë, varianca bie me një përqindje më të ulët. Prandaj është marrë numri 100 i firmave që do ta përbëjnë portofolin, sepse në këtë pikë pak a shumë është arritur maksimumi i diversifikimit. Edhe në qoftë se shtohen tituj të tjerë në portofol nuk do të ketë përfitim të vlefshëm të diversifikimit. Referuar përkufizimit kur numri i titujve shkon drejt infinitit, varianca e portofolit tenton drejt kovariancës mesatare, në rastin tonë kemi që varianca e portofolit 0.0593 me 100 tituj po tenton drejt kovariancës mesatare konkretisht 0.051.

Në tregun shqiptar të kompozuar nga 100 tituj, indeksi i variancës kalon nga 100% në 6.36% afërsisht. Ky rezultat do të thotë që niveli prej 93.64% i riskut të portofolit mund të reduktohet nëpërmjet diversifikimit, ndërsa niveli 6.36% përbën riskun sistematik të tregut shqiptar, të pamënjueshëm prej diversifikimit për shkak të kovariancës së lartë të titujve midis tyre brenda një ekonomie. Risku specifik i portofolit është 93.64% i cili mund të reduktohet nëpërmjet diversifikimit efikas. Ndërkohë për të reduktuar nivelin 6.36% duhet të përfshijmë diversifikimin ndërkombëtar.

3.5 Kthimi i portofolit

Kthimi i portofolit është mesatarja aritmetike e ponderuar e kthimeve individuale të çdo titulli që përfshihet në të, përgjatë periudhës t^{59} . Ponderimi është në bazë të peshës specifike të çdo titulli të investuar në portofol. Formula e llogaritjes së kthimit mesatar jepet më poshtë:

Formula 4:

N përfaqëson, numrin e titujve në portofol, W_i përfaqëson peshën specifike të çdo titulli, ndërsa $R_{pf, t}$ përfaqëson kthimin individual të çdo titulli.

Portofoli i zgjedhur i tregut përbëhet nga 100 tituj, që do të thotë që kthimi i këtij portofoli është mesatarja aritmetike e ponderuar e 100 titujve. Për secilin titull kam llogaritur kthimin mesatar (ROE) për periudhën 2011-2015, dhe pastaj kjo vlerë është shumëzuar me peshën specifike dhe sipas rezultatit kemi që:

Kthimi mesatar Al Index- 100 është 25.26%.

⁵⁹ Bundo Sh. 2016, *Teoria dhe drejtimi i portofolit*, 4^o. Tiranë, albPAPER, 100.

3.6 Varianca e portofolit

Risku i portofolit ka të bëjë me mundësinë e vlerave që marrin kthimet e portofolit në momente të ndryshme, por që ndikohen edhe nga faktorë të tjerë.

Varianca e portofolit varet nga karakteristikat individuale të titujve me të cilët përbëhet portofoli, ku përfshihen pesha specifike w , varianca individuale σ_i^2 dhe kthimi individual R_i . Faktorë të tjerë të rëndësishëm janë niveli i korrelimit ndërmjet titujve dhe numri i titujve me të cilët kompozohet portofoli. Formula e variancës së portofolit është:

Formula 5:

$$\sigma_{pf}^2 = \sum_{i=1}^N \sum$$

Duke zbatuar formulën e mësipërme, varianca e portofolit AL Index-100 është 0.0079. Me anën e rrënjës katrore gjejmë që devijimi standard i portofolit është 0.889.

3.7 Beta e titujve dhe e portofolit AL Index 100

Studiuesit kanë pranuar përgjithësisht modelin që për të analizuar dhe parashikuar kthimin e një titulli, mjafton që të analizojmë vetë tregun, meqenëse lëvizjet e kthimeve të titujve ndjekin pak a shumë tendencat e tregut. P.sh. koeficienti Beta shërben për të kuptuar luhatjet e titujve në treg të imponuar nga luhatjet e tregut. Ky koeficient shpreh raportin midis kovariancës së përqindjes së kthimit të një titulli me atë të indeksit të tregut dhe variancës së përqindjeve të kthimit të tregut, nëpërmjet formulës së mëposhtme:

Formula 6:

$$P.sh.: \beta_{ALBTELECOM} = \quad = \quad = 1.06$$

Varianca e tregut është 0.0079, ndërsa kovarianca e përqindjes së kthimit të firmës Albtelecom me atë të indeksit të tregut është 0.0084. Nga formula $\beta = 1.06$, do të thotë që nëse tregu rritet me 10%, kthimet e Albtelecom do të rriten me 10.6%.

Një përkufizim i Vasicek në vitin 1983 pohon që koeficienti Beta përbën karakteristikën unike më të rëndësishme të çdo aksioni ose portofoli. Sa më i mirëdiversifikuar të jetë një portofol, aq më shumë beta e tij do t'i afrohet njëshit. Beta e tregut është e barabartë me 1, duke qenë se kovarianca e një asemi me vetveten është e barabartë me variancën e tij. Duke shtuar një numër të madh asetesh në një portofol, mund të përfitojmë nga reduktimi i riskut total të portofolit. Ndaj, një ndër kriteret që portofoli i zgjedhur të shërbejë si një model portofoli indeksi për ekonominë

shqiptare, duhet që beta e tij të shkojë afër njëshit. Formula e betës së portofolit jepet më poshtë:

$$\text{Formula 7: } (\beta_{pf}) = \sum_{i=1}^N W_i \times b_i$$

N përfaqëson, numrin e titujve në portofol, w_i përfaqëson peshën specifike të çdo titulli, ndërsa b_i përfaqëson betën individuale të çdo titulli. Me formulën e mësipërme, llogarisim betën e portofolit, dhe sipas rezultatit kemi që:

β e portofolit AL Index 100 = 0.999, është një tregues i mirë sepse i përafrohet β të tregut të barabartë me 1.

3.8 Korrelacioni i firmave përbërëse të AL Index- 100

Analiza e regresionit përdoret për të matur fortësinë e dy variablave ndërmjet tyre. Në këtë studim do të përdoret për të analizuar tendencën e përqindjeve të kthimeve të titujve të zgjedhur. Koeficienti i korrelacionit merr vlera midis -1 dhe 1. Rasti ekstrem kur korrelacioni midis dy titujve është perfekt pozitiv, njihet si rasti kur diversifikimi nuk shërben për asgjë. Ndaj çështje e rëndësishme është të përfshihen në portofol tituj me korrelacion negativ. Por a gjenden në ekonomi të ndryshme tituj të korreluar negativisht, apo akoma më mirë perfekt negativisht? Tituj të tillë reduktojnë totalisht riskun e portofolit, por masa e tyre është e pakët.

Në portofolin e ndërtuar me 100 tituj, gjenden $n^2-n/2 = 4950$ korrelacione dhe kovarianca. Rezultatet gjenden të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3- Rezultatet përmbledhëse të korrelacionit ndërmjet firmave.

Përshkrimi	Numri
Firma me korrelacion > 0	2555
Firma me korrelacion < 0	2395
Firma me korrelacion < -0.5	1037
Firma me korrelacion < -0.75	397
Firma me korrelacion < -0.98	16
Firma me korrelacion < -0.99	6

Burimi: Llogaritje të autorit

Në portofolin e zgjedhur ekzistojnë 16 kombinacione dyshe të firmave me korrelacion negativ të nivelit më të ulët se -0.98, si p.sh. Albtelecom me Regjistrin Detar Shqiptar (-0.9827), Kastrati sh.a. me Digitalb (-0.9807), Geraldina Sposa me Ujësjellës Tirana (-0.9845) etj. Gjashtë prej këtyre janë me koeficient korrelacioni më të ulët se -0.99, ku

përfshihen 1. Ajsli 2011 me Ballej (-0.9917), 2. Alena Alb me Eko Vepra (-0.9924), 3. Stofrat e Holla me Kastrati sh.a. (-0.9933), 4. T a i w a n me Aeroportin “Nënë Tereza” (0.9941), 5. LC Waikiki me Alena Alb (-0.9946), 6. X.T. Designer me Eko Vepra (-0.9946). Ky grupim i përket korrelacionit perfekt negativ. Për rrjedhojë përqindjet e kthimeve të këtij grupimi do të ndryshojnë në të njëjtën kohë në drejtime të kundërta.

4. Konkluzione

Në përfundim të punimit tim, kam arritur në këto konkluzione:

- ✓ Në kushtet aktuale të Shqipërisë u arrit të krijohej një portofol-index që mund të shërbejë si një barometër tregu. Kjo tentativë u finalizua me 100 firma të përfshira në një portofol - indeks të quajtur “AL Index-100”. Ky portofol u ndërtua në bazë të të dhënave të siguruara nga informacioni kontabël. Bursa ALSE fillon veprimtarinë e saj tani në vjeshtën e 2017-ës, ku mendohet të realizohen deri në 100 000 transaksione në ditë. Me konsolidimin e kësaj burse do të kishim mundësinë të merrnim vlerësime tregu për çmimet e aksioneve sikurse indekset e huaja.
- ✓ Kthimi mesatar AL Index- 100 është 25.26%. Kthimi mesatar i S&P 500 është 11.96% i llogaritur me 31 dhjetor 2016. Kthimet më të larta ky index i ka pasur në vitin 1995 dhe 2013, përkatësisht me 37.58% dhe 32.39%. Nga kjo konkludojmë që portofoli i tregut shqiptar ka një vlerë kthimi që përfshihet brenda kthimeve mesatare të indeksit të tregut amerikan.
- ✓ Varianca e portofolit AL Index-100 është 0.79%, ndërsa devijimi standard i portofolit është 8.89%, ndërkohë që tregu belg me 200 aksione për 2012 ka variancë 2.25% dhe devijim standard 15%. Në qoftë se i referohemi sjelljes historike të kthimeve, për periudhën 1959-2015, tregu anglez i aksioneve ka dhënë kthim nominal për 9.22% në vit, me devijim standard 18.08%. Tregu francez ka dhënë kthim nominal të aksioneve 8.98% me devijim standard 18.01%, ndërkohë tregu botëror i aksioneve (World Index) ka dhënë kthim nominal 8.02% me devijim standard 17.95%. Rezultatet janë të të njëjtit rend me ato të regjistruara në SHBA. (Burimi: *Morgan Stanley Capital International, 2015*)⁶⁰. Nga vlerat shihet që portofoli i tregut shqiptar për periudhën 2011-2015 ka dhënë një kthim 25.26% me devijim standard 8.89%.

⁶⁰ Bundo Sh. 2016, *Teoria dhe drejtimi i portofolit*, 4 °. Tiranë, albPAPER, 107.

- ✓ Një nga pyetjet kërkimore të punimit është: A mund të gjenden në ekonominë shqiptare tituj të korreluar perfekt negativ? Titujt me korrelacion në intervalin ose afër tij (-0.98;-1) kanë lidhje perfekte midis tyre. Gjithashtu thuhet se titujt janë shumë të lidhur ndërmjet tyre, nëse katrori i koeficientit të korrelacionit, që është koeficienti i determinacionit është më shumë se 75%. Nga llogaritjet kemi që titujt me një $\rho < -0.87$, kanë një koeficient determinacioni më të madh se 75%. Në portofolin AL Index-100 gjenden 156 kombinacione dyshe që kanë një $\rho < -0.87$. Për t'i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore në ekonominë shqiptare sipas analizave të mia nuk u gjendën tituj me $\rho = -1$, por u gjendën 6 kombinacione dyshe afër -1, konkretisht me $\rho < -0.99$.

5. Rekomandime

- ✓ Bizneset shqiptare të ndërgjegjësohen për listimin në bursë, si një mënyrë eficiente për të përfituar financime nga jashtë. Një rekomandim i imi do të ishte që sipërmarrësit të punësojnë financiarë dhe punonjësit e tjerë në sajë të kualifikimit si një mënyrë që kontribuon direkt në performancën e firmës.
- ✓ Në qoftë se do të krijohej me të vërtetë një portofol tregu sugjerohet që drejtuesit e portofoleve individuale ose institucionale të përdorin të dhënat e portofolit të tregut për të fiksuar një objektiv për shkallën e caktuar të riskut, për të përfituar më shumë nga parashikimi i tregut dhe lëvizjeve të tij dhe gjithashtu të përdoret si bazë krahasimi për performancat e portofoleve.
- ✓ Sugjerohet që investitorët dhe drejtuesit e ardhshëm të portofoleve në Shqipëri të orientohen drejt diversifikimit si një mënyrë efektive për të mbrojtur fitimet dhe ulur riskun.
- ✓ Një rekomandim është që të zhvillohen workshop-e të ndryshme të drejtuara nga institucionet e arsimit të lartë, kryesisht nëpërmjet fakulteteve ekonomike në të gjithë vendin. Këto mund të përgatiten nga studentët qoftë si projekte kursi, por edhe si veprimtari univesitare. Me besimin se studentët janë “arma” më e fortë që mund t'i përçojnë idetë për financën.
- ✓ Struktura e Indeksit S&P 500 ka njohur ndryshime vazhdimisht, disa firma janë hequr, disa të tjera janë bërë pjesë e indeksit, ka pasur ndryshime në peshën e secilës prej tyre, në peshat e sektorëve etj. Të njëjtën gjë rekomandohet edhe për portofolin e zgjedhur të

tregut që të bëhet objekt i ndryshimeve në rastet e domosdoshme, në varësi të lëvizjeve dhe tendencave të tregut.

- ✓ Qëllimi është që ky të mos mbetet thjesht një punim shkencor, por të shërbejë si një sugjerim për institucionet përkatëse për realizimin e një portofoli të tillë dhe zhvillim të tregjeve financiare që të bëjnë të mundur që vetë tregjet të financojnë ekonominë shqiptare.

REFERENCAT

- Banka e Shqipërisë (2017), Rezultatet e Ankandëve të Bonove të Thesarit. Marrë në Maj 2017 nga: https://www.bankofalbania.org/web/Rezultatet_e_Ankandëve_2015_1.php
- Boriçi A. *Cikël leksionesh: Statistika*, 76-103.
- Bundo Sh. 2016, *Teoria dhe Drejtimi i Portofolit*, 4^o. Tiranë, albPAPER
- Dragusha B., Kinka A. *Cikël leksionesh: Drejtim Financiar*.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (2017). Informacion i përgjithshëm mbi biznesin. Marrë në Mars 2017 nga: <https://www.tatime.gov.al/c/4/106/117/informacion-i-pergjithshem>
- Kraja Y., *Cikël Leksionesh*, Mikroekonomia, fq. 35
- Luçi E. & Kripa D. 2007 *Drejtimi i investimeve*, 1^o. Tiranë, PEGI
- Brown K., Brown G. *Does the composition of the market portfolio really matter*. Journal of Portfolio Management 13, (1987). Marrë në Mars 2017 nga: <https://faculty.mcombs.utexas.edu/keith.brown/Research/JPM-12.87.pdf>
- Doeswijk R., Lam T., Swinkels L. (2012) *Strategic Asset Allocation: The Global Multi-Asset Market Portfolio 1959-2011*. Marrë në Shkurt 2017 nga https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2170275
- INSTAT. (2015). *Regjistri statistikor i ndërmarrjeve*. Marrë në Mars 2017, nga: http://www.instat.gov.al/media/331402/regjistri_ndermarrjeve_2015.pdf
- INSTAT. (2016). *Llogaritë Kombëtare Vjetore, Metoda e Prodhimit*. Instituti i Statistikave
- Louis R., Roncalli Th. (2012) *On the Market Portfolio for Multi-Asset Classes*. Marrë në Mars 2017 nga <http://www.thierry-roncalli.com/download/Market-Portfolio.pdf>
- LYXOR Asset Management (2011). *Strategic Asset Allocation*. Marrë në Maj 2017 nga www.lyxor.com: http://www.lyxor.com/uploads/tx_bilyxornews/Strategic_Asset_Allocation.pdf
- MSCI (2010). *Is There a Link Between GDP Growth and Equity Returns?* Marrë Në Prill 2017 nga: <https://www.msci.com/documents/10199/a134c5d5-dca0-420d-875d-06adb948f578>
- Open.data.al (2017). *Shoqëri Biznesi* Marrë në Mars 2017 nga: <http://www.open.data.al/sq/corporates/list/>
- Qendra Kombëtare e Biznesit (2017). *Kërkime në Rregjistrin tregtar*. Marrë në Mars 2017 nga: <http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>
- S&P 500 Annual Total Return (2017). Marrë në Prill 2017 nga: https://ycharts.com/indicators/sandp_500_total_return_annual

- Unsystematic Risk (2017). Marrë në Prill 2017 nga:
<http://www.investopedia.com/terms/u/unsystematicrisk.asp>

ISSN 2411- 4960

*Doli nga shtypi dhjetor, 2017 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*